



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I TIRANES
FAKULTETI I DREJTESISE



Rruga "Mito TUTULANI", Tirana, ALBANIATel/Fax. + 355 4 222 537, <http://www.fd-ut.edu.al>

DISERTACION
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

**"RREGULLIMI JURIDIK I PERSONIT FIZIK
NË TË DREJTËN CIVILE"**

Kandidati
Amarildo LAÇI

Udhëheqësi shkencor
Prof. dr. Ardian NUNI

TIRANË 2018

© E drejta e autorit:

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjete apo forme pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

Ky punim shkencor është formatuar sipas kërkesave të Rregullores së Rektoratit “*Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave*”, miratuar në Mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës me vendimin nr. 20, datë 13.11.2008.

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie

Abstrakti

Hyrje

Metodologjia

Çështje të etikës

KAPITULLI I: PERSONI FIZIK

1. Konsiderata historike në lidhje me personin fizik
2. Personi fizik në të drejtën e vjetër shqiptare
3. Personi fizik sipas pjesës së përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955
4. Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1981

KAPITULLI II: ZOTËSIA JURIDIKE E PERSONIT FIZIK

1. Zotësia civile e personit fizik
2. Nocione të përgjithshme
3. Karakteristikat e zotësisë juridike
4. Lidhjet ndërmjet personalitetit juridik dhe aftësisë
5. Fillimi i zotësisë juridike tek personi fizik
6. Mbarimi i zotësisë juridike të personit fizik
7. Përmbytja e zotësisë juridike të personit fizik

KAPITULLI III: ZOTËSIA PËR TË VEPRUAR E PERSONIT FIZIK

1. Nocione hyrëse
2. Pazotësia për të vepruar
3. Zotësia e kufizuar për të vepruar
4. Zotësia e plotë për të vepruar

KAPITULLI IV: IDENTIFIKIMI I PERSONIT FIZIK

1. Konsiderata të përgjithshme
2. Emri
3. Mbiemri
4. Vendbanimi dhe vendqëndrimi
5. Vendqëndrimi

KAPITULLI V: GJENDJA CIVILE

1. Nociione dhe karakteristikat kryesore të gjendjes civile
2. Aktet e gjendjes civile
3. Regjistrimi i aktit të lindjes
4. Regjistrimi i aktit të martesës
5. Regjistrimi i aktit të vdekjes
6. Emri mbiemri dhe ndryshimi tyre
7. Heqja e kombësisë si element i gjendjes civile
8. Veprimet për fitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare
9. Funkzioni i akteve të gjendjes civile
10. Komisioni Ndërkombëtar i Gjendjes Civile

KAPITULLI VI: MBROJTJA E PERSONIT FIZIK NË TË DREJTËN CIVILE

1. Mbrojtja e të miturit
2. Përfaqësimi i të miturve
3. Fëmijët e paaftë
4. Vendosja e personit të pazot në kujdestari

KONKLUZIONE.....

REKOMANDIME.....

BIBLIOGRAFIA.....

PARATHËNIE

Punimi me temë “Rregullimi juridik i personit fizik në të drejtën civile” ka ardhur si rezultat i një studimi disa vjeçar i një literature të pasur vendase dhe të huaj në lidhje me personin fizik. Gjithashtu, edhe në këndvështrimin tim si magjistrat gjithmonë jam përpjekur që t’u jap përgjigje problemeve të shumta që kam hasur në lidhje me personin fizik. Personi fizik në vendin tonë është trajtuar në përgjithësi vetëm në kufijtë që e ka trajtuar Kodi Civil. Në këtë kontekst nuk është folur për kufizimin e zotësisë juridike e cila nuk duhet ngatërruar me kufizimin e zotësisë për të vepruar tek personi fizik.

Duke u nisur nga ideja, se kjo zotësi juridike është një kusht sine qua non e cilësisë të subjektit të së drejtës, mendoj se shprehja më e duhur do të ishte “zotësia subjektive”, e cila do t’i jepte identitetin e vërtetë dhe specifikën e duhur përmbajtjes të konceptit që përfaqëson. Megjithatë duhet të pranojmë se në legjislacione të ndryshme, doktrinë dhe jurisprudencë është imponuar shprehja “zotësi juridike” dhe përdorimi i një shprehje tjetër do të jetë një sfidë për të ardhmen, pasi i duhet të mposhtë një “traditë”.

Përsa i përket rregullimeve ligjore do të shohim që zotësia juridike trajtohet në të gjitha fushat të cilat janë burime të së drejtës civile. Në këtë mënyrë ajo është trajtuar në Kushtetutë, Kodin Civil, Kodin e Familjes, Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Procedurave Administrative. Ligji civil e ndalon rreptësisht heqjen dorë pjesërisht nga zotësia juridike dhe a fortiori, heqjen dorë totalisht, e cila do të njësohej me një vdekje të vërtetë civile të një qenieje njerëzore, duke e mbrojtur në këtë këndvështrim subjektin e së drejtës kundër të gjitha tentativave të tij vetjake të momentit dhe duke shmangur në këtë mënyrë një burim të mundshëm të skllavërisë moderne.

Ky disertacion fokusohet tek personi fizik, gjendja e tij juridike duke filluar që nga lindja dhe deri në vdekjen e tij. I gjithë punimi u jep përgjigje të gjitha pyetjeve në lidhje me zotësinë juridike, zotësinë për të vepruar, identifikimin, gjendjen civile dhe mbrojtjen e personit fizik.

Shpresoj se ky disertacion do të shënojë një kthesë në mënyrën sesi është trajtuar deri më sot personi fizik dhe shpresoj t’u shërbejë të gjithë të interesuarve si një referencë e sigurt.

Disertacioni u adresohet të gjithë lëvruesve të së drejtës pa përjashtim, pa lënë mënjanë studentët e drejtësisë dhe juristët e rinj.

Me shpresën të kem qenë sadopak i dobishëm, mbetem i hapur për çdo sugjerim, vërejtje e kritikë

AUTORI

Mirënjohje

Duke finalizuar këtë etapë të jetës time, dëshiroj që t'u adresoj disa falenderime e mirënjohje të gjithë atyre të cilët më kanë ndihmuar dhe më kanë mbështetur gjatë gjithë kohës të përgatitjes të këtij studimi.

Në radhë të parë dëshiroj të shpreh mirënjohjen e thellë për udhëheqësin tim shkencor, Prof. dr. Ardian Nuni për përzgjedhjen e kësaj teme, përcaktimin e strukturës, literaturën e rekomanduar, udhëzimet e vyera, mbështetjen dhe inkurajimin gjatë gjithë periudhës të punimit shkencor.

Gjithashtu dëshiroj që të falenderoj mikun dhe kolegun tim, Dr. Bledar Ilia, që në kohën kur së bashku jepnim mësim në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, Albanian University, më ka ndihmuar me një literaturë me shumë vlerë rreth personit fizik në të drejtën civile rumune.

Dëshiroj të theksoj faktin se, kam përfutuar shumë nga diskutimet rreth personit fizik dhe nga bashkëpunimi ynë shkencor ndër vite. Mirënjohje, gjithashtu edhe për kolegët e mi, profesorët e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Departamenti i së Drejtës Civile, për mbështetjen morale, udhëzimet shkencore, bisedimet tona të cilat më kanë frymëzuar shumë.

Falenderoj në mënyrë të veçantë bashkëshortes time, Ortesja, e cila më ka mbështetur shumë gjatë gjithë këtyre viteve të punimit tim, duke më krijuar hapësirën e nevojshme për të punuar dhe mbajtur vetëm të gjithë barrën e angazhimeve familjare dhe rritjen e dy yjeve tanë, Matea e Olten.

Mirënjohje, gjithashtu, për të gjithë kolegët e mi nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, të cilët më kanë ndihmuar në përzgjedhjen e jurisprudencës të trajtuar në këtë disertacion.

Abstrakt

Studimi i realizuar ka trajtuar personin fizik dhe identifikimin e tij në të gjitha raportet familjare, sociale dhe juridike. Në të drejtën moderne nocioni tekniko-juridik i personit fizik shpreh cilësinë e njeriut për të qenë subjekt i së drejtës civile, kurse ekzistenca e tij biologjike nuk është vetëm e nevojshme, por edhe e mjaftueshme për t'i dhënë atij mundësinë që të jetë subjekt i të drejtave dhe detyrimeve. Zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar e personit fizik është trajtuar duke iu referuar një analize të gjerë historike, krahasuese dhe analitike. Në kontekstin e tezës së doktoratës, personi fizik identifikohet me elementët e tij sikurse janë, emri, mbiemri, vendbanimi dhe gjendja civile. Janë trajtuar analitikisht të gjitha aktet e gjendjes civile dhe roli i organeve të gjendjes civile. Një rëndësi e veçantë i është dhënë edhe mbrojtjes të personit në të drejtën civile dhe sidomos mbrojtjes së të miturit. Personi fizik është trajtuar gjithashtu edhe nën këndvështrimin e raporteve familjare sikurse janë martesë, njohja e atësisë, lindja, vdekja, ndryshimi i emrit ose mbiemrit, birësimi etj.

Fusha e studimit: E Drejtë Civile

Fjalët kyçe: Person fizik, zotësi juridike, zotësi për të vepruar, identifikim, subjekt, veprim juridik, mbrojtje juridike, gjendje civile, legjislacion, birësim, kujdestari, vendim gjyqësor, deklarim.

Abstract

The study carried out has addressed the physical person and his identification in all family, social and legal reports. In the modern law, the technical-juridical notion of a physical person expresses the quality of a human being to be subject of the civil law, and his biological existence is not only necessary, but as well sufficient to give him the opportunity to be subject of the rights and obligations. Legal capacity and ability to act of a natural person is dealt with by referring to a broad historical, comparative and analytical analysis. In the context of the doctoral thesis, the physical person is identified with its elements as are, name, surname, place of residence and civil status. All civil status acts and rows of civil status bodies have been treated analytically. A great importance has also been given to protecting the person by the means of civil law and especially the protection of the minor. Physical person is also treated from the point of view of family relationships such as marriage, paternity recognition, birth, death, name or surname change, adoption, etc.

The field of study: Civil Law

Keywords: Physical person, legal capacity, capacity to act, identification, subject, legal action, legal protection, civil status, legislation, adoption, guardianship, court decision, declaration.

HYRJE

Nga përvoja historike e kuptimit të fjalës “person” përcaktojmë se njeriu është destinacioni i të gjitha të drejtave.¹ Në çdo stad të zhvillimit të shoqërisë, nocioni i personalitetit përfaqëson një koncept juridik i cili e ka burimin e tij nga vetë eksperiencia e jetës sociale dhe ndodhet vazhdimisht nën vlerësimin kolektiv. Afirmimi i personalitetit juridik në gjithë historinë e njerëzimit njeh dy drejtime të mëdha:

Drejtimi i parë lidhet me tendencën për të çliruar individualizmin e njeriut nga limitet e vendosura nga ana e komunitetit, qytetit ose dhe vetë kombit. Pra, është një përpjekje e çlirimit të ndërgjegjes individuale nga asimilimi i saj kolektiv. Është gjithashtu një fitim personaliteti nga ana e individit kundër personalitetit të imponuar nga grupi social, familjar ose politiko-fetar.

Drejtimi i dytë lidhet me përpjekjet që janë bërë për njohjen e dinjitetit njerëzor të çdo qenieje njerëzore dhe eliminimin e dallimeve ndërmjet individëve në raport me të drejtat e akorduara (dallime ndërmjet personave *sui iuris* dhe *alieni iuris*, ndërmjet njerëzve të lirë dhe të robëruar). Në të drejtën moderne nocioni tekniko-juridik i personit fizik shpreh cilësinë e njeriut për të qenë subjekt i së drejtës civile. Duhet t’u theksojmë se nocioni i personit fizik i përket *ab originem* të drejtës civile.² Megjithatë personi fizik përdoret edhe nga degë të tjera të së drejtës për të shprehur cilësinë e njeriut si subjekt në një të drejtë ose tjetrën. Disa degë të së drejtës përdorin edhe terma të veçantë për të shprehur këtë cilësi, sikurse hasim në të drejtën kushtetuese termin *shtetas*.³ Kjo është edhe arsyeja se përse “*personi fizik*” shoqërohet herë pas here me shtesën “*si subjekt i së drejtës civile*”.

Nga ana tjetër, doktrina ka dhënë disa përkufizime të zotësisë për të vepruar të cilat ndryshojnë pjesërisht sa nga një autor tek tjetri. Autorët e së drejtës janë të opinionit që përkufizimi i zotësisë për të vepruar, duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementët e mëposhtëm: a) lidhja që duhet të ketë kjo lloj zotësie me zotësinë civile të vetë njeriut; b) kryerjen e veprimeve juridike civile dhe jo kryerjen e veprimeve juridike që u përkasin degëve të tjera të së drejtës; c) kryerja e veprimeve juridike nuk parashikon vetëm ushtrimin e të drejtave dhe marrjen përsipër të detyrimeve civile, por edhe fitimin e të drejtave subjektive civile sikurse edhe ekzekutimin e detyrimeve civile⁴.

Duke u nisur nga këto elemente, zotësia për të vepruar është ajo pjesë e zotësisë civile të njeriut, e cila konsiston në aftësinë e këtij të fundit, për të fituar dhe ushtruar të

¹ Dogaru Ion, Cercel Sevastian, *Drept civil, Persoanele*, Editura C.H. Beck, București, 2007, f. 12

² Dogaru Ion, Draghici Pompil, *Bazele dreptului civil, Vol. III, Teoria generală a obligatilor*, Editura C.H. Beck, București, 2009, f. 35

³ Boroi Gabriel, *Drept civil, Partea generală, persoanele*, Editura Hamangiu, București, 2010, f. 81

⁴ Urs I., Angheni S., *Drept civil. Partea generală. Persoanele*, vol. I, Ed. Oscar Print, București 1999, f. 124

drejtat civile sikurse edhe për të ekzekutuar detyrimet civile nëpërmjet veprimeve juridike⁵. Zotësia për të vepruar, në literaturën juridike emërtohet edhe me termin zotësi vepruese, kurse në disa raste përdoret edhe termi zotësia punuese⁶. Zotësia vepruese nënkupton, aftësinë dhe mundësinë e një personi fizik, që ai me deklarin e tij të lirë të mund të shkaktojë pasoja juridike në krijimin, ndryshimin, mbartjen ose shuarjen e të drejtave subjektive civile. Ky është përkufizimi i gjerë për zotësinë për të vepruar.

Zotësia për të vepruar është e lidhur ngushtë me zotësinë juridike. Kjo gjë ndodh për shkakun se personi fizik nuk mund të ketë zotësi për të vepruar, në qoftë se nuk ka zotësi juridike. E kundërta është e mundshme. Kjo do të thotë se një person mund të ketë zotësi juridike, por mund të mos ketë zotësi për të vepruar. Për të kuptuar lidhjen ndërmjet zotësisë juridike dhe zotësisë për të vepruar të personit fizik, duhet t'u referohemi karakteristikave të burimeve të të drejtave subjektive civile. Nga analiza e zotësisë juridike të personit fizik përcaktuar se kjo zotësi shpreh: "*cilësinë e subjektit të së drejtës civile*" duke qenë një cilësi e pandashme e njeriut pavarësisht moshës. Kjo zotësi juridike, fillon me lindjen e njeriut madje në disa raste që në momentin e zënies, domethënë shumë kohë më parë lindjes. Hyrja në marrëdhëniet juridike e njeriut, mund të bëhet me anën e fakteve juridike ose nëpërmjet kryerjes të veprimeve juridike⁷. Fakt quhet çdo sjellje e njeriut, ngjarje shoqërore ose fenomen i natyrës, të cilit ligji i ngarkon një pasojë juridike⁸.

Të identifikosh një person fizik do të thotë që t'i konstatosh identitetin dhe t'a individualizosh në një shoqëri të caktuar dhe në tërësinë e marrëdhënieve shoqërore në të cilat ai përfshihet. Njeriu ka të drejtën që të jetë subjekt në shumë degë të së drejtës. Në këtë mënyrë me identifikim të personit fizik do të kuptojmë individualizimin e këtij të fundit, pra përcaktimi i koordinatave të pozicionit të tij, përcaktimi i identitetit në jetën juridike⁹. Për të drejtën civile, identifikimi i personit fizik do të thotë individualizimi i njeriut në raportet e së drejtës civile, në të cilat ai merr pjesë, në cilësinë e subjektit aktiv ose pasiv. Është e kuptueshme që individualizimi i njeriut nuk realizohet vetëm në raportet e së drejtës civile, por edhe në të gjitha raportet e tjera juridike, në të cilat ai shfaqet si titullar të drejtash dhe detyrimesh. Si rrjedhim, në cilësinë e institutit juridik, domethënë si totali i normave të cilat individualizojnë njeriun në të gjitha raportet juridike në të cilat ai është pjesëmarrës, identifikimi i personit fizik është një institut juridik kompleks.

Të gjitha dispozitat ligjore parashikojnë mënyrën sesi vendoset dhe ndryshohet emri, por asnjëra prej tyre nuk parashikon përkufizimin e emrit. Doktrina ka nënvizuar se emri është "*thirrja që shërben për të përkufizuar në mënyrë grafike dhe orale personat*". Në një këndvështrim më të gjerë emri përbëhet nga disa elementë. Në këtë aspekt mund të themi se vetë emri është shuma e fjalëve që shërben për të individualizuar një person

⁵ Gh Beileu, *Drept civil, Persoanele*, 1982, f. 104-105

⁶ Kadriu Osman, *Hyrje në të drejtën civile*, Shkup, 2008, f. 175

⁷ Dogaru Ion, Danisor D.C., Popa Nicolae, Cercel Sevastian, *Bazele dreptului civil*, Vol. I, Teoria generală, Editura C.H. Beck, București, 2008, f. 576

⁸ Neni 7 i Kodit të Procedurës Civile

⁹ Dogaru Ion, Cercel Sevastian, *Drept civil, Persoanele*, Editura C.H. Beck, București, 2007, fq 108

fizik nëpërmjet të folurës ose të shkruarit¹⁰. Në këtë mënyrë është krijuar opinioni doktrinar se, emri është ai atribut i identifikimit të personit fizik i cili i jep të drejtën njeriut që të individualizohet në gjirin e familjes dhe të shoqërisë, gjithmonë sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Emri në këtë mënyrë shërben për afirmimin e personit në jetën juridike dhe sociale. Personi fizik i cili identifikohet nëpërmjet emrit ka të drejtën që të ushtrojë të gjitha të drejtat dhe të përfitojë të gjitha të mirat dhe në këtë mënyrë, emri është një element esencial i personalitetit të personit¹¹.

Mbiemri është, së fundmi, një element i personalitetit. Ai identifikon personin. Për çdo person, mbiemri familjar është “një emër i përveçëm”. Nuk është vetëm një përkatësi familjare, por një individualitet që bëhet i dukshëm. Në fillim, dukej se emri thjesht i mbivendosej personalitetit, por pak nga pak ai u bë pjesë integruese, identifikuese e tij, derisa u kthye në mbështetjen e elementeve të tjera të gjendjes civile, pika e referimit e identitetit të personit, qendra e vetëvlerësimit dhe e nderit.

Identifikimi i personit në hapësirë realizohet nëpërmjet vendbanimit¹². Kuptimi juridik i vendbanimit nuk është ai kuptim me të cilin jemi mësuar për vetë faktin se kuptimi juridik për vendbanimin është një kuptim fiktiv nga njëra anë dhe nuk duhet ngatërruar me vendqëndrimin ose banesën e një personi nga ana tjetër. Nën këndvështrimin etimologjik, fjala vendbanim e ka origjinën nga latinishtja *domum colere* që do të thotë “banesa në të cilën banon dikush” dhe për t’i dhënë kuptimin e plotë këtij fakti përdoret edhe shprehja latine *nemo de domo suo extrahi debet* (shtëpia ku banon dikush dhe nuk mund të dëbohet prej saj në kundërshtim me ligjin). Gjithsesi duhet që të kemi parasysh *ab initio* që jo çdo lloj banese që i përket një personi ka kuptimin juridik të vendbanimit, sepse nocioni i vendbanimit nuk varet nga e drejta e pronësisë mbi një shtëpi, e cila përdoret si hapësirë banimi.

Gjendja civile është tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj, si dhe të personave pa shtetësi, që janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre¹³.

Regjistri Kombëtar është dokumenti unik shtetëror, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile për çdo shtetas shqiptar, shtetas të huaj, person pa shtetësi si dhe për personat, të cilët kanë fituar statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes plotësuese, për faktet juridike, të cilat kanë ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në Regjistrin Kombëtar transkriptohen të dhënat për shtetasit shqiptarë sipas akteve të zyrave të gjendjes civile të vendeve të huaja. Pasqyrimi i këtyre akteve bëhet kronologjikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile janë kryer verifikimet e nevojshme për përputhshmërinë e të dhënave në dokumentacionin e administruar me ato të shërbimit të gjendjes civile.

¹⁰ Alexandresco, D., *Explicatiunea teoretică și practică a dreptului civil român. Partea I. Donațiunile între vii*, tomul IV, București, 1913, f. 256

¹¹ Fr. Terre, D. Fenouillet, *Droit Civil. Les personnes. La famille. Les incapacité*, Dalloz, Paris, 1996, f. 127

¹² Dogaru Ion, Cercel Sevastian, *Drept civil, Persoanele*, Editura C.H. Beck, București, 2007, f. 158

¹³Neni 2 i ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile"

Administrimi i Regjistrit Kombëtar bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Përditësimi i të dhënave të regjistrit bëhet nga nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në zyrat e gjendjes civile në bashki. Veprimet në Regjistrin Kombëtar dhe në aktet e gjendjes civile bëhen me anë të teknikave informatike. Mënyra e ngritjes së Regjistrit Kombëtar dhe rregullat për shfrytëzimin e teknologjisë informatike që do të përdoren për këtë regjistër, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Veprimet në Regjistrin Kombëtar kryhen vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe nga nëpunësi në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji¹⁴.

Në përgjithësi mund të themi se e drejta ka në qendrën e vëmendjes të saj mbrojtjen e njeriut dhe çdo degë e saj rregullon në mënyrë ligjore mbrojtjen e veçantë të tij. Tërësia e këtyre normave përbëjnë atë që quhet sistemi i mjeteve të mbrojtjes së njeriut, e cila hipotetikisht përbëhet nga mjete juridike të degëve të së drejtës kushtetuese, administrative, civile, tregtare, të punës, penale, procedurës civile dhe penale, ndërkombëtare (private dhe publike), familjes etj.¹⁵ Në të drejtën civile mbrojtja specifike juridike nuk u dedikohet të gjithë personave, por ajo është e destinuar vetëm për një kategori të caktuar personash.

¹⁴ Ibidem, neni 34

¹⁵ Nedelcu I., *Drept administrativ*, Editura Themis, Craiova 2000, f. 189

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Motivimi për zgjedhjen e kësaj teme ka një lidhje të ngushtë me vetë rëndësinë që paraqet studimi i personit fizik. Në qoftë se do t'i referohemi perspektivës dhe analizës juridike do të realizojmë se personi fizik është dhe do të jetë objekt studimi dhe interpretimi në studimet e shumë autorëve. Në vendin tonë, personi fizik është trajtuar shumë pak dhe ky ka qenë një tjetër motiv, i cili ka shërbyer si një shtysë për t'u thelluar në studimin tim dhe për të evidentuar të dhëna shumë interesante dhe premtuese për personin fizik të cilat do t'i shërbejnë edhe legjislacionit shqiptar.

Në qoftë se do t'u referohem edhe kërkimeve shkencore të mëparshme për personin fizik në vendin tonë mund të pohoj se ato janë shumë të pakta dhe manifestohet ndër vite një indiferencë në lidhje me trajtimin e personit fizik. Të gjitha këto studime nuk arrijnë që të kapërcejnë kufijtë e kodit civil dhe të familjes, brenda të cilëve është trajtuar personi fizik.

Për realizimin e këtij punimi, kam kryer fillimisht një studim të detajuar ndër vite të doktrinës dhe legjislacionit shqiptar në lidhje me personin fizik. Në një fazë të dytë kam kontribuar me disa ide novatore, të cilat do të japin disa zgjidhje juridike shumë të vlefshme për personin fizik. Gjithashtu kam treguar kujdes që të pasqyroj edhe një analizë krahasuese me legjislacionet e vendeve të Evropës. Jam fokusuar tek legjislacioni i Rumanisë dhe Francës duke analizuar qasjet e këtyre legjislacioneve rreth personit fizik.

Fillimisht për sa i përket studimit tim, u përgatit struktura e tij dhe më vonë u krijua një plan i detajuar kërkimesh, identifikimesh dhe gjetjesh kryesore. E gjithë literatura e studiuar është mjaft e pasur dhe kryesisht bazohet në atë të huaj shumëgjuhëshe dhe vendase. Nuk mungojnë gjithashtu edhe legjislacionet, marrëveshjet ndërkombëtare, jurisprudenca sikurse edhe burimet nga interneti.

Metoda e kërkimit që kam ndjekur bazohet kryesisht në interpretim, i cili ka si qëllim final, prodhimin e efekteve juridike në jetën e personit fizik sikurse edhe realizimin e qëllimeve të tij. Për arritjen e objektivave të propozuara, kam përdorur interpretimin gramatikor, ekzaminimin e gjenezës historike, qëllimet e ligjvënësit, etj. Në të njëjtën kohë një rëndësi të madhe ka pasur edhe analiza e krahasimit të të drejtave civile duke përdorur metodat krahasuese të legjislacioneve, jurisprudencës dhe doktrinave të vendeve të huaja, të cilat kanë shërbyer si një model frymëzimi për ligjvënësin shqiptar.

Si përfundim shpreh besimin se punimi në fjalë përbën një risi në fushën e së drejtës civile në përgjithësi dhe për personin fizik në veçanti. Ky disertacion rikualifikon juridikisht personin fizik duke i dhënë dimensione të tjera të panjohura për publikun vendas, të cilat nuk janë trajtuar më parë nga asnjë autor. Uroj që ky kontribut shkencor, të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë ata, të cilët dëshirojnë që të thellojnë njohuritë e tyre rreth personit fizik dhe atributeve të tij.

Çështje të etikës

Gjatë hartimit të këtij punimi jam treguar korrekt me literaturën dhe citimet e përdorura. Në të gjitha rastet janë respektuar të drejtat e autorit

KAPITULLI I

PERSONI FIZIK

1. Konsiderata historike në lidhje me personin fizik

1.1 Personi fizik në të drejtën romake

1.1.1 Omnes homines aut liberi sunt aut servi

Sipas Justinianit *omne autem ius quo utimur vel ad personas pertinent vel ad res vel ad actiones*, e gjithë e drejta që njohim i referohet personave fizikë, sendeve ose veprimeve të personave, sepse çdo e drejtë krijohet në favor të njerëzve. Për të përftuar një të drejtë sa më të dobishme, është mjaft e rëndësishme që më parë të analizojmë statusin e personave, të cilët duhet të përfitojnë nga kjo e drejtë.

Klasifikimi kryesor në lidhje me të drejtat e personave i referohet faktit që të gjithë personat ishin të lirë ose skllavër (*omnes homines aut liberi sunt aut servi*). Në atë kohë afirmohej se liria “është zotësia natyrore e njeriut për të realizuar atë që dëshiron me përjashtim të rasteve, kur një forcë e caktuar ose ligji e ndalon”, kurse skllavëria “është një gjendje në të cilën personi është i detyruar t’i nënshtrohet, në kundërshtim me ligjet e natyrës, pushtetit të tjetrit”¹. Për të promovuar idenë si “subjekt i të drejtës dhe detyrimeve civile”, në të drejtën romake, përdorej termi *caput* (kokë/krye), duke iu referuar kështu pjesës më të rëndësishme të trupit të njeriut për një individ në të gjitha aktivitetet e tij. Nga ky term, mesa duket, e ka origjinën edhe fjala moderne zotësi/kapacitet².

Nga ana tjetër, fjala *persona* (*per sonare*), fillimisht, do të thotë *masca* (*personatus*-i maskuar), term i cili përdorej si nga romakët, ashtu edhe nga grekët. Aktori i maskuar luante rolin e tij në skenë. Kuptimi juridik i fituar post-persona nuk përjashton simbolin e mëparshëm, por përkundrazi nxjerr në dukje rolin social të njeriut, zotësinë juridike, e cila mëshirohet nëpërmjet faktit se njeriu luan një rol në jetën juridike.

1.1.2 Gjendja juridike e skllavërve

¹ “*Libertas est naturalis facultate ius quod cuique facere libert, nisi si quid vi aut iure prohibetur. Servus est constitution iuris gentium, qua quis dominio alieno contra naturam subicitur.*” Cituar nga Sambrian, Teodor, *Iustiniani Digesta, Liber Primus*, Editura Universitaria, Krajovë, 2002, f. 100.

² Hanga, Vladimir, *Drept privat roman*, E.D.P., Bukuresht, 1978, f.158-160.

Në shoqërinë romake e drejta për të pasur të drejta dhe detyrime nuk u njihej të gjithë njerëzve. Në këtë kontekst, skllëverit nuk fitonin zotësinë juridike nga momenti i lindjes për vetë faktin se ata nuk konsideroheshin persona, por bënë pjesë tek kategoria e sendeve (*res*). Skllëverit emërtoheshin ndryshe edhe si instrumente pune zanorë (*instrumenta vocalia*), duke u privuar në këtë mënyrë nga një jetë juridike. Sipas të drejtës civile, shndërroheshin në skllëvër të gjithë ata që kapeshin robër nga armiqtë ose të gjithë fëmijët të lindur nga nëna skllave³. Ekzistonin gjithashtu disa njerëz të lirë me një gjendje juridike speciale (*quasi servi*), sikurse ishte situata e debitorit i cili ka pranuar huanë përpara magjistratit (*confessus in iure*) ose ka qenë i dënuar nga magjistrati (*indicatus*) që të paguajë një shumë të hollash.

Në rastin kur debitori nuk arrinte që të shlyente borxhin brenda 30 ditëve, atëherë ai mund të sillej *ob torto colo* përpara magjistratit, i cili do t'i caktonte masën e dënimit në prani të kreditorit. Debitori do të lidhej nga duart dhe këmbët (*nervo aut compedibus*) dhe do të mbahej për 60 ditë në qeli. Në këtë interval kohe, ai duhej të paraqitej 3 herë përpara magjistratit, i cili do t'i rikujtonte shumën e borxhit për të cilën ishte dënuar. Në qoftë se asnjë njeri nuk paguante borxhin e debitorit, atëherë kreditori kishte të drejtën t'a vriste ose t'a shiste si skllav. Ky sanksion, më vonë, do të zëvendësohej me shitjen e të gjithë pasurisë të debitorit nëpërmjet *vendictio bonorum*.

Zënia rob ishte forma më e përhapur e transformimit të njeriut të lirë në skllav. Ekzistonte rregull që i kapuri rob bëhej skllavi i personit, i cili e kishte mundur në luftë. Ky rregull nuk gjente zbatim për robërit e kapur nga piratët ose të kapur në një luftë civile. Në atë kohë këta të fundit gëzonin “të drejtën e rikthimit” (*ius postliminii*). I kthyeri në atdhe rifitonte të gjitha të drejtat e mëparshme. Ai konsiderohej sikur nuk ishte kapur rob asnjëherë dhe si rrjedhojë që nuk kishte qenë kurrë rob⁴.

Në epokën e perandorisë, mbrojtja juridike e skllëvërve u ngrit në një nivel më të përparuar. Në këtë mënyrë pronari mund t'i ngarkonte skllavit detyra për të drejtuar një biznes tregtar ose për të zhvilluar për një kohë më të gjatë një biznes tokësor ose detar. Në këtë kontekst skllavi ishte i detyruar që, në emër dhe për interes të pronarit, të lidhte kontrata të ndryshme. Gjithashtu pronari kishte të drejtën që t'i jepte skllavit për administrim sende, të holla dhe, në këtë mënyrë, vetë skllavi nënshkruante akte juridike të ndryshme.

Përpjekja e parë e mbrojtjes fizike të skllavit u realizua me ndihmën e ligjit *Lex Petronia Servis*, i propozuar nga ana e konsullit Publius Petronius Turpilianus në vitin 61 pas Krishtit. Sipas këtij ligji, të gjithë pronarët nuk kishin të drejtën që të jepnin skllëverit si “prehë për kafshët e egra në lojërat e cirkut”, pa pëlqimin paraprak të magjistratit. Perandori Claudius, në vitet 41-51 pas Krishtit, vendosi që t'i heqë të drejtën e pronësisë mbi skllavin, pronarit, i cili braktis një skllav të moshuar ose të sëmurë.

³ Dogaru Ion. Cercel Sevastian, *Drept civil, Persoanele*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2007, f. 4.

⁴ Në të drejtën romake, shtetasi i cili nuk paraqitej për të kryer shërbimin ushtarak në momentin e thirrjes të Servus Tullius, mund të shitej nga populli romak si skllav (*jam populus, cum eum vendidit qui miles factus non est*).

Antonius Pius në vitet 138-161 pas Krishtit miratoi dy kushtetuta, të cilat u ndalonin kategorikisht pronarëve vrasjen e skllavëve pa motiv dhe i detyronte gjithashtu pronarët mizorë që të shisnin skllavërit, të cilët keqtrajtoheshin. Në fund, perandori Konstandin i dënonte pronarët të cilët braktisnin skllavërit e porsalindur, duke humbur të drejtën e pronësisë mbi këta të fundit. Të gjitha masat e mësipërme kishin si qëllim mbrojtjen e interesit të shtetit në mënyrë që skllavërit të mos ishin objekt i trajtimit dhe përdorimit arbitrar.

Për shkak të kushteve shumë të këqija të shfrytëzimit, skllavërit janë ngritur shumë herë në kryengritje me në krye Herdonius, kryengritje të cilat janë shtypur gjithmonë me anë të forcës. Për të evituar dhe minimizuar kryengritjet e padëshiruara, u aplikuan vazhdimisht një mori masash në favor të skllavëve. Justiniani do të pohonte se “është në interes të shtetit që asnjë njeri të mos keqpërdorë pronën e tij” (*expedit enim rei publicae, ne quis re sua male utatur*)⁵.

1.1.3 Kushtet e personalitetit

Një personalitet i plotë në të drejtën romake bazohej mbi shumën e tre elementëve: liria (*status libertatis*), shtetësia (*status civitatis*) dhe cilësia e “Kryetarit” të familjes agnatike ose të paktën anëtar i kësaj familje (*status familiae*). Si fillim, gjendja e lirisë fitohet menjëherë me lindjen ose pas lindjes, duke u respektuar në këtë mënyrë rregull që “fëmija i lindur nga prindër të lirë është i lirë”, por në rastet kur njëri nga prindërit është skllav, fëmija fiton statusin e nënës. Në qoftë se nëna është skllave në momentin e lindjes, por në kohën e shtatzënies ka pasur cilësinë e gruas të lirë, atëherë fëmija i lindur konsiderohet i lirë. Pas lindjes, liria mund të fitohet edhe nëpërmjet lirimit nga robëria (skllavi, i cili për një periudhë prej 20 vitesh sillet me mirëbesim si një njeri i lirë, kthehet në njeri të lirë).

Vetëm qytetarët romakë gëzonin të gjitha të drejtat politike (*ius suffragi, ius honorum, ius militiae*) dhe të drejtat civile romake (*ius connubii, ius commercii*). Formula “*civis romanus sum*”, shërbeu si një nyje mbrojtëse për të gjithë qytetarët romakë të denjë dhe të lirë. Të huajt (*peregrini*) gëzonin në raport me qytetarët romakë disa të drejta civile dhe garanci politike, duke u konsideruar në këtë mënyrë të zotë sipas *ius gentium* (popujt të cilët nuk kanë nënshkruar traktate me Romën, *barbarët*, nuk kishin asnjë të drejtë). Si rregull, shtetësia fitohej me lindje dhe në këtë mënyrë fëmijët e shtetasve romakë gëzojnë këtë shtetësi. Në rastin kur njëri nga prindërit ishte i huaj, atëherë edhe fëmija ishte i huaj (*ligji Menicia*), por gradualisht u vendos që i sapolinduri konsiderohet shtetas, në qoftë se nëna e tij ka shtetësi romake në momentin kur lind fëmijën.

Me përjashtim të kriterit të lindjes, shtetësia fitohej edhe nëpërmjet lirimit nga robëria. Skllavi në momentin e fitimit të lirisë fitonte edhe shtetësinë, duke përfitur nga ndonjë favor personal ose kolektiv⁶. Shtetësia i hiqej shtetasit romak, i cili ka humbur lirinë, në rastet e heqjes dorë, por edhe kur shtetasi romak ishte i dënuar penalisht, sikurse është rasti i dënimit me punë të detyrueshme.

⁵ Dogaru, Ion. Dan Claudiu, Dănișor. Popa, Nicolae. Cercel, Sevastian. *vepër e cituar (op. cit.)* f. 503.

⁶ Në vitin 212 pas Krishtit, perandori Caracalla, i njohur zyrtarisht si Antonius, i akordoi, me disa përjashtime, shtetësinë romake të gjithë banorëve të Perandorisë Romake.

Së fundmi, përsa i përket *status familiae*, familja romake bazohej mbi pushtetin e një njeriu të vetëm, i cili ishte edhe kryetari i familjes (*pater familias*). Kryetari i familjes ishte i vetmi person i pavarur i familjes (*sui iuris*) dhe gjithë të tjerët, sikurse janë bashkëshortja dhe fëmijët, ndodhen nën pushtetin e tij (*alieni iuris*). Shefi i familjes është “ai që ka pushtetin në shtëpi”, do të shprehej Ulpiani (*pater familias appellatur qui in domo dominum habet*), pushtet i cili i ka rrënjët në traditë dhe është i bekuar nga ligji⁷. Pushteti i shefit të familjes është qysh nga fillimi një pushtet absolut, duke përfshirë edhe *Ius vitae necisque*. Megjithatë, ai njeh edhe disa kufizime. Aftësia për të pasur të drejta dhe detyrime në të drejtën romake i dedikohet faktit se gruaja konsiderohej e paaftë.

Në qoftë se do t'i referohemi të sëmurëve me të meta mendore ose atyre personave të cilët nuk kanë eksperiencë për shkak të moshës, do të kuptojmë arsyen se, përse romakët mendonin se vetëm burrat e shëndoshë mendërisht dhe të cilët kanë një moshë të caktuar duhet të gëzonin zotësi të plotë juridike.

1.1.4 Fillimi dhe mbarimi i personalitetit

Personaliteti fillon në momentin e lindjes dhe mbaron në momentin e vdekjes. Romakët kishin përcaktuar një rregull sipas të cilit “fëmija i ngjizur konsiderohet si i lindur aq herë sa e kërkon interesi i tij”—*infans conceptus pro iam nato habetur, quotiens de eius commodis agitur*. Gjithsesi vendoset kushti që i sapolinduri “të jetë i gjallë dhe të ketë një pamje humane”. Rëndësi të madhe paraqet fakti se, përfaqësuesit e shkollës prokuliane kërkonin që i sapolinduri të nxjerrë gjatë lindjes “një të qarë”, kurse ata të shkollës sabiniane kërkonin që i sapolinduri të manifestonte shenja jete. Opinioni i këtyre autorëve u adoptua edhe në të drejtën e Justinianit.

Përcaktimi i momentit të lindjes është mjaft i rëndësishëm për personalitetin juridik. Duke filluar me epokën e Augustit u shfaqën regjistrat, në të cilat hidheshin të dhënat e fëmijëve të lindur dhe prindërit ishin të detyruar që brenda 30 ditëve të regjistronin fëmijët dhe t'i vendosnin atij një emër.

Personaliteti mbaron njëherësh me vdekjen fizike ose nëpërmjet vdekjes civile (*morti coaequatur*). Në konceptin romak, liria, shtetësia dhe të drejtat familjare formojnë një ansambël unik dhe jetik për ekzistencën e personalitetit juridik dhe mungesa e një prej këtyre elementëve do të dëmtonte personin⁸.

Në këtë mënyrë, humbja e lirisë shkakton një *capitis deminutio maxima*; humbja e shtetësisë shkakton një *capitis deminutio media* dhe humbja e të drejtave familjare shkakton *capitis deminutio minima*. Vdekja civile eliminon personalitetin juridik të personit respektiv, por nuk arrin që të eliminojë edhe vdekjen biologjike, pasi personi i cili ka pësuar një *capitis deminutio minima* e vazhdon ekzistencën e tij në kufijtë e së drejtës natyrore. Sipas Ulpianit asnjë nuk mund të privohet nga të drejtat e tij edhe pse ka pësuar një *capitis deminutio*.

⁷ Në fillim, ky pushtet personifikohej nëpërmjet fjalës *manus* (dorë) dhe gradualisht u reflektua tek pushteti mbi bashkëshorten e martuar me *manus nuptiae cum manus*). Ekzistonin tre mënyra të fitimit të pushtetit martesor: *confarreatio*, *usus*, *coemptio*; martesa *sine manus* nuk nënshtronte gruan nën pushtetin e burrit, duke qenë në këtë mënyrë *sui iuris* (e pavarur). Pushteti mbi fëmijët emërtohet *patria potestas* dhe ai mbi skllëvërit *dominica potestas*, sepse *dominium* (zotërim) do të thotë e drejta e pronës mbi sendet e tjera.

⁸ Dogaru, Ion. Dan Claudiu, Dănișor. Popa, Nicolae. Cercel, Sevastian; op. cit., f. 505.

Çdo njeri fiton personalitet juridik me ardhjen në jetë. Personaliteti juridik është një dhuratë nga lindja, një e drejtë e lindur, një e mirë burimore. Çdo njeri lind si subjekt i të drejtës. Nuk ka qenë gjithmonë kështu, por për të gjetur përjashtime duhet të kthehemi pas në kohën e skllavërisë, ku disa njerëz nuk konsideroheshin si persona, por si sende, elemente të pasurisë së pronarëve të tyre.

2. Personi fizik në të drejtën e vjetër shqiptare

2.1 Kodi Civil i Zogut i vitit 1928

Fjala “person” nuk ekzistonte në burimet e së drejtës në mesjetë dhe ideja e mbajtësit të të drejtave dhe detyrimeve mishërohej nëpërmjet fjalës “njeri”. Në vendin tonë, për shkak të pushtimeve të ndryshme, situata politike dhe ekonomike kanë ndryshuar vazhdimisht. Këto ndryshime kanë influencuar padyshim situatën juridike dhe legjislative.

Deri në vitin 1912 në vendin tonë dominonte e drejta zakonore (*kamunet* respektivë që vepronin në krahinat e ndryshme) dhe e drejta osmane (*sheriati*). Këto dy të drejta, me kalimin e kohës, u transformuan në të drejtën shtetërore e cila, kishte një karakter të përgjithshëm dhe detyrues. Një nga momentet më të rëndësishme të evolucionit legjislativ ishte Kodi Civil i Zogut, i cili u frymëzua kryesisht nga Kodi Civil Francez i Napoleonit, Kodi Civil Italian dhe Kodi Civil Zvicerian.

Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, hyri në fuqi më 1 prill të vitit 1929 dhe përbëhej nga disa dispozita hyrëse, sikurse edhe katër libra:

- Personat dhe familja*;
- Dispozita “Mbi trashëgiminë ligjore dhe testamentare”*;
- Dispozita “Mbi sendet, zotërimin dhe mbi modifikimin e tij”*;
- Dispozita “Mbi mënyrat e fitimit dhe të transferimit të pronësisë, si edhe të drejtave mbi sendet”*.

Në Kodin Civil të Zogut të vitit 1928, në nenin 1 të tij, thuhet shprehimisht se: “Çdo shtetas gëzon të drejtat civile, kur nuk asht rrëzue nga ato me një dënim ndëshkimuer”, e cila nënkuptonte se gëzonin të drejtat civile të gjithë ata persona, të cilët nuk kanë marrë asnjë masë ndëshkimore. Këtë parim e shohim të konsakruar edhe në Nenin 195 të Statuti Themeltar të Mbretërisë Shqiptare.

2.2 Personaliteti juridik

Në librin e parë “Personat dhe familja” janë trajtuar fillimisht disa nocione të përgjithshme. *Kështu për personin jepen përkufizimi se, quhet subjekti real ose fiktiv, i zoti të ketë të drejta dhe detyra.*

Personat fizikë kanë një emër, kanë zotësi dhe mund të kenë pasuri dhe banesë. Personaliteti ekziston qysh në minutën që e lemja (*lindja*) është e plotë⁹. Deri në atë

⁹ Tsitso, Niko. “Elementa të së drejtës të personave dhe të familjes”, Shtypëshkronja “Dhori Koti”, Korçë, 1933, f. 27.

moment, njeriu nuk ka fituar jetën e vet, por konsiderohet si pjesë e nënës, *pars viscerum matris*. Megjithatë ekziston një përjashtim, sipas të cilit foshnja e zënë, por e palindur konsiderohet si e lindur, për aq kohë sa interesi i saj e kërkon këtë. Në këtë rast fëmija fitonte zotësinë juridike përfundimisht vetëm në momentin kur lindte e gjallë dhe jetonte.

Gjithashtu, fëmija i zënë, për të përfituar zotësinë juridike, duhet të plotësonte këto dy kushte:

a) Fëmija duhet të lindë i gjallë;

Në rastet kur fëmija lind i vdekur, atëherë nuk konsiderohej si person edhe në qoftë se vdekja ka ndodhur në momentin e lindjes, pa marrë parasysh në këtë mënyrë faktin se fëmija mund të kishte jetuar brenda barkut të nënës.

b) Fëmija duhet të lindë i jetueshëm;

Fjala “i jetueshëm” do të thotë i zoti për të jetuar (*vitae habilis*). Nuk u njihej personaliteti juridik fëmijëve të formuar normalisht që lindin para afatit fiziologjik dhe zhvillimi i organeve të tyre nuk ishte dhe aq i plotë sa të arrijnë të mbijetojnë. Gjithashtu, nuk u njihej personaliteti juridik të gjithë fëmijëve të cilët kishin lindur pa krye, pa zemër, të cilët vdesin me t’u këputur kordoni umbelikal nga kërthiza e tyre.

Ligji gjithashtu ka parashikuar një prezumim, nëpërmjet të cilit “*kur ka dyshim mbi jetueshmërinë, prezumohen të jetueshëm ata për të cilët konstatohet se kanë lindur të gjallë*”¹⁰.

Ligji nuk u refuzon personalitetin juridik njerëzve të lindur me deformime natyrore ose me sëmundje intelektuale. Personaliteti, domethënë zotësia juridike humbet bashkë me jetën. Vdekja është një fakt real, por nga ky fakt shumë herë lindin të drejta, sidomos për çështje trashëgimie, kur kjo e drejtë varet nga prova e prioritetit të vdekjes, domethënë nëse A ka vdekur më parë se B.

Këtë çështje e ka zgjidhur neni 652 i Kodit Civil të Zogut me dispozita, të cilat specifikojnë se: “*Në qoftë se midis dy ose më shumë personave që thirren respektivisht për të trashëguar njëri-tjetrit dhe ekzistojnë dyshime se cili person ka vdekur më parë, u lind e drejta që më parë të provojnë vdekjen e njërit ose të tjetrit. Në mungesë provash, prezumohet se ata kanë vdekur në të njëjtën kohë dhe në këtë mënyrë nuk transmetohet asnjë e drejtë nga njëri tek tjetri*”.

Është më se e qartë se, zotësia juridike humbet bashkë me vdekjen. Çdokush i cili pretendon një të drejtë që i rrjedh nga një tjetër person, duhet të provojë se ky person ekzistonte.

2.3 Emri i personit

Emër quhet mjeti që përdoret në gjuhë për të treguar një person në mënyrë të qëndrueshme dhe uniforme dhe për t’u dalluar, në këtë mënyrë, nga personat e tjerë. Emri përbëhet prej dy elementësh, domethënë prej emrit të vogël (*prénom*) dhe prej mbiemrit ose emrit familjar (*nom patronymique*). Emri i vogël shërben për të dalluar personat

¹⁰ Neni 458 dhe neni 2 i Kodit Civil të vitit 1928.

brenda së njëjtës familje. Në Shqipëri ekzistonte zakoni që t'u vendosnin të vegjëlvë nga dy ose më shumë emra. Emri i vogël i vendosej nga i ati dhe në mungesë të tij nga personi që gëzon të drejtën që t'i vendoste emrin fëmijës, nëna mbijetuese ose nëna natyrore. Në raste më të izoluara dhe në mungesë të prindërve, e drejta për t'i vendosur emrin i kalonte oficerit të gjendjes civile. Emrat e vegjël i imponoheshin fëmijës gjatë redaktimit të aktit të lindjes¹¹.

Mbiemri ose emri familjar ishte i përbashkët për të gjithë anëtarët e familjes që kishin të njëjtën atësi. Fëmijët legjitimë marrin mbiemrin e atit të tyre. Sipas nenit 249 të Kodit Civil të Zogut, fëmija natyror merr mbiemrin e prindit, të cilin e ka njohur më parë ose të të atit, në qoftë se është njohur prej të dy prindërve njëkohësisht. Është e arsyeshme që t'i jepet fëmijës emri i njërit prej prindërve që ushtron pushtetin atëror mbi të. Fëmijët natyrorë, atësia e të cilëve nuk dihet, kanë të shënuar në aktin e lindjes mbiemrin e nënës së tyre dhe jurisprudenca u ka njohur të drejtën që të mbajnë atë mbiemër.

Në rastin kur fëmija ka ardhur në jetë si pasojë e shkeljes së kurorës (*adulteri*) dhe ky fakt konstatohet me vendim gjyqësor mbi padinë e ngritur për mosnjohjen e atësisë (*désaveux de paternité*), fëmija nuk mund të mbante mbiemrin e bashkëshortit ligjor të nënës, por merrte emrin familjar të kësaj të fundit.

Të gjithë fëmijët e gjetur pa prindër marrin emrin dhe mbiemrin, të cilët u përcaktohen nga ana e oficerit të gjendjes civile ose nga ana e administratorit të strehës foshnjore publike pranë së cilës këta fëmijë janë dorëzuar. Në rastin kur me kalimin e kohës gjenden prindërit e vërtetë të fëmijëve, atëherë ata marrin mbiemrat e prindërve të tyre biologjikë. Në këtë mënyrë të gjithë emrat e vendosur nga organet shtetërore, në mungesë të prindërve, janë emra të përkohshëm. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për fëmijët natyrorë, të cilëve nuk u njihen prindërit. Në këto raste si mbiemër shërben një emër i vogël.

Gruaja pas martesës merrte mbiemrin e burrit¹². Ligjvënësi shqiptar, në këtë këndvështrim, paraqiste një inovacion, i cili nuk ekzistonte as në Kodin Civil të Francës dhe as në Kodin Civil të Italisë. Kjo dispozitë e ka bazën e saj në vetë zakonet shekullor të bazuar në ndjenja dhe koncepte elementare. Nga ana tjetër, vetë Kodi Civil shqiptar shton se: "*Gruaja pas shkurorëzimit merr përsëri mbiemrin e vajzërisë.*" dhe gjithashtu ekziston mundësia që me anën e një vendimi gjyqësor, t'i ndalohej gruas që të mbajë mbiemrin e burrit ose të autorizohet që të braktisë këtë mbiemër. Nga dispozitat e mësipërme kuptojmë se:

- a) Gruaja, duke marrë mbiemrin e të shoqit, nuk humbet mbiemrin e saj të vajzërisë;
- b) Marrja dhe mbajtja prej gruas të mbiemrit të burrit është pothuajse i imponuar nga stabiliteti i strehës të saj bashkëshortore. Në qoftë se ajo është e martuar, por edhe e ve, vazhdon që të mbajë mbiemrin e të shoqit. Në rastet e shkurorëzimit nuk ka të drejtë që t'a mbajë, sikurse edhe në rastet e veçimit.

¹¹ Tsitso, Niko; op. cit., f. 30, si dhe Neni 42 i Kodit Civil të vitit 1928.

¹² Neni 188 i Kodit Civil.

Për aq kohë sa vazhdon martesë, gruaja është e detyruar që të mbajë mbiemrin e bashkëshortit.

Nga dispozitat e nenit 222 të Kodit Civil të vitit 1928, rezulton se burri mund t'i shtojë mbiemrit të tij edhe atë të gruas. Kjo dispozitë nuk është e detyrueshme, sepse ligji përmend vetëm fjalën shtim dhe jo zëvendësim të mbiemrit të burrit me atë të gruas¹³.

Në rastet kur mbiemrit të burrit i shtohet edhe ai i gruas, këta mbiemra nuk transmetohen tek fëmijët, të cilët marrin vetëm mbiemrin e të atit. Është gjykuar të veprohet në këtë mënyrë, pasi pas disa gjeneratash do të përballeshim me mbiemra shumë të gjatë dhe të pambarueshëm. Në rastet e shkurorezimit, burri humbet të drejtën për të mbajtur mbiemrin e shtuar të gruas dhe në rastet e veçimit personal, gruaja ka të drejtën që të kërkojë nga burri mospërdorimin e mbiemrit të saj.

Një aspekt tjetër interesant është edhe mbrojtja e mbiemrit sikurse edhe ndërrimi ose ndryshimi i emrit. Mbrojtja e vetë mbiemrit është një mbrojtje e ligjshme. Ekzistonin raste kur një personi i kontestohet mbiemri ose i ishte grabitur mbiemri nga një person tjetër. Ashtu sikurse parashikonte edhe neni 275 i Kodit Civil të Zogut “*Ay, të cilit i kontestohet emëri, mund të kërkojë me anën e gjyqit njoftjen e së drejtës të tij*”. Këtë gjë mund t'a kërkonte në formën e një padie për konstatim, pa qenë i detyruar që të provojë ekzistencën e ndonjë gabimi ose dëmi¹⁴.

Posedimi i pakonstatuar i mbiemrit gjithashtu gëzonte mbrojtje ligjore. Në rastet kur vërehej përdorimi dhe ishte shkaktuar dëm, qoftë edhe moral, atëherë i dëmtuari kishte të drejtën që të kërkonte dëmshpërblim. “*Ay që lëndohet me grabitjen e emërit të tij, mund të kërkojë pushimin e kësaj, si edhe gjithë dëmshpërblimet, në rast se grabitësi ka qënë në faj*”¹⁵.

Në këtë kontekst, ligjvënësi ka synuar që paditësi është i detyruar që të provojë jo vetëm që është viktimi e një grabitje të mbiemrit të tij, por duhet të provojë se kjo grabitje i ka shkaktuar një dëm konkret, duke i kompromentuar reputacionin e mirë. Dëmi i paditësit mundet të jetë jo vetëm material, por edhe moral. Në rastet e padisë për konstatim, gjyqtari do të deklarojë se i padituri nuk ka të drejtë të ngrejë pretendime mbi mbiemrin e grabitur. Më pas mund të bëhen të gjitha korrigjimet përkatëse në regjistrat e gjendjes civile.

Ndryshimi i mbiemrit bëhej gjithmonë kur ekzistonin rrethana të cilat e impononin këtë veprim: “*Me dekret Mbretënor, kur ka shkaqe të arësyeshme, mund të lejohet një person me ndrue emërin*”¹⁶.

Zakonisht mbiemri ndërrohej kur shkaktonte konfuzione, ose kur ishte një mbiemër qesharak. Edhe shtetasi i huaj që dëshironte të kishte një mbiemër shqiptar mund të ndryshonte mbiemrin e tij. Kërkesa për ndryshimin e mbiemrit mund të vinte edhe nga ana e një të mituri ose nga persona me probleme mendore, por me kushtin që iniciativën e ndryshimit t'a kishte përfaqësuesi ligjor.

¹³ Tsitso, Niko; op. cit., f. 32.

¹⁴ Neni 482 i Shtojcës së Dytë të Procedurës Civile.

¹⁵ Paragrafi i dytë i Nenit 275 të Kodit Civil të vitit 1928.

¹⁶ Neni 276 i Kodit Civil të vitit 1928.

Kodi Civil i vitit 1928 ka rregulluar në këtë mënyrë të gjitha aspektet që lidhen me emrin, mbiemrin dhe personalitetin juridik.

2.4 Fitimi dhe humbja e shtetësisë

Kodi Civil i vitit 1928 kur flet për shtetësinë, merr gjithmonë parasysh edhe kombësinë e personave. Shtetësia përkufizohet si cilësia e personave që përcakton gjendjen dhe zotësinë juridike, përta i përket gëzimit dhe ushtrimit të të drejtave civile dhe politike. Në përcaktimin e shtetësisë, ligjvënësi merrte parasysh vendin e lindjes (*ius soli*) dhe kushtet e prindërve (*ius sanguini*). Të dyja këto rrethana janë vendimtare për përcaktimin e shtetësisë.

2.4.1 Fitimi i shtetësisë me anë të lindjes

“Ashtë shtetas shqiptar fëmija i lindur nga prindër shqiptarë”¹⁷. Me këtë dispozitë ligjvënësi ka synuar që t’u japë shtetësinë shqiptare të gjithë atyre fëmijëve të cilët kanë lindur nga prindër shqiptarë. Kodi Civil specifikon se të gjithë fëmijët, të cilët kanë lindur nga prindër shqiptarë jashtë kufijve të Shqipërisë përsëri lejohen që të marrin edhe shtetësinë e vendit të huaj në të cilin ata kanë lindur (*ius soli*). Në këtë mënyrë fëmijët do të kishin dy shtetësi që në momentin e lindjes.

Me anën e adoptimit fëmija nuk e fitonte shtetësinë shqiptare. Sipas dispozitës të nenit 241 të Kodit Civil të vitit 1928, fëmijët e lindur jashtë martesë prej një bashkimi adulteri ose nga persona të cilët e kanë të ndaluar me ligj që të lidhin martesë, për shkak të gjinisë ose krushqisë, nuk është e mundur që të njihen dhe as të legjitimohen.

Natyrisht, kur fëmija natyror nuk mund të ndjekë shtetësinë e të atit të tij dhe me qëllimin për të mos mbetur pa shtetësi, atëherë merr shtetësinë e nënës nga gjaku i së cilës rrjedh (*ius sanguinis*). Për të përcaktuar shtetësinë e fëmijës duhet të merret parasysh shtetësia që ka patur i ati ose e ëma në momentin e lindjes së fëmijës dhe jo të kohës në të cilën është zënë dhe as intervali kohor ndërmjet zënies dhe momentit të lindjes.

Neni 4 i Kodit Civil të Zogut formulon një prezumim ligjor kur thotë se: “Fëmija i gjetur në tokën e Mbretërisë Shqiptare, prindërit e të cilit nuk njihen, prezumohen se kanë lindur në Shqipëri deri në provim të së kundërtës”. Pra, me t’u provuar e kundërta, me anën e njohjes ose të deklarimit gjyqësor, fëmija do të marrë shtetësinë e huaj në qoftë se i ati ose e ëma kanë shtetësi të huaj¹⁸.

2.4.2 Fitimi i shtetësisë nëpërmjet natyralizimit

Natyralizimi është një nga mënyrat për fitimin e shtetësisë shqiptare dhe ka si karakteristikë të saj faktin që ajo është krejt vullnetare. Natyrisht që natyralizimi kërkon përmbushjen e disa kushteve ligjore, por përsëri edhe pas përmbushjes të tyre nga ana e të gjithë të interesuarve, janë vetë organet shtetërore të cilat japin verdiktin e akordimit ose të refuzimit. Shtetësia shqiptare i akordohej të huajit me anën e Dekretit Mbretëror ose

¹⁷ Neni 4 i Kodit Civil të vitit 1928.

¹⁸ Tsitso, Niko; op. cit., f. 10.

me anën e Dekretit të Këshillit të Ministrave. Sipas nenit 9 të Kodit Civil: "Shtetësia mund t'i akordohet me dekret mbretëror të huajit, i cili i ka bërë një shërbim të jashtëzakonshëm Shqipërisë".

2.4.3 Humbja e shtetësisë

Kodi Civil parashikon se "Shtetësia e huaj që i akordohet shtetasit shqiptar pa lejen e qeverisë ose që i akordohet në kundërshtim me vullnetin e tij nga një qeveri e huaj nuk ka asnjë efekt juridik"¹⁹. Në asnjë rast nuk mund t'i akordohet leje për ndërrim shtetësie, përpara se të provohet se kërkuesi i ka të gjitha mundësitë reale për t'u vendosur në një vend të huaj. Mënyrat me anën e të cilave humbet shtetësia shqiptare janë:

- Me anën e natyralizimit të shtetasit shqiptar në shtetas të huaj me autorizimin e qeverisë;
- Me anën e deklarimit gjyqësor, i cili përcakton zgjedhjen e shtetësisë, kur i huaji arrin moshën madhore, i cili deri në atë moment kishte shtetësinë shqiptare;
- Në rastet kur heq dorë nga shtetësia shqiptare, shtetasi shqiptar, i cili ka lindur dhe banon në një vend të huaj dhe e konsideron veten si shtetas të huaj për shkak të lindjes, por që duhet t'a deklarojë këtë fakt në momentin kur të arrijë moshën madhore.

Në të tre rastet, humbja e shtetësisë shqiptare është e formës së shprehur pasi bëhet me një deklaratë përpara autoriteteve kompetente të Mbretërisë Shqiptare. Është mjaft e rëndësishme që kërkesa për heqje dorë nga shtetësia të bëhet nga një person, i cili ka arritur moshën madhore dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor në zhvillim ose të ndodhet nën ndjekje penale²⁰.

Së fundmi, humbet shtetësinë shqiptare edhe gruaja e martuar me një burrë të huaj²¹. Humbja e shtetësisë është e kushtëzuar nga fakti se ajo përfiton shtetësinë e burrit të saj. Vetëm në rastin kur ligji i huaj nuk i akordon gruas shtetësinë e burrit, për shkak të martesës, dhe kur ajo nëpërmjet kontratës ka rezervuar të drejtën e saj për të mbajtur shtetësinë shqiptare, atëherë edhe pas martesës gruaja mbetet shqiptare.

2.5 Banimi dhe vendqëndrimi

Sipas nenit 76 të Kodit Civil të Zogut, *banesa civile e një personi asht në vendin ku ky ka qendrën kryesore të punëve dhe të interesave të veta*. Në paragrafin e dytë, ky nen thekson se *qëndresa ashtë në vendin ku persona ka ndenjën e zakonshme*. Ligjvënësi në atë kohë konsideronte se banesa (*domicilium*), është *qendra e jetës familjare dhe rregullisht dhe e okupasjonevet profesionale të personave*²². Neni 76 i Kodit Civil

¹⁹Neni 11 i Kodit Civil të Mbretërisë Shqiptare.

²⁰Neni 4 i Rregullores mbi shtetësinë.

²¹Neni 14 dhe 15 i Kodit Civil të vitit 1928.

²²Tsitso, Niko; op. cit., f. 98.

përmend banesën civile si një çështje fakti. Kjo banesë nuk konsiderohet e humbur në qoftë se personi ka deklaruar se ka banesën në një vend të ndryshëm. Në këtë mënyrë një banesë e fituar ligjërisht nuk humbet, deri sa të jetë fituar ligjërisht një banesë tjetër²³.

Qëndresa ose vendqëndrimi ndodhet në vendin ku personi ka ndenjën e zakonshme shprehej neni 76 i Kodit Civil i vitit 1929. Qëndresa ashtu sikurse e shohim më lart lidhet ngushtë me vendin ku qëndron personi. Vetëm prezenca e personit në një vend të caktuar, nuk e kualifikon këtë vend si qëndresë. Kushti kryesor që të transformojë një vend në një qëndresë, është që personi të ketë atje qëndresën e zakonshme. Në këtë mënyrë, i japin kuptimin e qëndresës dy elementët e mëposhtëm:

- a) *elementi i jashtëm dhe objektiv, i cili konsiston në faktin, që personi duhet të qëndrojë në një vend të caktuar;*
- b) *elementi i brendshëm dhe subjektiv, i cili konsiston në faktin, që personi duhet t'i japë kësaj qëndrese një karakter të qëndrueshëm.*

Parimisht, qëndresa nuk sjell efekte juridike me përjashtim të rasteve kur bëhen komunikime të ndryshme. Edhe në rastin e martesës, vendqëndrimi shërben si vendi i celebrimit. *Martesa mund të celebrimet në qëndresën e njërit nga bashkëshortët me kompetencën e gjykatave, pasi padia mund të ngrihet si në vendin e banimit, po ashtu edhe në atë të vendqëndrimit*²⁴.

3. Personi fizik sipas Pjesës së Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955

Personi fizik në këtë periudhë është trajtuar në bazë të ligjeve Nr. 2022, datë 2.4.1955 “*Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil*” dhe Nr. 2023, datë 2.4.1955 “*Mbi dispozitat zbatuese të pjesës së përgjithshme të Kodit Civil*”.

3.1. Zotësia juridike

Në nenin 7 të gjithë personave, pa dallim seksi, kombësie, besimi dhe origjine u njihet zotësia juridike, domethënë zotësi për të patur të drejta dhe detyrime civile. Në pajtim me këtë, çdo person gëzon të drejtën e punës, ka të drejtë të zgjedhë veprimtarinë dhe mjeshtërinë që nuk është e ndaluar dhe të marrë pjesë në organizata shoqërore; gëzon të drejtën e pronësisë dhe të drejtën e trashëgimisë brenda kufijve të lejuar nga ligji. Ka të drejtë të kryejë veprime juridike si dhe të gëzojë çdo të drejtë tjetër të njohur nga ligji.

Askush nuk mund të kufizohet në të drejtat civile veç në mënyrën dhe në rastet e caktuara në ligj. Çdo veprim juridik që kufizon zotësinë juridike është i pavlefshëm²⁵. Zotësia juridike fillon me lindjen e një personi gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Fëmija që nga koha e zënies, gëzon të drejta civile në qoftë se lind i gjallë. Kur dy ose më shumë persona kanë vdekur dhe nuk mund të provohet se kush prej tyre ka vdekur më parë, quhet se të gjithë kanë vdekur në një kohë²⁶.

²³ Tsitso, Niko; op. cit., f. 99.

²⁴ Neni 149 i Kodit Civil të Zogut.

²⁵ Neni 8, i ligjit Nr. 2022, datë 2.4.1955 “*Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil*”.

²⁶ Ibid, neni 10.

Përsa i përket zotësisë juridike të të huajve, ajo rregullohet nga traktatet që Republika Popullore e Shqipërisë ka lidhur me shtetet e tyre. Kur mungojnë traktatet, të huajt kanë po ato të drejta civile që u njihen shtetasve shqiptarë. Megjithatë, me ligj ose dispozita të Qeverisë mund të vihen kufizime.

3.2 Zotësia për të vepruar

Personi që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç (*madhori*) gëzon zotësi të plotë për të vepruar, domethënë zotësi që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile. Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe personi, që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç (*i mituri*) dhe nuk e humb këtë zotësi edhe sikur martesa të deklarohet e pavlefshme ose të zgjidhet para se të ketë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç është i pazoti për të vepruar. Megjithatë ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që ekzekutohen aty për aty, sikurse edhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundër shpërblim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij, përfaqësuesi i tij ligjor (prindi, kujdestari).

I mituri, që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin paraprak të përfaqësuesit të tij ligjor (*prindi, kujdestari*). Megjithatë, ai mund të hyjë si anëtar në kooperativa dhe në organizata të tjera shoqërore, të lidhë kontratë pune dhe të disponojë lirisht atë që fiton me punën e tij, të bëjë depozita në arkën e kursimit dhe t'i disponojë vetë këto depozita. I mituri, që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e shkaktuar prej tij.

Personit që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe që është krejt i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi mendor të metë, me vendim të gjykatës mund t'i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike. Për këtë person zbatohen dispozitat e nenit 12 të Kodit Civil.

Madhorit që për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi mendor të metë që nuk është krejt i pazoti të kujdeset për punët e tij, me vendim të gjykatës, mund t'i kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike²⁷. Çdo veprim juridik, që kufizon zotësinë juridike ose zotësinë për të vepruar është i pavlefshëm.

3.3 Banimi

Banimi është vendi ku personi, për shkak të shërbimit, të punës së përhershme ose të ndodhjes së pasurisë, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës. I mituri, që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç si dhe ata të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar (neni 14) kanë për banim atë të përfaqësuesve të tyre ligjorë. Kur prindërit që ushtrojnë të drejtën prindërore kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën katërmëdhjetë vjeç, ka për banim atë të prindërit pranë të cilit jeton²⁸.

3.4 Deklarimi i zhdukjes ose i vdekjes së një personi

²⁷ Ligji Nr. 2022, datë 2.4.1955 “*Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil*”, neni 15.

²⁸ *Ibid*, neni 18.

Një person që mungon nga vendi i banimit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për një kohë më shumë se një vit, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të deklarohet me vendim të gjykatës i zhdukur. Kur dita e lajmeve të fundit nuk mund të caktohet, afati një vjeçar fillon nga dita një e muajit që vjen pas atij në të cilin janë marrë lajmet e fundit, dhe kur nuk mund të caktohet as muaji, afati fillon nga dita 1 janar e vitit të mëpasshëm. Me deklarimin e zhdukjes së një personi, për pasurinë e tij caktohet kujdestar sipas rregullave të përgjithshme.

Personi që është deklaruar i zhdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të deklarohet me vendim të gjykatës i vdekur, kur kanë kaluar tre vjet nga dita që është dhënë vendimi i deklarimit të zhdukjes.

Sipas dispozitave të nenit 21 një person që ka humbur gjatë veprimeve luftarake dhe kjo humbje vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, mund të deklarohet i vdekur kur kanë kaluar dy vjet nga mbarimi i veprimeve luftarake, pa qenë e nevojshme që të deklarohet më parë i zhdukur. Gjithashtu një person që ka humbur gjatë një fatkeqësie në rrethana të tilla që bëjnë që të besohet që ka vdekur, mund të deklarohet i vdekur, kur ka kaluar një vit nga dita që ka ngjarë fatkeqësia, pa qenë e nevojshme që të deklarohet më parë i zhdukur.

Kur nuk mund të caktohet dita në të cilën ka ndodhur fatkeqësia, afati një vjeçar fillon nga dita një e muajit që vjen pas atij në të cilin ka ndodhur fatkeqësia, dhe kur nuk mund të caktohet as muaji, nga dita një janar e vitit të mëpasshëm. Gjykata, kur deklarohet vdekjen e një personi të zhdukur, cakton ditën që pranon se duhet të ketë ngjarë vdekja. Në qoftë se kjo ditë nuk është e mundur të dihet, si ditë të vdekjes, gjykata cakton ditën e fundit të afateve të parashikuara, sipas rastit nga nenet 20, 21 dhe 22. Kur më pas del, se personi ka vdekur në një ditë tjetër nga ajo e caktuar në vendim, me kërkesën e çdo të interesuari, data e vdekjes ndryshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin. Vdekja e deklaruar me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat me vdekjen e vërtetë.

Kur personi që është deklaruar i vdekur del se është gjallë, me kërkesën e çdo të interesuari, vendimi që ka deklaruar vdekjen prishet nga gjykata që e ka dhënë. Martesa e zgjidhur me deklarimin e vdekjes bëhet prapë e vlefshme, përveç kur bashkëshorti i personit të deklaruar të vdekur ka lidhur martesë tjetër.

Personi i deklaruar i vdekur, që del se është gjallë, ka të drejtë që të kërkojë në çdo kohë, pasurinë e tij dhe pasurinë e fituar me anën e asaj nga personat të cilëve, kjo pasuri u ka kaluar për shkak të deklarimit të vdekjes së tij. Gjithashtu ai ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë pasurinë e tij edhe nga personat e tretë që e kanë fituar nga ata, të cilëve u ka kaluar kjo pasuri për shkak të deklarimit të vdekjes së tij, por vetëm kur këta e dinin se personi i deklaruar i vdekur ishte gjallë, ose kur e kanë fituar këtë pasuri pa kundërshtim²⁹.

Vlen të përmendet fakti se pjesa e përgjithshme e Kodit Civil të Republikës

²⁹ Ligji Nr. 2022, datë 2.4.1955 “Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil”, neni 24.

Popullore të Shqipërisë ka hyrë në fuqi më 1 Maj 1955. Personave të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar me vendim të gjykatës para hyrjes në fuqi të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Civil, për shkaqe që nuk njihen nga ky kod, fitojnë zotësinë për të vepruar ditën e hyrjes në fuqi të këtij kodi³⁰.

4. Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i vitit 1981

Kodi Civil i vitit 1981, përfshin periudhën nga 01.01.1982 deri në 31.10.1994. Ky kod është miratuar nga Kuvendi Popullor i Republikës Socialiste të Shqipërisë, i cili ka trajtuar tre kategori subjektësh të marrëdhënies juridike civile:

a) Personat juridikë³¹;

Për të përmbushur një veprimtari të caktuar krijohen personat juridikë. Persona juridikë, si subjekte të marrëdhënies juridike civile, janë ndërmarrjet, institucionet, kooperativat bujqësore dhe organizatat shoqërore, të cilat kanë mjete materiale e monetare dhe, për pasojë, mund të fitojnë në emër të tyre të drejta, të marrin përsipër detyrime civile dhe të jenë paditës ose të paditur.

b) Shteti³²;

Shteti paraqitet si subjekt në ato marrëdhënie juridike civile që lindin nga disponimi i drejtpërdrejtë i mjeteve buxhetore dhe i pasurisë shtetërore që nuk i është dhënë për administrim ndonjë personi juridik, si edhe në marrëdhëniet e tjera civile në të cilat ai merr pjesë drejtpërdrejt.

Shtetasit³³;

Shtetasit, pa dallim seksi, race, kombësie, arsimit, pozite shoqërore a gjendjeje materiale kanë zotësi juridike, domethënë zotësi për të pasur të drejta dhe detyrime civile.

Ashtu sikurse konstatohet, Kodi Civil i vitit 1981 nuk përmend termin “person fizik”, por, megjithatë, nuk harron të specifikojë termin “person juridik”. Personi fizik në këtë kod, është njësuar me termin “shtetas”. Çdo shtetas ka zotësinë për të pasur të drejta dhe detyrime civile.

4.1 Personaliteti juridik

Zotësia juridike fillon në çastin e lindjes së personit dhe merr fund me vdekjen e tij ose me shpalljen si të pagjetur. Fëmija gëzon zotësi juridike që nga koha e zënies, në qoftë se lind i gjallë. Në këtë mënyrë, dispozitat e këtij kodi përmendin periudhën e fitimit të personalitetit të njeriut, personalitet, i cili lind në momentin e lindjes dhe në disa raste qysh nga koha e zënies. Pra, në këtë mënyrë fëmija konsiderohet si i lindur sa herë që e thërret interesi i tij.

³⁰ Ligji Nr. 2023, datë 2.4.1955 “Mbi dispozitat zbatuese të pjesës së përgjithshme të Kodit Civil”.

³¹ Neni 35 i Kodit Civil të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 6340, datë 26.06.1981.

³² Ibid, neni 45.

³³ Ibid, neni 46.

Përsa i përket trashëgimisë, Kodi Civil në nenet 96 dhe 98 të tij përcakton se: “mund të trashëgojë vetëm personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë” sikurse përcakton gjithashtu se: “për trashëgimtarin, që në kohën e çeljes së trashëgimisë nuk ka lindur, afati fillon nga data e lindjes së tij”. Sipas këtij kodi, shtetasit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile.

Këtë zotësi e fiton përgjithmonë me anë të martesës edhe gruaja që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Martesë mund të lidhë gruaja që ka mbushur moshën 16 vjeç dhe burri që ka mbushur moshën 18 vjeç³⁴. Gjithashtu, testament mund të bëjë çdo person që ka zotësi të plotë për të vepruar. Në këtë mënyrë është përcaktuar edhe mosha që duhet të ketë personi fizik që të bëjë testament.

I mituri, që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, ka zotësi të kufizuar për të vepruar. Ai mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin paraprak të prindërve ose të përfaqësuesit të tij ligjor. Megjithatë, ai mund të hyjë si anëtar në kooperativë bujqësore, në organizatat e tjera shoqërore, të disponojë lirisht ato që fiton me punën e tij, të bëjë depozita në arkën e kursimit dhe t'i disponojë vetë këto depozita. Sipas Kodit të Punës të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë shtetasi që ka mbushur 15 vjeç merret në punë. Marrja në punë bëhet sipas profesionit, aftësisë e prirjeve personale dhe në pajtim me nevojat e shoqërisë. Për të miturit që nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç, koha e punës nuk mund të kalojë 6 orë në ditë³⁵. Në këtë mënyrë, të gjitha të ardhurat që fiton, ai mund t'i depozitojë dhe t'i menaxhojë vetë këto të ardhura.

I mituri, që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e shkaktuar prej tij. Kur i mituri, që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, nuk nxjerr të ardhura nga puna ose nuk ka vetë pasuri, për dëmin e shkaktuar prej tij përgjigjen prindërit ose kujdestari i tij. Prindërit ose kujdestarët që kanë paguar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga të miturit ose nga persona, të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar, nuk kanë të drejtë të kërkojnë nga këta kthimin e shpërblimit të dëmit që kanë paguar.

I mituri, që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar. Ai mund të kryejë veprime juridike, që i përshtaten moshës së tij dhe që përbushen aty për aty, si edhe veprime juridike, që i sjellin dobi pa asnjë kundërshpërblim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi ligjor. Pasuria e të miturit, që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, administrohet nga prindërit në dobi të fëmijës, kurse pasuria e të miturit, që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, administrohet nga vetë i mituri, por gjithmonë me pëlqimin paraprak të prindërve.

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar prej tij. Për këtë dëm përgjigjen prindërit ose kujdestari i tij. Kur i mituri, që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, e ka shkaktuar dëmin gjatë kohës që

³⁴ Neni 14 i Kodit të Familjes të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr 6599, datë 29.06.1982.

³⁵ Neni 28 i Kodit të Punës të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i miratuar me ligjin Nr. 6200, datë 28.06.1980, ndryshuar me ligjin Nr. 6342 datë 27.06.1981.

ndodhej nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të një institucioni arsimor, edukues a shëndetësor ose nën mbikëqyrjen e një personi tjetër, për këtë dëm mbajnë përgjegjësi këta të fundit, në qoftë se nuk provojnë se nuk kanë pasur mundësi të ndalonin shkaktimin e dëmit³⁶.

Shtetasit, që është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi mendor të metë, me vendim të gjykatës mund t'i hiqet ose t'i kufizohet zotësia për të vepruar. Heqja ose kufizimi i zotësisë së një personi për të vepruar mund të kërkohet nga bashkëshorti, gjinia e afërt ose prokurori. Në kërkesën që i paraqitet gjykatës së rrethit të vendit të banimit të personit për të cilin kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, duhet të tregohen faktet në të cilat ajo bazohet, si edhe provat.

Për dëmet e shkaktuara nga një person që i është hequr zotësia për të vepruar përgjigjet kujdestari ose institucioni që e ka në mbikëqyrje këtë person. Personi, që nuk është i vetëdijshëm për veprën e tij, nuk përgjigjet për dëmin që ka shkaktuar duke u ndodhur në këtë gjendje, përveç rasteve, kur për faj të vet e ka sjellë veten në këtë gjendje.

Çdo veprim juridik, që kufizon zotësinë juridike ose zotësinë për të vepruar është i pavlefshëm. Kodi Civil në nenin 47 të tij përcaktonte se të gjithë shtetasit janë të barabartë para ligjit. Askush nuk mund të kufizohet në ushtrimin e të drejtave civile, veçse në mënyrën dhe në rastet e caktuara në ligj.

Zotësia juridike e të huajve rregullohet nga traktatet ose marrëveshjet që Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë ka lidhur me shtetet e tyre. Kur mungojnë traktatet ose marrëveshjet, të huajt kanë po ato të drejta civile që u njihen shtetasve shqiptarë. Megjithatë me ligj ose me dispozita të Këshillit të Ministrave mund të vihen kufizime.

4.2 Vendbanimi

Vendbanimi është vendi ku shtetasi jeton vazhdimisht ose të shumtën e kohës. I mituri nën moshën katërmëdhjetë vjeç, si edhe personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, kanë si vendbanim atë të prindërve ose të kujdestarëve të tyre. Vendbanimi konsiderohej si pronë vetjake e personit në një kohë kur mundësitë e personit për të pasur prona ishin shumë të kufizuara. Janë pronë vetjake të ardhurat nga puna dhe nga burime të tjera të ligjshme, shtëpia e banimit dhe sende të tjera, që shërbejnë për plotësimin e nevojave materiale e kulturore vetjake e familjare³⁷. Vendbanimi i shtetasit ka një rëndësi të veçantë sikurse është rasti i çeljes së trashëgimisë.

Kodi Civil ka përcaktuar se: “trashëgimia çelet në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit dhe në vendin ku trashëgimlënësi ka pasur banimin e tij të fundit ose, kur ky nuk dihet, në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij a pjesa e saj kryesore”.

³⁶ Neni 338 i Kodit Civil të vitit 1981.

³⁷ Ibid, Neni 77.

Shtetasve që janë thirrur për të kryer shërbimin ushtarak aktiv, nxënësve dhe studentëve që ndjekin shkollën në qytete të tjera, personave që ndodhen për mjekim në një institucion shëndetësor, atyre që dalin jashtë shtetit me punë, si edhe atyre që dërgohen përkohësisht me punë në një vend tjetër u ruhet sipërfaqja e banimit për gjithë kohën gjersa të përfundojë shërbimi, studimi ose mjekimi. Gjithashtu, u ruhet sipërfaqja e banimit personave të arrestuar përderisa të përfundojë hetimi dhe gjykimi i çështjes për të cilën janë marrë si të pandehur.

Personat që dënohen me heqje lirie ose internohen ose dëbohen për më tepër se gjashtë muaj humbasin të drejtën e sipërfaqes së banimit, në qoftë se sipërfaqja e banimit që disponojnë përbën dhomë të veçantë³⁸.

4.3 Shpallja i zhdukur dhe shpallja i vdekur e personit fizik.

Sipas nenit 51 të Kodit Civil të vitit 1981, shtetasi, me vendim të gjykatës, mund të shpallet si i pagjetur, kur në vendbanimin e tij të fundit nuk ka lajme për të prej më shumë se dy vjetësh ose brenda gjashtë muajve, kur ka humbur gjatë një fatkeqësie. Shtetasi, që ka humbur gjatë veprimeve luftarake, mund të shpallet si i pagjetur me vendim të gjykatës, kur ka kaluar një vit nga mbarimi i veprimeve luftarake. Dita e zhdukjes caktohet nga gjykata, duke u marrë parasysh rrethanat konkrete të ngjarjes. Kur dita e zhdukjes nuk del nga rrethanat e ngjarjes, si e tillë caktohet dita e fundit e afateve të përmendura në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni.

Shpallja e një personi si i pagjetur kërkohet nga prokurori, bashkëshorti ose gjinia e afërt e tij. Shkurtimi i kërkesës shpallet në një vend të dukshëm nga gjykata dhe nga Këshilli Popullor i vendit ku ka pasur banimin e fundit personi i pagjetur³⁹. Gjykata shqyrton çështjen jo më parë se një muaj nga kryerja e veprimeve të parashikuara nga neni 147/II të këtij kodi. Në shqyrtimin e kërkesës pyeten njerëz të afërm, administrohen të dhënat e kërkuara për këtë person nga Këshilli Popullor i vendbanimit të fundit të tij, nga Policia Popullore dhe nga çdo burim tjetër. Kundër vendimit për shpalljen e një personi si të pagjetur, mund të bëjnë ankim bashkëshorti ose gjinia e afërt e tij dhe protestë prokurori.

Vendimi që shpall një person si të pagjetur, i dërgohet komitetit ekzekutiv të këshillit popullor pranë të cilit ndodhet zyra e gjendjes civile ku është i regjistruar ky person, për të bërë shënimet përkatëse. Gjykata shqyrton edhe kërkesën për ndryshimin ose prishjen e vendimit që ka shpallur si të pagjetur një person. Gjykimi bëhet sipas rregullave të përcaktuara në këtë krye duke u thirrur personat që përmenden në nenin 147, si edhe personat që kanë fituar të drejta nga shpallja e personit si i pagjetur.

Në rastin kur personi, që është deklaruar i pagjetur, gjendet, vendimi prishet nga gjykata që e ka dhënë. Personit që del i gjallë i rikthehen të gjitha të drejtat pasurore që i kishin humbur me deklarimin e tij si të pagjetur. Ai ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë pasurinë e tij edhe nga personat e tretë që e kanë fituar nga ata, të cilëve u ka kaluar kjo pasuri për shkak të deklarimit të tij të pagjetur.

³⁸ Neni 284 i Kodit Civil të vitit 1981.

³⁹ Neni 147 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i miratuar me ligjin Nr. 6341, datë 27.06.1981.

KAPITULLI II

ZOTËSIA JURIDIKE E PERSONIT FIZIK

1. Zotësia civile e personit fizik

1.2 Nocione dhe elemente

Nga përvoja historike e kuptimit të fjalës person rezulton se njeriu është destinacioni i të gjitha të drejtave⁴⁰. Në çdo stad të zhvillimit të shoqërisë, nocioni i personalitetit përfaqëson një koncept juridik i cili e ka burimin e tij nga vetë eksperiencia e jetës sociale dhe ndodhet vazhdimisht nën vlerësimin kolektiv. Afirmimi i personalitetit juridik në gjithë historinë e njerëzimit njih dy drejtime të mëdha:

Drejtimi i parë lidhet me tendencën për të çliruar individualizmin e njeriut nga limitet e vendosura nga ana e komunitetit, qytetit ose dhe të vetë kombit. Pra, është një përpjekje e çlirimit të ndërgjegjes individuale nga asimilimi i saj kolektiv. Është gjithashtu një fitim personaliteti nga ana e individit kundër personalitetit të imponuar nga grupi social, familjar ose politiko-fetar.

Drejtimi i dytë lidhet me përpjekjet që janë bërë për njohjen e dinjitetit njerëzor, çdo qenieje njerëzore dhe eliminimin e dallimeve ndërmjet individëve në raport me të drejtat e akorduara (dallime ndërmjet personave *sui iuris* dhe *alieni iuris*, ndërmjet njerëzve të lirë dhe të robëruar). Në të drejtën moderne nocioni tekniko-juridik i personit fizik shpreh cilësinë e njeriut për të qenë subjekt i së drejtës civile. Duhet t'a theksojmë se nocioni i personit fizik i përket *ab originem* të drejtës civile⁴¹. Megjithatë, personi fizik përdoret edhe nga degë të tjera të së drejtës për të shprehur cilësinë e njeriut si subjekt në një të drejtë ose tjetrën. Disa degë të së drejtës përdorin edhe terma të veçantë për të shprehur këtë cilësi, sikurse hasim në të drejtën kushtetuese termin *shtetas*. Kjo është edhe arsyeja se përse "*personi fizik*" shoqërohet herë pas here me shtesën "*si subjekt i së drejtës civile*".

Në përgjithësi, zotësia juridike shpreh mundësinë për të qenë subjekt i së drejtës dhe për të pasur të drejta dhe detyrime. Kjo veti është esenciale për një person fizik në cilësinë e tij, si një anëtar i shoqërisë në të cilën ai jeton. Për të dhënë një ide sa më të qartë për personalitetin juridik duhet t'i japim së pari përgjigje pyetjes: se çfarë është personi ose personaliteti juridik? Natyrisht që si përgjigje mund të konsiderohet fakti se personaliteti juridik konsiston në zotësinë për të qenë subjekt i të drejtave dhe detyrimeve. Por cilat qenie gëzojnë këtë zotësi? Përgjigja e saktë, është se këtë zotësi

⁴⁰ Dogaru, Ion. Cercel, Sevastian, *Drept civil, Persoamele*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2007, f. 12.

⁴¹ Dogaru Ion, Draghici Pompil, *Bazele dreptului civil, Volumul III, Teoria generala a obligatorilor*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2009, f. 35.

padyshim e kanë njerëzit si qenie, të cilat ndodhen nën influencën e ligjit moral. Natyra njerëzore është padyshim titulli i personalitetit juridik.

Në të drejtën moderne është e mjaftueshme që një qenie njerëzore të ekzistojë në mënyrë që të fitojë automatikisht cilësinë e subjektit të së drejtës. Ekzistenca biologjike është e nevojshme dhe e mjaftueshme për të pasur personalitet juridik (neni 4 i KEDNJ). Cilësia e subjektit të së drejtës të qenies humane nuk kushtëzohet nga aftësia dhe kapaciteti intelektual, nga mënyra sesi vlerëson ose dallon të keqen nga e mira, të ligjshmen nga të paligjshmen, moralen nga imoralen, sepse ekzistenca e zotësisë juridike nuk varet nga ekzistenca e mënyrës të të menduarit juridikisht.

Kur pohojmë se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, është e lehtë që të pranojmë se i mituri por edhe i sëmuri me të meta mendore janë gjithashtu persona fizikë, subjekte të së drejtës dhe kanë zotësi juridike. Është mjaft e rëndësishme që njeriu, nëpërmjet faktit të thjeshtë që është njeri, është gjithashtu edhe person fizik. Vetëm njeriu është person fizik, duke përjashtuar në këtë mënyrë sendet dhe kafshët që të gëzojnë personalitet juridik.

Doktrina paralajmëron se e drejta moderne po përballet me “*personalizimin*” e kafshëve ose sendeve, por edhe me “*sendëzimin*” e personave (*send nga latinishtja res*), situatë, e cila është shumë e rrezikshme. Dihet që diferenca ndërmjet një personi human dhe një sendi përbën shtyllën kurrizore të civilizimit aktual, për aq kohë sa vihet theksi në respektimin e dinjitetit dhe heqjen e skllavërisë. Në emër të modernizimit vihet re se në ditët e sotme, po kalohet në personalizimin e sendeve dhe në sendëzimin e personave. Në këtë mënyrë nënshkruhen sot, akte juridike me ndihmën e një kodi informatik, e drejta e imazhit tregtohet (një tregtar merr pëlqimin e një personi për të përdorur imazhin e tij për reklamimin e një produkti) dhe një sportist shitet sa nga një klub tek tjetri (në futboll shumat e transaksioneve janë hiperbolike). Gjithashtu dhurohet një organ vital dhe në këtë mënyrë shembuj të tillë po rriten çdo ditë⁴².

Pares me nga agis quam similes. Në mënyrë intuitive, ne të gjithë mendojmë se, për vetë faktin që ne jetojmë, që ne marrim frymë - nga e qara e parë deri në grahmën e fundit – ne kemi të drejta, të drejta të lindura (natyrore), të pandashme nga qenia jonë, pazgjydhshmërisht të lidhura me ekzistencën tonë, të mbërthyer pas trupit tonë dhe ne e ndjejmë se, sipas kësaj perspektive universale, çdo qenie njerëzore ka, natyrisht që nga lindja, të njëjtat të drejta. Por, ne kemi gjithashtu ndjesinë se gjithkush është unik dhe se ne jemi të gjithë të ndryshëm, që situata jonë është e veçantë, kushtet tona janë të veçanta dhe se secili, në varësi të moshës, gjinisë, familjes, origjinës, kombësisë e profesionit, është i ndryshëm nga të tjerët.

Statuti juridik që e drejta civile u jep personave fizikë konfirmon këtë aspiratë të dyfishtë dhe reflekton këtë dysi. Nga disa pikëpamje, të gjitha qeniet njerëzore janë të ngjashme. Këta janë persona që si të tillë janë të pajisur me të njëjtat të drejta themelore dhe që kanë, si barazi civile, të njëjtin personalitet juridik. Përpara ligjit janë të gjithë të barabartë. Nga pikëpamje të tjera, personat fizikë janë të ndryshëm dhe e drejta civile përcakton pasoja juridike që lidhen me këto dallime. Ajo bën dallimin civil të personave.

⁴² Dogaru Ion, Cercel Sevastian, op. cit., f. 14.

Çdo individ ndodhet në një situatë personale që përbën atë që quhet gjendja e tij civile. E drejta e personave na jep një imazh të dyfishtë të shoqërisë që përfaqëson. Aty shihet ajo që është e përbashkët për të tërë dhe ajo që është e veçantë për secilin: nga njëra anë personaliteti juridik dhe barazia civile, nga ana tjetër, dallimi mes personave dhe gjendjes civile. Humanizmi i së drejtës së personave, si një e drejtë civile (qytetarie e qytetërimi) qëndron në lidhjen e ngushtë që ekziston mes hapjes dhe rrënjosjes që e karakterizon. E hapur për të gjithë, e pranishme te gjithkush.

Për të përkufizuar zotësinë civile, duhet t'u referohemi dy premisave kryesore: *së pari*, zotësia civile është pjesë e zotësisë të njeriut dhe nga ana tjetër duke iu referuar strukturës së saj, zotësia civile është një nocion i një sinteze të përgjithshme sepse zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar formojnë së bashku zotësinë civile të personit⁴³.

Duke ju referuar rrethanave të mësipërme mund të themi se *zotësia civile e personit fizik është ajo pjesë e zotësisë të saj juridike, e cila konsiston në zotësinë për të pasur dhe ushtruar të drejtat civile, sikurse edhe për të pasur detyrime civile nëpërmjet kryerjes të veprimeve juridike*⁴⁴. Zotësia civile e personit fizik është demonstrimi i fushës të veprimit si subjekt i së drejtës civile dhe në mungesë të këtij veprimi, cilësia e të qenit subjekt i së drejtës nuk do të kishte asnjë kuptim. Kjo kategori juridike koncepton dhe përkufizon personin fizik si titullar të drejtash dhe detyrimesh civile të cilat do t'i ushtrojë dhe ekzekutojë sipas rastit.

1.2.1 Elementet e zotësisë civile

Është shumë e qartë që në strukturën e zotësisë civile të personit fizik bëjnë pjesë dy elementë: *zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar*. Sipas nenit 1 të Kodit Civil, çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të patur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.

Personit fizik nuk mund t'i kufizohen të drejtat civile, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj. Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile⁴⁵.

Dallimi midis këtyre dy llojeve të zotësive është bërë edhe në kohët e hershme. Në thelb, zotësia juridike mëshiron cilësinë e njeriut për të qenë subjekt i së drejtës civile, pra mbartës i të drejtave dhe detyrimeve. Nën këtë aspekt terminologjik në doktrinë dhe jurisprudencë gjen përdorim përkrah shprehjes “zotësi juridike” edhe shprehja “personalitet juridik”. Zotësia për të vepruar është zotësia për të pasur të drejta dhe të marrë përsipër detyrime duke nënshkruar akte juridike. Ashtu sikurse dihet, akti juridik është burimi më i madh dhe më i rëndësishëm i të drejtave dhe detyrimeve në të drejtën civile. Akti juridik implikon vullnetin dhe ndërjegjen e njeriut me qëllim që të prodhojë disa efekte juridike (*të drejta dhe detyrime*).

Në këtë këndvështrim manifestimi i vullnetit të njeriut luan një rol vendimtar. Gjithashtu është e thjeshtë të konstatohet se pse *mosha* bëhet një kriter parësor i zotësisë për të vepruar. Falë zotësisë për të vepruar personi është në gjendje që të ketë të drejta

⁴³ Beleiu Gheorghe, *Drept civil, Persoanele*, Bukuresht, 1982, f. 40.

⁴⁴ Ibid, f. 41.

⁴⁵ Neni 6 i Kodit Civil.

dhe të marrë përsipër detyrime duke kryer veprime juridike personalisht dhe i vetëm pa ndërhyrjen juridike të një personi tjetër. Duke iu referuar dispozitave ligjore të mësipërme, doktrina e përkufizon *zotësinë për të vepruar të personit si atë pjesë të zotësisë civile të njeriut, e cila konsiston në aftësinë e njeriut që të fitojë të drejta dhe të ushtrojë të drejtat civile, sikurse edhe të marrë përsipër detyrime nëpërmjet kryerjes të veprimeve juridike.*

Ndarjen e zotësisë të personit fizik në zotësi juridike dhe zotësi për të vepruar do t'a gjejmë gjithë kohën vetëm në të drejtën civile dhe jo gjithmonë në *degët e tjera të së drejtës*. Praktikisht, zotësia e personit fizik mund të ndahet në këto dy elementë vetëm në ato degë të së drejtës, në të cilat të drejtat subjektive i përkasin vetëm një titullari pa qenë e nevojshme që në mënyrë simultane të kërkohet edhe ushtrimi i këtyre të drejtave.⁴⁶

Përsa i përket zotësisë civile në doktrinë janë ngritur disa pyetje në lidhje me shtrirjen e kësaj zotësie. Problemi qëndron në faktin, në qoftë se kjo duhet që të konsiderohet si një zotësi e përgjithshme (në kuptimin e një "zotësie në të gjitha degët e së drejtës", të një "zotësie në një shoqëri") apo një zotësi e një dege, domethënë e të drejtës civile.

Së pari, konsiderohet se nocioni i zotësisë civile ka prirje të përgjithshme, kurse zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar "ndërtojnë së bashku zotësinë civile në kuptimin e zotësisë në shoqëri dhe jo të zotësisë të së drejtës civile, me kufizime që variojnë sa nga një degë e së drejtës tek tjetra⁴⁷.

Së dyti, konsiderohet se zotësia civile është një zotësi e një dege dhe përkatësisht e së drejtës civile. Ekzistojnë disa argumente të cilat e përforcojnë më tej këtë ide. Një nga argumentet na paraqet një pasqyrë logjiko-juridike, sepse që nga momenti kur njihet autonomia e degëve të së drejtës, atëherë edhe pasojat që shfaqen do të kenë autonominë e tyre, duke iu referuar në këtë mënyrë zotësisë që është specifike për secilën degë. Nga ana tjetër, dallimi ndërmjet zotësisë civile dhe zotësisë në degë të tjera reflektohet në strukturë, përmbajtje dhe në mbarimin e zotësisë.

Degë të ndryshme të së drejtës aplikojnë edhe zgjidhje të ndryshme. Për shembull përsa i përket strukturës, e drejta civile dhe e drejta e procedurës civile mbështetet në zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar. Përsa i përket fillimit të zotësisë në kuptimin elektoral, zotësia e personit fillon me mbushjen e moshës 18 vjeç për të zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës, por, sipas nenit 86 të saj, të drejtën për t'u zgjedhur president e ka shtetasi shqiptar që nga lindja, i cili ka mbushur moshën 40 vjeç. Pra në këtë aspekt shohim se zotësia për t'u zgjedhur president fillon me mbushjen e moshës 40 vjeç. Zotësia fillon me mbushjen e moshës 16 vjeç në të drejtën e punës dhe në kushte të tjera 14 vjeç⁴⁸.

Në të drejtën familjare, zotësia fillon me mbushjen e moshës 18 vjeç, ose më parë kur gjykata lejon për shkaqe me rëndësi martesën përpara kësaj moshe. Në raste të caktuara dispozitat e ligjeve të cilat trajtojnë personat fizikë njohin vetëm të drejtat civile dhe nuk përmendin të drejtat subjektive. Si konkluzion, është më se i qartë që roli i së

⁴⁶ Dogaru, Ion. *Teoria generalë a dreptului*, Editura Sitech, Krajovë, 1998, f. 29.

⁴⁷ Popa, Nicolae. *Teoria generalë a dreptului*, Editura Actami, Bukuresht, 1998, f. 88.

⁴⁸ Neni 98, i Kodit të Punës të Republikës të Shqipërisë.

drejtës civile nuk duhet t'u imponohet degëve të tjera të së drejtës kur këto të fundit kanë rregullimet e tyre.

1.3 Lidhja reciproke e zotësisë me nocionet e tjera

Një interes të veçantë paraqet edhe lidhja reciproke ndërmjet zotësisë civile me nocionet ose konceptet e tjera, por gjithmonë duhet treguar kujdes që të mos krijojmë konfuzione. Ashtu sikurse kemi analizuar tashmë ndërmjet zotësisë civile dhe zotësisë juridike ekziston një raport. E para përfaqëson një pjesë, kurse e dyta pjesën e plotë. Lidhja ndërmjet zotësisë civile, zotësisë juridike dhe zotësisë për të vepruar është më komplekse nga sa duket. Në qoftë se do të marrim në konsideratë zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar do të kuptojmë se një person nuk mund të fitojë zotësinë për të vepruar, para zotësisë juridike, por është e mundur që një person të ketë zotësi juridike pa pasur zotësi për të vepruar.

Nga ana tjetër zotësia civile nuk duhet ngatërruar me të drejtat subjektive dhe as me detyrimet civile. Zotësia është një aftësi e përgjithshme, kurse e drejta është një mundësi konkrete. Të drejtat dhe detyrimet nuk mund të ekzistojnë jashtë sferës së zotësisë civile dhe kjo e fundit mëshiron në vetvete aftësinë për të pasur dhe ushtruar të drejtat subjektive dhe të marrë përsipër detyrimet civile nëpërmjet veprimeve juridike. Praktikisht, të drejtat dhe detyrimet civile i japin kuptim nocionit të zotësisë, kurse zotësia është premisa e të drejtave dhe detyrimeve.

Së fundmi, zotësia civile nuk duhet të ngatërrohet me “përgjegjësinë civile”. Ashtu sikurse e dimë të gjithë, ne jemi të përgjegjshëm për veprimet tona, të cilat padyshim janë të lidhura me të drejtën e lirisë, e cila është një parim themelor i së drejtës që shpreh marrjen e përgjegjësisë në rastin e veprimeve tona sociale të cilat janë në kundërshtim me ligjin dhe sjellin një rrezik social⁴⁹.

Përgjegjësia juridike haset në më shumë degë të së drejtës sikurse janë: përgjegjësia kushtetuese, përgjegjësia penale, përgjegjësia administrative, përgjegjësia civile etj. Një nga kushtet esenciale të përgjegjësisë civile është konstatimi i fajit të personit, i cili ka shkaktuar dëmin. Në këtë kontekst zotësia civile përbën një premisë të përgjegjësisë civile, me supozimin se ndërmjet elementëve përbërës të zotësisë civile dhe kushteve të përgjegjësisë civile ekziston një lidhje komplekse.

2 Nocione të përgjithshme

2.1 Përkufizime dhe rregullime juridike

Sipas nenit 1 të Kodit Civil “*Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të patur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj*”. Zotësia juridike është një cilësi e pandarë e personit⁵⁰. Zotësia juridike nuk duhet të ngatërrohet me të drejtat subjektive. Me qëllim që personi të bëhet me të vërtetë titullar të drejtash apo detyrimesh duhet që të vërtetohen fakte juridike, me të cilat ligji lidh lindjen e këtyre

⁴⁹ Dogaru, Ion. Dănișor D.C. Dănișor Gh., *Teoria generală a dreptului*, Editura Științifică, Bukuresht 1999, f. 33.

⁵⁰ Nuni, Ardian. *Hyrje në të drejtën civile*, Botimet Morava, Tiranë 2006, f. 114.

të drejtave dhe subjekteve dhe, për pasojë, personi të marrë pjesë si subjekt (si palë) në një ose disa marrëdhënie juridike konkrete. Në qoftë se do të bëjmë një interpretim sistematik të zotësisë juridike, na rezulton se kjo zotësi përkufizohet si aftësia për të pasur të drejta dhe detyrime civile por jo të drejta subjektive dhe detyrime të përgjithshme. Disa dispozita ligjore njohin si *expresis verbis* vetëm të drejtat civile.

Zotësia juridike e personit fizik është ajo pjesë e zotësisë civile të njeriut e cila konsiston në aftësinë e këtij të fundit për të pasur të drejta dhe detyrime civile. Në thelb, zotësia juridike e personit fizik shpreh cilësinë e njeriut për të qenë subjekt i të drejtës civile, domethënë pjesëmarrës në të gjitha raportet juridike. Në fakt, doktrina ka kritikuar zgjedhjen e shprehjes “zotësi juridike” për të përfaqësuar aftësinë ose “zotësinë për të pasur të drejta dhe detyrime”. Doktrina konsideron se termi “zotësi juridike ose zotësi e përdorimit” do të vlerësohet si një e drejtë për të përdorur një send të caktuar dhe na krijon idenë se, këtë send jo vetëm që e përdor por mund edhe të përfitosh nga ky send. Është kritikuar gjithashtu edhe përdorimi i shprehjes “personalitet juridik”, shprehje e cila nuk përfaqëson një terminologji të duhur dhe krijon paqartësi në kuptimin e vërtetë të këtij koncepti.

Parimi kushtetues i cili frymëzon të drejtën civile është se të gjithë njerëzit janë të barabartë. Kjo barazi juridike është abstrakte dhe virtuale. Ajo nuk u siguron konkretisht të gjithëve të njëjtat përparësi ekonomike dhe të njëjtat pozicione shoqërore. Barazia civile ka për bazë personalitetin juridik: ajo gjendet njëherësh në njohjen e personalitetit juridik dhe në afirmimin e të drejtave të pandashme nga ky personalitet. Kur thuhet se të gjithë individët janë të barabartë në të drejta, do të thotë që:

- a) të pranosh se të gjithë zotërojnë personalitet dhe janë në këtë mënyrë persona me zotësi juridike; dhe
- b) falë kësaj cilësie ata kanë si attribute të personalitetit disa të drejta parësore.

Njohja e personalitetit juridik dhe atributet e personalitetit janë dy bazat themelore të së drejtës së personave të cilat përcaktojnë vlerën e rëndësishme të personit në të drejtën civile shqiptare. Personaliteti juridik i njihet nga ligji civil çdo qenieje njerëzore; ai i takon çdo individ. Njohja ligjore e qenies njerëzore dhe respekti që i garanton e drejta që në fillim të jetës së tij, është nga një nga provat më të mëdha të veçantisë të personalitetit juridik.

Duke u nisur nga ideja se kjo zotësi është një kusht *sine qua non* e cilësisë të subjektit të së drejtës, konsiderohet që shprehja më e duhur do të ishte “zotësia subjektive”, e cila do t’i jepte identitetin e vërtetë dhe specifikën e duhur përmbajtjes të konceptit që përfaqëson⁵¹. Megjithatë duhet të pranojmë se në legjislacione të ndryshme, doktrinë dhe jurisprudencë është imponuar shprehja “zotësia juridike” dhe përdorimi i një shprehje tjetër do të jetë një sfidë për të ardhmen, e cila tashmë duhet të mposhtë një “traditë”. Natyrisht që sfidat shoqërohen edhe me argumente, të cilët do ta kenë shumë të vështirë që të bindin autorët e së drejtës.

3 Karakteristikat e zotësisë juridike

⁵¹ Malaurie, Ph. Aynes, L. *Droit civil. Les Personnes*. Defrenois, Paris, 2003, f. 45.

Zotësia juridike, si pjesë e zotësisë civile, disponon edhe disa karakteristika juridike të veçanta. Në doktrinën e sotme afirmohet se, *zotësia juridike është e ligjshme, e përgjithshme, e pandashme, e pakufizuar, e barabartë dhe universale*⁵².

3.1 Zotësia juridike si një zotësi e ligjshme

Me “ligjshmëri” të zotësisë juridike të personit fizik do të kuptojmë, atë pjesë të kësaj zotësie, e cila është e rregulluar nëpërmjet ligjit në të gjitha aspektet e saj sikurse janë: njohja, fillimi, përmbajtja dhe mbarimi. Zotësia juridike është një ekskluzivitet i fushës ligjore, pra krijohet nëpërmjet ligjit dhe nuk varet nga fusha e vullnetit individual. Njohja e zotësisë juridike të personit fizik është realizuar nëpërmjet ligjit. “*Zotësia juridike është e barabartë për të gjithë personat fizikë pa asnjë dallim*”.

Kushtetuta e vendit tonë specifikon se shtetasit shqiptarë gëzojnë të drejtat dhe liritë të cilat mbrohen me anën e kushtetutës dhe nëpërmjet ligjeve të tjera. Fillimi dhe mbarimi i zotësisë juridike është parashikuar në Kodin Civil, i cili shprehet se zotësia juridike fillon me lindjen e njeriut dhe mbaron me vdekjen e tij.

3.2 Zotësia juridike si një zotësi e përgjithshme

Me “përgjithësi” të zotësisë juridike të personit fizik do të kuptojmë faktin, se kjo zotësi shpreh aftësinë e përgjithshme të njeriut që të ketë të gjitha të drejtat dhe detyrimet civile. Në lidhje me këtë karakteristikë të zotësisë juridike, doktrina ka theksuar faktin se “*çdo njeri posedon të gjithë zotësinë*”⁵³. Gjithashtu është nënvizuar se zotësia juridike konfiguron potencialisht të gjitha të drejtat subjektive, të cilat, mundet që të fitojë një person. Por zotësia juridike nuk duhet të ngatërrohet me këto të drejta, pasi ajo shpreh vetëm aftësinë e përgjithshme dhe abstrakte për të fituar këto të drejta⁵⁴.

Është mjaft e rëndësishme që të kujtojmë se ligji civil nuk mundet dhe as nuk duhet që të përmbajë një inventar të të drejtave dhe detyrimeve civile të personave fizikë, por të ofrojë mundësinë që personi të fitojë çdo të drejtë dhe të ndërhyjë edhe atje, ku fakte të ndryshëm kufizojnë këto të drejta. Praktikisht, do të konstatojmë se përmbajtja e përgjithshme e zotësisë juridike buron nga fakti se personi është i lirë që të fitojë të gjitha të drejtat dhe të marrë përsipër detyrime civile, të cilat ligji nuk i ndalon shprehimisht.

Në të drejtën civile, përmbajtja e zotësisë juridike mund të shprehet nëpërmjet idesë se “*Personit fizik i lejohet çdo gjë që nuk është e ndaluar me ligj*” dhe në këtë mënyrë fusha e lirisë të personit njih dimensione të gjera. Karakteri i përgjithshëm rezulton edhe në përkufizimin juridik të zotësisë juridike, sipas nenit 1 të Kodit Civil “*Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të patur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj*”. Përkufizimi, sikurse e shohim, nuk përmend shprehimisht se cilat të drejta apo detyrime ka personi.

3.3 Zotësia juridike si një zotësi e pandashme

⁵² Pop, Teofil. *Drept civil român. Persoanele fizice și Persoanele juridice.*, Editura Lumina Lex, Bukuresht, 1994, f. 93.

⁵³ Negrea, C. *Dreptul civil, vol I, fasc.I*, Tipografia Bernat, Cluj, 1920, f. 138-140.

⁵⁴ Castaing, Zenati, A-F., *Manuel de droit des personnes*, PUF, Paris, 2006, f. 81.

Në të drejtën civile ekziston rregulli që të drejtat subjektive mund të transmetohen lirisht tek të tretët (nëpërmjet veprimeve juridike). Zotësia juridike e personit fizik nuk është një një e drejtë subjektive, ndërsa aftësia, prirja e saj juridike, për të pasur të gjitha të drejtat dhe akoma më shumë zotësia juridike nuk është një send (*res*). Zotësia juridike është një zotësi e pandashme për personin fizik dhe në këtë mënyrë asnjë nuk mund të heqë dorë plotësisht ose pjesërisht nga zotësia juridike. Në stadin aktual të civilizimit, zotësia juridike është një arritje e qenies humane dhe në këtë mënyrë përjashtohet fakti që ajo të jetë objekt i heqjes dorë nga disa veprime juridike nga ana e subjektit të së drejtës.

Në doktrinë gjithashtu është përcaktuar se të gjitha veprimet juridike në të cilat një subjekt i së drejtës heq dorë totalisht ose pjesërisht, përkohësisht ose përgjithmonë nga zotësia e tij juridike do t'i nënshtrohen pavlefshmërisë absolute, por gjithsesi nuk duhet që të ngatërrojmë "heqjen dorë nga një e drejtë subjektive civile e caktuar" me "heqjen dorë nga aftësia e përgjithshme për të fituar këtë të drejtë", fitimi i të cilës do të cenonte cilësinë e të qenit subjekt i së drejtës, duke qenë në këtë mënyrë e ndaluar me ligj⁵⁵.

Ligji civil e ndalon rreptësisht heqjen dorë pjesërisht nga zotësia juridike dhe *a fortiori*, heqjen dorë totalisht, e cila do të njësohej me një vdekje të vërtetë civile të një qenieje njerëzore, duke e mbrojtur në këtë këndvështrim subjektin e së drejtës kundër të gjitha tentativave të tij vetjake të momentit dhe duke shmangur në këtë mënyrë një burim të mundshëm të skllavërisë moderne⁵⁶. Në qoftë se titullari i zotësisë juridike nuk mund të heqë dorë nga kjo zotësi, *a fortiori*, asnjë person tjetër nuk mund të ushtrojë në vendin e tij këtë zotësi. Si konkluzion mund të pohojmë se zotësia juridike është një zotësi e pandashme dhe një bashkudhëtare e personit fizik gjatë gjithë jetës së tij.

3.4 Zotësia juridike si një zotësi e pakufizuar

Me pakufizueshmëri të zotësisë juridike nënkuptohet karakteristika e kësaj të fundit, që nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, sikurse është parashikuar në nenin 1 të Kodit Civil.

Në konceptin aktual zotësia juridike konsiderohet si një zotësi e pakufizuar (e plotë dhe e pakufizuar nga normat juridike), por kufizimi i kësaj zotësie përbën në një farë mënyre përjashtimin, i cili mund të ekzistojë vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Nga ana tjetër, çdo ligj i cili kufizon zotësinë juridike duhet që të përcaktojë edhe "kushtet" në të cilat ky kufizim mund të gjejë zbatim.

Në doktrinë gjithashtu është theksuar fakti se, ligji përmend në mënyrë afirmative dhe korrekte "kufizimin" e zotësisë juridike, por nuk i referohet "mungesës" të kësaj zotësie (*ashtu sikurse parashikon në rastin e zotësisë për të vepruar*), sepse është e pakonceptueshme që një qenie njerëzore të ketë mungesë të zotësisë juridike. Duke rregulluar në rrugë ligjore vetëm kufizimin e zotësisë juridike, vetë ligji përjashton në mënyrë kategorike, variantin e mungesës totale të zotësisë juridike.

⁵⁵ Stătescu, C. *Drept civil. Contractul de transport. Dreptul de creație intelectuală*, E. D. P., Bukuresht, 1967, f. 30.

⁵⁶ Dogaru, Ion. *Valențele juridice ale voinței*, Editura Științifică și Enciclopedică, Bukuresht, 1996, f. 122-123.

Karakteri i pakufizueshmërisë të zotësisë juridike të personit fizik është shprehur edhe në nenin 16 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut, i cili i referohet të drejtave civile dhe politike të njeriut. Në këtë nen do të konstatojmë se “*çdo njeri gëzon të drejtën që t’i njihet kudo personaliteti juridik*”. Edhe Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 15 të saj, shprehet se, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

Në nenin 17, kushtetuta shprehet se kufizime të të drejtave dhe lirive të njeriut mund të vendosën vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast ato, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Pra, kushtetuta ka parashikuar edhe rastet e kufizimit të kësaj zotësie.

Në këtë mënyrë kuptojmë se zotësia juridike është një zotësi e pakufizuar me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Të gjitha kufizimet e përcaktuara me ligj duhet të jenë të qarta dhe të argumentojnë arsyet se përse duhet të ekzistojnë këto kufizime.

3.5 Zotësia juridike si një zotësi e barabartë

Ashtu sikurse dihet, barazia në të drejta është një parim themeltar i së drejtës moderne dhe në këtë mënyrë edhe i të drejtës civile. Në të drejtën kushtetuese barazia e shtetasve është një parim, sipas të cilit, çdo shtetas shqiptar pa dallim gjinie, race, feje, etnie, gjuhe, bindje politike, fetare a filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore mund të përfitojë në mënyrë të barabartë me të tjerët të gjitha të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet. Gjithashtu, ai mund të marrë pjesë në jetën politike, ekonomike dhe sociale pa asnjë lloj diskriminimi dhe duhet të gëzojë trajtim në mënyrë të barabartë me të tjerët në të gjitha institucionet publike.

“*Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe në të drejta*”, shprehet neni i parë i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe po e njëjta deklaratë në nenin 7 të saj shpreh se: “*të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe përfitojnë në mënyrë të barabartë nga mbrojtja e ligjit*”. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, parashikon, gjithashtu, “barazinë” me përmbajtjen “*të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe gëzojnë pa asnjë diskriminim mbrojtje të barabartë nga ligji*”. Në këtë këndvështrim, ligji duhet të ndalojë çdo lloj diskriminimi dhe t’u garantojë të gjithë personave një mbrojtje të barabartë dhe efikase kundër diskriminimit veçanërisht racial, të ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, bindjes politike, origjinës etnike ose sociale, gjendjes ekonomike dhe përkatësisë prindërore në çdo lloj rrethane.

Të një rëndësie të madhe janë edhe dispozitat e nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), i cili shprehet se: “*Ushtrimi i të drejtave dhe lirive të njohura nga kjo konventë duhet të përmbushen pa asnjë dallim të seksit, gjuhës, fesë, bindjes politike, origjinës etnike ose sociale, gjendjes ekonomike, përkatësisë etnike dhe prindërore në çdo lloj rrethane*”.

Nga parimet e mësipërme do të konstatojmë se barazia është parë më shumë si një “mosdiskriminim”, duke konsideruar se parimi i mosdiskriminimit është një formë

moderne dhe perfekte e parimit të barazisë dhe numërimi i kriterëve, të cilat nuk duhen të jenë objekti i diskriminimit, është sqarues, por jo kufizues. Praktikisht, “asnjë rrethanë” nuk mund të justifikojë idenë se personat të ndodhur në të njëjtën situatë do të kenë zotësi juridike të ndryshme, nuk përjashtohet fakti, kur personat të ndodhur në situata të ndryshme, të kenë edhe zotësi juridike të ndryshme⁵⁷.

3.6 Zotësia juridike si një zotësi universale

Kjo karakteristikë e zotësisë juridike të personit fizik qëndron në faktin se kjo zotësi u njihet të gjithë njerëzve. Në këtë mënyrë universaliteti afirmon edhe njëherë titullarët e zotësisë juridike dhe gjithashtu mbështet idenë se të gjithë njerëzit kanë këtë zotësi. Gjithashtu universaliteti si karakteristikë e zotësisë juridike të personit fizik është parashikuar edhe në të drejtën e brendshme sikurse edhe në të drejtën ndërkombëtare. Zotësia civile u njihet të gjithë personave dhe asnjë njeriu nuk duhet t’i mungojë zotësia civile⁵⁸. Karakteri universal i zotësisë juridike është i pranishëm edhe në nenin 6 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila shprehet më konkretisht në këtë mënyrë: “Secili gëzon të drejtën që t’i njihet personaliteti juridik, kudo qoftë ai person” dhe po në një kontekst të ngjashëm e rithekson edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike në nenin 16: “Çdo njeri ka të drejtën që t’i njihet kudo personaliteti juridik.”.

Universaliteti i zotësisë juridike shpreh idenë se, të gjithë njerëzit kanë këtë zotësi, pavarësisht kohës dhe vendit, ku ata ndodhen. Edhe sipas Kushtetutës, të gjithë shtetasit gëzojnë të drejtat dhe liritë të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet, sikurse marrin përsipër edhe detyrimet ligjore.

4. Lidhjet ndërmjet personalitetit juridik dhe aftësisë

Aftësia juridike është një përbërës i gjendjes së personave. Ajo përcaktohet si aftësia për t’u bërë titullar i të drejtave ose i detyrimeve dhe për t’i ushtruar ato. Pra, duket qartë se aftësia juridike dhe personaliteti juridik përputhen pjesërisht. Megjithatë, të dyja nocionet nuk mbivendosen. Aftësia juridike ndahet në aftësi për të ushtruar dhe në aftësi për të gëzuar. Personaliteti juridik nuk krijon të njëjtat marrëdhënie me secilin prej këtyre dy nocioneve.

4.1 Personaliteti juridik dhe aftësia për të ushtruar

Aftësia e ushtrimit është zotësia për t’a ushtruar vetë personi një të drejtë që ai ka, për t’i dhënë vlerë ai vetë. Kjo supozon domosdoshmërisht që individi i pajisur me një aftësi të tillë ka personalitet juridik. Por, e anasjellta nuk ekziston. Si një aftësi për t’u bërë subjekt i së drejtës, personaliteti juridik ekziston edhe nëse përjashtohet aftësia e ushtrimit. Njohja e personalitetit juridik nuk ka të bëjë fare me faktin nëse subjekti i së drejtës është ose jo i aftë t’i ushtrojë vetë të drejtat e tij. Të paaftët (një i mitur nën 18 vjeç, një person në moshë madhore nën kujdestari) janë dhe mbeten subjekte të së drejtës.

⁵⁷ Filipescu P., Ion. *Drept civil. Dreptul de proprietate și alte drepturi reale*. Editura Actami, Bukuresht, 1998, f. 156-157.

⁵⁸ Laurent, François. “*Principes de droit civil français*”, vol I, Paris, ed. a III-a, 1878, f. 24.

Në rendin e trashëgimisë ata mund të bëhen pronarë, kreditorë, debitorë. Paaftësitë për të ushtruar të drejtat nuk cenojnë aspak personalitetin juridik të atyre që u përkasin ato.

Duke qenë se personaliteti juridik shtrihet vetëm në planin e aftësisë për të fituar të drejta, ai nuk cenohet nga çështja e të ushtruarit të të drejtave. Duhet pranuar se në realitetin e jetës, paaftësitë për të ushtruar të drejtat përbëjnë një kufizim për personat në fjalë dhe se aftësia e plotë e ushtrimit të tyre është plotësimi i natyrshëm i personalitetit juridik. Ja përse paaftësitë e të ushtruarit të të drejtave janë përjashtime dhe i përkasin të drejtës së kufizuar. Aftësia e ushtrimit të së drejtës është parimore.

4.2 Personaliteti juridik dhe aftësia e gëzimit

Duke qenë se zhvillohen në të njëjtin plan, domosdoshmërisht të dyja nocionet kanë pika të përbashkëta takimi. Mungesa e personalitetit juridik mund të përkufizohet si një paaftësi e përgjithshme e gëzimit të të drejtave. Nëse do të pranohej një paaftësi e përgjithshme e gëzimit do të ishte e barazvlefshme me mungesën e personalitetit juridik. Brenda kufijve të tyre, paaftësitë e veçanta të gëzimit janë cenime të personalitetit juridik, cungime të pjesshme të tij⁵⁹.

Mos do të thotë kjo se të dyja nocionet ngatërrohen me njëra-tjetrën? Dallimi specifik është i dyfishtë. E drejta franceze e trajton nën aspektet e mëposhtme:

- a) Aftësia e gëzimit njihet dy ndarje. Dallohet aftësia politike (aftësia për të gëzuar të drejta juridike) dhe aftësia civile (aftësia për të gëzuar të drejta civile). Por, të dyja këto aftësi janë të pavarura nga njëra-tjetra. Neni 7 i Kodit Civil Francez shpreh se ushtrimi (duhet kuptuar gëzimi) i të drejtave civile është i pavarur nga ushtrimi (gëzimi) i të drejtave politike. Kështu, të huajt nuk gëzojnë në parim të drejta qytetare që janë të rezervuara për qytetarët francezë. Por, ata gëzojnë të gjitha të drejtat civile që nuk u janë kundërshtuar posaçërisht nga ndonjë dispozitë. Aftësia e gëzimit është pra e ndashme. Personaliteti juridik është i pandashëm në mënyrë radikale.
- b) Aftësia e gëzimit të të drejtave (kryesisht aftësi civile) ndahet në shkallë. Ajo njihet përjashtime të veçanta që vijnë prej paaftësive të veçanta të gëzimit (për shembull, për mbrojtjen juridike të personave në moshë madhore, paaftësinë për anëtarët e profesioneve mjekësore për të marrë në ngarkim detyrën e kujdestarit për pacientët e tyre). Për arsye të kufizimeve të tyre, këto paaftësi për të gëzuar të drejta, cenojnë personalitetin juridik. Por, ky i fundit, si një aftësi e përgjithshme për të qenë subjekt i së drejtës, është i patjetërsueshëm. Personat e goditur nga një paaftësi për të gëzuar, mbeten subjekte të së drejtës, subjekte të së drejtës që nuk gëzojnë të gjitha të drejtat, ligjërisht të specifikuara dhe me ndikim deri diku të ngushtë.

4 Fillimi i zotësisë juridike të personit fizik

⁵⁹ Cornu, Gerard. Droit civil, *Les personnes*, 13 edition, Montchrestien, 2007, f. 28.

5.1 Rregulli i fitimit të zotësisë juridike

Zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë, sipas nenit 2 të Kodit Civil. Zotësinë juridike e fiton edhe fëmija që nga koha e zënies, por kur lind gjallë⁶⁰. Si rezultat, data e lindjes është data e fillimit të zotësisë juridike të personit fizik ose “njeriu është subjekt i së drejtës që nga momenti ku lind”. Ky rregull është ndjekur në të gjitha kohërat.

Në teorinë e të drejtës civile, lindja e njeriut është një eveniment juridik, pra një rrethanë e cila lind pavarësisht vullnetit të njeriut (në rastin tonë të sapolindurit). Në këtë moment ligji civil i jep njeriut disa të drejta (në rastin tonë, aftësia për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime). Me qëllim që të konsiderohet një “eveniment juridik”, fakti i lindjes (*parturitia*) është *i kushtëzuar* dhe është më se e natyrshme, që i sapolinduri të jetë *i gjallë*. Ashtu sikurse duket, jeta “juridike” dhe jeta “biologjike” janë të pandashme⁶¹.

E drejta romake mendonte se njeriu konsiderohet i lindur në momentin kur shkëputet nga nëna (*natum accipe et si exsecto ventre editus*), sepse përpara lindjes fëmija nuk ka ekzistencë vetjake, por bën pjesë tek trupi i nënës (*partus antequam edatur, mulieris portio est, vel viscerum*). Pra, përpara lindjes ai nuk mund të konsiderohet si njeri⁶² (*partus nondum editus, homo non recte fuisse dicitur*). Nga ana tjetër, që i sapolinduri të jetë “person fizik” dhe të fitojë personalitet juridik, duhet që të lindë i gjallë (*vivus*). Në të drejtën romake thuhej se: “të gjithë ata që lindin të vdekur, nuk konsiderohen si të lindur dhe as të konceptuar, pasi asnjëherë nuk mundën që të kishin titullin si fëmijë” (*qui mortui nascuntur, neque procreati videntur, qui nunquam liberi appellari potuerunt*).

Disa kode civilë të huaj konsiderojnë se fëmija, i cili lind i vdekur konsiderohet sikurse nuk ka ekzistuar kurrë. Duhet të përmendim faktin se për aq kohë sa ka jetuar fëmija, ai ka zotësi juridike edhe sikur të ketë vdekur menjëherë pas lindjes (*licet illico postquam in terram cecidit, vel in manibus obstetricis decessit*). Që të konsiderohet i gjallë duhet që fëmija të paktën të ketë marrë frymë një herë, fakt i cili mund të vërtetohet nëpërmjet prezencës të ajrit në mushkërinë e fëmijës. Në të drejtën e vjetër romake, juristkonsultët konsideronin se një kusht që duhej plotësuar për të provuar jetën e të sapolindurit ishte klithma (*voce emissa*). Më vonë Justiniani hodhi poshtë këtë argument duke pretenduar se, nuk përjashtohet mundësia që i sapolinduri të jetë memec (*quod et si mutus fuerat*).

Përsa i përket kushtit (*vitae habilis*) që fëmija të ketë aftësi që të jetojë mund të themi se e drejta jonë nuk e përmban kushtin e mësipërm. Në këtë mënyrë fëmija i cili lind i gjallë duhet të plotësojë edhe kushtin që të ketë edhe aftësi për të jetuar me qëllim që të fitojë zotësinë juridike. Në të drejtën tonë përcaktohet se zotësia juridike fillon me

⁶⁰Neni 320 i Kodit Civil: “Ka zotësi për të trashëguar personi që në kohën e çeljes të trashëgimisë është gjallë ose kur është zënë para vdekjes të trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë”.

⁶¹ Chelaru, Eugen, *Curs de drept civil. Drepturile reale principale*, Editura All Beck, Bukuresht, 2000, f. 88-92.

⁶² Hanga, Vladimir. *Principiile dreptului privat român*, Editura Dacia, Cluj-Napoca, 1989, f. 25.

lindjen e personit gjallë. Sipas Kodit Civil, për të fituar zotësinë juridike kërkohet që fëmija të lindë gjallë, jo që ai të jetë i aftë për të jetuar⁶³. Duhet të kujtojmë se në të drejtën romake nuk mund të fitonin zotësinë juridike ata fëmijë të cilët kishin lindur “kundër formës të natyrës”(non sunt liberi, qui contra formam humani generis converso more procreatur, vel si mulier monstrosam aliquid, aut prodigiosum enixa sit), sepse kërkohet që i sapolinduri të mos kishte pamjen e një monstre (hoc tantummodo requirendo, si vivus ad orbem totus processit ad nullum declinans monstrum vel prodigium).

Në ditët e sotme është kontestuar ky fakt nga e drejta moderne dhe që fëmija të fitojë zotësinë juridike është e mjaftueshme që fëmija të lindë i gjallë. Ekziston një interes praktik për përcaktimin e zotësisë juridike duke u mjaftuar vetëm me faktin se fëmija ka lindur gjallë apo të ketë aftësi për të jetuar. Disa sisteme të së drejtës kanë eliminuar opinionet të shkencës të mjekësisë për aftësinë që duhet të ketë fëmija për të jetuar. Si konkluzion do të konsiderohet si “person” fëmija i lindur para kohe por edhe fëmija i cili paraqet deformime në lindje, në lidhje me të cilët shkenca mjekësore mbështet tezën se ky fëmijë nuk mund të jetojë. Në këtë situatë kufiri “një frymëmarrje e vetme” bën diferencën ndërmjet fitimit ose jo të zotësisë juridike⁶⁴. Në Kodin Civil Rumun nuk ekziston asnjë shënim për sa i përket defekteve në lindje dhe as në ligjin e akteve të gjendjes civile të datës 11 korrik 1913⁶⁵. Nga ana tjetër rregullat e kishës katolike nuk lejonin pagëzimin e të sapolindurve të cilët kishin pamjen e një monstre. Për t’i akorduar personalitetin juridik kodi civil spanjoll përcakton dy kushte: së pari, fëmija nuk duhet të ketë kokë si monstër dhe së dyti të jetë i aftë që të jetojë i ndarë nga nëna për një kohë prej 24 orësh.

Në sistemin francez, ku fëmija duhet të lindë i gjallë dhe të ketë aftësi për të jetuar, aplikohet një prezumim i thjeshtë sipas të cilit çdo fëmijë që lind i gjallë, është i aftë edhe për të jetuar, edhe pse mund të vdesë në një kohë të shkurtër pas lindjes⁶⁶. Nuk mjafton të jesh ngjizur dhe të jesh lindur për të qenë plotësisht një person: duhet të lindësh i gjallë dhe me aftësi për të jetuar. Fëmijët e lindur të vdekur nuk janë persona. Fëmijët e lindur të gjallë, por pa aftësi për të jetuar, konsiderohen se nuk kanë patur kurrë personalitet juridik. Të lindurit gjallë dhe aftësia për të jetuar, nga plotësimi i këtyre dy kushteve së bashku varet konfirmimi (pohimi plotësisht) i personalitetit juridik. Një fëmijë lind i gjallë kur në lindje ai merr frymë plotësisht. Frymëmarrja pas çastit të lindjes është shenja e jetës pas lindjes. Ky është një fakt i cili provohet lirisht duke u mbështetur mbi dëshmitë dhe vëzhgimet e mjekësisë ligjore. Aftësia për të jetuar është e natyrshme. Çdo fëmijë që lind i gjallë prezumohet se ka aftësi të jetojë, edhe pse mund të vdesë shpejt më pas.

Një prezumim i aftësisë për të jetuar lidhet me shenjën e parë të jetës. Frekuenca mjaft e ulët e vdekjeve perinatale (nga java 28 e shtatzënisë deri në ditën e shtatë pas lindjes) përforcon gjasat e prezumimit të aftësisë për të jetuar, dhe kjo vlen si një e dhënë fillestare. Por, ky është një prezumim i thjeshtë, lehtësisht i rrëzueshëm nga prova e

⁶³ Kondili, Valentina. *E Drejta Civile I*, Geer, Tiranë, 2008, f. 114.

⁶⁴ Boroi, G. *Drept civil. Partea generală. Persoanele*, Editura All Beck, Bukuresht, 2001, f. 128.

⁶⁵ Beileu Gh. *Drept civil român. Introducere în dreptul civil. Subiectele dreptului civil, ediția a VII-a revizuită și adăugită de Marian Nicolae, P. Trușcă*, Ed. Universul Juridic, Bukuresht, 2001, f. 275.

⁶⁶ Bihl, Ph. *Droit civil general*, 13 edition, Dalloz, Paris, 2000, f.34.

kundërt (që duhet paraqitur nga të gjithë ata që kanë interes të tregojnë se fëmija nuk kishte aftësi për të jetuar). Ky mund të jetë rasti i disa fëmijëve të lindur mjaft para kohe apo të keqformuar (ata që dikur quheshin përbindështa - *monstra vel prodigia*). Më saktë, një fëmijë konsiderohet se nuk është i aftë të jetojë (edhe pse ka lindur i gjallë) kur në mungesë të një organi thelbësor për të jetuar, ai është domosdoshmërisht i paracaktuar të zhduket.

Mungesa e aftësisë për të jetuar lidhet deri tani me keqformimet e lindura dhe çrregullime të mirëfillta që e bëjnë vdekjen të pashmangshme. Megjithatë, ky kriter tradicional është duke u zbehur në një kriter teknik sasior: duke e shtyrë pragun e aftësisë për të jetuar, Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon të pranohet aftësia për të jetuar “në fund të javës së 22-të të mungesës së menstruacioneve ose në peshën 500 g”, pa marrë parasysh keqformimet apo çdo kriter tjetër. Kalohet kështu nga një kriter klinik *in casu* në një marrëveshje eksperimentale të njëtrajtshme.

E drejta ka nevojë për këto pika referimi për arsye praktike: bëhet fjalë për të ditur nëse duhet marrë parasysh ky fëmijë në trashëgimi, aftësia e tij për të përfituar lidhet me aftësinë e tij për të jetuar. Një tjetër pasojë rrënjësore: asnjë veprim që lidhet me birësimin e një fëmijë që nuk ka aftësi për të jetuar nuk është i pranueshëm.

Në vendin tonë zotësia juridike është një kategori juridike, që i takon çdo individ dhe fitohet me lindjen e personit gjallë, zgjat gjatë gjithë gjallërisë së tij dhe mbaron me vdekjen e personit⁶⁷. Pra, edhe njëherë legjislacioni ynë nuk e përmban aftësinë për të jetuar pas lindjes të fëmijës, si kusht për fitimin e zotësisë juridike.

Aftësia për të jetuar është një zotësi natyrore e njeriut i cili bën të mundur qëndrimin e tij në jetë. Në këtë mënyrë shenjës së parë të jetës të fëmijës të sapolindur i shtohet një prezumim i aftësisë për të jetuar. Është një prezumim relativ por që mund të kontestohet, në qoftë se provohet e kundërta, ashtu sikurse ndodh në situatën e fëmijëve të lindur para kohe ose me deformime qysh në lindje. Praktikisht, humbja e aftësisë për të jetuar është e lidhur ngushtë me faktin që fëmijës qysh në lindje i mungon një organ vital, i cili do të shkaktonte një anomali dhe si pasojë edhe vdekjen e sigurt të fëmijës⁶⁸. Pra, në të gjitha rastet e këtyre anomalive vdekja e të sapolindurve është e pashmangshme dhe pritët të ndodhë në çdo kohë.

Që të konsiderohet i aftë për të jetuar fëmija duhet që të ketë të gjitha organet vitale, të cilat duhet të jenë mjaftueshëm të zhvilluara për t'i ofruar fëmijës aftësinë për të jetuar. Këtë tezë e mbështesin edhe mjekët specialistë. Praktika mjekësore konsideron se nuk është i aftë për të jetuar fëmija, i cili ka një peshë më të vogël se 500 gram, paraqet anomali të sistemit nervor qendror dhe ka gjithashtu anomali të rënda në barkushet e zemrës. Vështirësitë e sistemit, i cili vendos kushtet e aftësisë për të jetuar, shfaqen atje ku realiteti demonstroi që të tilla pengesa mund edhe të kalohen (për shembull, fëmijë me një peshë më të vogël se pesha normale, e cila konsiderohet si e nevojshme për të jetuar, jetojnë dhe zhvillohen normal).

5.1.1 Regjistrimi i lindjes

⁶⁷ Latifi, Juliana. *E Drejta Civile*, Shtëpia Botuese ILAR, Tiranë 2001, f. 49.

⁶⁸ Terre, F. Fenouillet, D. *Droit civil, Les personnes. La famille. Les incapacités*, Dalloz, 1996, f. 19-20.

Ashtu sikurse dihet, lindja është momenti i fillimit të zotësisë juridike të personit fizik dhe për këtë arsye shfaqet një interes i madh në regjistrimin e kësaj date. Në të drejtën moderne, vërtetimi i lindjes bëhet nëpërmjet aktit të lindjes në gjendjen civile, i cili ka një rubrikë e cila emërtohet “data e lindjes” duke treguar vitin, muajin dhe datën e lindjes të fëmijës. Ligji Nr. 10129, datës 11.05.2009 “Për gjendjen civile” rregullon deri në detaje hartimin e aktit të lindjes.

Në këtë mënyrë lindja e fëmijës deklarohet tek nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme⁶⁹.

Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara, që çdo ditë të hënë, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre. Nga ana tjetër njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në pikën 2 të nenit 40 të ligjit “Për gjendjen civile”, në zonën që mbulojnë.

Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja. Megjithatë ekzistojnë edhe rastet e mëposhtme sikurse janë:

- *për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.*
- *për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare, në vendin ku ka lindur. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur regjistrimi i lindjeve kryhet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe brenda 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.*

Kur data e vendi i lindjes nuk mund të përcaktohen, shënohen si të tilla koha e vendi i takimit të deklaruesit me nënën, e cila ka vdekur më pas, ose koha e vendi i gjetjes së fëmijës⁷⁰. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur sipas ligjit, vërtetimi i

⁶⁹ Neni 40 i ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.

⁷⁰ Ibid, neni 45.

faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës. Në këtë rast dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes⁷¹.

5.2 Përjashtimi nga rregulli i fitimit të zotësisë juridike

Infans conceptus pro nato habetur quoties de commodis ejus agitur. Ky rregull përjashtues për fitimin e zotësisë juridike në të drejtën romake, zbatohet gjithashtu edhe në të drejtën moderne, në shumë vende të botës. Edhe në të drejtën shqiptare, zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij⁷². Nga ana tjetër, ka zotësi për të trashëguar personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur gjallë⁷³. Në këtë kontekst, do të vlerësojmë se, fëmija i zënë konsiderohet si i lindur, në qoftë se është në interesin e tij.

Parimi romak është mjaft i rëndësishëm për rastet e trashëgimisë. Dihet qartë që trashëgimia bazohet në parimin *inter vivos*. Në këtë mënyrë, do të trashëgojë fëmija i zënë por që ka lindur i gjallë. Në qoftë se fëmija ka lindur i vdekur atëherë ai konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar kurrë. Ky është këndvështrimi që kanë disa legjislacione evropiane. Vetëm personi që lind gjallë mund të jetë subjekti së drejtës. Në të gjitha rastet kur personi i zënë nuk lind i gjallë, ai nuk fiton statusin e subjektit juridik⁷⁴. Edhe në rastet e kontratave të dhurimit, disa legjislacione moderne afirmojnë faktin se është i aftë që të pranojë dhurata çdo fëmijë i zënë në momentin e dhurimit.

Për të aplikuar parimin, *infans conceptus pro nato habetur quoties de commodis ejus agitur*, duhet të plotësohen dy kushte të rëndësishme:

- a) fëmija i zënë duhet që të fitojë vetëm të drejta dhe jo detyrime;
- b) fëmija të lindë i gjallë (jo i aftë për të jetuar).

Ligji parashikon shprehimisht, se njihen qysh nga periudha e zënies “të drejtat e fëmijës” dhe në këtë mënyrë, përjashtimi nga rregulli aplikohet vetëm në qoftë se është fjala, që të fitojë të drejta në favor të fëmijës dhe jo detyrime mbi fëmijën. Në të drejtën romake, fëmija i zënë, i cili do të lindte, konsiderohej si i lindur dhe ekzistent vetëm atëherë kur ai fitonte të drejtat e tij. Në qoftë se do të ishte fjala për të drejtat e dikujt tjetër, atëherë ai do të ekzistonte vetëm kur të lindë në të vërtetë (*Quod dicimus eum qui nasci speratur, pro superstite esse, tunc verum est, cum de ipsius iure quaeritur. Aliis autem non prodest, nisi natus*)

Pra, në një farë mënyre mund të themi shkurtimisht se, fëmija i zënë konsiderohet i lindur, vetëm për interesin e tij dhe jo për interesin e të tretëve. Fitimi i zotësisë juridike të parakohshme përmban vetëm aftësinë e fëmijës për të pasur të drejta dhe jo detyrime, sepse fitimi i zotësisë juridike të parakohshme është një masë legjislative në favor të fëmijës dhe jo kundër tij.

⁷¹ Neni 38 i ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.

⁷² Nuni, Ardian, op. cit., f. 115.

⁷³ Neni 320 i Kodit Civil i vitit 1994.

⁷⁴ Kadriu, Osman. *Hyrje në të drejtën civile*, Tringa Disign, Tetovë, 2008, f. 169.

Së pari, fëmija duke fituar këtë trashëgimi fiton edhe të drejta mbi këtë, por nga ana tjetër ka edhe detyrime. Gjithsesi doktrina ka konsideruar se ky rast nuk kundërshton rregullin e përjashtimit të fitimit të zotësisë juridike.

Kushti i dytë, i cili parashikon që fëmija të lindë i gjallë është analizuar nga doktrina, sepse nga ky eveniment varet edhe fitimi i zotësisë juridike në përgjithësi dhe jo vetëm kaq, por nga ky eveniment varet edhe fitimi i zotësisë juridike të parakohshme. Për këtë motiv zotësia juridike e parakohshme kualifikohet si një zotësi “e kushtëzuar”.

Në doktrinë, është theksuar fakti se ekzistenca e kushtit që fëmija të lindë i gjallë, kusht, i cili nuk dihet në qoftë se do të plotësohet në momentin e zënies, i jep një avantazh faktit që, sipas rregullit *infans conceptus*, nuk i referohet akordimit të zotësisë juridike fëmijës të zënë ose të zotësisë të parakohshme, por njohjes prapavepruese të kësaj zotësie, duke filluar që nga momenti i zënies.

5 Mbarimi i zotësisë juridike të personit fizik

6.1 Nocione hyrëse

Sipas përmbajtjes së nenit 2 të Kodit Civil, zotësia juridike mbaron me vdekjen e personit. Vetëkuptohet që njëherësh me vdekjen, personi humbet cilësinë e të qenit subjekt i të drejtës civile. Në këtë kontekst, merr fund zotësia juridike e personit fizik. Vetëm një qenie humane ekzistente e lindur ose e zënë ka aftësinë për të qenë subjekt i së drejtës dhe të ketë zotësi juridike në të drejtën civile. Si rezultat do të thotë që të konstatohet datën e mbarimit të zotësisë juridike duhet të konstatohet më parë datën e vdekjes të personit.

Vdekja është një proces biologjik që nënkupton pushimin e funksioneve jetësore të organizmit pas të cilit vjen menjëherë shuarja e veprimtarisë së indeve dhe qelizave të organizmit të njeriut⁷⁵. Me ndarjen e një personi nga jeta ai ndahet edhe nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i ka pasur dhe i ka gëzuar në kohën që ka qenë gjallë. Kjo vlen për të gjitha të drejtat dhe detyrimet të natyrës pasurore dhe jopasurore. Me vdekjen natyrore ose fizike barazohet edhe vdekja civile. Tek vdekja civile personi në fjalë është i gjallë. Ai vetëm privohet nga të gjitha të drejtat civile⁷⁶. Vdekja mund të ndodhë në çdo moshë të jetës së njeriut. Dallohen dy lloje vdekjesh: vdekja e parakohshme dhe vdekja e natyrshme. Këto lloje vdekjesh mund të konstatohen fizikisht.

Sipas ligjit “Për gjendjen civile”, deklarimi i vdekjes bëhet nga çdo pjesëtar madhor i familjes ose nga personat më të afërt të familjes dhe, në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga i ngarkuari i posaçëm i njësisë administrative, në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi ka vendbanimin/vendqëndrimin ose ku është gjetur kufoma. Të gjitha deklaramet janë të vlefshme kur shoqërohen me raport mjekësor. Afati i deklarimit të vdekjes bëhet brenda 10 ditëve nga ndodhja ose gjetja e kufomës dhe brenda 60 ditëve, kur vdekja ka ndodhur jashtë shtetit.

⁷⁵ Meksi, Sokrat. Çipi, Bardhyl. *Mjekësia Ligjore*, Shtëpia Botuese “Arbëria”, Tiranë, f. 19.

⁷⁶ Kadriu, Osman, op. cit., f. 170.

Drejtuesit e spitaleve, të reparteve ushtarake, të burgjeve, të reparteve të riedukimit dhe të institucioneve të tjera detyrohen të njoftojnë me shkresë zyrën e gjendjes civile më të afërt, brenda 5 ditëve, për vdekjet e ndodhura në institucionet e tyre. Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, ku saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij. Shtetasi shpallet i vdekur edhe për rastet kur personi dhe organi i interesuar bëjnë vërtetimin faktik, në rrugë gjyqësore, sipas Kodit Civil.

Kur kufoma nuk mund të identifikohet, vihen re shenja ose dyshohet të jetë vdekje e dhunshme, raporti lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor. Në këto raste, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndjekjes penale, veprimet në gjendjen civile kryhen vetëm me lejen e prokurorit. Në raportin mjekësor shkaqet e vdekjes klasifikohen në shkaqe shëndetësore, aksidentale ose kriminale. Vendimi i gjykatës, që shpall shtetasin të vdekur, regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile/ regjistrin themeltar (arkivi), pa u mbajtur akti i vdekjes. Vdekjet jashtë shtetit vërtetohen sipas ligjit të vendit, ku ka ndodhur vdekja, me përjashtim të rasteve kur vdekja ndodh në territorin e përfaqësive diplomatike, në avion apo në anije shqiptare, në udhëtim, në zonat ndërkombëtare, për të cilat zbatohet ky ligj⁷⁷.

Në këtë mënyrë, data e vdekjes është edhe data e mbarimit të zotësisë juridike. Legjislacioni i vendit tonë nuk e përmban vdekjen civile. Sipas të drejtës franceze, fundi i personalitetit juridik përkon patjetër me atë të jetës njerëzore, me vdekjen natyrore. Parimi i së drejtës universale, marrë në zhvillimin e saj, çon në një pohim të dytë: Çdo njeri e ruan personalitetin e tij deri në vdekje. Personaliteti zgjat po aq sa jeta. Ai shuhet vetëm në çastin e vdekjes. Ky rregull është absolut në kuptimin që asnjë ngjarje tjetër nuk shkakton humbjen e personalitetit. Nuk ka më të vdekur civilë dhe të paaftët janë dhe mbeten persona.

6.2 Kufizime që lidhen me paaftësitë civile

Kufizimet, që një individ mund të hasë gjatë ushtrimit apo gëzimit të të drejtave të tij, nuk ndikojnë gjithmonë mbi personalitetin e tij, por dhe kur ato e cenojnë atë, nuk e bëjnë të zhdukët. Disa paaftësi i përkasin ushtrimit të së drejtës. Personi që ndodhet në kushtet e kësaj paaftësie mund të fitojë disa të drejta; ai nuk konsiderohet si i aftë që t'i ushtrojë vetë ato vetëm për shkak të moshës apo të tjetërsimit të aftësive të tij mendore. Si masë mbrojtëse, një përfaqësues ligjor i ushtron në vend të tij. I paafti e ruan të plotë personalitetin e tij, aftësinë për të fituar të drejta. Paaftësia e ushtrimit nuk e cenon aspak personalitetin juridik të atij që e mbron dhe nuk e zhduk nga marrëdhëniet juridike. Ajo i plotëson interesat e saj nëpërmjet përfaqësimit apo nganjëherë asistencës.

Në të kundërt, paaftësitë në gëzimin e të drejtës e privojnë rrënjësisht individin, pasi ato prekin aftësinë për të fituar një të drejtë të caktuar. Është gëzimi i vetë të drejtës (dhe aftësia për ta fituar) që i refuzohet. Një paaftësi e ushtrimit bëhet pashmangshmërisht pengesë për zhvillimin e plotë të personalitetit juridik. Megjithatë, një paaftësi e tillë është gjithmonë e veçantë. E caktuar posaçërisht për një të drejtë të caktuar, ajo nuk e pengon aftësinë e përgjithshme për t'u bërë subjekt i së drejtës. Ajo e

⁷⁷ Neni 53 i ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile".

dëmton pjesërisht, por e bën të pavlefshëm personalitetin juridik vetëm në kufijtë e saktë të paaftësisë që ajo krijon.

Nuk ekziston paaftësi gëzimi e përgjithshme: ky do të ishte mohim i personalitetit juridik. Ekzistenca e paaftësive të veçanta të gëzimit vërteton, në të kundërt, se personaliteti juridik nuk është gjithmonë i plotë dhe i tërë. Ai mund të jetë pjesërisht i cenueshëm nga kufizime ligjërishit dhe pjesërisht të specifikuara.

6.3 Shpallja i zhdukur dhe shpallja i vdekur i personit fizik

Përveç vdekjes të konstatuar fizikisht ekziston edhe vdekja e shpallur me vendim të gjykatës ose ndryshe sikurse njihet “vdekja e prezumuar”. Kjo lloj vdekje kalon etapat e mëposhtme:

Fillimisht, personi që mungon nga vendbanimi ose vendqëndrimi i fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës. Në rrethin e personave të interesuar padyshim ligji nënkupton, bashkëshortin, fëmijët madhor të personit të zhdukur si dhe të afërmit e tij. Kur dita e lajmeve të fundit nuk mund të caktohet, afati i mësipërm fillon nga dita e parë e muajit pasardhës në të cilin janë marrë lajmet e fundit⁷⁸. Kur muaji nuk mund të caktohet afati fillon nga dita 1 janar e vitit të mëpasshëm. Sipas nenit 15 të Kodit Civil rezulton se shpallja e zhdukjes së personit fizik bëhet me vendimin e gjykatës.

Kompetente për shqyrtimin e çështjes sipas nenit 375 të Kodit të Procedurës Civile është gjykata e vendbanimit të fundit të personit të zhdukur. Subjekti i legjitimuar për të vënë në lëvizje gjykatën sipas të dyja dispozitave të përmendura është çdo person i interesuar. Kërkesa për shpalljen e një personi të zhdukur duhet të përmbajë rrethanat nëpërmjet të cilave bëhet e besueshme zhdukja e tij, gjithashtu duhet të tregohet edhe kujdestari ose përfaqësuesi tjetër ligjor i personit të zhdukur.

Vendimi i gjykatës me anën e të cilit një person është shpallur i zhdukur botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse. Me shpalljen e zhdukjes së një personi merren masa për administrimin e pasurisë së tij duke u caktuar një kujdestar. Në të drejtën italiane, në qoftë se një person zhduket nga vendqëndrimi i tij i fundit ose nga vendbanimi i tij i fundit dhe nuk ka më njoftime për të (nuk dihet nëse është i gjallë ose i vdekur), mund të lindë mbi të gjitha problemi i marrjes së masave për ruajtjen e pasurisë së tij⁷⁹.

Ata që prezumohen të jenë trashëgimtarët e tij ose çdo i interesuar tjetër apo prokurori mund t'i kërkojë gjykatës së vendqëndrimit apo të vendbanimit të tij të fundit, caktimin e një kujdestari për të zhdukurin. Pas kalimit të dy vjetëve nga data e lajmit të fundit, gjykata mund të bëjë deklarinimin e zhdukjes së personit dhe të vendosë në posedim të përkohshëm sendet e të zhdukurit.

⁷⁸ Nuni, Ardian, *op. cit.*, f. 124.

⁷⁹ Galgano, Francesco; *op. cit.*, f. 89.

Edhe në Kodin Civil të vitit 1929 është trajtuar gjerësisht mungesa e një personi nga banesa e tij, për të cilin nuk ka asnjë informacion në qoftë se është gjallë ose vdekur. Ky Kod e klasifikonte këtë lloj gjendje të personit si absencë. *Absent konsiderohej njeriu i cili është zhdukur nga banesa e tij dhe për atë nuk ka asnjë lajm në qoftë se jeton ose ka vdekur*. Kodi Civil bënte diferencën nga këndvështrimi juridik, ndërmjet absencës dhe mungesës. Në këtë mënyrë konsiderohet absent, personi për të cilin, ekzistenca e tij është e paqartë.

Në të drejtën rumune, sikurse e parashikon Kodi Civil në nenin 49 të tij, në rastin kur një person është zhdukur dhe ekzistojnë prova që ky i fundit ka pushuar së jetuari, atëherë mund të deklarohet i vdekur me vendim të gjykatës me kërkesën e të interesuarve, në qoftë se kanë kaluar dy vjet nga data e informacioneve të fundit ose të provave të fundit, të cilat tregojnë se ky person ka qenë në jetë. Sipas nenit 50 të Kodit Civil të Rumanisë, personi i cili është zhdukur për shkak të një fatkeqësie natyrore sikurse janë përmbytjet, tërmeti, katastrofat, aksidentet hekurudhore ose ajrore, mbytjet e anijeve ose në rastet e luftërave, atëherë ai mund të deklarohet i vdekur në qoftë se kanë kaluar 6 muaj nga data e ngjarjes të fatkeqësisë. Në rastet kur ka siguri që vdekja ka ndodhur edhe pse nuk është gjetur kufoma ose të bëhet identifikimi i saj, vdekja mund të shpallet me anën e vendimit gjyqësor pa respektuar kalimin e ndonjë afati kohor⁸⁰.

Pra, sikurse e shohim në të drejtën rumune, nuk nevojitet një vendim gjykate që të shpallë fillimisht të zhdukur personin i cili mungon nga banesa e tij, por menjëherë me kalimin e dy vjetëve ai shpallet me vendim gjykate i vdekur. Në këtë mënyrë është eliminuar e ashtuquajtura etapë e parë e cila trajtohet në të drejtën tonë dhe njihet si “shpallja i zhdukur i personit”. Afati dy vjeçar, i cili shpall të zhdukur personin në Shqipëri dhe Itali me anën e vendimit të gjykatës e shpall personin të vdekur në Rumani.

Sipas ligjit shqiptar, personi që është shpallur i zhdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme katër vjet nga dita që është shpallur i zhdukur. Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë⁸¹. Përjashtim nga rregullat që përmendëm më sipër, ligji bën në ato raste kur, një person që ka humbur gjatë veprimeve luftarake dhe kjo humbje vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, në rast se kanë kaluar pa patur lajme dy vjet, nga dita që ka hyrë në fuqi marrëveshja e paqes ose tre vjet nga mbarimi i veprimeve luftarake, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, pa qenë nevoja të shpallet më parë i zhdukur.

Gjithashtu personi që ka humbur gjatë një fatkeqësie natyrore ose në rrethana që bëjnë të besohet se ka vdekur, mund të shpallet si i tillë me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme dy vjet nga dita që ka ngjarë fatkeqësia, pa qenë e nevojshme të shpallet më parë i zhdukur. Kur nuk caktohet dita në të cilën ka ndodhur fatkeqësia, afati dy vjeçar fillon nga dita e parë e muajit që vjen pas atij në të cilin ka ndodhur fatkeqësia dhe, kur nuk mund të caktohet as muaji, afati fillon nga dita e parë e muajit janar të vitit

⁸⁰ Costin M.N., *Marile Instituții ale dreptului civil român, vol I-III, Persoana fizică și persoana juridică*, Ed. Dacia, Cluj Napoca, 1983-1984, f. 345.

⁸¹Neni 22 i Kodit Civil.

të mëpasshëm. Në të gjitha rastet, kur shpallet vdekja e një personi të zhdukur, caktohet edhe dita se kur ka ngjarë ajo. Gjykimi i shpalljes së zhdukur dhe i vdekjes së një personi sipas Kodit të Procedurës Civile është një gjykim i posaçëm. Në këtë mënyrë gjykata brenda afatit të 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës për gjykim është e detyruar që t'i dërgojë një kopje të saj bashkisë ose komunës ku ka pasur vendbanimin e fundit personi që kërkohet të shpallet i zhdukur ose i vdekur, për t'a shpallur në një vend të dukshëm.

Kërkesa e mësipërme botohet në Fletoren Zyrtare si dhe të paktën në njërën nga gazetatat lokale. Shqyrtimi i çështjes nga gjykata nuk mund të bëhet pa kaluar 6 muaj nga shpallja e kërkesës ose botimi i saj në Fletoren Zyrtare⁸². Vendimi i gjykatës që e deklaroi një person të zhdukur ose të vdekur i dërgohet për regjistrim zyrës të gjendjes civile në të cilën ai ka qenë i regjistruar, pasi të sigurohet se është bërë publikim i tij sipas nenit 381 të Kodit të Procedurës Civile. Shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes së një personi është e lidhur ngushtë edhe me pasojat që do të shtrihen mbi pasurinë e tij⁸³.

Sipas nenit 16 të Kodit Civil, për administrimin e pasurisë të personit të shpallur si i zhdukur caktohet një kujdestar. Me shpalljen e vdekjes të një personi kuptohet që do të çelet trashëgimia kundrejt trashëgimtarëve të tij. *Kujdestari kërkon kryerjen e inventarit të pasurisë trashëgimore, merr masa për administrimin e pasurisë, ushtron të drejtën e padisë dhe u përgjigjet padive në lidhje me këtë pasuri, depoziton në bankë paratë që ndodhen në trashëgim ose që rrjedhin prej tij, kryen veprime të tjera të kësaj natyre dhe jep llogari në mbarim të administrimit*⁸⁴.

Mund të ndodhë që personi, i cili është shpallur i vdekur të dalë se është gjallë. Në këtë rast, me kërkesën e tij ose të çdo interesuari, vendimi i dhënë për shpalljen si i vdekur prishet nga gjykata që e ka dhënë. Personi që del se është gjallë, ka të drejtë të kërkojë pasurinë e tij dhe pasurinë e fituar me anë të saj nga ata që e kanë fituar për shkak të shpalljes së tij si i vdekur, por edhe nga personat e tretë në kufijtë dhe kushtet që parashikohen në Kodin Civil dhe në Kodin e Familjes.

Kështu, sipas Kodit Civil, nuk kthehen sendet e luajtshme të fituara me mirëbesim dhe kundrejt shpërblimit edhe sikur tjetërsuesi të mos ishte disponues i tij, apo në rastet e fitimit të pronësisë mbi një send në kushtet e parashkrimit fitues⁸⁵. Në këtë rast, ai që i ka fituar ato në këto kushte ligjore, bëhet pronar i sendeve.

Kur bashkëshorti që është shpallur i vdekur del se është gjallë, martesë e mbaruar me shpalljen e vdekjes bëhet përsëri e vlefshme, përveçse kur bashkëshorti tjetër ka lidhur martesë të re⁸⁶. Në shqyrtimin e kërkesës ose prishjen e vendimit që ka deklaruar një person si të vdekur duhet të thirren personat që kishin kërkuar deklarinimin e vdekjes dhe personat që kanë fituar të drejta nga deklarimi i vdekjes.

⁸²Neni 227 i Kodit të Procedurës Civile.

⁸³ Latifi, Juliana; op. cit., f. 57.

⁸⁴ Neni 345 i Kodit Civil.

⁸⁵ Kondili, Valentina; op. cit., f. 123-124.

⁸⁶ Neni 123, 124 i Kodit të Familjes.

Në rastin e së drejtës italiane, shpallja i vdekur i personit fizik bëhet në qoftë se kanë kaluar 10 vjet nga dita e lajmit të fundit të të zhdukurit. Në këtë rast, gjykata mund të deklarojë vdekjen e prezumuar e gjithashtu mund të deklarojë zhdukjen edhe në qoftë se kjo nuk ishte deklaruar më parë. Ky vendim gjyqësor prodhon të njëjtat efekte të vdekjes natyrore dhe i prodhon ato që nga data e vdekjes së prezumuar. Kjo është data nga e cila çelet edhe trashëgimia. Ata që ishin vënë në posedim e përkohshëm të sendeve, fitojnë disponibilitetet të plota. Bashkëshorti mund të lidhë martesë të re.⁸⁷ Megjithatë mund të ndodhë që personi i prezumuar i vdekur mund të rishfaqet. Në këtë rast atij i duhen kthyer të gjitha sendet, por në gjendjen në të cilën ato ndodhen. Në qoftë se sendet janë shitur, ai ka të drejtën e atyre sendeve në të cilat çmimi i shitjes është investuar. Por, në qoftë se fitimi i realizuar nga shitja është konsumuar, ai nuk ka asnjë të drejtë. Martesa e bashkëshortit humbet efektin e saj dhe rifiton fuqi lidhja martesore e mëparshme.

Në rastin e së drejtës të Republikës të Kosovës që një person të shpallet i vdekur duhet të plotësojë dy kushte: së pari ai duhet të mungojë për një periudhë të caktuar nga banesa dhe së dyti të ketë fakte të qarta që ai person nuk është gjetur dhe nuk është gjallë. Sipas Kodit Civil të Republikës të Kosovës, kushtet për shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur, janë:

- *gjatë pesë viteve të fundit nuk ka asnjë informacion për të dhe ka mbushur moshën 70 vjeç;*
- *ekzistojnë fakte të mjaftueshme që provojnë se nuk është gjallë;*
- *personi i cili është zhdukur në fatkeqësi natyrore ose ndonjë rrezik tjetër të drejtpërdrejtë për jetën dhe nuk ka asnjë lajm gjatë 6 muajve nga dita e përfundimit të rrezikut;*
- *personi i zhdukur në luftë ose në rrethana lufte dhe për jetën e tij nuk ka asnjë lajm gjatë një viti nga mbarimi i luftës.*

Në rastin e së drejtës së Republikës së Maqedonisë, rrethanat për vdekjen e prezumuar përcaktohen me ligj. Sipas këtij ligji, një person shpallet i vdekur në rast se në 5 vitet e fundit nuk ka asnjë lajm për atë dhe jetën e tij, sikurse dhe ka një moshë më të madhe se 60 vjet.

Mosha 60 vjeçare, si një prej rrethanave ligjore për shpalljen e një personi të zhdukur për të vdekur në formë shprehimore parashikohet në shumë legjislacione. *Në Republikën e Malit të Zi* aplikohet e njëjta moshë. *Në Republikën e Serbisë* mosha e personit si rrethanë dhe kusht ligjor, tek shpallja e personit të zhdukur dhe të vdekur rritet në 70 vjet.

Përfundim nga rregullat që përmendëm më sipër, ligji bën në ato raste kur, një person që ka humbur gjatë veprimeve luftarake dhe kjo humbje vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, në rast se ka kaluar pa patur lajme një vit nga mbarimi i veprimeve luftarake. Në këtë mënyrë ai mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, pa qenë nevoja të shpallet më parë i zhdukur. Gjithashtu edhe personi i cili është zhdukur në

⁸⁷ Galgano, Francesco; op. cit., f. 90.

fatkeqësi natyrore ose ndonjë rrezik tjetër të drejtpërdrejtë për jetën dhe nuk ka asnjë lajm gjatë 6 muajve nga dita e përfundimit të rrezikut⁸⁸ shpallet i vdekur.

Kërkesa për shpalljen e personit të vdekur bëhet sipas Kodit të Procedurës Civile. Data e vendimit gjyqësor konsiderohet edhe si data e vdekjes të personit fizik. Në qoftë se vendimi nuk përmban edhe orën e vdekjes atëherë llogaritet që ora e vdekjes është ora e fundit e ditës të shpallur si dita e vdekjes. Në qoftë se personi i shpallur i vdekur, është në jetë atëherë mund të kërkohet në çdo moment pavlefshmëria e vendimit të shpalljes si i vdekur. Personi i deklaruar si i vdekur mund të kërkojë kthimin e të gjitha sendeve të tij.

Edhe në të drejtën ndërkombëtare private është trajtuar gjerësisht lindja dhe vdekja e personit fizik. Në këtë mënyrë, ato janë konsideruar si skajet e ekzistencës së personit fizik, për të kaluar më pas në mungesën e tij apo në vdekjen e prezumuar⁸⁹. Lindjen e personit e kanë trajtuar shumë legjislacione të botës. Disa legjislacione si kusht për fillimin e personalitetit të një personi, kërkojnë atë të lindjes duke u shkëputur nga organizmi i nënës, ndërsa legjislacionet e tjera kërkojnë që fëmija të jetojë përtej kufirit 24 orësh pas lindjes së tij. Momentin e vdekjes së personit shumë legjislacione civile të shteteve të botës nuk e kanë specifikuar. Përveç vdekjes natyrore, e cila mund të konstatohet materialisht, fundi i një personi nga ana juridike mund të vendoset edhe me anën të një vendimi gjyqësor në një procedurë të veçantë, në rastin e zhdukje së tij, duke deklaruar në këtë mënyrë në gjykatë shpalljen e personit të zhdukur ose vdekjen e prezumuar⁹⁰.

Deklarimi ose shpallja e personit si të pagjetur dhe vdekja e prezumuar janë dy institute të lidhura midis tyre. Të dyja institutet ndjekin të njëjtën linjë, atë të zhdukjes të personit ose atë të pushimit të ekzistencës së personalitetit të tij, me anë të një deklarimi gjyqësor, që procedon në dhënien e një vendimi përfundimtar me pasoja juridike të shprehura në ligj.

Ligji që deklaron mungesën apo vdekjen e prezumuar të personit është ai i shtetësisë, i cili duhet të përcaktojë se në cilat raste, mund të bëhet një deklarim i tillë dhe cilat do të jenë pasojat juridike të këtij deklarimi. Në këtë mënyrë në qoftë se do të bëhej fjalë për shtetasit shqiptarë, gjykatat tona pa marrë parasysh elementin e huaj në marrëdhënien juridike (si për shembull, vendin e zhdukjes së personit, vendbanimin e fundit kur ai u zhduk, etj.) do të aplikojnë dispozitat e kodit tonë civil i cili parashikon këto rrethana. Në qoftë se do të bëhej fjalë për të huaj, përsëri do të aplikohet ligji shtetëror përkatës⁹¹.

E drejta ndërkombëtare është përpjekur që të gjejë ligjin e zbatueshëm në rastin e deklarimit të shtetasit si i zhdukur, por edhe për deklarimin e vdekjes së prezumuar. Ligji i aplikueshëm, e gjen veten në ligjet e së drejtës ndërkombëtare procedurale. Sigurisht që nuk mund të anashkalojmë edhe kompetencat e gjykatave të shteteve përkatëse. Në nenin

⁸⁸ Kadriu, Osman; op. cit., fq .172.

⁸⁹ Kalia, Ardian. *E Drejta Ndërkombëtare Private*. Shtëpia Botuese, Flesh, Tiranë, 2010, f. 81.

⁹⁰ Ibid, f. 81.

⁹¹ Ibid, f. 82.

12 të ligjit Nr. 3920, datë 21.11.1964 “Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt” thuhet se, për shtetasit e shteteve, me të cilat Shqipëria nuk ka nënshkruar ndonjë konventë, në raste të deklarimit të zhdukjes apo të shpalljes si të vdekur të tyre, do të aplikohet *lex patria* apo ligji i shtetësisë të këtyre shtetasve.

Disa autorë theksojnë se, gjykatat e një shteti mund të deklarojnë vetëm zhdukjen ose vdekjen e prezumuar të shtetasve të tyre dhe jo të shtetasve të huaj. Disa autorë të tjerë janë të mendimit se gjykatat mund të deklarojnë zhdukjen ose vdekjen e prezumuar të një shtetasi të huaj, por me kushtin që rregullimi juridik të bëhet më anë të praktikës gjyqësore. Normat juridike që lidhen me formën e zhvillimit të gjykimit mund të reduktohen vetëm brenda kufijve të *lex fori*. Nga ana tjetër normat që lidhen me kompetencën e gjyqtarit në procedime të tilla si, deklarimi i zhdukjes apo i shpalljes të vdekur të personit, nuk janë të përfshira vetëm në kufijtë e *lex forit*, por i kapërcejnë kufijtë e legjisllacionit të një shteti të dhënë.

6.4 Situata e komorientëve

Mbarimi i zotësisë juridike në rastin personave fizikë, të cilët janë zhdukur ose kanë vdekur nën të njëjtat rrethana, pa u përcaktuar fakti se kush ka vdekur i pari ose kush i ka mbijetuar njëri-tjetrit, shfaq një interes të madh. Në të drejtën romake, situata e komorientëve (*commorientes, simul periunt*) prezumohejse personat më të fortë nën këndvështrimin e gjinisë dhe moshës kishin mbijetuar. Në këtë mënyrë, përsa i përket trashëgimisë, këta persona të cilët konsideroheshin të gjallë ditën e çeljes të trashëgimisë, kishin të drejtën që të trashëgonin⁹². Në qoftë se komorientët nuk kishin lidhje fisnore konsideroheshin që ata kishin vdekur në të njëjtën kohë.

Në të drejtën shqiptare, Kodi Civil në nenin 20 të tij shprehet se: “Kur dy ose më shumë persona kanë vdekur dhe nuk mund të provohet kush prej tyre ka vdekur më parë, për efekte juridike, quhet se të gjithë kanë vdekur në një kohë”. Ky parim ka rëndësi praktike pasi këta persona nuk trashëgojnë njëri-tjetritin, dhe për rrjedhojë për secilin do të çelet trashëgimia testamentare ose ligjore duke mos trashëguar njëri tjetritin⁹³.

Përcaktimi i kohës së vdekjes ka rëndësi praktike sepse:

- përcakton përbërja e pasurisë trashëgimore, e cila përfshin të drejtat dhe detyrimet që u kalojnë trashëgimtarëve;
- përcakton rrethin e trashëgimtarëve;
- përcakton afatet që zbatohen për institute të caktuara në marrëdhëniet juridike të trashëgimisë, si heqja dorë nga trashëgimia apo ngritja e padisë për kërkimin e trashëgimit;
- përcakton ligjin e kohës kur është çelur trashëgimia.

Në vende të tjera, si Francë apo Maqedoni, për të përcaktuar renditjen e vdekjes duhet që të marrim në konsideratë moshën dhe gjininë. Konform këtyre kriterëve,

⁹² Dimitrescu, Gr., *Drept roman. Obligatiumi, succesiumi*, Bukuresht, 1936, f. 38.

⁹³ Kondili, Valentina; op. cit., f. 123.

prezumohet se personi më i ri në moshë i ka mbijetuar më të moshuarit dhe personi i gjinisë mashkullore i ka mbijetuar personit të gjinisë femërore. Të dyja këto kritere merren parasysh nga e drejta civile e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Çështja e komorientëve konform kritereve të përmendura më sipër ka qenë e rregulluar me dispozita konkrete në disa shtete. Për këtë çështje janë shprehur dispozitat e neneve 720-722 të Kodit Civil të Francës dhe dispozitat e paragrafit 52 të Kodit Civil të Serbisë të vitit 1844. Dispozitat e nenit 6 të Kodit Civil të Etiopisë, janë të njëjta me dispozitat e nenit 20 të Kodit Civil të Shqipërisë.

Hipoteza e moshës dhe gjinisë ka prodhuar edhe kontradikta të cilat janë kritikuar nga doktrina dhe autorët e së drejtës. Në këtë mënyrë, në qoftë se në një aksident automobilistik kanë vdekur e bija dhe i ati, atëherë duke u nisur nga kriteri i moshës na rezulton se vajza i ka mbijetuar të atit. Por, duke u nisur nga kriteri i gjinisë na rezulton se i ati i ka mbijetuar të bijës. Si konkluzion duhet të jetë se e bija i ka mbijetuar të atit dhe për këtë arsye do të duhen prova dhe fakte të reja, për përcaktimin e renditjes së vdekjes. Pikëpamja tjetër që sot dominon teorinë e së drejtës civile në rastin e komorientëve qëndron në faktin se ata do të konsiderohen se kanë humbur jetën në të njëjtën kohë.

Kodi Civil i Rumanisë nuk ka adoptuar dispozitat e neneve 720-722 të Kodit Civil të Francës, i cili përdorte kriteret e moshës dhe të gjinisë për të prezumuar se cili nga personat ka vdekur i pari dhe cili ka mbijetuar. Në rastin kur nuk provohej se cili kishte vdekur i pari, atëherë pasuria nuk kalonte nga njëri tek tjetri.

Në *sistemin francez* të së drejtës, në rastin e vdekjes të më shumë personave nën të njëjtat rrethana, fillimisht kërkoheshin prova në vendngjarje për të përcaktuar se cili person ka vdekur i pari. Kur mungonin këto prova atëherë respektoheshin kriteret e moshës dhe të gjinisë. Në këtë mënyrë, në qoftë se të gjithë të implikuarit ishin më të vegjël se 15 vjeç, do të prezumohej se kishte mbijetuar personi më i madh në moshë. Në qoftë se personat ishin më të mëdhenj se 60 vjeç, do të prezumohej se ka mbijetuar personi më i ri në moshë. Në rastin kur disa persona ishin më të vegjël se 15 vjeç dhe disa të tjerë më të mëdhenj se 60 vjeç, atëherë prezumohej se të parët kishin mbijetuar. Në situatën kur shumë persona kanë vdekur së bashku dhe kanë mbushur moshën 15 vjeç, por janë më të vegjël se 60 vjeç, atëherë burri prezumohet që ka mbijetuar në rastin kur ata kanë të njëjtën moshë ose kur diferenca ndërmjet tyre është një vit. Në qoftë se ata kanë të njëjtën gjini atëherë prezumohet se më i riu i ka mbijetuar më të madhit në moshë.

Në këtë mënyrë doktrina na demonstroi se në situatën e komorientëve duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) *dy ose më shumë persona të kenë vdekur në të njëjtat rrethana;*
- b) *në këto kushte të mos jetë e mundur që të përcaktohet se cili ka vdekur i pari;*
- c) *personat duhet që të trashëgojnë njëri-tjetrin dhe për këtë arsye është mjaft e rëndësishme që të përcaktohet koha e vdekjes të personave.*

Në përgjithësi, vërtetimi i kohës së vdekjes bëhet me anën e çdo prove. Megjithatë, ekzistojnë rrethana kur një vërtetim i tillë është i pamundur, ashtu sikurse është edhe situata e komorientëve. Një situatë të kësaj natyre na paraqet vdekja e dy personave të cilët trashëgojnë njëri-tjetrin në një aksident rrugor. Ndodhemi përpara një fakti, ku nuk mund të përcaktojmë se cili person i ka mbijetuar tjetrit. Në këtë moment vdekja është e sigurtë, por nuk dihet koha kur kanë vdekur të dy personat. Me shumë rëndësi është fakti se cili nga këta ka mbijetuar qoftë edhe për pak çaste, në mënyrë që kjo mbijetesë t'i ketë dhënë cilësinë e trashëgimtarit, personit të mbijetuar. Fitimi me anën e mbijetesës të të gjitha të drejtave transmetohet tek trashëgimtarët e tjerë.

7. Përmbajtja e zotësisë juridike të personit fizik

7.1 Konsiderata të përgjithshme

Zotësia juridike përfaqëson aftësinë e njeriut për të qenë titullar i të drejtave dhe detyrimeve. Ashtu sikurse e kemi përmendur, zotësia juridike paraqet edhe një subjektivitet juridik ose personalitet juridik⁹⁴. Në të gjitha doktrinën, zotësia juridike përkufizohet si aftësia e njeriut për të pasur të drejta dhe detyrime por në asnjë prej tyre nuk specifikohen se cilat janë këto të drejta dhe detyrime, duke theksuar në këtë mënyrë karakterin e përgjithshëm të tyre. Në këtë mënyrë, kuptojmë se personi fizik është destinacioni i të gjitha të drejtave. Zakonisht të drejtat subjektive dhe detyrimet civile paraqiten të ndara përsa i përket metodologjisë, sepse në realitet ato janë të pandara. Çdo të drejtë i korrespondon një detyrim civil dhe çdo detyrim i korrespondon një e drejtë subjektive civile.

Ashtu sikurse e dimë, të drejtat subjektive civile ndahen në të drejta pasurore dhe të drejta jopasurore. Në këtë mënyrë është e drejtë pasurore, e drejta e pronës, e drejta e trashëgimisë, etj.

E drejta subjektive jopasurore, sikurse është e drejta e autorit, e cila përfshin dhe mbron të drejtat vetjake jopasurore të autorit, duke siguruar respektin ndaj cilësive të tij intelektuale dhe personale në punë dhe të drejtat pasurore të autorit në lidhje me interesat e tij ekonomikë⁹⁵. Në këtë kontekst disa të drejta të tjera janë: a) e drejta e bërjes publike të veprës; b) e drejta e njohjes dhe përmendjes së autorësisë; c) e drejta e nderit, personalitetit dhe reputacionit; ç) e drejta e pronësisë intelektuale. Gjithashtu, edhe e drejta e emrit është një tjetër e drejtë jopasurore e njeriut.

7.2 Kufizimet e zotësisë juridike të personit fizik

Për të përcaktuar përmbajtjen e zotësisë juridike, duhet të kemi gjithmonë parasysh të gjitha aktet normative të cilat konsiderohen si burim i së drejtës civile.⁹⁶ Shtrirja reale e përmbajtjes së zotësisë juridike të njeriut, sigurisht që përballet edhe me disa kufizime.

⁹⁴ Galgano, Francesco; op. cit., f. 86.

⁹⁵ Neni 20, Ligji 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

⁹⁶ Cercel, S. *Drept civil. Patrimoniul. Posesia. Proprietatea*, Editura Universitaria, Krajovë, 2002, f. 54.

Personit fizik nuk mund t'i kufizohen të drejtat civile, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj. Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile⁹⁷. Edhe pse në konceptin aktual, zotësia juridike është një nocion i cili nuk njeh kufizime (*është një zotësi e plotë dhe jo e limituar nga norma juridike*), sistemi juridik me anën e disa përjashtimeve, ka pranuar kufizimin e kësaj zotësie.

Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Kushtetuta, mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast, ato nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁹⁸. Pra, në këtë mënyrë Kushtetuta ka parashikuara të gjitha rastet, kur mund të kufizohen këto të drejta.

Të gjitha kufizimet e zotësisë juridike duhet të jenë të parashikuara në dispozita ligjore dhe në pamje të parë na duken të shumta, por nuk duhet të harrojmë se të drejtat dhe detyrimet civile janë në parim të pakufizuara dhe personat fizikë në të drejtën civile, janë të lirë që të përfshihen në çdo lloj angazhimi juridik⁹⁹.

Kufizimet e zotësisë juridike mund të klasifikohen sipas kriterëve të mëposhtme¹⁰⁰:

- *Sipas mënyrës të përfundimit të kufizimeve:*
 - a) kufizime me karakter sanksioni;
 - b) kufizime me karakter masash mbrojtëse të personit fizik.

- *Sipas mënyrës sesi këto kufizime operojnë ndahen në:*
 - a) kufizime të cilat operojnë me të gjitha të drejtat (*ope legis*);
 - b) kufizime të cilat operojnë në bazë të një vendimi gjyqësor.

- *Sipas burimit të së drejtës ato mund të ndahen:*
 - a) kufizime të parashikuara nga ligji civil;
 - b) kufizime të parashikuara nga ligji penal.

7.2.1 Kufizime me karakter sanksioni

Këto lloj kufizimesh ndahen në kufizime të cilat shoqërohen me dënime penale dhe në kufizime të cilat shoqërohen me dënime civile. Dënimi është një ndëshkim që i shkaktohet individit që ka kryer një krim, nga autoriteti shtetëror. Dënimi është i nevojshëm dhe i domosdoshëm, pasi siguron shoqërinë që kriminelin po merr atë që i

⁹⁷ Neni 6 i Kodit Civil.

⁹⁸ Dispozitat e nenit 17 të Kushtetutës së Shqipërisë të viti 1998.

⁹⁹ Petit, B. *Introduction general au droit, sixième édition*, Presses universitaires de Grenoble, 2006, f. 112.

¹⁰⁰ Nedelcu, Iulian. *Drept Administrativ si elemente de stiinta administratiei*, Universul Juridic, Bukuresht, 2009, f. 243.

takon¹⁰¹. Kodi Penal i Republikës të Shqipërisë në kreun V të tij, përmban të gjitha dënimet të cilat aplikohen mbi personin fizik. Dënimi është një metodë shtrënguese dhe një mjet riedukimi i të burgosurit. Nëpërmjet vuajtjes të dënimit synohet gjithmonë që të arrihet një qasje tjetër e të dënuarit në raport me punën, shoqërinë, rendin publik dhe bashkëjetesën në komunitet. Sipas nenit 29 të Kodit Penal për personat që kanë kryer krime jepen këto dënime kryesore: a) me burgim të përjetshëm; b) me burgim; c) me gjobë. Gjithashtu për personat që kanë kryer kundërvajtje penale jepen këto dënime kryesore: a) me burgim; b) me gjobë.

Sipas nenit 30 të Kodit Penal për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese sikurse janë¹⁰²: a) ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike; b) konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale; c) ndalimi për të drejtuar automjete; ç) heqja e dekoratave, titujve të nderit; d) heqja e së drejtës të ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie; dh) heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë; e) ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative; ë) nxjerrja jashtë territorit; f) detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor; g) humbja e përgjegjësisë prindërore.

Ashtu sikurse e shohim, dënimi plotësues shkakton humbjen e përgjegjësisë prindërore tek personi fizik. Humbja e përgjegjësisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore, kur ai dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një veprë penale ndaj fëmijës ose si bashkëpunëtor me fëmijën në kryerjen e një veprë penale¹⁰³. Në çdo rast përgjegjësia prindërore mund të kthehet me vendim të gjykatës, kur pushon shkaku për të cilin është hequr kjo përgjegjësi. Në këtë mënyrë, është vetë gjykata e cila u jep prindërve përsëri të drejtat për mirëritje, edukim dhe arsimimin e fëmijës.

Nga ana tjetër, bëjnë pjesë në gamën e kufizimeve me anën e disa dënimeve të karakterit civil edhe ato kufizime në fushën e trashëgimisë. Në këtë mënyrë sipas nenit 322 të Kodit Civil nuk mund të trashëgojë si i padenjë: a) ai që me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij; b) ai që ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një veprë penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rreme në një gjykim penal; c) ai që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rreme ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve. Që një person të përjashtohet nga trashëgimia është e domosdoshme që ai të deklarohet si i padenjë për të trashëguar trashëgimlënësin me vendim të gjykatës mbi kërkesën e trashëgimtarëve të tjerë¹⁰⁴.

¹⁰¹ Ikononi, Luljeta, *Filozofia e së Drejtës*, Shtëpia Botuese Onufri, Tiranë, 2010, f. 299.

¹⁰² Elezi, Ismet. Kaçupi, Skënder. Haxhia, Maksim, *Komentari i Kodit Penal së Republikës së Shqipërisë*, Shtëpia Botuese West Print, Tiranë 2009, f. 202.

¹⁰³ Neni 223 i Kodit të Familjes.

¹⁰⁴ Kondili, Valentina; op. cit., f. 206.

KAPITULLI III

ZOTËSIA PËR TË VEPRUAR E PERSONIT FIZIK

1. Nocione hyrëse

1.1 Përkufizime dhe rregullime juridike

Zotësia për të vepruar përkufizohet si në Kodin Civil, po ashtu edhe në doktrinë. Sipas Kodit Civil: “*Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile*”. Nga ana tjetër, doktrina ka dhënë disa përkufizime të zotësisë për të vepruar të cilat ndryshojnë pjesërisht sa nga një autor tek tjetri.

Autorët e së drejtës janë të opinionit që përkufizimi i zotësisë për të vepruar, duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementët e mëposhtëm: a) lidhja që duhet të ketë kjo lloj zotësie me zotësinë civile të vetë njeriut; b) zotësia për të vepruar presupozon kryerjen e veprimeve juridike civile dhe jo kryerjen e veprimeve juridike që u përkasin degëve të tjera të së drejtës; c) kryerja e veprimeve juridike nuk parashikon vetëm ushtrimin e të drejtave dhe marrjen përsipër të detyrimeve civile, por edhe fitimin e të drejtave subjektive civile sikurse edhe ekzekutimin e detyrimeve civile¹⁰⁵.

Duke u nisur nga këto elemente, zotësia për të vepruar është ajo pjesë e zotësisë civile të njeriut, e cila konsiston në aftësinë e këtij të fundit, për të fituar dhe ushtruar të drejtat civile sikurse edhe për të ekzekutuar detyrimet civile nëpërmjet veprimeve juridike. Zotësia për të vepruar, në literaturën juridike emërtohet edhe me termin zotësi vepruese, kurse në disa raste përdoret edhe termi zotësia punuese¹⁰⁶.

Zotësia vepruese nënkupton, aftësinë dhe mundësinë e një personi fizik, që ai me deklarin e tij të lirë të mund të shkaktojë pasoja juridike në krijimin, ndryshimin, mbartjen ose shuarjen e të drejtave subjektive civile. Ky është përkufizimi i gjerë për zotësinë për të vepruar. Zotësia për të vepruar është e lidhur ngushtë me zotësinë juridike. Kjo gjë ndodh për shkakun se personi fizik nuk mund të ketë zotësi për të vepruar, në qoftë se nuk ka zotësi juridike. E kundërta është e mundshme. Kjo do të thotë se një person mund të ketë zotësi juridike por mund të mos ketë zotësi për të vepruar.

¹⁰⁵ Urs I. , Angheni S. *Drept civil. Partea generală. Persoanele*, vol. I, Ed. Oscar Print, Bukuresht 1999, f. 124.

¹⁰⁶ Kadriu, Osman; op. cit., f. 175.

Hyrja në marrëdhëniet juridike e njeriut, mund të bëhet me anën e fakteve juridike ose nëpërmjet kryerjes të veprimeve juridike. Fakt quhet çdo sjellje e njeriut, ngjarje shoqërore ose fenomen i natyrës, të cilit ligji i ngarkon një pasojë juridike¹⁰⁷.

Veprimet juridike janë manifestime të vullnetit të lirë të cilat janë kryer me vetëdije nga ana e personit fizik dhe kanë si synim kryesor, prodhimin e disa efekteve juridike. Si rezultat nuk është e mjaftueshme që të ekzistojë vetëm një subjekt i së drejtës, por duhet që personi fizik të ketë arritur edhe një moshë të caktuar. Ashtu sikurse askujt nuk mund t'i mohohet zotësia juridike edhe realiteti ka demonstruar se zotësia për të vepruar fitohet me arritjen e një moshe të caktuar.

Ligji civil ka përcaktuar ndryshimin ndërmjet “ekzistencës të thjeshtë të personit”, e cila është e mjaftueshme për t'i dhënë këtij të fundit cilësinë e subjektit të së drejtës dhe “aftësisë për të vepruar në mënyrë të përgjegjshme”, e mjaftueshme për t'i akorduar personit fizik aftësinë për t'u angazhuar juridikisht, duke kryer veprime juridike.

Në doktrinë, me të drejtë është trajtuar koncepti i të dy zotësive duke klasifikuar zotësinë juridike, si ajo zotësi e cila i jep të drejtën personit fizik që të ketë cilësinë e subjektit të së drejtës, por gjithashtu prevalon fakti se zotësia për të vepruar kërkon domosdoshmërisht, arritjen e një kufiri të moshës, pra, pjekurisë të njeriut, me ndihmën e së cilës ky njeri do të demonstrojë vullnetin e tij duke kryer veprime juridike.

Në përbërjen e zotësisë për të vepruar nuk është e mjaftueshme vetëm aftësia abstrakte e personit që të jetë pjesë e një akti juridik, aftësi e cila ekziston tek zotësia juridike, por aftësia e personit që të kryejë i vetëm veprime juridike dhe jo nëpërmjet personave të tjerë ose me pëlqimin e tyre¹⁰⁸. Pikërisht, ky është edhe thelbi i zotësisë për të vepruar, të cilën do t'a analizojmë edhe në vazhdim, thelb i cili shpreh aftësinë e personit fizik si subjekt i së drejtës që të kryejë i vetëm dhe në mënyrë individuale veprime juridike dhe jo me ndërmjetësimin ose ndihmën e personave të tjerë. Zotësia për të vepruar, ashtu sikurse edhe zotësia juridike, është rregulluar ligjërisht në shumë akte normative dhe kode sikurse janë Kodi Civil, Kodi i Familjes dhe Kodi i Procedurës Civile.

Në këtë mënyrë Kodi Civil, në nenet 6-10, parashikon, si më poshtë vijon:

“Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile.

Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe gruaja që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Ajo nuk e humbet këtë zotësi edhe kur martesa është deklaruar e pavlefshme ose është zgjidhur para se të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç”.

Edhe në Kodin e Familjes zotësia për të vepruar është trajtuar në nenet 307-313 të cilët shprehen se: “Gjykata, në vendimin për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të

¹⁰⁷ Neni 7 i Kodit të Procedurës Civile.

¹⁰⁸ Deak, Fr. *Drept civil. Contracte speciale*, Editura Actami, Bukuresht, 1996, f. 23-25.

vepruar, cakton dhe kujdestarin për personin që i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar”.

Kodi i Procedurës Civile. gjithashtu ka parashikuar në nenet 382-387 se: *“Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar bëhet me kërkesë të bashkëshortit, gjinisë së afërt, të prokurorit, si dhe të personave që kanë interes të ligjshëm për këtë fakt. Kërkesa i paraqitet gjykatës së vendit ku ka banimin personi që kërkohet t’i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar”.*

1.2 Premisat dhe llojet e zotësisë për të vepruar

Zotësia për të vepruar ka dy premisa kryesore të cilat përmbushin ekzistencën e saj:

- a) *ekzistenca e zotësisë juridike të personit fizik;*
- b) *ekzistenca e aftësisë mendore të personit fizik.*

Në këtë kontekst premisa e parë nuk paraqet asnjë problem për aq kohë sa kemi konstatuar që në të drejtën moderne, karakteristika kryesore e zotësisë juridike është universaliteti i saj, pra është një zotësi të cilën e gëzojnë të gjithë njerëzit.

Premisa e dytë sigurisht që provokon një debat të gjerë rreth aftësisë mendore të njeriut me qëllimin e vetëm që të zbulohet, në qoftë se ky njeri ka aftësinë që të mendojë, gjykojë dhe të vlerësojë veprimet dhe pasojat. Duke qenë në fushën e së drejtës civile, me fjalë të tjera mund të themi, që aftësia mendore paraqet fuqinë e njeriut, e cila mund të kuptojë në mënyrë të përgjegjshme pasojat juridike civile, që kanë ardhur si rezultat i shprehjes të vullnetit të tij.

Ekzistenca fizike dhe biologjike e njeriut është element përcaktues për ekzistencën e tij juridike, por nuk është e mjaftueshme për të pasur “një jetë vetjake juridike”. Rregullimi ligjor i zotësisë për të vepruar në rastin e mungesës të aftësisë mendore ose ekzistencës së saj në një masë të pamjaftueshme, është realizuar në mënyrë të tillë që të mos kthehet kundër interesave të jetës juridike të personit në fjalë. “Aftësia mendore” është aftësia për të menduar dhe mësuar, si dhe aftësia e një individi për të kuptuar e jetuar me emocionet e veta dhe reagimet e të tjerëve.

Gjithashtu, mund të themi se “çrregullim i shëndetit mendor” është çrregullimi thelbësor i mendimit, perceptimit, orientimit ose kujtesës, që dëmtojnë sjelljen, gjykimin, kapacitetin për të njohur realitetin ose aftësinë e personit për të përmbushur kërkesat e jetës, çka e bën atë mendërisht të sëmurë, ose është prapambetja mendore, kur shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të papërgjegjshme¹⁰⁹. Aftësia mendore gjithashtu mund të cenohet edhe nga mbushja e një moshe të caktuar nga njeriu dhe si pasojë, kjo moshë sjell edhe disa çrregullime, të cilat ulin aftësinë e të gjykuarit të personit. Si konkluzion, mund të themi se aftësia për të menduar varet nga dy elementë bazë: a) nga moshja; b) shëndeti mendor.

¹⁰⁹Ligji Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”.

Për të kuptuar sa më saktë zotësinë për të vepruar, duhet që të fokusohemi tek zotësia juridike dhe aftësia mendore e personit fizik. Zotësia juridike fitohet nga personi fizik në mënyrë të pakushtëzuar dhe ai fiton të drejtat dhe detyrimet pavarësisht nga burimet e tyre, të cilat mund të jenë: ngjarje, veprime njerëzore ose veprime juridike. Në të kundërt, zotësia për të vepruar fitohet në raport me aftësinë mendore dhe është një zotësi, e cila ka si objekt ekskluziv veprimet juridike civile (ajo nuk ka lidhje me faktet juridike *stricto sensu*)¹¹⁰.

1.3 Llojet e zotësisë për të vepruar

Për të përcaktuar llojet e zotësisë për të vepruar, ligjvënësi ka marrë parasysh konsideratat që do t'i referohen aftësisë mendore, duke iu referuar edhe “eksperiencës së jetës” aq e nevojshme për një “jetë juridike vetjake”, e cila fitohet në mënyrë graduale me kalimin e kohës. Nisur nga mundësia e realizimit të të drejtave dhe ekzekutimit të detyrimeve juridike civile, pra nga zotësia për të vepruar, personat si subjekt i së drejtës civile ndahen në tre grupe:

- *Persona me zotësi të plotë për të vepruar;*
- *Persona me zotësi të kufizuar për të vepruar ose me zotësi të pjesshme për të vepruar;*
- *Persona të pazotë për të vepruar.*

Në grupin e parë bëjnë pjesë personat me zotësi të plotë për të vepruar, sipas përcaktimit të nenit 6 të Kodit Civil, pra persona që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe gratë që janë martuar nën këtë moshë. Ky rregullim bazohej në nenin të 14 të Kodit të Familjes, i cili ka qenë në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të Kodit Civil. Me hyrjen në fuqi të Kodit aktual të Familjes dhe më konkretisht në nenin 7 të tij është përcaktuar se: “*Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe*”.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë të gjithë ata persona që kanë zotësi të kufizuar për të vepruar. Edhe në këtë rast Kodi Civil në nenin 7 të tij përcakton se: “*I mituri, që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të tij ligjor. Megjithatë, ai mund të bëjë pjesë në organizata shoqërore, të disponojë atë që fiton me punën e tij, të depozitojë kursimet dhe t'i disponojë vetë këto depozita.*” Gjithashtu parashikohet që edhe personit madhor, që për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t'i kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës.

Në grupin e tretë bëjnë pjesë të gjithë ata persona, të cilët janë të pazotë për të vepruar. Në këtë rast Kodi Civil në nenet 8-10 të tij ka përcaktuar se: “*I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, është i pazoti për të vepruar. Ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty, si dhe*

¹¹⁰ Beleiu, Gheorghe; op. cit., f. 107-108.

veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundërshtim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi ligjor.”

Gjithashtu në këtë kontekst edhe i mituri me moshë katërbëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetë vjeç, i cili është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi të metë mendor, mund t'i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor. Edhe personit madhor, që për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t'i hiqet apo kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës.

Përpara se të analizojmë këto tre stadi të zotësisë për të vepruar më gjerësisht, do të analizojmë më parë karakteristikat juridike të kësaj zotësie.

1.3 Karakteristikat juridike të zotësisë për të vepruar

Zotësia për të vepruar është një pjesë e zotësisë civile dhe për këtë arsye gëzon edhe karakteristikat kryesore të kësaj sikurse janë: a) ligjshmëria; b) përgjithshmëria; c) paprekshmëria; d) patjetërsueshmëria¹¹¹. Nga ana tjetër, edhe dispozitat ligjore imponojnë idenë se edhe barazia është një tjetër karakteristikë juridike e zotësisë për të vepruar. Duhet të specifikojmë dhe të sqarojmë se karakteristikat juridike të mësipërme i referohen “zotësisë të plotë për të vepruar” dhe “zotësisë të kufizuar për të vepruar” sepse këto karakteristika nuk kanë kuptim në mungesë të zotësisë për të vepruar të personit fizik. Shihet qartë se, në qoftë se do t'a krahasojmë me zotësinë juridike, tek zotësia për të vepruar mungon karakteristika e universalitetit.

Në këtë mënyrë, zotësia për të vepruar nuk mund të gjejë aplikim tek të gjithë njerëzit, për vetë faktin se njerëzit që nuk kanë aftësi mendore, nuk mund të kenë as zotësi për të vepruar. Doktrina ka dëshmuar se ligjshmëria e zotësisë për të vepruar e personit fizik, do të thotë që fillimi dhe mbarimi i kësaj zotësie parashikohet sipas ligjit, kurse normat ligjore, të cilat u referohen këtyre aspekteve të zotësisë për të vepruar, kanë karakter urdhërues dhe si pasojë personat fizikë nuk mund t'u shmangen.

Zotësia për të vepruar është e patjetërsueshme dhe askush nuk mund të heqë dorë plotësisht ose pjesërisht nga ajo. Nëpërmjet paprekshmërisë të zotësisë për të vepruar kuptojmë faktin se askush nuk ka të drejtën të kufizojë këtë zotësi me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

Barazia e zotësisë për të vepruar e personit fizik vjen si rezultat i faktit që të gjithë njerëzit janë të barabartë. Edhe personat fizikë janë të barabartë përpara ligjit civil. Të gjithë personat pa dallim gjinie, race, feje, origjine etnike, niveli arsimor dhe kulturor kanë të njëjtën zotësi për të vepruar. Asnjë nga elementët të cilët përmendëm nuk ka influencë mbi zotësinë për të vepruar.

2. Pazotësia për të vepruar

¹¹¹ Dogaru, Ion. Draghici, Pompil. *Bazele dreptului civil, Volumul III, Teoria generala a obligatilor*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2009, f. 125.

2.1 Personat e pazotë për të vepruar dhe përfaqësimi i tyre ligjor

Në këtë rast Kodi Civil, në nenet 8-10 të tij, ka përcaktuar se, i mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, është i pazoti për të vepruar. Megjithatë, nga ky rregull ligji ka përcaktuar përjashtimet. Ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty, si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundërshtim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi ligjor, sepse në të kundërt veprimet e kryera prej tyre janë të pavlefshme¹¹².

Pasuria e të miturit që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç administrohet nga prindërit në dobi të fëmijës, kurse pasuria e të miturit që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç administrohet nga vetë i mituri, por gjithmonë me pëlqimin paraprak të prindërve ose të kujdestarit¹¹³. Disa veprime të cilat kapërcejnë kufirin e administrimit të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit si tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të çdo fëmije të mitur deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç, lënia hipotekë, ngarkimi me një barrë, marrja hua në emër të të miturit, heqja dorë nga trashëgimia apo legu ose mospranimi i një dhurimi, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe me autorizim të gjykatës së vendbanimit të të miturit¹¹⁴.

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar. Prindërit, kujdestari ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijëve nën moshën katërmëdhjetë vjeç, të personave nën kujdestarinë e tyre dhe të atyre që i kanë nën mbikëqyrje e me të cilët banojnë, por që nuk kanë zotësi për të vepruar, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit¹¹⁵.

Megjithatë, ka edhe raste të tjera kur i mituri duhet t'i kryejë vetë disa veprime sikurse është rasti i birësimit: *“Kur i birësuarit ka mbushur moshën dhjetë vjeç merret mendimi i tij dhe në moshën dymbëdhjetë vjeç kërkohet pëlqimi i tij”*. Gjithashtu, në këtë kontekst edhe i mituri me moshë katërmëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetë vjeç, i cili është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi të metë mendor, mund t'i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor.

Edhe personit madhor, që për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t'i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këta persona nuk janë të zotë për të pasur ndërgjegjen e shfaqjes të vullnetit të tyre dhe për pasojë nuk janë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e kryerjes së veprimeve të tyre. Të sëmurët psikikë janë ata persona që për shkak çekuilibrimesh psikike, kanë humbur zotësinë për të vepruar dhe

¹¹² Neni 232 i Kodit të Familjes: *“Prindërit përfaqësojnë fëmijën e tyre të mitur që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç në të gjitha veprimet juridike, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, i mituri mund t'i kryejë vetë.”*

¹¹³ Neni 233 dhe 272 i Kodit të Familjes.

¹¹⁴ Ibid, neni 234.

¹¹⁵ Neni 613 i Kodit Civil.

për të pasur ndërgjegje të qartë të veprimeve të tyre. Mbi të sëmuret mendore duhet të vendoset gjithmonë kujdestaria¹¹⁶.

Është mjaft e rëndësishme që të kuptojmë se Kodi Civil nuk ka parashikuar një tjetër kategori personash të cilët nuk kanë zotësi për të vepruar. Motivet të cilat legjitimojnë mungesën e zotësisë për të vepruar i referohen mungesës së aftësisë mendore dhe gjithashtu na tregojnë mënyrën sesi mbrohen ata persona të cilët nuk kanë aftësi mendore¹¹⁷. Në rastin e heqjes të zotësisë për të vepruar me vendim të gjykatës duket qartë se kjo gjë ndodh për shkak të një sëmundje mendore e cila prek jetën psikike të njeriut. Në këtë mënyrë heqja e zotësisë për të vepruar ka si qëllim suprem, mbrojtjen e të sëmurit psikik.

I tillë është edhe rasti i **vendimit nr. 739, datë 20.12.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhë**, me objekt heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin T.K., i datëlindjes 18.07.1967.

Pala kërkuese i është drejtuar gjykatës me anë të kësaj kërkesë duke pretenduar se shtetasi T.K. është i sëmurë prej vitesh, sëmundje e cila ka filluar gradualisht të rëndojë gjendjen e tij shëndetësore. Sipas kërkueses M.K., në seancën gjyqësore të datës 14.11.2016, të caktuar për shqyrtimin e padisë, bashkëshortja e të paditurit T.K. ka paraqitur një kërkesë me shkrim, duke njoftuar gjykatën se shtetasi T.K. nuk mund të marrë pjesë në gjykimin civil për shkak se vuan nga një sëmundje psikike, me kartelë mjekësore, i sëmurë psikik me diagnozë skizo-afektive depresive, me element paranoidë.

Në këto kushte, shtetësja M.K. i është drejtuar gjykatës me anë të kësaj kërkesë duke kërkuar që shtetasit T.K. t'i hiqet zotësia për të vepruar dhe t'i caktohet një kujdestar. Në cilësinë e provës, pala kërkuese ka paraqitur një përgjigje rekomandim të datës 14.11.2016 lëshuar nga mjeku në Evropë K.B., ku rezulton se ky mjek ka arritur në konkluzionin se, T.K. ka çrregullime skizo-afektive depresive me element paranoid. Aktualisht, është i paafte për të vepruar.

Gjykata, gjatë gjykimit thirri edhe shtetasin T.K., për të cilin kërkohet heqja e zotësisë për të vepruar, i cili u dëgjua nga ana e gjykatës. Gjithashtu, gjykata vendosi kryerjen e një ekspertimi psikiatriko-ligjor, duke caktuar si ekspert z. G.M.

Gjithashtu, pala kërkuese paraqiti si provë shkresën “Rekomandim” të lëshuar më datë 14.11.2016 nga mjekja e përgjithshme G.Gj. ku në këtë rekomandim citohet se: shtetasi T.K. ka çrregullime depresive psikotike, çrregullime të personalitetit, SPOK, hepatit. Mjekja G.Gj. u pyet edhe si dëshmitare nga ana e gjykatës, e cila deklaroi se shtetasi T.K. ka 2-3 vjet që e ka si pacient, ka marrë rekomandim për t'u vizituar dhe se merr vazhdimisht mjekim.

Ndërsa nga vërtetimi për sëmundje të përgjithshme me nr. 95640/2, datë 07.12.2016, lëshuar nga KMCAP Lezhë, rezulton se shtetasi T.K., plotëson kushtet për të përfituar të ardhura për invaliditet të plotë, nga data 01.01.2017 deri më datë 31.12.2017, sepse vuan nga sëmundja: çrregullime depresive persistente, me tipare psikotike, çrregullim i personalitetit. Invalidi nuk ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm të familjarit dhe se nuk

¹¹⁶ Kondili, Valentina; op. cit., f. 220-221.

¹¹⁷ Dogaru, Ion. Cercel, Sevastian, *Drept civil, Persoanele*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2007, f. 87.

është i aftë për asnjë lloj pune. Fakti që shtetasi T.K. përfiton pension invaliditeti për sëmundjen e mësipërme rezultoi edhe nga vërtetimi i lëshuar më datë 07.12.2016 të Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Lezhë.

Eksperti psikiatër, në aktin e ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. 104, ka arritur në këto konkluzione:

- Nga të dhënat e ekzaminimit objektiv rezultoi se shtetasi T.K. vuan nga sëmundja psikike e depresionit psikotik.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit mjekësor dhe të dhënat anamnezike konstatohet se sëmundja i është shfaqur para 22 vjetësh.
- Sëmundja psikike nga e cila vuan shtetasi T.K. e bën atë të paaftë të kuptojë rëndësinë e veprimeve juridiko-civile që kryen si dhe pasojat që rrjedhin prej tyre.
- Shtetasi T.K. ka nevojë për përkujdesje, pasi nuk është në gjendje që të kujdeset për veten e tij.

Në përfundim të gjykimit, gjykata, duke u bazuar në nenet 126 dhe 309 të Kodit të Procedurës Civile vendosi: Pranimin e kërkesës. Heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit T.K. Caktimin si kujdestare të shtetasit T.K., bashkëshorten e tij, Sh.K., e cila ngarkohet të përfaqësojë të gjykuarin T.K. në të gjitha veprimet juridike dhe të administrojë pasurinë e tij sipas ligjit.

Rast tjetër që mund të përmendet në këtë drejtim është edhe **vendimi nr. 1504, datë 30.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër**, që ka marrë për shqyrtim kërkesën e shtetasës Gj.L., e cila kërkonte heqjen e zotësisë për të vepruar dhe caktimin e kujdestarisë për shtetasin P.L.

Sipas kërkueses, bashkëshorti i saj, shtetasi P.L. është i paaftë të kujdeset për nevojat e veta. Ai prej vitesh, për shkak të një aksidenti automobilistik, nuk orientohet në kohë, nuk komunikoi as nuk lëviz, për më tepër, nga ana e institucioneve të posaçme shtetërore si KMCAP dhe ISSH ai është konstatuar si i paaftë për punë, duke u disponuar edhe me vendimet përkatëse për këtë fakt.

Sipas fletë drejtimit për KEMP ka rezultuar se P.L. vuan prej paralizës cerebrale post. coma cerebrale-status vegetans post contusion hemo. I është nënshtruar një trajtimi intensiv fillimisht në reanimacion e më pas në klinikën N/Kirurgji, Kanjule tracheotomie, sonde nasogastrike, kateter, subklavian, urinar etj. Nga ekzaminimi subjektiv ka rezultuar se nuk komunikoi, nuk orientohet në kohë dhe në hapësirë, nuk komandon defektimin, urinimin, ushqehet me sondë, nuk aktivizohet përveç se me ndihmën e familjarëve. Në këto kushte, ka rezultuar e nevojshme që të përcaktohet një kujdestar që të kryejë veprime lidhur me të sëmurin P.L.

Sipas mjekes së familjes A.Z., e cila e ka ndjekur prej vitesh shtetasin P.L., ka rezultuar se ai nuk flet, nuk komunikoi, nuk lëviz dhe pothuajse gjithë kohën e kalon në shtrat, është krejt i pavetëdijshëm. Nga deklarimi i mjekëve V.H. dhe G.N., të cilët u caktuan nga Gjykata me qëllim verifikimin e gjendjes shëndetësore dhe mendore të shtetasit P.L. rezultoi se shtetasi ai ka pësuar komocion cerebral, hemorragji cerebrale

dhe paralizë cerebrale pas aksidentit me motor në vitin 2005. Që nga ajo kohë, ai ka qenë në pozicion pasiv, në pamundësi për të lëvizur. Me të sëmurin nuk komunikohet fare, nuk ka orientim auto-psikik dhe alo-psikik, humori dhe emocionet janë të shpërlara.

Mjekja V.H. ka arritur në konkluzionin se:

- Shtetasi P.L. vuan nga komocion cerebral, hemorragji cerebrale dhe paralizë cerebrale;
- Shtetasi P.L. nuk është i aftë të kuptojë dhe të kryejë veprime ligjore pa ndihmën e kujdestarit ligjor të tij;

Gjykata, pasi pyeti edhe të sëmurin, konkludon në përfundimin se shtetasi P.L. për shkak të sëmundjes nga e cila vuan dhe shkallës së agravimit të saj, nuk arrin të kuptojë rëndësinë e veprimeve juridike që kryen dhe pasojat që i vijnë prej tyre.

Përfundimisht, gjykata ka vendosur: Pranimin e kërkesës. Heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit P.L., lindur dhe banues në Velipojë. Vendosjen e shtetasit P.L., nën kujdestarinë e bashkëshortes së tij, shtetases Gj.L.

Në një vendim tjetër gjyqësor nr. 992, datë 19.07. 2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër e cila ka marrë për shqyrtim kërkesën e shtetases D.K., e cila ka kërkuar heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin K.K. dhe caktimin si kujdestare të kërkueses.

Gjykata në këtë rast ka thirrur me cilësinë e personit të tretë shtetasen T.K., nënën e të sëmurit për ta pyetur në seancë, nga ku ajo ka deklaruar se është në pamundësi për t'u kujdesur për djalin e saj, pasi ka probleme shëndetësore dhe e ka të nevojshme të operohet. Ndërsa kërkuësja D.K. ka deklaruar se është tezhja të të sëmurit K.K. Sipas kërkueses ky shtetas vuan nga prapambetje mendore dhe është i paafte të kujdeset për nevojat e veta, prej vitesh është diagnostifikuar me këtë sëmundje mendore dhe për më tepër, nga ana e institucioneve të posaçme shtetërore si KMCAP dhe ISSH ai është konstatuar si i paafte për punë, duke u disponuar edhe me vendimet përkatëse për këtë fakt.

Nga deklarimi i mjekes V.H. e cila e ka kuruar atë ndër vite rezultoi që: Shtetasi K.K. që në moshë të hershme ka pasur infeksione të rënda, ka vazhduar me zhvillim të vonshëm psiko-motor, ka filluar të flasë në moshën 3 vjeçare dhe të ecë në moshën 4 vjeçare. Ka bërë 8 klasë shkollë në shkollën speciale "3 Dhjetori". Di të shkruajë emrin e tij, lexon ndonjë resht, por nuk ka aftësi riprodhuese. Komunikimi është i varfër. Nuk njuh orën, nuk njuh paranë. Është i varfër në mendime, flet me zë të ulët, është apatik. Ka çrregullime të sjelljes, shpesh herë dhe acarohet. I sëmuri është bërë vartës i prindërve. Po ashtu sipas vlerësimit të mjekes, i sëmuri ka prapambetje të vonë mendore.

Bazuar në sa më lart, gjykata në këtë rast, pasi pyeti edhe të sëmurin, ka arritur në përfundimin se shtetasi K.K. për shkak të sëmundjes nga e cila vuan dhe shkallës të agravimit të saj, nuk arrin të kuptojë rëndësinë e veprimeve që kryen dhe pasojat që i vijnë prej tyre, ndaj bazuar në nenet 126- 306 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, ka

vendosur: Pranimin e kërkesës. Heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit K.K, i datëlindjes 08.08.1993, i lindur dhe banues në Shkodër dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të shtetasës D.K.

Sipas të drejtës civile italiane, një gjendje e njëjtë me atë që çon në heqjen e zotësisë për të vepruar është parashikuar edhe nga Kodi Penal për personin, i cili është dënuar me burgim të përjetshëm, ose me burgim për një kohë jo më pak se 5 vjet. Në këtë rast, bëhet fjalë për pazotësi ligjore për të vepruar që rrjedh drejtpërdrejt nga dënimi penal. Kjo është një gjendje pazotësie e vendosur jo në mbrojtje të të pazotit, si në rastin e të sëmurit psikik, por si një dënim plotësues i dënimit penal, për një ndëshkim më të rëndë ndaj të dënuarit. Ndaj personit që i është hequr zotësia për të vepruar, si pasojë e një vendimi plotësues, zbatohen të njëjtat norma si për personin që i është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor, përse i përket administrimit të sendeve dhe përfaqësimit të tij¹¹⁸.

I miturit i cili nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, nuk ka aftësi mendore për shkak të zhvillimit të pamjaftueshëm trupor dhe psikik. Në këtë kuptim heqja e zotësisë për të vepruar, e mbron këtë të mitur nga kryerja e disa veprimeve juridike të cilat do të sillnin pasoja negative në planin juridik. Kur i mituri nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, ai asistohet nga prindërit, të cilët janë përfaqësuesit e tij ligjorë. Në rastin kur prindërve u është hequr përgjegjësia prindërore atëherë është kujdestari i cili caktohet si përfaqësues ligjor i fëmijës. Përfaqësues ligjor i fëmijës mund të jetë edhe njëri nga prindërit në rastin kur tjetri ka vdekur.

Në të drejtën ndërkombëtare private problemet e lidhura me zotësinë e personit janë të ndryshme. Në disa raste, pazotësia përdoret për të kontestuar a posteriori një vendim gjyqësor, në raste të tjera trajtohet si një element përbërës i statusit të personit, duke përfutur nga një sistem mbrojtje sociale të vazhdueshme nëpërmjet organeve të posaçme përfaqësi, asistence ose kontrolli.

Në fushën e pazotësisë ekziston një *summa divisio*, ndikimi i së cilës është i dukshëm drejtpërdrejt në terrenin e konfliktit të ligjeve. Bëhet fjalë për dallimin mes pazotësive të përgjithshme (zotësia juridike) dhe pazotësive të veçanta (zotësia për të vepruar)¹¹⁹. Pazotësitë e përgjithshme janë ato që prekin personin për të gjitha llojet e veprimeve. Para së gjithash, ato kanë të bëjnë me pazotësinë e përgjithshme të ushtrimit (mosha e mitur, kujdestari) sepse pazotësitë e përgjithshme për të gëzuar nuk ekzistojnë më. Pak rëndësi kanë nëse këto pazotësi të përgjithshme kanë prejardhje ligjore apo juridike. Për këto pazotësi vepron ligji kombëtar i personit të interesuar për arsye të vazhdimësisë të nevojshme të mbrojtjes që duhet t'i garantohet atij që është i pazoti edhe përtej kufijve.

Pazotësitë e veçanta janë ato që prekin personin në rastet e veprimeve të veçanta. Për shembull, pazotësia për të dhënë ose për të marrë, e parashikuar për disa veprime

¹¹⁸ Galgano, Francesco; op. cit., f. 93.

¹¹⁹ Gutmann, Daniel;. *E Drejta Ndërkombëtare Private*, Botimet Papirus, Tiranë, 2015, f. 172.

juridike të caktuara. I tillë është rasti që shpreh pazotësinë e mjekut për të marrë dhurata nga pacienti i tij gjatë kurimit të sëmundjes së fundit ose pazotësia e kujdestarit për të marrë nga i mituri nën kujdestari. Këto pazotësi kanë karakter të veçantë, i cili përcaktohet nga natyra e veprimit juridik në fjalë. Ato janë nën veprimin e ligjit që zbatohet për institucionin nga varen, gjë që përbën një përjashtim nga kompetenca e ligjit të brendshëm¹²⁰.

Pazotësia e një personi mund të jetë një fakt i panjohur për bashkëkontraktuesin e tij. Prandaj anulimi i aktit juridik përbën rrezik për stabilitetin e marrëveshjeve të lidhura në mirëbesim mes të pazotit dhe individëve të tjerë. Këtë gjë e pranoi edhe Gjykata e Kasacionit në Francë në një vendim ekzemplar, vendimi në çështjen Lizardi¹²¹. Neni 13 i Rregullores Roma I, i 17 qershorit 2008, mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore, e autorizon një kontraktues, i cili ka zotësi sipas ligjit të vendit ku është lidhur kontrata, të rregullojë pazotësinë e tij vetëm nëse në momentin e lidhjes së kontratës, kontraktuesi tjetër ishte në dijeni të kësaj pazotësie ose nuk e dinte për faj të pakujdesisë së tij. Kjo qasje mikroskopike e pazotësisë vjen në kundërshtim me qasjen makroskopike që përdoret për të përcaktuar ligjin e zbatueshëm për mbrojtjen organike të të pazotëve¹²². Mbrojtja organike e të pazotëve rregullohet në parim nga ligji kombëtar i personit të pazot, në përputhje me rregullin që zbatohet për pazotësitë e përgjithshme. Por ky rregull është vënë në diskutim nga rëndësia e madhe e Konventës së Hagës të 5 Tetorit 1961 mbi mbrojtjen e të miturve, si dhe nga rregullat e miratuara së fundi për mbrojtjen e të rriturve të pazotë.

3.1 Aktet juridike civile të lejuara personit të pazot për të vepruar

Në parim, personi i cili është i pazot për të vepruar nuk është në gjendje që të kryejë veprime juridike civile për shkak të mungesës të aftësisë mendore. Nga sa trajtuam më lart, konstatojmë se mungesa e zotësisë për të vepruar është një masë mbrojtëse ndaj këtyre personave. Kryerja e këtyre veprimeve mund të dëmtojë rëndë interesat e tyre. Për këtë arsye janë të kufizuara ato lloj veprimesh që këta persona mund t'i kryejnë të vetëm, veprime të cilat janë të një natyre që nuk dëmtojnë interesat e tyre. I mituri mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty, si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundërshtim. Zakonisht personat e pazotë mund të blejnë ushqime, artikuj shkollorë, bileta të transportit publik ose bileta teatri. Të gjitha këto lloj veprimesh juridike civile nuk mund të shpallen të pavlefshme

¹²⁰ Gutmann, Daniel; op. cit., f. 172.

¹²¹ Në këtë çështje, një meksikan 23 vjeç bleu në Paris disa bizhuteri dhe kishte refuzuar t'i paguante. Ai kishte pretenduar se sipas ligjit meksikan, ai konsiderohej si minore, sepse ishte nën 25 vjeç. Kjo do të thoshte se veprimet e tij nuk ishin të vlefshme. Por Gjykata e Kasacionit në Francë refuzoi një argumentim të tillë, duke marrë në konsideratë faktin se shitësi francez kishte besuar në zotësinë e blerësit. Gjykata deklaroi se zbatimi i statusit të huaj duhej të kufizohej dhe të ndryshohej, gjë pa të cilën rrezikohej që edhe në raste të mëvonshme të bëheshin gabime ose të kishte të papritura në dëm të francezëve. Më saktësisht gjykata vendosi se një kontratë konsiderohet e vlefshme, kur francezi ka hyrë në marrëdhënie kontraktore pa neglizhuar asgjë, pa pakujdesi dhe në mirëbesim.

¹²² Gutmann, Daniel; op. cit., f. 174.

për faktin se janë kryer nga persona të pazotë. Asnjë nga këto veprime nuk dëmton interesat e personit të pazot dhe as ligji nuk ndalon këto lloj veprimesh¹²³.

Ekzistojnë raste kur ligji ndalon këto lloj transaksionesh sikurse është rasti i shitjes së alkoolit dhe duhanit të të miturve. Në këtë rast, ligji i ndalon tregtarët e këtyre produkteve që t'u shesin të miturve. Ky ndalim ka ardhur si pasojë e mbrojtjes të të miturve nga këto produkte kaq të dëmshme për shëndetin e tyre. Kurse pasuria e të miturit që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç administrohet nga vetë i mituri, por gjithmonë me pëlqimin paraprak të prindërve ose të kujdestarit.

Situata e personave të pazotë nuk është totalisht e privuar nga moskryerja e veprimeve juridike. Në këtë mënyrë, ekziston një mundësi minimale edhe për këtë kategori njerëzish për kryerjen e akteve juridike civile duke na demonstruar në këtë aspekt se edhe këta persona kanë një jetë juridike të tyre.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 në nenin 12 të saj përcakton se fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar. Fëmija i cili ka mbushur moshën 10 vjeç ka të drejtën që të dëgjohet detyrimisht dhe para mbushjes të kësaj moshe, janë vetë autoritetet kompetente, të cilat vlerësojnë në qoftë se dëgjimi i fëmijës është i rëndësishëm për zgjidhjen e problemit. Në këtë kontekst mund të themi se i mituri ka të drejtë që të kërkojë të informohet mbi çështjen rreth të cilës do të pyetet dhe ka të drejtën që të këshillohet mbi opinion që do të japë me qëllim që të kuptojë se çfarë pasoja mund të sjellin deklaratimet e tij. Fëmija gëzon të drejtën që të dëgjohet në të gjitha proceset gjyqësore ose administrative pavarësisht natyrës së tyre (civile, penale, tregtare etj). I vetmi kusht i kërkuar nga ligji është që fëmija të jetë i aftë mendërisht.

Në doktrinën franceze¹²⁴ konsiderohet se aftësia mendore arrin një nivel të kënaqshëm në moshën 7-8 vjeç dhe lejohet që verifikimi i ekzistencës së saj të jetë në vlerësimin e gjyqtarit. Pra, në këtë mënyrë, ligji i akordon fëmijës një të drejtë për t'u dëgjuar, në qoftë se ai dëshiron dhe nga ana tjetër gjyqtari mund të refuzojë që të dëgjojë të miturin për shkak të moshës, pjekurisë të fëmijës, ekuilibrit të tij psikologjik.

3.2 Mbarimi i pazotësisë për të vepruar

Gjendja juridike e mungesës të zotësisë për të vepruar nuk zgjat pambarimisht. Për të miturin nën 14 vjeç kjo mungesë zotësie mbaron në rastet e mëposhtme:

- a) *kur i mituri mbush moshën 14 vjeç dhe si pasojë fiton zotësinë e kufizuar për të vepruar ashtu sikurse e parashikon edhe Kodi Civil në nenin 7 të tij;*
- b) *gjendja juridike e mungesës të zotësisë për të vepruar mbaron me vdekjen fizike ose me shpalljen si i vdekur të të miturit.*

¹²³ Filipescu, I. P., *Drept civil. Dreptul de proprietate și alte drepturi reale*, Editura Actami, Bukuresht, 1998, f. 112-115.

¹²⁴ Terré, François. Fenouillet, Dominique. *Droit Civil. Les personnes. La famille. Les incapacités*, Dalloz, Paris, 1996, f. 844-845.

Në rastin kur zotësia për të vepruar është hequr me vendim të gjykatës, kjo gjendje juridike merr fund në rastet e mëposhtme:

- a) *personave të cilëve, u hiqet zotësia për të vepruar, brenda kritereve ligjore, mund t'u kthehet, po sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile*¹²⁵;
- b) *gjendja juridike e mungesës të zotësisë për të vepruar mbaron me vdekjen fizike ose me shpalljen si i vdekur të të miturit.*

3. Zotësia e kufizuar për të vepruar

Kodi Civil u njeh zotësinë e kufizuar për të vepruar personave që kanë mbushur moshën 14 vjeç dhe më konkretisht përcakton se: *“I mituri, që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të tij ligjor. Megjithatë, ai mund të bëjë pjesë në organizata shoqërore, të disponojë atë që fiton me punën e tij, të depozitojë kursimet dhe t'i disponojë vetë këto depozita.”*¹²⁶

Në këtë mënyrë i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç, i nënshtrohet pushtetit të prindërve ose të kujdestarit të tij¹²⁷. Ai mund të kryejë çdo lloj veprimi juridik pa asnjë kufizim, po ashtu si dhe personat madhorë, por një gjë e tillë është e kushtëzuar me dhënien e pëlqimit paraprak nga ana e përfaqësuesit ligjor të të miturit që, sipas rastit, është prindi ose kujdestari¹²⁸. Dhënia e pëlqimit është në këtë mënyrë kusht për vlefshmërinë e veprimeve juridike të kryera nga i mituri mbi 14 vjeç. Mungesa e pëlqimit e bën veprimin juridik të anulueshëm. Megjithatë, ai mund të bëjë pjesë në organizata shoqërore, të disponojë atë që fiton me punën e tij, të depozitojë kursimet dhe t'i disponojë vetë këto depozita pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit.

Gjithashtu, i mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e paligjshëm të shkaktuar prej tij. Prindërit ose kujdestari përgjigjen për dëmin e mësipërm kur i mituri nuk nxjerr të ardhura nga puna ose nuk ka vetë pasuri, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit¹²⁹. Në kategorinë e të miturve, që kanë zotësi të kufizuar për të vepruar bëjnë pjesë edhe ata persona madhorë të cilëve me vendim të gjykatës u kufizohet zotësia për të vepruar. Duhet që të kemi parasysh se edhe për ata persona, të cilët ndodhen në kufirin e moshës nga 14 deri në 18 vjeç, ligji u ka dhënë të drejtën që të kryejnë disa veprime juridike personalisht, por termi personalisht nuk do të thotë që ata mund të kryejnë këto veprime të vetëm, pa pëlqimin paraprak të prindërve ose kujdestarit.

¹²⁵Kondili, Valentina; op. cit., f. 121.

¹²⁶Neni 7 i Kodit Civil.

¹²⁷ Neni 232 i Kodit të Familjes në të cilin parashikohet se: *“I mituri që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç i kryen vetë veprimet juridike, por kurdoherë me pëlqimin paraprak të prindërve, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, mund t'i kryejë vetë”*, kurse në nenin 272 të po këtij kodi përcaktohet se: *“Kujdestari kujdeset për të miturin, e përfaqëson atë në të gjitha veprimet juridike dhe administron pasurinë e tij, sipas dispozitave të këtij Kodi”*.

¹²⁸Nuni, Ardian; op. cit., f. 119.

¹²⁹ Neni 614 i Kodit Civil.

Disa veprime juridike janë të ndaluara për të miturit e moshës nga 14 deri 18 vjeç, por janë të lejuara për persona, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar. Në fushën e trashëgimisë, tek përpilimi i testamentit kemi risi të veçanta. Ashtu sikurse dihet, moshë e nevojshme luan një rol përcaktues për përpilimin dhe për lidhjen e testamentit. Përpilimi i testamentit është një punë rigoroze dhe formale. Zakonisht testamenti hartohet kur është arritur moshë madhore. Në raste të veçanta, legjislacioni ka përcaktuar saktë moshën e personit fizik, i cili do të përpilojë testamentin sikurse edhe kushtet përkatëse plotësuese të cilat duhet të përmbushen për çdo person fizik.

Në vendin tonë Kodi Civil ka përcaktuar zotësinë për të disponuar me testament. Sipas nenit 373 të këtij kodi, testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, si dhe gruaja nën këtë moshë kur është e martuar. I mituri nga 14 deri në 18 vjeç mund të bëjë testament vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij. Personi të cilit me vendim gjyqi i është hequr zotësia për të vepruar, si dhe ai që në kohën e bërjes së testamentit nuk është në gjendje për të kuptuar rëndësinë e veprimit të tij, nuk mund të bëjë testament.

Në Republikën e Maqedonisë testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 15 vjeç, por me kushtin që personi në fjalë të jetë i aftë për të gjykuar dhe të kuptojë rëndësinë e këtij veprimi juridik¹³⁰. Në Republikën e Kosovës, testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, por në raste të veçanta, mund të bëjë testament edhe personi i cili është i martuar dhe ka moshën mbi 16 vjeç. Në rastin e Republikës të Serbisë, moshë minimale e personit duhet të jetë 16 vjeç. Do të shohim se në Republikën e Malit të Zi kjo moshë ulet në 15 vjet.

Sipas të drejtës civile italiane mund t'u kufizohet zotësia për të vepruar atyre që shpërdorjnë pasurinë e tyre ose atyre që abuzojnë në mënyrë të përhershme me pijet alkoolike ose me substancat narkotike, në qoftë se i sjellin dëme ekonomike vetes së tyre ose familjes¹³¹. Një diskutim i veçantë bëhet për ata që përkëtojnë shurdhmemecit dhe të verbërit të lindur ose atij që është i tillë që nga vegjëlja. Si parim, ata janë plotësisht të zotë për të vepruar. Megjithatë mangësitë e tyre fizike, në mungesë të një edukimi të përshtatshëm, mund të influencojnë negativisht mbi zhvillimin psikik e t'i bëjë ata pjesërisht, madje edhe plotësisht të pazotë për të mbrojtur interesat e tyre. Në këto raste atyre mund t'ju kufizohet ose në qoftë se verifikohet pazotësia e plotë dhe mund t'ju hiqet zotësia për të vepruar.

Në lidhje me zotësinë e kufizuar për të vepruar vlen të përmendet edhe qëndrimi i shumë shteteve evropiane të cilat kanë kodifikuar të drejtën civile. Në shumicën e shteteve evropiane vihet re se, kufiri minimal i moshës është shumë herë më i ulët sesa parashikohet nga legjislacionet e shteteve të rajonit tonë. Në disa shtete kjo moshë fillon nga moshë 10 vjeç. Duke iu referuar të drejtës krahasuese do të konstatojmë se në shumë shtete zotësia e kufizuar për të vepruar fitohet edhe në moshë shumë të vogla.

Në këtë kontekst, Gjermania ka parashikuar që zotësia e kufizuar për të vepruar të fitohet me mbushjen e moshës 7 vjeçare (neni 104 -113 i Kodit Civil). Në Zvicër kërkohet zotësi e kufizuar për të vepruar në disa raste të gjykimit për rëndësinë e

¹³⁰Kadriu, Osman; op. cit., f. 180.

¹³¹Galgan, Francesco; op. cit., f. 94.

veprimeve juridike pa marrë parasysh moshën (neni 19 i Kodit Civil). *E drejta greke* parashikon moshën 10 vjeç (neni 134-135 i Kodit Civil). Duke u nisur nga të dhënat e mësipërme do të shohim se arritja e një moshe të caktuar është një kriter rregullues dhe vendimtar për fitimin e zotësisë për të vepruar.

3.1 Kufizimi i zotësisë për të vepruar

Me mbushjen e moshës 14 vjeç ose 18 vjeç, personi e fiton zotësinë e pjesshme ose të plotë për të vepruar *ipso iure*. Por mund të ndodhë që edhe personat madhorë për shkak sëmundje psikike ose zhvillimi mendor të metë nuk janë të zotë që tërësisht ose pjesërisht të kujdesen për punët e tyre. Këta persona nuk janë të zotë për të pasur, ndërgjegjen e shfaqjes të vullnetit të tyre dhe për pasojë nuk janë në gjendje që të kuptojnë rëndësinë e kryerjes së veprimeve të tyre. Të sëmurët psikikë janë ata persona që për shkak çekuilibrimesh psikike, kanë humbur zotësinë për të gjykuar dhe për të pasur ndërgjegje të veprimeve të tyre. Të sëmurët psikikë ose ata me zhvillim mendor të metë mund të jenë krejtësisht ose pjesërisht të pazotë për të vepruar prandaj, mbi ta, duhet vendosur kujdestaria.

Për të vendosur kujdestarinë, personave mund t'u hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar me vendim të gjykatës¹³².

Sipas nenit 9 të Kodit Civil ekzistojnë edhe rastet kur të miturit me moshë katërmbëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetë vjeç, i cili është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi të metë mendor, mund t'i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor. Sipas Kodit të Procedurës Civile, në neni 382 të saj, është përcaktuar se: "*Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar bëhet me kërkesë të bashkëshortit, gjinisë së afërt, të prokurorit, si dhe të personave që kanë interes të ligjshëm për këtë fakt*". Në të gjitha rastet kërkesa i paraqitet gjykatës së vendit ku ka banimin personi që kërkohet t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar. Kërkesa për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar i njoftohet prokurorit¹³³. Kërkesa duhet të përmbajë faktin në të cilin ajo bazohet si dhe provat e nevojshme. Gjykata vendos lidhur me kërkesën, pasi të ketë pyetur personin për të cilin kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, persona nga gjinia e afërt e tij, mjekun që e ka kuruar ose pasi të ketë marrë mendimin e mjekëve të tjerë ekspertë, si dhe prova të tjera që do t'i çmojë të nevojshme.

Marrja në pyetje e personit të cilit i kërkohet t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar, bëhet në institucionin që është shtruar për mjekim ose në banesën e tij nga një gjyqtar i deleguar, kur nuk është e mundur të paraqitet vetë në gjykatë. Kundër vendimit për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, mund të bëjnë ankim vetë personi i mësipërm, kujdestari i përkohshëm i tij, personi që ka bërë kërkesën, si dhe të gjithë personat e tjerë që sipas nenit 382 të këtij Kodi kanë të drejtë të kërkojnë heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, pavarësisht nga pjesëmarrja ose jo e tyre në gjykimin e kësaj çështjeje. Në këtë rast, gjykata i lejon ata të njihen me materialet e dosjes gjyqësore. Në të gjitha rastet, dispozitat e parashikuara zbatohen edhe për kthimin e

¹³² Kondili, Valentina; op. cit., f. 120-121.

¹³³ Neni 383 i Kodit të Procedurës Civile.

zotësisë për të vepruar. Si konkluzion heqja dhe kufizimi i zotësisë për të vepruar si dhe kthimi i tyre bëhet me vendim të gjykatës, organ i caktuar me ligj. Si rrjedhojë, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar si dhe kthimi i tyre nuk varen nga vullneti i individëve prandaj dhe veprimi juridik që kufizon zotësinë për të vepruar është i pavlefshëm.

3.2 Fillimi dhe mbarimi i zotësisë të kufizuar për të vepruar

Sipas Kodit Civil, fillimi i zotësisë të kufizuar për të vepruar fillon në momentin kur personat kanë mbushur moshën 14 vjeç. Nuk është e mjaftueshme që personi të ketë hyrë në vitin kur mbush këtë moshë, por ai duhet që kjo moshë të jetë mbushur efektivisht (viti, muaji, dita). Vetëm në qoftë se data e lindjes të fëmijës është 1 janari, atëherë, hyrja në vitin e ri përkon me mbushjen e moshës dhe me fillimin e zotësisë së kufizuar për të vepruar. Në këtë mënyrë në qoftë se një fëmijë ka lindur më 1 janar 2004, ai fiton zotësinë e kufizuar për të vepruar më 1 janar 2018.

Kohëzgjatja e zotësisë të kufizuar për të vepruar nuk është e pakufizuar dhe mund të themi se ajo zgjat 4 vjet (nga mosha 14 vjeç deri më 18 vjeç). Kjo periudhë shërben që t'a përgatisë fëmijën me përgjegjësinë e plotë juridike në të ardhmen. Ligji i akordon të miturit disa lehtësira dhe gjithashtu i siguron disa liri në jetën e tij juridike. Është mjaft e rëndësishme që të kuptojmë se në momentin kur fëmija humbet zotësinë e kufizuar për të vepruar dhe fiton zotësinë e plotë për të fituar, ai duhet të kryejë i vetëm të gjitha veprimet juridike. Në këtë mënyrë zotësia e kufizuar për të vepruar mbaron me mbushjen e moshës 18 vjeç, moshë në të cilën ai fiton zotësinë e plotë për të vepruar.

Zotësia e kufizuar për të vepruar mund të mbarojë edhe në rastin e martesës. Sipas nenit 6 të Kodit Civil, personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile. Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe gruaja që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Ajo nuk e humbet këtë zotësi edhe kur martesa është deklaruar e pavlefshme ose është zgjidhur para se të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Pra, si konkluzion mund të themi se gruas i mbaron zotësia e kufizuar për të vepruar në rastin kur martohet. Gjithashtu, zotësia e kufizuar mbaron edhe me anën e vendimit të gjykatës e cila, i rikthen personit madhor zotësinë e plotë për të vepruar. Mënyra e fundit e mbarimit të zotësisë së kufizuar për të vepruar është nëpërmjet vdekjes, moment kur mbaron edhe zotësia juridike e personit (vdekja mund të jetë e konstatuar fizikisht ose nëpërmjet shpalljes si i vdekur të personit fizik).

4. Zotësia e plotë për të vepruar

4.2 Nocione, përmbajtje dhe përfundimi i zotësisë për të vepruar

Doktrina e ka përkufizuar zotësinë e plotë për të vepruar si aftësinë e njeriut për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime civile nëpërmjet kryerjes të veprimeve juridike. Në këtë këndvështrim, zotësia e plotë për të vepruar ka disa karakteristika kryesore:

Përsa i përket përmbajtjes të zotësisë të plotë për të vepruar duhet të themi se ajo mbështetet fuqishëm mbi tre të dhëna kryesore:

Në radhë të parë, karakteri juridik ose i quajtur ndryshe “përgjithshmëria e zotësisë për të vepruar” nxjerr në dukje faktin që zotësia për të vepruar është aftësia e personit fizik për të kryer të gjitha veprimet juridike me anën e të cilave fiton dhe ushtron të drejtat subjektive, sikurse edhe për të marrë përsipër detyrime.

Në radhë të dytë, zotësia e plotë për të vepruar nënkupton aftësinë e njeriut për të kryer të gjitha veprimet juridike i vetëm dhe me anën e të cilave fiton dhe ushtron të drejtat subjektive sikurse edhe për të marrë përsipër detyrime.

Zakonisht në momentin që fitohet zotësia për të vepruar ajo ruhet gjatë gjithë jetës. Përderisa ligji ka parashikuar një moshë minimale nuk ka asnjë motiv që të përcaktojë edhe një moshë maksimale për zotësinë e plotë për të vepruar. Në lidhje me mbarimin e zotësisë për të vepruar mund të themi se ajo mbaron njëherësh me zotësinë juridike të personit fizik në momentin kur ky i fundit vdes.

Nga ana tjetër fitimi i zotësisë për të vepruar lidhet ngushtë me arritjen e një moshe të caktuar nga ligji ose në kushtet e caktuara nga ligji, por njëkohësisht, përveç moshës, është e lidhur edhe me aftësinë mendore të personit fizik. Personat të cilët kanë arritur moshën e caktuar, por janë të sëmurë mendorë, e kanë mundësinë për të pasur të drejta dhe detyrime, por nuk mund t’i fitojnë dhe t’i realizojnë vetë këto të drejta dhe detyrime. Të drejtat dhe detyrimet e tyre këta persona i realizojnë nëpërmjet personave të tjerë, në kushtet e përcaktuara nga ligji¹³⁴.

Doktrinat e huaja konsiderojnë se shpallja e pavlefshme e martesës mund të sjellë edhe humbjen e zotësisë të plotë për të vepruar të femrës e cila nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Gjithsesi kjo humbje e zotësisë të plotë për të vepruar mund të jetë e përkohshme për vetë faktin se femra nëpërmjet lidhjes të një martese të re mund të rifitojë zotësinë e plotë për të vepruar duke humbur zotësinë e kufizuar për të vepruar.

Identik është edhe rasti i martesës putative ose e thënë ndryshe martesa e lidhur në mirëbesim, e cila ndeshet së pari në dispozitat e Kodit Civil të Napoleonit në vitin 1804. Me deklarimin e pavlefshmërisë së martesës putative synohet kthimi në gjendjen e origjinës. Ajo që nuk është e vlefshme, nuk sjell as pasoja. Ky parim nuk është gjithmonë i bazuar kur flitet për pavlefshmërinë e martesës putative. Martesa e konsumuar në fakt, por e pavlefshme për shkak të shkeljes së kushteve të lidhjes së martesës ose të ekzistencës së ndonjë pengesë ligjore të lidhjes së martesës, konsiderohet e njëjtë me bashkëjetesën e çiftit që nuk ka lidhur martesë ligjore¹³⁵.

¹³⁴Kondili, Valentina; *op. cit.*, f. 115.

¹³⁵ Cârperaru, St., *Drept civil. Contractul de transport. Drepturile de creație intelectuală. Succesumile*. Editura Didactică și Pedagogică, Bukuresht, 1971, f. 22.

KAPITULLI IV

IDENTIFIKIMI I PERSONIT FIZIK

1. Konsiderata të përgjithshme

1.1 Nocione dhe mënyrat e identifikimit të personit fizik

Të identifikosh një person fizik do të thotë që t'i konstatosh identitetin dhe t'a individualizosh në një shoqëri të caktuar dhe në tërësinë e marrëdhënieve shoqërore në të cilat ai përfshihet. Ky problem e shoqëron personin fizik gjatë gjithë jetës biologjike të tij dhe jo vetëm në jetën juridike, por edhe në jetën ekstrajuridike¹³⁶.

Në kohët e sotme identiteti i njeriut ka një rëndësi të veçantë në planin e marrëdhënieve me të tretët, por njëkohësisht duhet që të merren masa për mbrojtjen e identitetit të gjithsecilit. E drejta e identitetit parashikohet në legjislacionet e brendshme dhe në ato ndërkombëtare.

Sipas nenit 8 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, shtetet palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme. Në qoftë se një fëmijë i mohohet në mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, Shtetet palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

Në realitet, identiteti i gjithsecilit kërkon një mbrojtje të veçantë dhe të specializuar. Problemi i kontrollit dhe verifikimit të identitetit të personave është një nga detyrat kryesore të çdo shteti, të cilët kanë hartuar legjislacione të ndryshme për realizimin e këtij misioni. Këto legjislacione kanë ndërthurur lirinë individuale me interesat e rendit publik dhe mbi të gjitha me sigurinë e personave fizikë dhe sendeve në pronësi të tyre.

Me identifikim të personit fizik do të kuptojmë individualizimin e këtij të fundit, pra përcaktimi i koordinatave të pozicionit të tij, përcaktimi i identitetit në jetën juridike¹³⁷. Për të drejtën civile, identifikimi i personit fizik do të thotë individualizimi i njeriut në raportet e së drejtës civile, në të cilat ai merr pjesë, në cilësinë e subjektit pasiv ose aktiv. Individualizimi i njeriut nuk realizohet vetëm në raportet e së drejtës civile por edhe në të gjitha raportet e tjera juridike, në të cilat ai shfaqet si titullar të drejtash dhe

¹³⁶ Buse, Ionel. *Filosofie*, Editura Universitaria, Krajovë 2012, f. 178.

¹³⁷ Dogaru, Ion & Cercel. Sevastian, *Drept civil, Persoanele*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2007, f. 108.

detyrimesh. Si rrjedhim në cilësinë e institutit juridik, domethënë si totaliteti i normave të cilat individualizojnë njeriun në të gjitha raportet juridike në të cilat ai është pjesëmarrës, identifikimi i personit fizik është një institut juridik kompleks.

Vetëm një pjesë e këtij instituti juridik i përket së drejtës civile, domethënë pjesës që është e përbërë nga normat juridike, të cilat rregullojnë mënyrat e individualizimit të njeriut në raportet civile. Doktrina dhe jurisprudenca mbështesin fuqishëm idenë se identifikimi i njeriut është një domosdoshmëri e përhershme dhe e përgjithshme¹³⁸. Ashtu sikurse jeta juridike, si një shprehje e jetës sociale, është e përhershme, po ashtu është edhe domosdoshmëria e identifikimit të njeriut. Njeriu, që nga momenti i lindjes dhe deri në atë të vdekjes, merr pjesë në shumë raporte civile (dhe jo vetëm civile), në të cilat faktori identitet luan një rol të madh.

Në cilësinë si pjesëmarrës në raportet civile, njeriu shoqërohet gjithmonë nga domosdoshmëria e individualizimit të tij: në lindje, fëmija “regjistrohet” që do të thotë se identifikohet për herën e parë. Ligji civil mbron fëmijën e mitur pavarësisht se ai nuk ka zotësi të plotë për të vepruar ose ka zotësi të kufizuar për të vepruar, fakt që kërkon domosdoshmërisht identifikimin e fëmijës. Edhe në momentin kur personi fizik bëhet madhor dhe kryen i vetëm veprimet juridike, përsëri identifikimi është një element shumë i rëndësishëm. Gjithashtu edhe momenti i vdekjes biologjike ose i shpalljes si i vdekur mbështeten mbi identitetin e personit fizik. Identifikimi i personit fizik është mjaft i rëndësishëm jo vetëm në raportet e së drejtës civile, por edhe në degët e tjera të së drejtës si më poshtë vijojnë:

- *në të drejtën e procedurës civile ose penale, identifikimi i palëve në proces është një domosdoshmëri (i padituri, paditësi, i pandehuri, viktimas);*
- *në të drejtën kushtetuese, në fushën elektorale është mjaft e domosdoshme lista e zgjedhësve;*
- *në të drejtën penale, është mjaft e rëndësishme të dihet “autori”, “bashkautori”, “ndihmësi” ose “shtytësi”. Pra, në këtë mënyrë përsëri kërkohet identifikimi, si një element i pashmangshëm.*

Shoqëria ka nevojë të madhe që të identifikojë të gjithë personat, të cilët hyjnë në raport me njëri-tjetrin. Nga ana tjetër, kjo nevojë është mjaft e rëndësishme edhe në planin individual ose personal për vetë faktin se personi fizik do të arrijë që të individualizojë këto raporte juridike.

Nën aspektin terminologjik, nocioni “mënyrat e identifikimit” ose “elementet e identifikimit” ka dy kuptime:

Së pari, nëpërmjet “mënyrave të identifikimit” do të kuptojmë ato elementë, të cilët shërbejnë për t’u dalluar një person nga pjesa tjetër e personave. Këto elementë janë të rregulluar nga e drejta civile, por edhe nga të drejtat e tjera. Në këtë mënyrë, në të drejtën kushtetuese, shtetësia është statusi që përcakton përkatësinë shtetërore të

¹³⁸ Malaurie, Ph., Aynes, L., *Droit civil. Les Personnes. Les incapacités*, ed.a 5-a, Ed. Cujas, Paris, 1999, f. 123.

individëve¹³⁹. Nocioni i shtetësisë paraqet lidhjen juridike të qytetarit me shtetin. Qytetarët të cilët gëzojnë të drejta dhe detyrime (besnikëri, të drejta politike, ushtrimi i shërbimit ushtarak, mbrojtja konsullore jashtë shtetit, ekstradimi në atdhe, mbrojtjen nga ekstradimi në shtet tjetër etj.) dhe i nënshtrohen juridiksionit shtetëror quhen shtetas. Në të drejtën civile elementët kryesorë të identifikimit janë emri, vendbanimi dhe gjendja civile.

Së dyti, nëpërmjet “mënyrave të identifikimit” do të kuptojmë ato elementë, (dokumente zyrtarë) nëpërmjet të cilave vërtetohen të drejtat subjektive ose cilësitë të cilat individualizojnë njeriun. Janë në këtë mënyrë mjete identifikimi: certifikata e lindjes, certifikata e vdekjes, certifikata e martesës, vërtetimi i gjendjes gjyqësore dhe vendimet gjyqësore. Duhet të kujtojmë se sistemi i mjeteve të identifikimit të personit fizik promovon dhe shpreh nga ana juridike dy koordinata bazë të identitetit:

- a) përkatësinë e grupit social të personit fizik (familje, shoqëri);
- b) individualitetin e njeriut në gjirin e grupit social.

1.2 Veçoritë e identifikimit të personit fizik

Është më se e qartë se veçoritë e identifikimit të personit fizik inkuadrohen tek të drejtat personale jopasurore. Sipas nenit 5 të Kodit Civil, çdo person fizik ka të drejtën dhe detyrimin të ketë emrin dhe mbiemrin e tij që i vihen sipas ligjit. Personi, të cilit i mohohet e drejta e përdorimit të tyre ose cenohet nga përdorimi që të tjerët i bëjnë padrejtësisht, mund të kërkojë në gjykatë përdorimin e emrit ose të mbiemrit të vet, pushimin e cenimit, si dhe shpërblimin e dëmit përkatës. Kjo kërkesë mund të paraqitet edhe nga persona që, ndonëse nuk mbajnë emrin ose mbiemrin e cenuar, apo të përdorur padrejtësisht, kanë interesa familjare të denja për t’u mbrojtur. Gjykata kur pranon padinë urdhëron botimin e vendimit në Fletoren Zyrtare. Me kërkesën e paditësit gjykata mund të urdhërojë botimin e vendimit të saj edhe në gazeta të tjera.

Pseudonimi i përdorur nga personi fizik gëzon të njëjtën mbrojtje. Gjithashtu, sipas nenit 23 të ligjit nr. 35/2016 “*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*”, pavarësisht nga të drejtat pasurore të autorit, edhe pas transferimit të të drejtave në fjalë, autori ka të drejtën të kundërshtojë çdo shtrembërim, ndryshim, tjetërsim ose veprime të tjera denigruese që nuk respektojnë tërësinë e veprës, duke cenuar nderin, personalitetin dhe reputacionin e tij, sipas rregullave të përcaktuara në legjisllacionin në fuqi.

Në këtë mënyrë mund të themi se karakteristikat e veçorive të identifikimit janë të drejta personale jopasurore. Gjithashtu ato janë edhe të drejta absolute “*erga omnes*”. Në të njëjtën kohë janë të lidhura pazgjidhshmërisht me personin dhe nuk mund të tjetërsohen¹⁴⁰. Pa asnjë dyshim që ato janë të drejta universale dhe në këtë mënyrë u

¹³⁹ Ilia, Bledar, *Statul ca Subiect al Dreptului de Proprietate Publica*, Editura Privirea, Bukuresht, 2010, f. 26.

¹⁴⁰ Kondili, Valentina; op. cit., f. 124.

përkasin të gjithë njerëzve. Identifikimi i personit fizik është trajtuar në legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Nëse, nga pikëpamja e personalitetit juridik, të gjithë individët janë të ngjashëm përsa i përket kriterit civil, e drejta civile, në raporte të tjera, bën dallim mes individëve sipas kriterëve që i individualizojnë. Para se të studiojmë me hollësi dy parimet e individualizimit/të personit, emrin dhe banesën dhe situatën jo të zakonit të mungesës, ndër të tjera është e udhës që të trajtojmë një vështrim të përgjithshëm të dallimeve të shumta të së drejtës së personave.

Ligji civil merr në konsideratë tek individ, një sërë veçorish dhe cilësish, të cilave u bashkëlidh pasoja të ndryshme juridike. Në doktrinën tradicionale, elementet e vetme që merreshin në konsideratë, ishin ato që e lidhnin individin me një shtet apo me familjen e tij. Duke qenë se i referohej vetëm gjendjes qytetëse (*status civitatis*) dhe gjendjes së familjes (*status familiae*), gjendja e një personi përfshinte vetëm kombësinë dhe atësinë (filiacionin nga nëna dhe babai).

Doktrina moderne është e prirur të ketë një qasje më të hapur dhe të shumëllojshme ndaj gjendjes civile. Moshë, seksi, profesioni, madje dhe besimi fetar janë gjithashtu të njohura, me pak apo shumë efekte, si elemente të gjendjes. Gjendja familjare nuk rezulton vetëm nga lidhja prindërore, por, duke u ndërthurur me gjendjen martesore dhe prindërore, pasqyron të gjitha ngjarjet e rëndësishme në jetë: martesën, ndarjen, divorcin, rimartesën, atësinë, amësinë. Në pjesën më të madhe të përdorimeve të saj, gjendja e personave përmbledh edhe aftësinë.

Edhe pse të ndryshëm, këto elemente përmbushin të gjithë të njëjtin funksion të përgjithshëm: karakteristikë tipike, ata ndihmojnë për të individualizuar çdo person në shoqëri; ata përbëjnë, në kuptimin e gjerë të fjalës, faktorët e identifikimit civil. Por, në mënyrë specifike, çdo element prodhon efekte juridike që i përkasin vetëm atij; secili është burim të drejtash dhe detyrimesh. Tërësia e këtyre pasojave juridike përcakton situatën personale të një individit përballë ligjit civil, ajo i jep një lloj statusi civil, duke përcaktuar gjendjen e tij civile.

Nga ky çast shfaqet, për secilin prej këtyre elementeve, një problem paraprak i përbashkët, ai i përputhshmërisë me parimin themelor të barazisë civile. Këto elemente individualizimi, mos ndoshta janë faktorë pabarazie, apo dhe më tej – diskriminimi? Është e pamundur që kësaj pyetje t'i japësh një përgjigje të vetme. Disa nga pasojat që vijnë nga njëri apo tjetri element i gjendjes së personave mbeten humnera të një të drejte të pabarabartë. Parimi i barazisë civile nuk e njeh ende përmbushjen e tij të përkryer. Disa dispozita të posaçme kanë, në të kundërt, qëllimin për të korrigjuar pabarazitë natyrore dhe shoqërore, për të vendosur me mjetet e duhura, një barazi që natyra ose shoqëria e ka dëmtuar: masa të mbrojtjes civile ose të kompensimit social.

1.3 Shenjat e përgjithshme identifikuese

Problemet e identifikimit të individëve kanë të bëjnë me përcaktimin e identitetit të njeriut të gjallë ose të vdekur. Për zgjidhjen sa më të saktë shkencore të tyre përdoren

kryesisht metoda të përbashkëta mjeko-ligjore dhe kriminalistike, duke shfrytëzuar të dhënat e shkencave mjekësore si të anatomisë normale, antropologjisë, gjenetikës, stomatologjisë dhe arrijet e reja shkencore të kriminalistikës në fushat e teknikave të fotografisë, të informatikës, të televizionit, të metodave grafike etj.

Në praktikë problemet e identifikimit janë të shumëllojshme si në çështjet civile ashtu dhe penale. Në fushën civile, lind nevoja e identifikimit të fëmijëve të gjetur, të të moshuarve të braktisur, të personave me gjendje civile false etj. Në çështjet penale, identifikimi i personit bëhet në radhë të parë në kufomat e panjohura të freskëta ose të dekompozuar me ose pa dëmtime të trupit si p.sh. në vdekjet e papritura, vetëvrasjet, katastrofat e ndryshme (ajrore, detare, hekurudhore, nga zjarret, lufta), në vrasjet kriminale etj. Në raste të tjera lind nevoja e identifikimit të përsëritësve që kanë rrezikshmëri shoqërore më të madhe dhe për t'iu shmangur dënimeve më të rënda përpiqen të fshehin identitetin e tyre¹⁴¹.

Shenjat e përgjithshme identifikuese kanë të bëjnë me përcaktimin e gjinisë, të shtatit, moshës, racës, pamjes së fytyrës, ngjyrës së syve, pigmentimit të lëkurës etj.

1.3.1 Shtati

Përcaktimi i shtatit te personi i gjallë që qëndron më këmbë, në pozicionin vertikal dhe zbathur, realizohet me ndihmën e një antropometri. Matet lartësia e majës së kokës ndaj planit horizontal, ku janë mbështetur shputat e këmbëve.

1.3.2 Gjinia

Përcaktimi i gjinisë, si te personi i gjallë ashtu dhe tek kufoma nuk përbën problem mjeko-ligjor, me përjashtim të çështjeve të hermafroditizmit, apo ndërhyrjeve kirurgjikale për ndryshimin e seksit që ndeshen shumë rrallë në praktikë. Në këto raste mund të kërkohet mendimi i mjekut ligjor.

1.3.3 Moshë

Ky përcaktim mbështetet në radhë të parë në veçoritë e jashtme moshatare të njeriut¹⁴². Te fëmijët dhe të rinjtë ky përcaktim do të jetë më i saktë sesa tek personat e moshuar. Interes të veçantë tek personat e gjallë kanë nganjëherë përcaktimi i moshës që mund të kërkohet si ekspertim mjeko-ligjor i veçantë. Kështu, p.sh. kur nuk dihet moshë e saktë e adoleshentit për vendosjen e masës së dënimit, ose kur kërkohet korrigjimi i moshës së personave që pretendojnë të jenë regjistruar në një moshë që nuk i përgjigjet realitetit, ose në zëvendësimet e fëmijëve kur kanë humbur dokumentet që vërtetojnë moshën e tyre.

1.3.4 Veçoritë raciale dhe etnike

Ky përcaktim tek njerëzit mbështetet në veçoritë e jashtme karakteristike të etnive dhe racave njerëzore të ndryshme. Kështu, p.sh. pigmenti i theksuar i lëkurës në njerëzit me ngjyrë të Afrikës Perëndimore, pala epikantike apo plica palpebro-nasalis e racave mongoloide (të verdha), flokët e kuq të keltëve, apo lëkura bionde e racës nordike etj.

¹⁴¹Meksi, Sokrat & Çipi Bardhyl; op. cit., f. 165-166.

¹⁴²Çipi, Bardhyl. *Identifikimi i Personit*, ShBLU, Tiranë, 2011, f. 21.

1.3.5 Pigmenti i lëkurës

Tek njerëzit dallimet në pigmentin e lëkurës ndërmjet tre grupeve të racave kryesore: të bardha, të verdha dhe të zeza, në përgjithësi janë të qarta. Megjithatë, nuk është e lehtë të dallohet shtimi i lehtë i melaninës te racat e verdha kundrejt racave të bardha.

1.3.6 Ngjyra e flokëve

Ngjyra e flokëve, sidomos të atyre të kokës, sjetullave përbën një nga shenjat identifikuese të njeriut.

1.4 Shenjat e veçanta identifikuese

Shenjat e veçanta identifikuese janë pamja e fytyrës, tatuazhet, vrazat (cikatricat) dhe stigmatet profesionale.

1.4.1 Pamja e fytyrës

Pamja e fytyrës është një nga faktorët bazë e cila ndihmon në identifikimin e çdo personi.

1.4.2 Tatuazhet

Tatuazhet janë zbulime të lëkurës me anën e futjes së pigmenteve dhe bojërave të ndryshme (boja e kinës) nën epidermë, në mënyrë manuale me anën e mjeteve shpuese si për shembull, një age, apo me anën e vibratorit elektrik. Tatuazhet mund të jenë figura me karakter thjesht zbulues, fantastik, historik, erotik, emblema patriotike, fetare, shënime datash, inicialesh, simbolesh etj. Ato shërbejnë si shenja të veçanta identifikuese, duke ofruar të dhëna të çmuara mbi profesionin, etninë, përkatësinë fetare, shtresën shoqërore (në vitet 1900 aristokratët anglezë bënë tatuazhe në trupin e tyre)¹⁴³.

1.4.3 Vrazat (cikatricat)

Vrazat përbëjnë një shenjë mjaft të rëndësishme për identifikimin e personave të panjohur.

1.4.4 Stigmatet profesionale

Stigmatet profesionale që lidhen me profesionin e individit, bëjnë pjesë në shenjat e veçanta identifikuese. Ato përmbajnë zakonisht të gjitha ndryshimet që pëson lëkura në përgjithësi, duart, këmbët dhe disa organe të tjera nën ndikimin e ushtrimit të një profesioni të caktuar nga përdorimi i mjeteve të punës, apo ndikimi i substancave të ndryshme kimike, etj.

2. Emri

2.1 Konsiderata të përgjithshme

¹⁴³ Çipi, Bardhyl; op cit., f. 35.

Emri në pamje të parë tregon personin. Pra tregon sesi “quhet ai”. Emri, qysh në kohët e vjetra ka qenë një element, i cili dallon dhe individualizon njeriun në një shoqëri ose në një komunitet të caktuar. Në të drejtën romake, emri i personit fizik ishte i përbërë nga tre elemente bazë. Elementi i parë ishte *nomen* ose *nomen gentile*, i cili përdorej nga personat që i përkisnin të njëjtit fis. Elementi i dytë ishte *praenomen*, i cili identifikonte personat brenda të njëjtit fis. Elementi i tretë ishte *cognomen*, që do të thotë pseudonim¹⁴⁴. Në këtë mënyrë emri i oratorit të madh ishte: Marcus (emri), Tullius (mbiemri), Cicero (pseudonimi).

Kodi Civil dhe Kodi i Familjes përmbajnë dispozita në lidhje me emrin, personin fizik, aktet e gjendjes civile etj.

2.2 Efikasiteti juridik i emrit

Në të drejtën civile emri luan një rol dytësor, pak të rëndësishëm. Ai konsiderohet si ndihmës për identifikimin e personit dhe ndjek në disa drejtime regjimin e mbiemrit. Emri shërben si një aksesor dhe është i pamjaftueshëm për të identifikuar i vetëm individin. Në parim, emri nuk përbën i vetëm një identitet dhe nuk mund të mbrohet. Megjithatë, ka disa përjashtime. Ndodh që në rrethana shumë të veçanta, emri të marrë përsipër personalitetin dhe të njihet si nënshkrim (i një testamenti të shkruar nga vetë personi). Po kështu, personi që e mban – dhe që njihet vetëm nga emri i tij – të pranohet ta mbrojë atë.

Emri e mbiemri mund të ndryshojnë në rastet e përcaktuara në ligj¹⁴⁵. Emri e mbiemri i personit madhor mund të ndryshojnë vetëm me kërkesën e tij. Subjektet e përcaktuara në këtë ligj mund të kërkojnë ndryshimin për rastet e papërshtatshmërisë. Emri i personit mund të ndryshojë pas vdekjes, me kërkesë të personave, që kanë atë emër përbërës të gjendjes së tyre civile, vetëm për shkak të papërshtatshmërisë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile përcakton emrat e papërshtatshëm, në kuptim të këtij ligji, duke marrë mendim paraprak nga institucione të specializuara. Emrat e vlerësuar të papërshtatshëm me vendim gjyqësor përfshihen, drejtpërdrejt, në një përmbledhëse, që i vihet në dispozicion çdo zyre të gjendjes civile.

Ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit të prindit pasqyrohet tek fëmija i mitur. Tek fëmija në moshën madhore ndryshimi mund të bëhet me pëlqimin e tij, përveç rasteve të papërshtatshmërisë. Ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar, pas miratimit të kërkesës së shtetasit, nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile.

Në procesverbalin që mbahet në këtë rast pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkakun e ndryshimit, si dhe emri e mbiemri i ndryshuar. Procesverbali nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga nëpunësi i gjendjes civile dhe përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile. Emri e mbiemri i ndryshuar, si dhe numri e data e procesverbalit pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.

Në bazë të procesverbalit ose të vendimit gjyqësor bëhen korrigjimet për personat, që kanë nënshkruar dhe për të miturit, ndërsa për pjesëtarët e tjerë madhorë, korrigjimet

¹⁴⁴ Dumitrescu, M. A., *Manual de drept roman*, Bukuresht, 1920, f. 88.

¹⁴⁵Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”.

bëhen vetëm pasi të kenë dhënë pëlqimin me shkrim, të nënshkruar, të procesverbalit, përveç rasteve të vendosura nga gjykata. Personat, që e kanë përbërës emrin ose mbiemrin, por që janë familje më vete, bëjnë ndryshimin me kërkesën e tyre, me procesverbal të veçantë, ndërsa në rastet e papërshtatshmërisë, janë të detyruar ta pasqyrojnë ndryshimin brenda 1 muaji nga marrja dijani.

Shtetasit shqiptarë të cilët kërkojnë të bëjnë ndryshimin e emrit dhe të mbiemrit duhet të paraqesin këto dokumente:

- a) kërkesë drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, në të cilën ndodhet regjistri themeltar ku është i regjistruar shtetasi, në të cilën ai parashton shkakun e ndryshimit të emrit dhe të mbiemrit. Kërkesa duhet të protokollohet në zyrën e protokollit të njësisë administrative;
- b) dëshmi nga prokuroria e rrethit dhe gjykata e rrethit gjyqësor, në juridiksionin e të cilëve banon shtetasi i interesuar, të cilat dëshmojnë se ndaj këtij shtetasi nuk ka kallëzim ose nuk ka nisur ndonjë procedim penal.

Nëse zyra e gjendjes civile nuk ka në organikë drejtues të zyrës, ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit të bëhet nga nëpunësi i zyrës të gjendjes civile. Deri në lëshimin e numrit të identitetit, i cili është numri unik, i papërsëritshëm, që vërteton identitetin e shtetasve, duhet:

- Të mos bëhet ndryshimi edhe i emrit edhe i mbiemrit për të njëjtin shtetas;
- Të mos bëhet ndryshimi i emrit ose mbiemrit, më shumë se një herë, me përjashtim të rasteve kur shtetasit kërkojnë të rimarrin emrin ose mbiemrin e regjistruar në aktin e lindjes¹⁴⁶.

Përveç ndryshimeve të mësipërme, emrit dhe mbiemrit mund t'i bëhen përmirësime dhe korrigjime, që lidhen me ndryshime e saktësime të shkronjave të veçanta. Këto ndryshime bëhen në bazë të kërkesës së personit të interesuar, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Shtetasit mund të kërkojnë që t'i bëjnë përmirësime rubrikave të emrit/ mbiemrit¹⁴⁷. Këto përmirësime lidhen me saktësimin e shkronjave të veçanta që kanë të bëjnë me rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Për këto raste shtetasit paraqesin në zyrën e gjendjes civile kërkesën për përmirësimin e emrit si dhe çdo dokument tjetër që disponojnë, apo që provon shqiptimin ndryshe nga shkrimi, të një shkronje të veçantë të emrit/ mbiemrit.

Gjithashtu, në zyrën e gjendjes civile shtetasi dorëzon:

- kopje të aktit të lindjes ose certifikatë nga akti i lindjes;
- certifikatë personale apo familjare nga çdo regjistrim ku i interesuari ka patur vendbanimin, me të gjitha shënimet që ekzistojnë në regjistër për ndryshime apo korrigjime të mëparshme;

¹⁴⁶ Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr. 13, datë 19.12.2002 “Për procedurën për ndryshimit e emrit dhe të mbiemrit”.

¹⁴⁷ Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr. 481, datë 05.09.2013 “Për procedurat e korrigjimit të emrit/mbiemrit si korrigjim material”.

Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile brenda 5 ditëve pune harton një relacion ku shpreh mendimin e tij në lidhje me korigjimin dhe ia përcjell bashkë me dokumentacionin e mbledhur Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së praktikës merr vendimin për miratimin ose jo të kërkesës së shtetasit. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile pasqyron në Regjistrin Kombëtar vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Sipas nenit 168 të Kodit të Familjes, në rastin e ngatërimit ose zëvendësimit të fëmijës, në çdo rast, edhe kur bëhet në mënyrë të pavullnetshme, mund të kërkohej me padi njohjeje ose kundërshtimi një identiteti i ndryshëm i fëmijës, nëse konstatimi është bërë përpara ose pas marrjes së aktit të lindjes. Neni 169 i Kodit të Familjes përcakton se në mungesë të aktit të lindjes ose në qoftë se fëmija është regjistruar me emër të rremë, ose pa treguar emrin e nënës dhe të atit, amësia dhe atësia mund të vërtetohen me vendim gjyqësor.

Në të drejtën civile italiane një e drejtë e personalitetit i takon secilit në lidhje me emrin e tij. Kjo nisur nga fakti që emri është mjeti i identifikimit të personit: shenja që i lejon subjektit që t'i referojë vetvetes cilësitë personale dhe ngjarje së jetës njerëzore. E drejta e emrit mbrohet nga neni 5 i Kodit Civil, mbrojtje që bëhet nën një aspekt të dyfishtë:

- a) si e drejtë për përdorimin e emrit të vet, ose si e drejtë e identifikimit të vetvetes me anë të emrit dhe si e drejtë për të qenë nga të tjerët i identifikuar me anën e emrit¹⁴⁸;
- b) e drejta e emrit është e mbrojtur me anë të padisë për pushimin e cenimit dhe pagimin e detyrimit përkatës. Kjo drejtohet kundër kujtqo që i kundërshton personit emrin ose që i pengon atij përdorimin e emrit të tij, ose kundër atij që identifikohet me një emër të ndryshëm nga ai i tij;
- c) si e drejtë e përdorimit ekskluziv të emrit të personit.

Veç emrit, mbrojtje juridike gëzon edhe pseudonimi, ose emri artistik, kur ky ka fituar të njëjtën rëndësi si të emrit, sipas përcaktimeve të fjalisë së fundit të paragrafit të tretë, të Kodit Civil.

Emri dhe mbiemri i personit fizik është një prejtributeve pa të cilin jeta e çdo personi do të ishte e pakuptimtë. Atributi në fjalë përfshin emrin, në një të anë dhe mbiemrin e personit fizik, në anën tjetër. Emri është emërtim i përhershëm i një personi fizik në komunikacionin juridik¹⁴⁹. Me emërtimin e një personi, faktikisht, bëhet edhe individualizimi i tij prej anëtarëve të tjerë në familjen e tij. E drejta e emrit është një e drejtë personale, ajo garantohet me aktin më të lartë juridik të një shteti, Kushtetutën.

E drejta e emrit garantohet edhe me aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare. Një prej tyre është edhe Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës. Sipas kësaj konvente, fëmija që nga vetë çasti i lindjes së tij ka të drejtë për emër. Për emrin e fëmijës

¹⁴⁸ Galgano, Francesco; op. cit., f. 104-105.

¹⁴⁹ Kadriu, Osman; op. cit., f. 187.

së lindur vendosin prindërit e fëmijës. Lindja e fëmijës deklarohet para organit zyrtar të shtetit, respektivisht para nëpunësit shtetëror. E drejta e emrit është një e drejtë e natyrës personale që nënkupton të drejtat jopasurore, por nga ana tjetër, këto të drejta janë të patjetërsueshme. Kjo e drejtë fitohet me pasqyrimin në librat publikë të shtetit. Pasqyrimi i kësaj të drejte në librat publikë ka fuqi konstitutive. Kjo e drejtë, pra e drejta e emrit, nuk parashkruhet.

Nëpunësi i gjendjes civile në aktin e lindjes duhet të pasqyrojë emrin dhe mbiemrin e fëmijës. Lidhur me emrin, nëpunësi i gjendjes civile duhet të vendosë atë emër që dëshirojnë prindërit e fëmijës, me përjashtim të rastit kur emri është i papërshtatshëm, me karakter fytes, imoral ose racist. Në këtë rast, refuzimi i regjistrimit të emrit të caktuar mund të kundërshtohet në rrugë gjyqësore. Kur prindërit kanë vdekur, nuk janë në gjendje fizike ose mendore, apo nuk gjenden, emri caktohet nga pjesëtarët e familjes, të afërmit e tjerë e në mungesë të tyre zbatohen rregullat për foshnjën e gjetur që nuk i dihen prindërit¹⁵⁰.

Të gjitha dispozitat ligjore parashikojnë mënyrën sesi vendoset dhe ndryshohet emri, por asnjëra prej tyre nuk parashikon përkufizimin e emrit. Doktrina ka nënvizuar se emri është “ thirrja që shërben për të përkufizuar në mënyrë grafike dhe orale personat”. Në një këndvështrim më të gjerë emri përbëhet nga disa elementë. Mund të themi se vetë emri është totaliteti i fjalëve që shërben për të individualizuar një person fizik nëpërmjet të folurës ose të shkruarit¹⁵¹.

Në këtë mënyrë, është krijuar opinioni se emri është ai atribut i identifikimit të personit fizik, i cili i jep të drejtën njeriut që të individualizohet në gjirin e familjes dhe të shoqërisë, gjithmonë sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Emri në këtë mënyrë shërben për afirmimin e personit në jetën juridike dhe sociale. Personi fizik, i cili identifikohet nëpërmjet emrit, ka të drejtën që të ushtrojë të gjitha të drejtat dhe të përfitojë të gjitha të mirat dhe në këtë mënyrë, emri është një element esencial i personalitetit të personit¹⁵². Duhet të kujtojmë faktin se në doktrinë, legjislacion dhe jurisprudencë termi “emër” ka dy kuptime:

Stricto sensu, nëpërmjet termit “emër” nënkuptohet emri i familjes ose ndryshe sikurse e emërtojmë “emër patronimik” (mbiemri).

Lato sensu, nëpërmjet termit “emër” nënkuptohet emri i familjes, por edhe emri. Për përkufizimin e termit “emër” duhet të kemi parasysh aspektet e mëposhtme:

- a) *Emri është një atribut i identifikimit të personit fizik;*
- b) *Emri është i përbërë nga më shumë se dy fjalë (të paktën dy fjalë) dhe jo nga një fjalë e vetme për aq kohë sa ai përbëhet nga dy elementë, emri dhe mbiemri;*
- c) *Emri individualizon personin fizik në familje, por edhe në shoqëri;*
- ç) *Emri përcaktohet gjithmonë sipas ligjit në fuqi.*

¹⁵⁰ Nuni, Ardian; op. cit., f. 136.

¹⁵¹ Alexandresco, D., *Explicațiunea teoretică și practică a dreptului civil român. Partea I. Donațiunile între vii*, tomul IV, Bukuresht, 1913, f. 256.

¹⁵² Terré, François & Fenouillet, Dominique; op. cit., f. 127.

Si rezultat struktura e emrit përbëhet nga dy elementë, të cilët janë emri dhe mbiemri. Në jetën sociale megjithatë, emri operon si një njësi e vetme, unitare duke realizuar në këtë mënyrë qëllimin e tij, i cili është identiteti i personit fizik. Në këtë mënyrë emri ka një karakter unitar edhe pse është i përbërë nga dy elementë, të cilët janë analizuar në mënyrë të ndarë. Gjithsesi struktura e emrit nuk duhet që të ngatërrohet me përmbajtjen juridike të së drejtës subjektive mbi emrin, gjë e cila është e mundur falë titullarit, i cili disponon këtë emër.

Emri mund të përdoret edhe për qëllime profesionale dhe tregtare. Titullari mund të përdorë lirshëm emrin e tij me qëllim për t'u dalluar nga një person tjetër. Praktika sociale ka treguar se personat fizikë përdorin emrin e tyre në profesionet e lira (avokat, noter, arkitekt, mjek etj.). Në rastin e profesionit të avokatit, vula duhet të jetë unike dhe duhet të përmbaje titullin "Avokat" dhe identitetin e avokatit ose të zyrës së avokatisë. Gjithashtu edhe zyrat e avokatisë identifikohen me emrat e avokatëve. Emri i avokatit është elementi bazë i cili bën dallimin ndërmjet zyrave të avokatisë edhe pse ato ofrojnë të njëjtat shërbime juridike.

Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status. Tregtari dhe shoqëritë tregtare e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën emrin e regjistruar. Emri i tregtarit është emri i tij, sipas nenit 5 të Kodit Civil, i regjistruar në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Emri i shoqërisë tregtare duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 23 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Tregtari dhe shoqëritë tregtare mund të përdorin dhe emërtime tregtare, si dhe shenja të tjera dalluese të veprimtarisë dhe i regjistrojnë këto në përputhje me nenin 44 pika 1 shkronja a, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Emri i tregtarit ndiqet nga shtojca "tregtar i regjistruar" ose shkurtimi përkatës "TR". Emri i shoqërisë kolektive duhet të ndiqet nga shtojca "shoqëri kolektive" ose shkurtimin "SHK". Emri i shoqërisë komandite duhet të ndiqet nga shtojca "shoqëri komandite" ose shkurtimin "SHKM". Emrat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe të shoqërive aksionare përmbajnë shkurtimet, të cilat tregojnë se janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "SHPK" ose shoqëri aksionare "SHA".

Personi, të cilit i transferohet veprimtaria e një tregtari ose e një shoqërie tregtare, mund të vijojë të përdorë emrin e regjistruar apo shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë, me ose pa një shtesë, që tregon ndërrimin e pronësisë, nëse titullari i mëparshëm i veprimtarisë apo trashëgimtarët e tij e miratojnë këtë përdorim. Nëse emri i regjistruar apo shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë vijnë të përdoren, titullari i ri i veprimtarisë trashëgon të gjitha detyrimet tregtare të titullarit të mëparshëm.

Në këtë mënyrë personi fizik ka mundësinë që të kthejë emrin e tij në një emër tregtar. Nga ana tjetër, një person ose trashëgimtarët e tij mund t'i japin të drejtën e

përdorimit të emrit tregtar një personi tjetër për qëllime tregtare, praktikë e cila përdoret gjerësisht në fushën e sportit dhe të spektaklit.

Emri shërben për të emërtuar një person, një kafshë ose një send. Ai mund të jetë i përbashkët për të gjithë anëtarët e llojit ose i veçantë për njërin prej tyre. E drejta civile merr në konsideratë vetëm emrat e përveçëm dhe sipas këtij kuptimi, emri i përveçëm i sendeve (emri i anijeve, p.sh.) nuk bën pjesë në teorinë e përgjithshme të saj. E drejta civile përqendrohet tek emrat e përveçëm të personave. Në këtë rast kemi të bëjmë me *antroponimi*.

Emri është objekt i një të drejte të mirëfilltë të pronësisë individuale për atë që e mban. Çdokush është pronar i emrit të vet. Jashtë kategorie, emri komercial (që nuk do të trajtohet këtu) është objekt i një pronësie jomateriale.

Nëse konsiderohet në tërësinë e funksioneve e tij, emri është një institucion me shumë aspekte: është qendra dhe madje nyja e interesave të shumta që bashkohen tek ai dhe në regjimin e tij juridik. Nga këndvështrimi i interesit publik, emri ka kontribut në identifikimin e personit në shoqëri. Ai paraqet një faktor rendi dhe një element individualizues. Kjo është njëra anë e funksionit të tij social.

Emri është një emblemë familjare. Shenjë e dukshme e përkatësisë familjare, shenjë e bashkimit të një fisi, nganjëherë e një dege familjare, ai tregon bashkimin familjar. Si shfaqje e lidhjes familjare, ai emërtohet “mbiemër familjar” dhe ka disa pasoja të së drejtës që lidhen me të.

Emri është së fundmi një element i personalitetit. Ai identifikon personin. Për çdo person, mbiemri familjar është “një emër i përveçëm”. Nuk është vetëm një përkatësi familjare, por një individualitet që bëhet i dukshëm. Në fillim, dukej se emri thjesht i mbivendosej personalitetit, por pak nga pak ai u bë pjesë integruese, identifikuese e tij, derisa u kthye në mbështetjen e elementeve të tjera të gjendjes civile, pika e referimit e identitetit të personit, qendra e vetëvlerësimit dhe e nderit.

Në këtë mënyrë emri është në mënyrë të pandashme një shenjë e qytetarisë, një pikë referimi gjenealogjik dhe pjesë përbërëse e gjendjes civile të gjithsecilit. Edhe pse aktualisht emri zë një vend kryesor, vlera themelore e mbiemrit mbetet po ajo. Mbiemri është te secili një prani shpirtërore dhe në çdo rast një burim referencash, nga të cilat mund të ndërtohet personaliteti.

3. Mbiemri

Mbiemri, ashtu sikurse edhe emri, konsiderohet një e drejtë personale jopasurore. Çdo person fizik ka të drejtën dhe detyrimin që të ketë një mbiemër¹⁵³.

Në të drejtën familjare njihet e drejta e caktimit të mbiemrit që bashkëshortët do të mbajnë pas lidhjes së martesës. Mbiemri dhe emri i personit nuk shërben vetëm për të bërë individualizimin e çdo personi, por edhe si element për kryerjen e të gjitha veprimeve juridike që personi duhet të kryejë gjatë gjithë jetës së tij. Mbiemri dhe emri janë të lidhur ngushtë me statusin e shtetasit. Duke u nisur përsëri nga parimi i barazisë,

¹⁵³ Neni 5 i Kodit Civil.

ligjvënësi i jep mundësi bashkëshortëve: të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajë secili mbiemrin e vet.

Mbiemri që vendoset të mbahet nga bashkëshortët regjistrohet në regjistrin e martesave, para momentit të hartimit të aktit të martesës. Pra është detyrë e organit kompetent të lidhjes së martesës të pyesë bashkëshortët e rinj të vendosin dhe të shprehin se cilin mbiemër do të mbajnë gjatë jetës bashkëshortore. Në përgjithësi për shkak edhe të traditës shumë shekullore shqiptare, gratë pas lidhjes së martesës preferojnë të marrin mbiemrin e bashkëshortit të tyre. Ky fenomen nuk cenon aspak parimin e barazisë.

Sigurisht ekziston një numër grash të afirmuara në një fushë të caktuar të artit, kulturës, shkencës, sportit, politikës etj, të cilat edhe pas lidhjes së martesës mbajnë mbiemrin e vajzërisë. Fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve. Në rast se prindërit kanë mbiemra të ndryshëm, të gjithë fëmijët mbajnë të njëjtin mbiemër, e pikërisht atë që do të vendosin prindërit me marrëveshje. Në rast se prindërit nuk arrijnë në marrëveshje, fëmijët mbajnë mbiemrin e babait.

Sipas nenit 146 të Kodit të Familjes, bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës. Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës.

Me lindjen e fëmijës së parë të martesës së tyre, prindëritqë mbajnë mbiemra të ndryshëm, kanë me ligj të drejtën për të zgjedhur me marrëveshje të përbashkët mbiemrin e fëmijës dhe do të jetë ky mbiemri që do të figurojë në përcaktimet e aktit të tij të lindjes. Zgjedhja e prindërve nuk është e lirë. Ajo mund të kryhet vetëm për mbiemrin e njërit prej paraardhësve të drejtpërdrejtë. Por përcaktimi ligjor lë hapësira. Të dy prindërit mund t'i japin fëmijës së tyre të përbashkët ose mbiemrin e babait ose atë të nënës. Zgjedhja u takon prindërve, mbiemri gjithashtu, por ai mund të jetë vetëm i nënës ose i babait. Në të dyja rastet, fëmija ka lidhje mbiemërore vetëm me njërin nga të dy prindërit, pra lidhja është e njëanshme dhe mund të jetë ose atërore, ose amësore.

Mbiemri i babait në mungesë të një deklaratë të përbashkët. Në mungesë të një deklaratë ku përcaktohet zgjedhja e prindërve, fëmija merr, në përputhje me ligjin mbiemrin e babait. Kalimi i mbiemrit atëror kryhet me të drejta të plota. Gjejmë këtu një mekanizëm ligjor të transmetimit të mbiemrit të familjes, i cili favorizon mbiemrin e babait, por ky është plotësues dhe ruan një prirje që ende ekziston.

Në nenin 171 përcaktohet se fëmija i lindur jashtë martese merr mbiemrin e prindit, amësia ose atësia e të cilit është vendosur më përpara. Në qoftë se amësia dhe atësia vendosen në të njëjtën kohë, prindërit vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do të mbajë fëmija. Në rast mosmarrëveshjeje, fëmijës i vendoset mbiemri i të atit. Kur nuk ka atësi të njohur, fëmijës i vendoset mbiemri i nënës. Fëmija jashtë martese merr mbiemrin e vajzërisë së nënës.

Mjaft interesant paraqitet caktimi i mbiemrit të fëmijës në *Spanjë dhe në Portugali*. Në qoftë se i ati quhet Luis Sanchez Martinez dhe e ëma quhet Maria Garsia

Zapata, atëherë fëmija i tyre Pedro do të marrë dy mbiemrat e parë të secilit prind duke u quajtur Pedro Sanchez Garsia.

Në *Greqi*, pas martesës secili bashkëshort ka të drejtë të mbajë mbiemrin e vet ose me marrëveshje ata mund të caktojnë mbiemrin e njërit prej bashkëshortëve. Fëmijët e tyre mbajnë emrin e njërit prej prindërve. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në Zvicër.

3.1. Atributet e mbiemrit

Mbajtja e mbiemrit dhe mbrojtja e tij janë dy atributet që duhen marrë në konsideratë. Për çdo individ mbajtja e mbiemrit përbën një të drejtë, por gjithashtu një detyrim. Çdokush përdor mbiemrin e tij. Secili ka të drejtën të përdorë mbiemrin e tij në të gjitha aktet e jetës civile: në aktet juridike, në aktet e gjendjes civile, në ushtrimin e aktiviteteve profesionale dhe tregtare. Një kufizim shfaqet megjithatë në këtë pikë në jurisprudencë.

Mbajtësi legjitim i një mbiemri nuk mund të përfitojë nga një homonimi për të ushtruar një veprimtari tregtare analoge me atë të një tregtari tjetër, i cili ishte bërë i njohur më parë me këtë mbiemër¹⁵⁴. E drejta e markave i jep përparësi të drejtës së depozituesit të parë që mund të sjellë ndalimin ose rregullimin e përdorimit të mbiemrit nga personi i dytë.

Përdorimi i mbiemrit është një e drejtë e paparashkrueshme. Një individ nuk mund ta humbasë të drejtën që të mbajë mbiemrin që i jep ligji. I interesuari mund të kërkojë gjithmonë të rimarrë përdorimin e mbiemrit për të cilin ai ka të drejtë, pa qenë i detyruar t'i kundërvihet parashkrimit shues të mbiemrit, pasi ai nuk humbet nga mospërdorimi.

Çdokush ka detyrën të mbajë mbiemrin e tij. Mbiemri shfaqet këtu si një institucion i sigurisë publike, element identifikimi. Shteti dhe të tretët janë të interesuar për respektimin e një detyrimi të tillë. Megjithatë, ky detyrim ka kufijtë e tij.

Zgjedhja e pseudonimit është e lirë dhe e ligjshme. Ai që ka krijuar dhe ka mbajtur për një kohë të gjatë një pseudonim origjinal ka të drejtën t'ia ndalojë përdorimin e tij dikujt tjetër.

Po kështu, përveç rasteve ku individ i është i detyruar të paraqesë identitetin e tij, ai mund të ruajë anonimat. Anonimati është një liri, sidomos në situatat kontraktuale (apo në publikimin e një vepre). Këto liri pushojnë vetëm kur ato cenojnë interesin legjitim të një të treti.

Detyrimi për të mbajtur mbiemrin e vërtetë mund të hasë një tjetër sanksion, në raportet mes individëve, me nismën e një të treti që mbron mbiemrin e tij kundrejt huazimit të tij, qoftë edhe në mirëbesim (si pseudonim apo si mbiemër familjar): rendi publik nuk është më i përfshirë drejtpërsëdrejti në çështje. Është interesi privat i mbajtësit legjitim të emrit që i kundërvihet cenimit ose uzurpimit të tij.

¹⁵⁴ F. Polluaud – Dulian, “*L’utilisation du nom patronimique comme nom commercial*”, J.C.P 1992. I. 3618.

Mbajtësi legjitim i një mbiemri duhet ta mbrojë atë. Kjo prerogativë nuk përkon me një detyrim, por me një të drejtë. Është një mbrojtje që ofrohet nga e drejta.¹⁵⁵

E drejta për të mbrojtur mbiemrin mbrohet me padi të ndryshme në drejtësi. Një nga paditë më të rëndësishme është padia për cenim të mbiemrit. Është një padi kundërshtuese për gjendjen kur mbajtësi legjitim i një mbiemri i kundërshton një të treti të drejtën për të mbajtur të njëjtin mbiemër. Ai i kërkon gjyqtarit që ta ndalojë në të ardhmen mbajtjen e mbiemrit të cenuar dhe nëse nevojitet, të korrigjojë për pasojë aktet e gjendjes civile. Në këtë padi themelore, ajo çka vihet në lojë është e drejta e cenesit të pretenduar për të mbajtur një mbiemër të kundërshtuar. Shpesh, ai pretendon se ka të drejtë për mbiemrin që i është kundërshtuar duke sjellë për shembull parashkrimin fitues që mund të jetë kryer në favorin e tij (shih vendimin e Dhomës së I-rë Civile të Gjykatës franceze të Kasacionit, datë 13 korrik 1955, Arbellot de Rouffignac, D. 1955.717).

Një tjetër lloj padie ushtrohet nga mbajtësi legjitim i një mbiemri kundër përdorimit abuziv të këtij mbiemri nga një shkrimtar, një kineast, për qëllime letarare apo artistike. Mbajtësi i një mbiemri ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për dëmin moral të shkaktuar nga përdorimi abuziv i mbiemrit të tij që një autor e huazon duke ia dhënë një personazhi të një romani apo të një filmi. Në këtë rast duhet të provohet se, përdorimi i mbiemrit i ka shkaktuar dëm paditësit, duke patur pasoja dëmtuese mbi personazhin real, nëpërmjet personazhit fiktiv.

Një tip i tretë padie siguron mbrojtjen e mbiemrit kundrejt përdorimit për qëllime tregtare (apo publicitare) nga të tretët. Kemi të bëjmë me një padi paralele me të mëparshmen, nëpërmjet të cilës mbajtësi legjitim i mbiemrit e ndalon një të tretë që të përdorë të njëjtin mbiemër apo një mbiemër të përafërt për arsye tregtare.

Teoria që dominon sot harmonizohet me kushtet që jurisprudenca i vendos mbrojtje mbiemrit. Mbiemri është një element i personalitetit: ai mund të mbrohet vetëm nëse personaliteti cenohet. Kushtet e interesit dhe të dëmit konkretizojnë cenimet ndaj personalitetit.

6. Vendbanimi dhe vendqëndrimi

6.1 Nociione të përgjithshme

Identifikimi i personit në hapësirë realizohet nëpërmjet vendbanimit¹⁵⁶. Kuptimi juridik i vendbanimit nuk është ai kuptim me të cilin jemi mësuar, për vetë faktin se ai është një kuptim fiktiv nga njëra anë dhe nuk duhet ngatërruar me vendqëndrimin ose banesën e një personi nga ana tjetër. Nën këndvështrimin etimologjik, fjala vendbanim e ka origjinën nga latinishtja *domum colere* që do të thotë “banesa në të cilën banon dikush” dhe për t’i dhënë kuptimin e plotë këtij fakti përdoret edhe shprehja latine *nemo de domo suo extrahi debet* (shtëpia ku banon dikush dhe nuk mund të dëbohet prej saj në kundërshtim me ligjin). Gjithsesi duhet që të kemi parasysh *ab initio* që jo çdo lloj banese që i përket një personi ka kuptimin juridik të vendbanimit, sepse nocioni i vendbanimit nuk varet nga e drejta e pronësisë mbi një shtëpi, e cila përdoret si hapësirë banimi.

¹⁵⁵ Cayser, P. “La défense du nom d’après la jurisprudence civile et d’après la jurisprudence administrative”, RTD civ., 1959.10.

¹⁵⁶ Dogaru, Ion & Cercel, Sevastian. *Drept civil, Persoanele*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2007, f. 158.

Sipas nenit 38 të Kushtetutës së Shqipërisë: “*Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit*”. Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij. Personi nuk mund të ketë njëkohësisht me shumë se një vendbanim¹⁵⁷. Nisur nga mundësia që i njeh ligji personit për të zgjedhur banimin e tij, banimi përcaktohet si banim vullnetar, kur ai zgjidhet lirisht prej tij dhe si banim i detyrueshëm, kur ai caktohet nga ligji dhe jo nga vullneti i personit. Përcaktimi i banimit ka rëndësi për qëndrueshmërinë e marrëdhënieve juridike midis qytetarëve, por është i nevojshëm edhe nga pikëpamja e interesave të përgjithshme shtetërore¹⁵⁸.

Vendbanimi i një personi është qendra e realizimit dhe e interesave të tij. Ky është vendi në të cilin, personi kalon të shumtën e kohës dhe kjo kohë ka lidhje parimisht edhe me punën që ushtron. Pra, personi konsiderohet si i përhershëm në një vend. Në fjalorin juridik përdoren termat “vendbanimi i përhershëm”, “vendi i banimit të përhershëm”, “vendi në të cilin personi jeton gjithmonë”. Në teorinë e së drejtës civile kërkohet plotësimi i dy kushteve për vendbanimin.

Së pari, duhet të ekzistojë një vend si vendbanim;

Së dyti, duhet të ekzistojë vullneti i personit fizik, i cili jep pëlqimin e tij për të jetuar në të njëjtin vend.

Në vendbanimin e një personi fizik realizohen edhe të drejtat e tij politike, sikurse është për shembull, e drejta zgjedhore, qoftë ajo aktive ose pasive¹⁵⁹.

Në shumicën e shteteve personi fizik mund të ketë vetëm një vendbanim. Sipas të drejtës gjermane, personi fizik mund të ketë njëkohësisht shumë vendbanime. Sipas të drejtës greke, në parim personi fizik mund të ketë vetëm një vendbanim. Në raste përjashtimore, kur një person ushtron një veprimtari tregtare jashtë vendit, në të cilin ka edhe vendbanimin e tij, ligji grek parashikon mundësinë që personi fizik me këtë veprimtari tregtare në vendin e ushtrimit të saj të ketë një vendbanim special.

Dispozita të cilat trajtojnë vendbanimin, krahas Kodit Civil dhe ligjit për gjendjen civile, i hasim edhe në Kodin e Familjes. Në këtë mënyrë trajtohet nga ky kod e drejta për të caktuar vendbanimin, sipas të cilit burri dhe gruaja që kanë lidhur martesë midis tyre janë të detyruar të jetojnë së bashku. Vendbanimi i përbashkët i familjes zgjidhet me marrëveshjen e të dy bashkëshortëve. Në rast se marrëveshja nuk arrihet, secili bashkëshort ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për të përcaktuar vendbanimin. Gjykata, pasi dëgjon mendimet e bashkëshortëve dhe nëse është e domosdoshme, dëgjon edhe mendimin e fëmijës që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, mundohet të gjejë një zgjidhje me mirëkuptim. Në rast se përsëri nuk gjendet mirëkuptimi, gjykata vendos për zgjidhjen që e quan më të përshtatshme për interesat e familjes.

¹⁵⁷Neni 12 i Kodit Civil.

¹⁵⁸Kondili, Valentina; op. cit., f. 126.

¹⁵⁹Kadriu, Osman; op. cit., f. 189-190.

Vendbanimi është vendi ku një person qëndron të shumtën e kohës dhe konsiderohet si i përhershëm, fakt i cili afirmon edhe njëherë se vendbanimi mund të ndryshojë nga banimi i thjeshtë, i cili mund të jetë një vend ku personi qëndron përkohësisht, për shembull për pushime, pasi ai ka një shtëpi të dytë, qëndrimi në një hotel, etj.

Dispozita që trajtojnë vendbanimin i gjejmë edhe në Paktin Ndërkombëtar të të Drejtave Civile dhe Politike, në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, sikurse edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, kjo konventë parashikon se: kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij. Pra, ashtu sikurse parashikohet edhe në këtë konventë, banimi zgjidhet lirisht prej personave, sipas vullnetit të tyre.

Kuptimin e banimit e përcakton ligji. Mund të ndodhë që, në kushtet e përcaktuara nga ligji, një person të mos e zgjedhë vetë vendbanimin e tij. Sipas nenit 13 të Kodit Civil, i mituri që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç, ka për banim atë të prindërve të tij. Kur prindërit kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën katërbëdhjetë vjeç ka për banim atë të prindit pranë të cilit jeton. Personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe fëmijët nën kujdestari kanë për banim atë të përfaqësuesit të tyre ligjor. Në këtë rast, banimi i këtyre personave konsiderohet banim i detyrueshëm. Kur prindërit mund të jenë të shkurorëzuar ose qëndrojnë të ndarë *de facto*, banimi i fëmijës, është i kushtëzuar, pranë atij prindi me të cilin ai jeton. Banim të detyrueshëm nuk kanë të miturit katërbëdhjetë deri tetëmbëdhjetë vjeç.

6.2 Rëndësia praktike e vendbanimit

Vendbanimi është një nocion që ka një rëndësi të veçantë për të gjitha degët e së drejtës dhe në këtë aspekt padyshim që ka një rëndësi edhe për të drejtën civile.

- a) vendbanimi ka rëndësi për të përcaktuar vendin e ekzekutimit të një detyrimi në të holla. Pagesa kryhet në vendbanimin e kreditorit në datën e pagesës. Kreditori mund të caktojë një vend tjetër brenda kufijve të shtetit ku ka vendbanimin në kohën e pagimit ose të lindjes së detyrimit¹⁶⁰;

Në rast se vendi ku duhet të ekzekutohet detyrimi nuk caktohet në kontratë, nga ligji ose nuk kuptohet nga vetë natyra e detyrimit, ekzekutimi bëhet në vendin ku debitori ushtron veprimtarinë e tij profesionale ose në vendbanimin e tij;

- b) përcaktimi i vendbanimit ka rëndësi për çeljen e trashëgimisë.

Trashëgimia çelet në vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj¹⁶¹;

- c) përcaktimi i vendbanimit ka rëndësi për shpalljen e zhdukur të personit fizik.

¹⁶⁰Neni 448 i Kodit Civil.

¹⁶¹Ibid, neni 318.

Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës¹⁶²;

ç) përcaktimi i vendbanimit ka rëndësi për të përcaktuar gjykatën kompetente për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje civile të caktuar.

Paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij dhe kur këto nuk dihen, në gjykatën e vendit ku ai ka banesën e përkohshme. Kur i padituri nuk ka vendbanim, as vendqëndrim dhe as banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, paditë ngrihen në gjykatën ku banon paditësi¹⁶³;

d) Vendbanimi ka rëndësi për emërimin e kujdestarit për sigurimin e pasurisë trashëgimore;

Sipas nenit 344 të Kodit Civil, kur nuk dihet a ka trashëgimtarë ose kur trashëgimtarët mungojnë dhe nuk ka lajme për ata ose kur trashëgimtarët ligjorë apo testamentarë kanë hequr dorë nga trashëgimi dhe nuk dihen trashëgimtarët e tyre, gjykata e rrethit ku është çelur trashëgimi, kryesisht ose me kërkesën e çdo të interesuari, emëron një kujdestar të trashëgimit;

e) sipas nenit 263 të Kodit të Familjes, gjykata kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit.

6.3 Llojet e vendbanimeve

Evidentohen disa lloje vendbanimesh në funksion të mënyrës sesi përcaktohet vendbanimi.

- *vendbanimi vullnetar*, i cili nënkupton një banesë të zgjedhur në mënyrë të lirë nga personi për të banuar; vendbanimi vullnetar është vendosur në mënyrë të pavarur nga vetë subjekti i së drejtës. Ky person fizik ka zotësi të plotë për të vepruar. Zgjedhja e vendbanimit garantohej me anë të ligjit.
- *vendbanimi ligjor*, i cili është deklaruar nga personi fizik në përputhje me ligjin.
- *vendbanimi i zgjedhur ose konvencional*, i cili konsiderohet si i tillë për shkak të disa marrëdhënieve juridike në të cilat është i përfshirë personi fizik dhe ky vendbanim e gjen kuptimin e tij vetëm në lidhje me përmbushjen e këtyre marrëdhënieve.
- doktrina ka afirmuar edhe faktin se mund të flitet edhe për një vendbanim politik ose vendbanimi civil në qoftë se do t'i referohemi ushtrimit të të drejtave politike dhe civile të personit fizik¹⁶⁴.

¹⁶² Kodi Civil, neni 15.

¹⁶³ Neni 42 i Kodit të Procedurës Civile.

¹⁶⁴ Dogaru, Ion & Cercel, Sevastian; op. cit., f. 161.

6.4 Deklarimi dhe regjistrimi i vendbanimit

Shtetasit kanë të drejtë të kenë një apo më shumë banesa për përdorim vetjak apo familjar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e çdo banese për përdorim, sipas kësaj pike. Gjithashtu, ata kanë të drejtë të zgjedhin lirisht se në cilën banesë të jetojnë zakonisht ose të shumtën e kohës. Banesën, në të cilën shtetasi jeton zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik, ka detyrimin ta deklarojë si vendbanimin e tij¹⁶⁵.

6.5 Regjistrimi dhe ndryshimi i vendbanimit

Regjistrimi fillestar i vendbanimit/adresës së banesës, si dhe ndryshimi i vendbanimit/adresës së banesës, si rregull, bëhet në zyrën e gjendjes civile të njësisë administrative që ka në juridiksion territorial vendbanimin apo banesën e deklaruar. Nëse një shtetas ka më shumë se një banesë për përdorim, sipas pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile”, ai duhet të deklarojë banesën, në të cilën ka vendbanimin e tij. Shtetasit nuk mund të deklarojnë njëherazi më shumë se një vendbanim. Në rast ndryshimi të vendbanimit, apo kur një banesë nuk përdoret më për përdorim vetjak apo të familjes, ky ndryshim deklarohet në zyrën e gjendjes civile. Regjistrimi fillestar i vendbanimit apo ndryshimi i tij bëhet jo më vonë se 30 ditë nga ardhja në këtë vendbanim. I njëjti afat zbatohet edhe për deklarimin e banesave që nuk kanë statusin e vendbanimit. Rregullat e veprimeve për pasqyrimin e regjistrimit dhe ndryshimit të vendbanimit të shtetasve, përcaktohen nga ministri që mbulon gjendjen civile.

6.5.1 E drejta për deklarimin e vendbanimit

Deklarimin e vendbanimit apo të banesës për pjesëtarët e një familjeje ka të drejtë ta bëjë kryefamiljari ose, në pamundësi të tij, çdo person madhor i familjes. Çdo person madhor, që vendos të jetojë në një vendbanim të ndryshëm nga ai i pjesëtareve të tjerë të familjes, bën deklaram individual të vendbanimit. Shtetasi mund të deklarojë, gjithashtu, në mënyrë individuale një banesë për përdorim vetjak. Shtetasi i mitur, apo që i është hequr zotësia për të vepruar, ka vendbanim të njëjtë, sipas rastit, me atë të kryefamiljarit, prindit me të cilin jeton apo të kujdestarit të tij. Kur një i mitur apo një person, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, banon në një vendbanim të ndryshëm nga prindërit e tij, deklarimi për të bëhet, sipas rastit, nga kryefamiljari, njëri nga prindërit, apo personi që zotëron kujdestarinë. Në këtë rast zyra e gjendjes civile administron edhe dokumentacionin që provon kujdestarinë mbi të miturin dhe vendbanimin e kujdestarit.

6.5.2 Pranimi në një vendbanim tjetër

Një person apo një ose më shumë familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një personi apo të një familjeje tjetër kur nuk kanë lidhje familjare, kur plotësohen standardet e sipërfaqes së banimit për frymë, si dhe kur zotërojnë një kontratë ose kur kryefamiljari i familjes pritëse apo shtetasi që zotërojnë titull të ligjshëm pronësie

¹⁶⁵ Neni 14 i ligjit Nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”.

ose përdorimi të banesës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat e ndryshimit të vendbanimit¹⁶⁶.

Në këtë rast, kryefamiljari i familjes pritëse dhe personi apo kryefamiljari që kërkon të banojë në vendbanimin e tij shprehin vullnetin e tyre për këtë qëllim para nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është vendbanimi i familjes pritëse. Në rast të lidhjeve familjare të vërtetuara, pranimi i personit apo i familjes në vendbanimin e ri bëhet në bazë të deklaramit të tyre para nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është vendbanimi i familjes pritëse. Strukturat komunitare të njësisë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës ndodhet vendbanimi i ri, kryejnë verifikimet përkatëse, në lidhje me plotësimin e standardeve të sipërfaqes së banimit për frymë. Pas kryerjes së verifikimit, strukturat komunitare përgatisin një raport, i cili është pjesë e praktikës që administron nëpunësi i zyrës së gjendjes civile për këtë qëllim.

6.5.3 Afati i deklaramit të ndryshimit të vendbanimit për arsye pune ose arsimimi

Shtetasit që për arsye të kryerjes së detyrave shtetërore apo për shkak punësimi janë të detyruar të jetojnë zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje apo për më shumë se gjashtë muaj, gjatë një viti kalendarik, në një vendbanim të ndryshëm me atë të regjistruar në zyrën e gjendjes civile, janë të detyruar të deklarojnë vendbanimin e ri brenda 30 ditëve nga ardhja në atë vendbanim, pranë zyrës së gjendjes civile që ka në juridiksion territorial vendbanimin e ri. Rregulli i përcaktuar më sipër zbatohet edhe për shtetasit që ndryshojnë vendbanimin për arsye arsimimi, kur ata ndjekin programe shkollore apo universitare në sistemin me shkëputje nga puna dhe kur programi i plotë akademik është më i gjatë se 1 vit. Bëjnë përjashtim nga ky rregull shtetasit që banojnë apo regjistrojnë vendbanimin e tyre brenda territorit të qarkut apo në rrethet fqinje me atë, në të cilin ndodhet adresa e institucionit arsimor, pavarësisht se nuk janë në të njëjtin qark.

6.5.4 Deklarimi i vendbanimit pranë punëdhënësit apo institucionit arsimor

Shtetasit që për arsye pune/arsimimi ndryshojnë vendbanimin, janë të detyruar të paraqesin pranë institucionit shtetëror apo punëdhënësit, në çastin e fillimit të marrëdhënies së punës, ose pranë institucionit arsimor, në çastin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim në vitin akademik, një nga dokumentet që vërteton vendbanimin, në përputhje me kërkesat e këtij ligji¹⁶⁷. Në çdo rast, ky dokument duhet të paraqitet jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i detyrës, marrëdhënies së punës ose paraqitjes së kërkesës për regjistrim në vitin akademik të studimeve. Në rast se regjistrimi në vitin akademik bëhet automatikisht dhe pa kërkesë, institucioni verifikon kushtet e parashikuara në këtë nen dhe, kur identifikon mangësi në dokumentacionin provues të vendbanimit, njofton brenda 5 ditëve shtetasin që ka detyrimin për deklaram, si dhe zyrën e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin arsimor.

¹⁶⁶ Ibid, neni 17.

¹⁶⁷ Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", neni 20.

Institucionet shtetërore dhe arsimore, si dhe punëdhënësit e përcaktuar në këtë nen, janë të detyruar të informojnë brenda 5 ditëve zyrën e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, për shtetasit që ndryshojnë vendbanimin për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe që nuk kanë paraqitur ende dokumentin që vërteton vendbanimin.

Zyra e gjendjes civile, brenda 5 ditëve, në bashkëpunim me institucionin përkatës që ka bërë informimin, njofton me shkrim shtetasit, të cilët, për arsye pune apo arsimimi, janë vendosur me vendbanim në njësinë administrative në juridiksion të zyrës përkatëse të gjendjes civile, për detyrimin për regjistrim të vendbanimit dhe për sanksionet në rast mos-regjistrimi. Kur edhe pas kalimit të afatit për regjistrim, shtetasi nuk ka deklaruar vendbanimin e tij, zyra e gjendjes civile njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC). Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e komunikimit midis institucioneve apo punëdhënësve, subjekte të këtij neni, si dhe të njoftimit të shtetasve nga zyrat e gjendjes civile.

6.5.5 Regjistrimi i vendbanimit të shtetasve të huaj dhe i personave pa shtetësi

Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë në zyrën e gjendjes civile vendbanimin e tyre, brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së lejes së qëndrimit nga organi kompetent¹⁶⁸. Zyra që mbulon shtetësinë dhe refugjatët njofton brenda 5 ditëve DPGJC-në për çdo akt të ri për këtë kategori shtetasish. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim në Republikën e Shqipërisë, kur ndryshojnë vendbanim, janë të detyruar të njoftojnë zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të tyre brenda 30 ditëve nga ardhja në vendbanimin e ri.

6.6 Dokumentacioni për vërtetimin e vendbanimit dhe ndryshimit të tij

Zyra e Gjendjes Civile e regjistron deklarin e vendbanimit ose banesës për përdorim vetjak apo familjar të shtetasit kur ai paraqet dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose një kontratë apo dokument tjetër të ligjshëm të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që i jep shtetasit të drejtën e përdorimit të banesës (kontratë qiraje, huapërdorje etj.) Përcaktimi i dokumentacionit të nevojshëm që vërteton vendbanimin apo banesën për përdorim vetjak ose familjar të shtetasit, si dhe mënyra e administrimit të këtij dokumentacioni nga zyra e gjendjes civile, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Deklarimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Për shtetasit që, me dekret të Presidentit të Republikës, lënë shtetësinë shqiptare, DPGJC-ja u kërkon zyrave të gjendjes civile, ku shtetasit kanë vendbanimin e tyre, që brenda 30 ditëve të bëjnë çregjistrimin e tyre nga Regjistri Kombëtar¹⁶⁹. E drejta e DPGJC-së të mbledhë të dhëna nga institucione të treta. DPGJC-ja ka të drejtë të ketë

¹⁶⁸ Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, neni 21.

¹⁶⁹ Ibid, neni 23.

akses ose të kërkojë informacion, në mënyrë periodike apo rast pas rasti, nga institucione ose ente shtetërore e private të tjera që mbledhin dhe administrojnë baza të dhënash të shtetasve që përmbajnë të dhëna lidhur me adresën e personit apo të vendbanimit të tij.

7. Vendqëndrimi

E drejta e vendqëndrimit është një e drejtë personale jopasurore dhe është e parashikuar edhe në disa dispozita ndërkombëtare. Për të drejtën civile, vendqëndrimi është një atribut identifikimi i personit fizik në hapësirë dhe këtë fakt e shpreh edhe ekzistenca e banesës së dytë. Karakteristikat juridike të vendqëndrimit nuk janë të njëjta me karakteristikat juridike të vendbanimit. Vendqëndrimi është fakultativ dhe varet nga vullneti i personit fizik në qoftë se ai vendos t'a deklarojë ose jo si adresë të korrespondencës.

Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre. Për shembull, dy bashkëshortë kanë një vendbanim të përbashkët, por ato kanë vendqëndrime të ndryshme, për shkak të punës që ata kryejnë ose detyrave të caktuara që ata kanë. Në të drejtën civile, caktimi i vendbanimit dhe i vendqëndrimit është i lidhur ngushtë me institute të tjera të saj¹⁷⁰. Vendqëndrimi dallon nga banimi. Vendqëndrimi, sikurse është përcaktuar në ligj, lidhet me qëndrimin e përkohshëm të personit në një vend të caktuar për të realizuar veprimtari të ndryshme. Personi mund t'a zgjedhë vetë vendqëndrimin, i kushtëzuar nga qëllimi që kërkon të realizojë ose i caktohet në mënyrë të detyrueshme për shkak të rrethanave të pranishme. Në dallim nga vendqëndrimi, vendbanimi është vend ku personi qëndron zakonisht ose më të shumtën e kohës, pra pjesën më të madhe të kohës, në krahasim me vendqëndrimin në të cilin qëndron përkohësisht¹⁷¹.

Prej vendbanimit dhe vendqëndrimit dallojmë *banimin e rëndomtë* ose ndryshe sikurse quhet banimi i thjeshtë. Banimi i thjeshtë është ai vend në territorin e të cilit një person fizik qëndron vetëm përkohësisht dhe për një interval kohor të shkurtër sikurse është rasti i pushimeve në një vend të caktuar, pushimi në një vend në të cilin personi fizik ka një shtëpi pushimi. Kjo gjendet jashtë territorit në të cilin personi konkret ka vendbanimin e tij. Shembujt e mësipërm janë të vlefshëm edhe me rastet e qëndrimit në hotel për një kohë të caktuar¹⁷².

¹⁷⁰ Latifi, Juliana; op. cit., f. 55.

¹⁷¹ Kondili, Valentina; op. cit., f. 128.

¹⁷² Kadriu, Osman; op. cit., f. 191.

KAPITULLI V

GJENDJA CIVILE

1. Nocione dhe karakteristikat kryesore të gjendjes civile

Gjendja civile është tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj, si dhe të personave pa shtetësi, që janë me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre¹⁷³.

Regjistri Kombëtar është dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj dhe çdo personi pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Ndërsa “Regjistri Themeltar i Gjendjes Civile” është libri me fletë të hapur për çdo familje, ku pasqyrohen, për secilin person, të gjithë përbërësit e gjendjes civile. Ky libër ruhet në Zyrën e Arkivi të Gjendjes Civile, pranë Prefektit të Qarkut.

Njëherësh, përbërës të gjendjes civile janë të gjitha elementet që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj apo çdo personi pa shtetësi me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Të dhënat, individuale e familjare, të përbërësve të gjendjes civile kanë karakter personal. Aktet, të dhënat dhe konfirmimet shkresore për gjendjen civile i jepen vetëm personit, që i përkasin këto të dhëna, anëtarit të familjes, kujdestarit, përfaqësuesit ligjor ose, me prokurë dhe pas vdekjes, atyre, që kanë legjitimitetin e kërkimit të trashëgimisë ligjore ose trashëgimtarëve testamentarë.

Të dhënat individuale e familjare të përbërësve të gjendjes civile mund të kërkohen dhe të merren nga institucionet e organet, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Këto subjekte, që kërkojnë dhe marrin të dhëna të gjendjes civile, drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, i përdorin ato vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë, duke u rezervuar në përhapjen e tyre.

1.1 Vlera juridike e të dhënave të gjendjes civile

Të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm nëse lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile, në mënyrën dhe formën e parashikuar në ligjin për gjendjen

¹⁷³ Neni 2 i ligjit Nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”.

civile dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij. Për çdo akt dhe dokument, që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuara me ligj, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile shënon, në mënyrë të plotë, emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vet dhe përdor vulën zyrtare të shërbimit të gjendjes civile.

Elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të çdo akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen.

1.2 Papajtueshmëria e veprimeve

Nëpunësi i gjendjes civile nuk mund të kryejë veprime të gjendjes civile aty ku është emëruar, kur këto i përkasin atij vetë, bashkëshortit e fëmijëve të tij, prindërve, gjyshit, gjyshes, vëllezërve, motrave, vjehrrit ose vjehrrës. Në këtë rast, veprimet kryhen nga një nëpunës tjetër i shërbimit të gjendjes civile.

1.3 Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve

Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri i identitetit, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj.

Shtetësia shqiptare, si përbërës i gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi

Numri i identitetit është numri unik i papërsëritshëm, që i caktohet çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj, si dhe çdo personi pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm, me lidhje të caktuara ekonomike nga shërbimi gjendjes civile.

Veçoritë e disa përbërësve të gjendjes civile sikurse janë lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë, dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t'u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë¹⁷⁴. Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore sikurse janë lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja vërtetohen rregullisht, si fakte juridike, nga personat dhe organet, të cilëve u njihet ky tagër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Faktet juridike të prezumuara me ligj ose të rrjedhura nga veprimet e vetë personit, që vërtetohen, janë raportet e atësisë, amësisë dhe familja. Përbërës të rrjedhur nga aktet e organeve të tjera si birësimi, shtetësia, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, si përbërës kryesorë të gjendjes civile, burojnë dhe pasqyrohen vetëm në mbështetje e në përputhje me aktin e organit përgjegjës shtetëror, sipas ligjit. Prej tyre përcaktohen edhe përbërësit e tjerë kryesorë të gjendjes civile, kur ndryshohen sipas ligjit.

Gjendja civile e një personi mund të jetë¹⁷⁵:

a) *“Beqar/e” është shtetasi, i cili nuk ka kryer akt martesë;*

¹⁷⁴ Neni 8 i ligjit Nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”.

¹⁷⁵ Ibid, neni 13.

- b) *“I/e martuar” është shtetasi i lidhur me akt martesë;*
- c) *“I/e ve” është shtetasi pas vdekjes së bashkëshortes/bashkëshortit, me të cilën/cilin ishte i/e lidhur me akt martesë;*
- d) *“I/e divorcuar” është shtetasi, martesë e të cilit është zgjidhur me vendim gjyqësor.*

Përbërësit e gjendjes civile pasqyrohen në faqen individuale të Regjistrin Kombëtar për shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si edhe për shtetasit e huaj, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë. Kur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile vërehen gabime materiale ose gjendet rubrikë, që nuk pasqyron përbërësin përkatës, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile bën korrigjimin ose plotësimin.

2. Aktet e gjendjes civile

Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes plotësohen e pasqyrohen në akte të veçanta, në formë elektronike dhe të printuara vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklaratimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto akte mbahen, për çdo rast, të renditura kronologjikisht. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes për shtetasit e huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përhershëm në Shqipëri, mbahen në zyrën e gjendjes civile në njësitë administrative, ku ato janë të regjistruar ose ku ka ndodhur lindja apo vdekja. Këto akte mbahen nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.

Aktet e martesës, të mbajtura në postet konsullore, si dhe deklaratimet e lindjes e të vdekjes, të mbajtura në shërbimin e gjendjes civile të vendeve të huaja, për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përcillen, periodikisht, nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila ia dërgon për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse”.

3. Regjistrimi i aktit të lindjes

Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.

Fëmija me prindër të panjohur prezumohet i lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor. Ai pajiset me procesverbal nga organet përkatëse të rendit publik dhe raport mjekësor, të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose, kryesisht, me miratimin e kryetarit të bashkisë, ku është gjetur fëmija, atij i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindërisht imagjinarë, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhor, ose me vërtetimin ligjor të prindërve. Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për fëmijët me

prindër të panjohur, që kanë humbur kujtesën ose janë të paaftë mendërisht dhe që nuk identifikohen. Fëmijës së gjetur mund t'i ndryshojë kjo gjendje, në rastet kur i kthehet kujtesa, kur shërohet mendërisht ose identifikohet me një mënyrë tjetër.

Në të gjitha rastet e parashikuara nga ligji, fëmija i gjetur regjistrohet në vendin, ku vendoset për jetesë, me përjashtim të të gjeturit madhor, që flet vetëm gjuhë të huaj e që regjistrohet si person pa shtetësi. Kriteret e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personin madhor, që ka humbur kujtesën, që është i paaftë mendërisht e që nuk i dihen prindërit, është gjetur me prindër të vdekur, të paidentifikuar, përveç rastit, kur ky person flet vetëm gjuhë të huaj. Në këtë rast ai trajtohet si person pa shtetësi.

3.1 Deklarimi i lindjes

Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme¹⁷⁶.

Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.

Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.

Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara, që çdo ditë të hënë, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre.

3.2 Akti i lindjes

Akti i lindjes vërteton ligjërisht lindjen e shtetasit. Akti i lindjes është procesverbali, që mbahet për çdo të lindur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile në njësinë administrative dhe deklaruesi. Ai përmban: a) numrin rendor, datën e mbajtjes dhe zyrën e gjendjes civile; b) datën e plotë dhe orën e lindjes; c) vendin e lindjes; ç) emrin e mbiemrin, të caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi; d) numrin e identitetit të fëmijës; dh) gjininë; ë) shtetësinë; f) faktin nëse ka lindur normal, binjak apo siamez; g) numrin e identitetit dhe identitetin e nënës; gj) numrin e identitetit dhe identitetin e babait, kur njihet, sipas dispozitave ligjore në fuqi; h) identitetin, numrin e identitetit dhe cilësinë e deklaruesit; i) numrin e identitetit, emrin dhe mbiemrin e përkthyesit.

Akti i lindjes është absolutisht i pavlefshëm, kur nuk është mbajtur nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, ose kur nuk është nënshkruar qoftë edhe nga njëri prej personave të parashikuar në pikën 2 të nenit 42 të këtij ligji. Në raste të tjera, akti i lindjes është i relativisht i pavlefshëm. Nuk mund të konfirmohet përmbajtje tjetër nga ajo e aktit të lindjes pa u vërtetuar pavlefshmëria absolute ose relative, pasaktësia ose falsiteti i

¹⁷⁶ Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", neni 40.

pretenduar për aktin përkatës. Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër, që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t'i parashtrajnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile. Njohja ose kundërshtimi i atësisë e i amësisë bëhen sipas kritereve të përcaktuara në Kodin e Familjes.

Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar mund të ndryshohet drejtpërdrejt nga nëpunësi i gjendjes civile në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, për emrin, mbiemrin dhe shtetësinë e përkohshme, ndërsa, me kërkesë të shtetasit përkatës, brenda 1 viti nga plotësimi i moshës madhore dhe pas kësaj me vendim gjykate.

Plotësimi i të dhënave të aktit të lindjes¹⁷⁷ pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar sikurse janë e për aq sa përmban akti i lindjes, shoqëruar me shënimin për të dhënat e përkohshme. Kur në aktin e lindjes është caktuar emri i përkohshëm, mund të bëhet shënimi, në çdo kohë, kundrejt deklarimit e nënshkrimit të përbashkët të prindërve ose me vendim gjykate. Kur fëmija bëhet madhor, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm prej tij, përveç rastit kur i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Plotësimi i të dhënave në Regjistrin Kombëtar, kur në aktin e lindjes ka rubrika të paplotësuara, bëhet, sipas rastit, me vendim gjykate. Kur data e vendi i lindjes nuk mund të përcaktohen, shënohen si të tilla koha e vendi i takimit të deklaruesit me nënën, e cila ka vdekur më pas, ose koha e vendi i gjetjes së fëmijës.

4. Regjistrimi i aktit të martesës

4.1 Forma e aktit të martesës

Akti i martesës është procesverbali i mbajtur nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në njësinë administrative, ku pasqyrohet vullneti i përbashkët i bashkëshortëve të ardhshëm, i shprehur në prani të nëpunësit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes. Kur nuk janë plotësuar kërkesat për shpalljen e martesës, ka vend për dyshime ose vihen re pengesa ligjore për lidhje martese apo parregullsi në dokumentet e identitetit të palëve, ndërpriten veprimet. Kur është e mundur, bëhet verifikimi i menjëhershëm dhe veprimet vazhdojnë vetëm kur rrëzohen shkaqet që sollën ndërprerjen.

4.2 Mënyra e mbajtjes së aktit dhe dokumentacioni i kërkuar¹⁷⁸

Akti i martesës nënshkruhet nga bashkëshortët, në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve. Kur bashkëshortët nuk dinë ose nuk janë në gjendje fizike të nënshkruajnë, shkak i mosnënshkrimit pasqyrohet në akt. Martesa lidhet kur nëpunësi i gjendjes civile vërteton, pasi ka përfunduar procedura e shpalljes së martesës, sipas Kodit të Familjes, identitetin e secilit prej bashkëshortëve. Martesa e shtetasit të huaj ose e personit pa shtetësi, që banon jashtë shtetit ose është banues i përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, me shtetas shqiptar lidhet sipas dokumenteve të shtetit, shtetas i të cilit është ose ku ka banimin e përhershëm, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga data që kërkohet të

¹⁷⁷ Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", neni 45.

¹⁷⁸ Ibid, neni 47.

lidhet martesë, përveç rasteve kur ka mënyra dhe një afat tjetër, të përcaktuar në marrëveshje shumëpalëshe ose dypalëshe.

Për të huajt, të cilët kanë përfitur azil në Republikën e Shqipërisë ose janë refugjatë, akti i martesës bazohet në dokumentet personale, të vërtetuara brenda 15 ditëve nga organi përkatës shqiptar ose drejtpërdrejt nga të dhënat e këtij organi. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, mund të lidhin martesë ndërmjet tyre në një zyrë të gjendjes civile, me dëshirën e vet. Gjithashtu, martesë mund të lidhet kur njëri ose të dy janë të burgosur në Republikën e Shqipërisë, kur në vendin e tyre nuk mund të lidhin martesë ose nuk mund të shkohet për shkaqe objektive.

Në aktin e martesës pasqyrohen treguesit e mëposhtëm¹⁷⁹: a) zyra e gjendjes civile, ku kryhet akti i martesës; b) numri dhe data e mbajtjes së aktit të martesës; c) numri dhe data e shpalljes së martesës; ç) numri dhe data e vendimit të gjykatës; d) vendi i lidhjes së martesës dhe ora; dh) identiteti, numri i identitetit të secilit prej bashkëshortëve të ardhshëm; e) vendbanimi /vendqëndrimi para martesës; ë) vendbanimi pas martesës; f) mbiemri që do të mbajë pas lidhjes së martesës secili nga bashkëshortët; g) njohja e atësisë ose amësisë së fëmijëve të bashkëshortëve, të lindur para martesës; gj) regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve; h) numri i identitetit, emri, mbiemri dhe vendbanimi i dëshmitarëve; i) numri i identitetit, emri, mbiemri i përkthyesit; j) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile.

Fakti juridik i martesës lind dhe vërtetohet me dokumentin që hartohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi e që pasqyron vullnetin e personave, në prani të nëpunësit të gjendjes civile dhe të dy dëshmitarëve.

Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet për mbajtjen e aktit të martesës në Regjistrin Kombëtar dhe përditëson të dhënat, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes. Transkriptimi i të dhënave referuese të aktit të martesës, që shtetasit shqiptarë kanë lidhur në zyrat e gjendjes civile në vende të huaja, në Regjistrin Kombëtar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shtetasi, që pretendon se i është cenuar një e drejtë nga pasaktësitë në aktin e martesës, mund t'i drejtohet gjykatës kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

5. Regjistrimi i aktit të vdekjes

5.1 Akti i vdekjes

Akti i vdekjes është dokumenti që vërteton ligjërisht vdekjen e shtetasit dhe mbahet për çdo të vdekur. Ky akt nënshkruhet nga nëpunësi i gjendjes civile dhe deklaruesi, pasi të jetë administruar dokumenti “skedë vdekjeje”, i lëshuar nga institucionet e autorizuar shëndetësore, që kanë të drejtë të vërtetojnë këtë fakt. Akti i vdekjes përmban: a) zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative ku mbahet akti i vdekjes; b) numrin dhe datën e mbajtjes së aktit të vdekjes; c) vendin dhe orën e vdekjes; ç) shkakun e vdekjes, të përcaktuar sipas dokumentit shëndetësor; d) identitetin

¹⁷⁹ Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, neni 48.

dhe numrin personal të të vdekurit ose konfirmimin e të ngarkuarit të posaçëm, për kufomat e gjetura, që nuk mund të identifikohen; dh) numrin personal, emrin dhe mbiemrin e mjekut ose të ekspertit mjeko-ligjor, që ka plotësuar skedën e vdekjes; e) të dhënat referuese të njoftimit përkatës të institucionit të prokurorisë, që autorizon kryerjen e veprimeve për raste të përcaktuara në këtë ligj; ë) emrin, mbiemrin e nëpunësit të zyrës së gjendjes civile”.

5.2 Deklarimi i vdekjes

Deklarimi i vdekjes bëhet nga: a) çdo pjesëtar madhor i familjes; b) nga persona të afërt të familjes; c) për personat e vetmuar, nga i ngarkuari i posaçëm i njësisë administrative, në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi që ka ndërruar jetë ka pasur vendbanimin/vendqëndrimin e tij të fundit, ose në zyrën e gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës është gjetur kufoma apo ka ndodhur fakti juridik i vdekjes¹⁸⁰. Deklarimet janë të vlefshme, kur shoqërohen me raport mjekësor. Afati për deklarimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë, nga data e vdekjes ose gjetja e kufomës, për vdekjet brenda vendit, dhe 90 ditë, nga data e vdekjes, për vdekjet jashtë vendit”. Për vdekjen aksidentale, afati i deklarimit në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë nga lëshimi i lejes nga prokurori, e cila paraqitet në zyrën e gjendjes civile nga subjektet e përcaktuara më lart.

Drejtnesit e spitaleve, të reparteve ushtarake, të burgjeve, të reparteve të riedukimit dhe të institucioneve të tjera detyrohen të njoftojnë me shkresë zyrën e gjendjes civile më të afërt, brenda 5 ditëve, për vdekjet e ndodhura në institucionet e tyre. Kur vdekja ndodh ditët e pushimeve dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit të varrimit kërkon dokumentet, që vërtetojnë vdekjen dhe me këto dokumente bën deklarimin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile, në ditën e parë të punës.

Me deklarimin e vdekjes, zyra e gjendjes civile jep edhe lejen e varrimit. Në fshatra që nuk kanë zyrë të gjendjes civile, lejen për varrimin e jep kryetari i fshatit. Në këtë rast, ai, pasi ka administruar dokumentet, që vërtetojnë vdekjen, është i detyruar që, brenda pesë ditëve, të njoftojë zyrën e gjendjes civile, ku janë të dhënat e shtetasit, për regjistrimin e aktit të vdekjes.

Zyra e gjendjes civile, kur merr njoftimin për vdekje, sipas pikës 4 të këtij neni dhe për ato raste kur nuk paraqiten të afërm të viktimës për të bërë deklarimin, kërkon të bëhet verifikimi nga përfaqësuesit e pushtetit vendor. Në rast se konfirmohet vdekja, atëherë mban aktin e vdekjes, për të cilin duhet të firmosin, sipas rastit, përfaqësues të pushtetit vendor, kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes, ose përfaqësuesi i shërbimit të varrimit, si palë e interesuar.

Shërbimi i gjendjes civile, kur ka të dhëna se persona të vdekur vazhdojnë të qëndrojnë të regjistruar në regjistrin themeltar dhe në Regjistrin Kombëtar, mund të ngrejë padi në gjykatë për të vërtetuar vdekjen, pasi të ketë shfrytëzuar të gjithë procedurën administrative. DPGJC-ja është detyruar që për çdo muaj të gjenerojë nga

¹⁸⁰ Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, neni 52.

Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile listën e shtetasve që kanë mbushur moshën 100 vjeç dhe për çdo datë 5 të muajit pasardhës shpërndan listën, sipas zyrës së gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile, në bashkëpunim me përfaqësuesit e pushtetit vendor, bën verifikimin rast pas rasti, sipas procedurës së miratuar nga ministri që mbulon gjendjen civile.

5.3 Vërtetimi i faktit juridik të vdekjes

Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, ku saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij. Shtetasi shpallet i vdekur edhe për rastet kur personi dhe organi i interesuar bëjnë vërtetimin faktik, në rrugë gjyqësore, sipas Kodit Civil. Kur kufoma nuk mund të identifikohet, vihen re shenja ose dyshohet të jetë vdekje e dhunshme, raporti lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor.

Në këto raste, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndjekjes penale, veprimet në gjendjen civile kryhen vetëm me lejen e prokurorit. Në raportin mjekësor shkaqet e vdekjes klasifikohen në shkaqe shëndetësore, aksidentale ose kriminale. Vendimi i gjykatës, që shpall shtetasin të vdekur, regjistrohet në Regjistrin Kombëtar/ regjistrin themeltar (arkivi), pa u mbajtur akti i vdekjes. Vdekjet jashtë shtetit vërtetohen sipas ligjit të vendit, ku ka ndodhur vdekja, me përjashtim të rasteve kur vdekja ndodh në territorin e përfaqësive diplomatike, në avion apo në anije shqiptare, në udhëtim, në zonat ndërkombëtare, për të cilat zbatohet ky ligj.

5.4 Vërtetimi i vdekjes

Vdekja vërtetohet nga mjeku i zonës përkatëse ku ka ndodhur vdekja (mjekë, qendër shëndetësore, spital, urgjencë etj.). Për vdekjet e shkaktuara nga përdorimi i dhunës ose për vdekjet e dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i vlefshëm vetëm kur lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor dhe është nënshkruar edhe nga prokurori¹⁸¹.

5.5 Pavlefshmëria e aktit të vdekjes

Akti i vdekjes është absolutisht i pavlefshëm kur personi, në fakt, nuk ka vdekur, gjë që vërtetohet me paraqitjen e tij fizike ose ekzistencën pas datës së aktit të vdekjes, në çdo rast me mungesë kufome apo kufomë të një personi tjetër. Akti i vdekjes është i pavlefshëm kur ka vdekur një person tjetër nga ai që përmban akti dhe, në këtë rast, është i detyrueshëm të mbahet akt i veçantë për të vdekurin në fakt. Akti i vdekjes shpallet relativisht i pavlefshëm kur nuk i përgjigjet realitetit, për sa i përket kohës, shkaku e vendit të vdekjes. Pavlefshmëria konstatohet nga gjykata, pas kërkesës së paraqitur, në çdo kohë, nga personi, për të cilin është mbajtur akti i vdekjes.

Përveç personit që rezulton i gjallë, pavlefshmëria kërkohet edhe nga personat, të cilët kanë pasojat juridike nga mungesa e aktit të vdekurit në fakt. Kur këta janë të mitur, u është hequr zotësia për të vepruar ose nuk janë në gjendje mendore apo fizike dhe nuk paraqitet kërkesë nga përfaqësuesi ligjor apo kujdestari, ose kur nuk ka të tillë, si dhe kur pasojat rëndojnë mbi shtetin, kërkesa paraqitet nga prokurori. Prokurori paraqet kërkesë edhe kur personi, që rezulton i gjallë, ndonëse i ka mundësitë, nuk bën kërkesë ose shmanget qëllimisht. Kur nuk mund të përcaktohet identiteti i personit të vdekur

¹⁸¹ Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", neni 54.

realisht, çështja shqyrtohet më vete, duke bërë identifikimin ose jo, por, në çdo rast, duke mbajtur një akt tjetër vdekjeje.

Pavlefshmëria kërkohet nga të interesuarit, që kanë zotësi juridike ose nga prokurori, kur pasojat rëndojnë mbi të miturit, personat madhorë, që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur: a) kjo nuk ushtrohet nga përfaqësuesit ligjorë ose kujdestari; b) nuk ka të tillë; c) pasojat lidhen me shtetin.

Me shpalljen e pavlefshmërisë së aktit të vdekjes me vendim gjyqësor, shënimet në fletën familjare të regjistrit themeltar ose në Regjistrin Kombëtar anulohen ose ndryshohen dhe ky veprim pasqyrohet në rubrikën e vërejtjeve dhe në vetë aktin e vdekjes.

6. Emri, mbiemri dhe ndryshimi i tyre

Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, në juridiksionin e së cilës ka ndodhur lindja, pasi administron deklaratën e shkruar të personave të përcaktuar në nenin 40 të ligjit për gjendjen civile, lidhur me: a) emrin që do t'i vendosin fëmijës së lindur, përveç emrave të klasifikuar të papërshtatshëm; b) mbiemrin që do të mbajë fëmija, në përputhje me Kodin e Familjes, i pasqyron këta përbërës të gjendjes civile në aktin e lindjes. Refuzimi i regjistrimit të emrit të caktuar mund të kundërshtohet në organet gjyqësore. Kur prindërit nuk bien dakord, nëpunësi i gjendjes civile cakton një emër, me shënimin në kllapa “i përkohshëm”, deri në zgjidhjen e konfliktit nga gjykata. Kur shkaku ka lindur pas regjistrimit të emrit, nuk ka papërshtatshmëri, sipas këtij ligji. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, kur konstaton një emër të papërshtatshëm, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me padi, duke thirrur si palë të paditur personin që ai pretendon se mban një emër të papërshtatshëm, me objekt ndryshimin e emrit.

Një kthesë të rëndësishme ka shënuar edhe caktimi i mbiemrit të fëmijës i cili reflektohet edhe në dy ligjet e mëposhtme: sipas ligjit nr. 8950 i datës 10.10.2002 mbiemri është ai i prindërve. Kur secili nga prindërit ka mbiemër të veçantë, vendoset mbiemri i babait dhe, kur e kërkon nëna, të dy mbiemrat. Fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve.

Por në dallim nga ky parashikim, ligji nr. 9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë”, përcaktoi se: “*Kur prindërit kanë mbiemra të ndryshëm, të gjithë fëmijët mbajnë një mbiemër, atë që do të vendosin prindërit me marrëveshje. Kur marrëveshja nuk arrihet, fëmijët mbajnë mbiemrin e të atit.*” Pra kjo hapësirë që u krijua për prindërit që mbanin mbiemra të ndryshëm për t'i transmetuar fëmijës mbiemrat e secilit, pati jetë vetëm një vit, pasi më 24 dhjetor të vitit 2003 hyri në fuqi Kodi i Familjes, që nuk pranoi pasjen e dy mbiemrave nga fëmija. Përcaktimin e Kodit të Familjes e përkrahu edhe ligji për gjendjen civile i vitit 2009, ndaj tashmë është i kapërcyer debati se, fëmijët e lindur nga prindër që mbajnë mbiemra të ndryshëm, mund të mbajnë vetëm njërin prej mbiemrave të prindërve.

Kur prindërit kanë vdekur apo nuk janë në gjendje fizike a mendore ose nuk gjenden, emri caktohet nga pjesëtarët e familjes, të afërmit e tjerë dhe, në mungesë të tyre, nga nëpunësi i gjendjes civile.

6.1. Rastet e ndryshimit të mbiemrit dhe të emrit

Me përjashtim të rastit të korigjimit të emrit/mbiemrit, çdo shtetas mund të kërkojë ndryshimin e emrit ose të mbiemrit pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin. Kërkesa duhet të përmbajë arsyen/shkakun e ndryshimit të emrit/mbiemrit dhe emrin/mbiemrin e ri që kërkohet të merret. Kërkesa paraqitet personalisht nga kërkuesi në zyrën e gjendjes civile përkatëse.

Kërkesa për ndryshimin e emrit të përkohshëm, të vendosur nga prindërit, mund të bëhet nga vetë personi brenda një viti nga data e mbushjes së moshës madhore. Në këtë rast kërkesa përmban datën dhe nënshkrimin e kërkuesit, i cili duhet të përcaktojë qartë emrin e përhershëm që kërkon të marrë. Kërkesa për ndryshimin e emrit ose mbiemrit duhet të bëhet vetëm një herë dhe vetëm për shkaqe papërshtatshmërie. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim në rastin e aplikimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të përkohshëm, sipas pikës 2 të këtij neni.

Fillimisht, mbi kërkesën shpreh opinionin e tij nëpunësi i gjendjes civile ku është paraqitur ajo dhe, mva pas dosja përkatëse i dërgohet për kompetencë prefektit të qarkut. Ky i fundit, pasi kryen verifikimet mbi dosjen dhe çmon se janë përmbushur kërkesat dhe procedurat e ligjit për gjendjen civile, përsa i përket ndryshimit të emrit/mbiemrit, për shkak të papërshtatshmërisë, urdhëron afishimin e shpalljes së kërkesës në zyrën e gjendjes civile ku është paraqitur kërkesa dhe ku kërkuesi ka vendbanimin, si dhe në dy prej gazetave dhe/ose në Fletoren Zyrtare, për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Kërkesa për ndryshimin të emrit/mbiemrit duhet të publikohet me qëllim marrjen dijeni të personave që mund të preken nga ndryshimi i kërkuar.

Në asnjë rast nuk mund të kërkohet marrja e mbiemrave që u përkasin personave me rëndësi historike, apo të tillë që mund të çojnë në lajthim, lidhur me përkatësinë e familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë, ku ka vendbanimin kërkuesi. Ministri përgjegjës për gjendjen civile parashikon me udhëzim rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave që konsiderohen të papërshtatshëm, si dhe listën me emra dhe mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkitë përkatëse, së bashku me një listë, pasi merr paraprakisht mendimin e institucioneve të specializuara. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga zyrat e gjendjes civile, si dhe çdo organ tjetër shtetëror.

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme¹⁸²: a) vërtetimin e gjendjes gjyqësore/formularin e plotësuar të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore; b) vërtetimin nga prokuroria se nuk është në ndjekje penale; c) vërtetimin nga gjykata se nuk është në proces gjyqësor; ç) kopjen e letërnjoftimit; d) certifikatën e lindjes dhe certifikatën e përbërjes familjare; dh) vërtetimin se nuk është marrë ndaj tij ndonjë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër; e) vendimin gjyqësor, i njohur sipas legjislacionit shqiptar, në rast të ndryshimit të emrit apo mbiemrit në një vend tjetër, jashtë rasteve të parashikuara nga Kodi i Familjes.

¹⁸² Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", neni 57/2.

Emri dhe mbiemri nuk ndryshohen në rastet kur: a) shtetasi është në proces gjyqësor ose nuk ka mbaruar ndjekja penale¹⁸³; b) vërtetohet se ndaj shtetasit është marrë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër.

Çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit apo mbiemrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes. Kundërshtimi bëhet me kërkesë me shkrim dhe duhet të depozitohet pranë prefektit ose në zyrën e gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin. Në këtë rast, kërkesa i përcillet pa vonesë prefektit të qarkut ku bën pjesë zyra e gjendjes civile.

a) Vendimi për kërkesën

Me kalimin e afatit të parashikuar për kundërshtimin e të tretëve, pas verifikimit të ligjshmërisë së procedurës së parashikuar, si dhe vlerësimit të kundërshtimeve që mund të jenë paraqitur, prefekti nxjerr mendim të arsyetuar për themelin e kërkesës për ndryshimin, sipas rastit, të emrit apo mbiemrit, duke i propozuar Komisionit Kombëtar për Vlerësimin Përfundimtar të Kërkesës për Ndryshimin e Emrave apo të Mbiemrave pranimin apo refuzimin e ndryshimit¹⁸⁴. Mendimi i prefektit për kërkesën për ndryshimin e emrit apo mbiemrit, së bashku me fashikullin e kërkesës, i përcillet për shqyrtim dhe miratim Komisionit Kombëtar pranë ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, i cili vendos për kërkesën, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ky ligj dhe në bazë të procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Nëse prefekti vlerëson se ndryshimi i kërkuar ka të bëjë me mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara apo të mirënjohura në juridiksionin e tij, që nuk janë në listën e miratuar me udhëzim, përpara përcjelljes së kërkesës pranë Komisionit Kombëtar, ai ka të drejtë t'i kërkojë mendim këshillit bashkiak apo institucioneve të tjera publike të specializuara të fushës për marrjen e emrave apo mbiemrave që kërkohen të merren nga kërkuesi. Mendimi i këshillit bashkiak, apo i institucionit të specializuar, përfshihet në fashikullin që shoqëron kërkesën. Nëse këshilli bashkiak apo institucioni i specializuar nuk shprehen brenda afatit 90 ditor, ky fakt konsiderohet si moskundërshtim i heshtur i kërkesës dhe evidentohet në procesverbal nga ana e prefektit.

Me qëllim vlerësimit përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave/mbiemrave, pranë ministrisë që mbulon punët e brendshme, krijohet Komisioni Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave. Përbërja dhe rregullat për funksionimin e Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, si dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të komisionit miratohen me urdhër të ministrit që mbulon punët e brendshme. Pas përcjelljes së kërkesës dhe fashikullit shoqërues në Komisionin Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, ky i fundit, në përfundim të procedurës administrative për marrjen e të dhënave të nevojshme, shprehet me vendim përfundimtar për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit. Vendimi i komisionit, i arsyetuar, i njoftohet

¹⁸³ Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", neni 57/3.

¹⁸⁴ Ibid, neni 57/6.

kërkuesit dhe personave të interesuar, prefektit, si dhe zyrës së gjendjes civile përkatëse për veprim, sipas rastit, si dhe për mbajtjen e shënimeve përkatëse në regjistër.

b) Kërkesa për korrigjimin e emrit dhe mbiemrit për shkak gabimi material

Çdo person, që ka interes për të korrigjuar emrin/mbiemrin e vet, për shkak të një gabimi të provuar material, të bërë gjatë transkriptimit të akteve të gjendjes civile, mund të paraqesë kërkesë pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme¹⁸⁵: a) kopje të aktit të lindjes; b) çdo dokument tjetër që provon gabimin. Në rastin e gabimeve materiale të provuara në një akt të gjendjes civile, personi i interesuar apo pjesëtarët e familjarët që preken nga ai akt, mund të kërkojnë ndreqjen e gabimit të ndodhur, kur provojnë gabimin material gjatë kryerjes së veprimeve në Regjistrin Kombëtar¹⁸⁶.

Nëpunësi i gjendjes civile, pas pranimit të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese, ia përcjell atë për vendim Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, së bashku me një mendim mbi themelin e saj. Vendimi i drejtorit i komunikohet prefektit të qarkut përkatës dhe ky i fundit ka të drejtë t'ia njoftojë atë Komisionit Kombëtar. Rregullat për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për korrigjim miratohen me urdhër të ministrit.

Pas miratimit të kërkesës së shtetasit, ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar¹⁸⁷. Në procesverbalin, që mbahet në këtë rast, pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkakut i ndryshimit, si dhe emri e mbiemri i ndryshuar. Procesverbali nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga nëpunësi i gjendjes civile dhe përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile. Emri e mbiemri i ndryshuar, si dhe numri e data e procesverbalit, pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.

6.2 Praktika gjyqësore në lidhje me ndryshimin dhe korrigjimin e emrit dhe mbiemrit

Praktika gjyqësore ka njohur raste të padive për ndryshimin dhe korrigjimin e emrit dhe mbiemrit, si shkak i mosmarrëveshjeve të krijuara me zyrat e gjendjes civile, që kishin refuzuar ndryshimin e tyre.

Kështu, në çështjen me palë ndërgjyqëse, paditëse, S.K., kundër të paditurve, Zyra e Gjendjes Civile e Prefekturës së Qarkut Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme, me objekt: “Ndryshimin e të dhënës në aktin e saj të lindjes, duke bërë përmirësimin e shkronjave të veçanta të tij për emrin tim nga Siljana në Silvana”, **Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 350, datë 25.02.2016**, ka vlerësuar se vendimi nr. 525, datë 28.01.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është pranuar padia, duhet të prishet duke u vendosur pushimi i gjyqimit të padisë, si padi që nuk mund të ngrihet.

¹⁸⁵ Ligji Nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, neni 57/8.

¹⁸⁶ Ibid, neni 57/9.

¹⁸⁷ Ibid, neni 57/10.

Në arritjen e këtij përfundimi, Gjykata Administrative e Apelit, *inter alia*, arsyetoi si më poshtë:

“Nga aktet e dosjes së gjykimit rezulton se në datën 19.06.2012, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar padia objekt gjykimi. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 525, datë 28.01.2013 ka vendosur: “Pranimin e padisë së paditëses Silvana K. Ndryshimin e të dhënës në aktin e lindjes së paditëses Silvana K. nr. 11, datë 28.01.1976, duke korrigjuar shkronja të veçanta të emrit të saj nga Siljana në Silvana K. (K)...”.

Në analizë të rrethanave të faktit dhe të ligjit, kjo Gjykatë ka vlerësuar se paditësja Silvana Kazazi ka investuar gjykatën me kërkesëpadinë objekt gjykimi, duke kërkuar korrigjimin e gabimit të konstatuar në aktin e gjendjes civile, certifikatën e saj të lindjes, në një kohë që kërkimi në fjalë duhet t’i drejtohej organeve administrative, duke mos i dhënë kështu mundësi gjykatës për të vlerësuar bazueshmërinë në ligj e prova të pretendimeve të parashtruara në kërkesë padi.

Gjykata Administrative e Apelit në këtë vendim ka arsyetuar se mosmarrëveshja objekt gjykimi rregullohet nga ligji nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i cili është ligji që përcakton rregullat për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e përbërësve të gjendjes civile, si dhe organizimin e funksionimit të shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 130/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”, ndryshime këto që i shtrijnë efektet edhe për çështjen konkrete. Për këtë arsye këto ndryshime duhet të ishin marrë parasysh nga ana gjykatës dhe në bazë të këtyre parashikimeve të reja ligjore, gjykata kishte detyrimin të argumentonte e të shprehej mbi bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruara në kërkesëpadinë objekt gjykimi.

Konkretisht me ligjin nr. 130/2013, në ligjin për gjendjen civile është shtuar neni 57/9, në të cilin është parashikuar se:

“1. Në rastin e gabimeve materiale të provuara në një akt të gjendjes civile, personi i interesuar apo pjesëtarët e familjarët që preken nga ai akt, mund të kërkojnë ndreqjen e gabimit të ndodhur, kur provojnë gabimin material gjatë kryerjes së veprimeve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëpunësi i gjendjes civile, pas pranimit të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese, ia përcjell atë për vendim Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, së bashku me një mendim mbi themelin e saj. Vendimi i drejtorit i komunikohet prefektit të qarkut përkatës dhe ky i fundit ka të drejtë t’ia njoftojë atë Komisionit Kombëtar.

2. Rregullat për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për korrigjim miratohen me urdhër të ministrit”.

Në interpretim të kësaj dispozite, konstatohet se korrigjimi i gabimeve materiale që evidentohen në aktet e gjendjes civile është në juridiksionin administrativ dhe jo atë gjyqësor. Në këto raste, personi i interesuar, kur konstaton pasaktësi të të dhënave që pasqyrohen në aktet e gjendjes civile, ka të drejtën t’i drejtohet organeve kompetente të administratës publike, si organet e ngarkuara me ligj me kompetencat për shqyrtimin dhe për vendimmarrjen lidhur me rastet e gabimeve materiale. Bazuar në konsideratat e mësipërme, kjo Gjykatë ka arritur në konkluzionin se në rastin konkret jemi përpara një padie që nuk mund të ngrihej, për shkak se për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, konkretisht për kërkimin lidhur me korrigjimin e gabimit material që konsiston në emrin

e paditëses, të evidentuar në aktin e lindjes të datës 26.01.2012 dhe atë të datës 24.01.2013, i cili është nxjerrë në bazë të aktit të lindjes nr. 11, datë 28.01.1976, paditësja Silvana K. duhet t'i drejtohej organeve të gjendjes civile...”

Në analizë të vendimit të mësipërm, arrijmë në përfundimin se, sipas nenit 57/9 të ligjit për gjendjen civile, organet e gjendjes civile janë pajisur me tagrin për të vendosur, së pari, lidhur me ekzistencën ose jo të gabimeve materiale në të dhënat që formësojnë përmbajtjen e akteve të gjendjes civile dhe, së dyti, për korrigjimin ose jo të tyre sipas rastit. Në këto rrethana, padia objekt gjykimi nuk mund të ngrihet në kushtet kur ligji i posaçëm parashikon në mënyrë të shprehur faktin që kompetencat për të vendosur për çështje të kësaj natyre i janë njohur organeve të gjendjes civile, e për këtë arsye gjykata nuk mund të investohet me padi që kanë një objekt të tillë, e nuk mund të disponojë lidhur me bazueshmërinë ose jo të saj.

Në një vendim tjetër (**nr. 1997 (1924), datë 04.05.2017**), **Gjykata Administrative e Apelit**, gjatë shqyrtimit të padisë së paditësit A.Sh. me palë të paditur, Zyrën e Gjendjes Civile Vlorë, me objekt “Korrigjim i aktit të lindjes së fëmijës së tij”, nga ku emri dhe mbiemri i të cilit është shkruar “Sabian Xoga” në certifikatën personale, por që ka marrë emrin e ri të pagëzimit “Sava Sharka”, në bazë vendimit të Gjykatës së Paqit Karditsa, i njohur nga Gjykata e Apelit, Vlorë, me vendimin nr. 78, datë 03.07.2014.

Mosmarrëveshja objekt gjykimi ka lindur për shkak se nga ana e paditësit A.Sh. kërkohet korrigjimi i emrit dhe mbiemrit të djalit të tij në certifikatën personale. Konkretisht, referuar aktit të lindjes së gjendjes civile nr. 1206, datë 29.12.2008, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Trikala, Greqi, rezulton se, djali i paditësit, Savvas Xoga Sharka, ka lindur në datën 21.12.2008, në Trikala, Greqi dhe referuar pagëzimit konstatohet se: *“U pagëzua në Matargka Kardhicë, më 31-05-2011 nga Prifti S.K. në Kishën e Shenjtë të “Ag. Nikolaou” sipas dogmës ortodokse lindore dhe mori emrin “Savvas” nga nuni z. S.N.”.*

Paditësi A.Sh. dhe nëna e fëmijës E.X. i janë drejtuar Gjykatës së Paqit, Karditsa, Greqi, për korrigjimin e aktit të lindjes së fëmijës përse i përket mbiemrit nga Xoga në Sharka, gjykatë kjo e cila me vendimin nr. 11/2014, datë 24.01.2014 ka vendosur korrigjimin e aktit të lindjes të gjendjes civile nr. 1206, datë 29.12.2008, të Trikalas dhe të aktit të pagëzimit nr. 1206, datë 07.07.2011, lidhur me mbiemrin e fëmijës nga i gabuar Xoga në të saktin Sharka. Ky vendim është njohur nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 78, datë 03.07.2014, duke iu dhënë fuqi juridike për ekzekutim në Republikën e Shqipërisë.

Rezulton se djali i paditësit është regjistruar me emrin Savas Xoga Sarka, referuar certifikatës së lindjes së datës 22.07.2014 të Zyrës së Gjendjes Civile të Rrethit Trikala, Greqi. Ndërsa nga certifikata personale nr. 006850114, datë 15.01.2015, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Vlorë, konstatohet se djali i paditësit figuron me emrin Sabian Xoga. Për këtë arsye, me kërkesën e datës 10.11.2014, pala paditëse i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile Vlorë duke kërkuar korrigjimin e emrit të djalit të tij në regjistrin e gjendjes civile Bashkia Vlorë, kërkesë që iu refuzua.

Më tej, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me kërkesëpadinë objekt gjykimi, duke kërkuar ndryshimin e emrit dhe mbiemrit të djalit të tij. Për sa i përket mbiemrit, pala paditëse hoqi dorë nga ky kërkim, pasi ky korrigjim është kryer nga vendimi i Gjykatës së Paqit Karditsa, Greqi, i njohur nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Në analizë të akteve e provave të administruara në gjykim, të rrethanave të faktit dhe të ligjit, si dhe të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se, kërkesëpadia është e bazuar në ligj dhe në prova lidhur me kërkimin e paditësit për ndryshimin e emrit të djalit të tij.

Gjykata ka arsyetuar se, sipas nenit 38 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, lindja vërtetohet me certifikatën e asistencës në lindje, me raport mjekësor ose procesverbal të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, ndërsa në rastin konkret zyra e gjendjes civile ka kryer regjistrimin e fëmijës pa patur këto dokumente. Rezulton se deklarimi i lindjes së fëmijës është kryer nga prindërit në gjendjen civile të Trikala dhe më pas është kryer dhe në Zyrën e Gjendjes Civile Vlorë, e cila ka bërë regjistrimin në bazë të aktit të lindjes nr. 1206, datë 29.12.2008, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Trikala.

Gjykata e Karditsa, me Vendimin e datës 16.01.2014 ka vendosur të korrigjojë mbiemrin e djalit nga Xoga në Sharka, vendim i cili është njohur dhe nga Gjykata e Apelit Vlorë. Në vendimin e Gjykatës së Karditsa citohet se nga martesja e prindërve Artur Sharka dhe Elisabeta Xoga ka lindur një fëmijë, Sava Xoga dhe kjo gjykatë ka bërë korrigjimin e mbiemrit të fëmijës nga Xoga në Sharka. Për sa i përket emrit, në këtë vendim është konsideruar e rregullt se djali i mitur quhet Savvas ashtu sikurse është pagëzuar.

Nga provat e paraqitura në gjykim, ka rezultuar se emri i fëmijës është Savas dhe jo Sabian, megjithëse në aktin e lindjes me nr. 1206/29.12.2008 gjykata nuk mund të bëjë korrigjime, pasi është një akt administrativ që është nxjerrë nga një shtet i huaj dhe gjykata, pa u bërë më parë ndryshimi sipas ligjeve të shtetit grek, nuk mund të bëjë ndryshim të aktit të lindjes, por vetëm pas ndryshimit nëpërmjet gjykatës greke dhe njohjes së vendimit në fjalë nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Nga provat e paraqitura rezultojnë se i mituri Sabian Sharka është i njëjti me Savvas Sharka, fakt i njohur dhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, që e ka marrë të mirëqënë emrin e fëmijës Savvas. Për këtë arsye, gjykata ka arritur në përfundimin se duhet të bëhet korrigjimi në regjistrat e Zyrës së Gjendjes Civile Vlorë për shtetasin Sabian Sharka, duke e korrigjuar emrin e tij, konform vendimit të Gjykatës së Karditsa, njohur me vendimin nr. 78, datë 03.07.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë, sipas të cilit emri i djalit të mitur është Savvas. Për sa i përket korrigjimit të mbiemrit në aktin e lindjes, gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit pasi paditësi ka hequr dorë nga ky kërkim.

Gjykata Administrative e Apelit, në përgjigje të ankimit të Zyrës së Gjendjes Civile, Bashkia Vlorë, ka arsyetuar, si më poshtë:

“Në analizë të parashikimeve të ligjit të posaçëm në bazë të të cilit rregullohet mosmarrëveshja objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se paditësi nuk kishte detyrimin për të shteruar më parë ankimin administrativ përpara se të investonte gjykatën me kërkesë padinë objekt gjykimi. Në nenin 43 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen

civile” i ndryshuar, i cili është ligji që përcakton rregullat për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e përbërësve të gjendjes civile, si dhe organizimin e funksionimit e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë, është parashikuar se:

“1. Akti i lindjes është absolutisht i pavlefshëm, kur nuk është mbajtur nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, ose kur nuk është nënshkruar qoftë edhe nga njëri prej personave të parashikuar në pikën 2 të nenit 42 të këtij ligji. Në raste të tjera, akti i lindjes është i relativisht i pavlefshëm.

2. Nuk mund të konfirmohet përmbajtje tjetër nga ajo e aktit të lindjes pa u vërtetuar pavlefshmëria absolute ose relative, pasaktësia ose falsiteti i pretenduar për aktin përkatës.

3. Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër, që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t’i parashatrojnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile.

4. Njohja ose kundërshtimi i atësisë e i amësisë bëhen sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin e Familjes”.

Në interpretim dhe zbatim të kësaj dispozite, rezulton se personi që pretendon pasaktësinë e përmbajtjes së aktit të lindjes ka jo vetëm të drejtën, por ligjëvënësi i ka njohur si të vetmen mundësi për të realizuar të drejtat e tij, investimin e gjykatës me kërkesëpadi me qëllim rivendosjen e të drejtave të shkelura apo të cënuara për shkak të pasaktësisë së të dhënave të evidentuara në aktin e lindjes.

Në rastin konkret, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Vlorë duke kërkuar korrigjimin e aktit të lindjes së fëmijës së tij, pikërisht për shkak të pasaktësisë së pretenduar nga ana e tij në aktin e lindjes, lidhur me emrin e djalit të tij nga Sabian në Savvas. Për sa më sipër, Gjykata konkludon se paditësi jo vetëm që nuk kishte detyrimin të ezauronte më parë rekursin administrativ, por zgjidhja gjyqësore e mosmarrëveshjes së krijuar me palën e paditur, është i vetmi mjet ligjor i njohur, përmes të cilit paditësi mund të rivendosë të drejtat e pretenduara së janë shkelur.

Gjykata Administrative e Apelit çmon me rëndësi të theksojë se në rastin konkret, në të kundërt nga sa është pretenduar nga pala e paditur, nuk jemi në kushtet e një gabimi material të konstatuar në aktin e lindjes...

Në interpretim të kësaj dispozite [nenit 57/9 të ligjit për gjendjen civile], konstatohet se korrigjimi i gabimeve materiale që evidentohen në aktet e gjendjes civile është në juridiksionin administrativ dhe jo atë gjyqësor. Në këto raste, personi i interesuar, kur konstaton gabime materiale në të dhënat që pasqyrohen në aktet e gjendjes civile, ka të drejtën t’i drejtohet organeve kompetente të administratës publike, si organet e ngarkuara me ligj me kompetencat për shqyrtimin dhe për vendimmarrjen lidhur me rastet e gabimeve materiale. Pra, personi i interesuar ka detyrimin për të shteruar më parë ankimin administrativ, vetëm në ato raste kur kërkon korrigjimin e një gabimi material të konstatuar gjatë kryerjes së veprimeve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Sikurse është evidentuar edhe më sipër në këtë vendim, në çështjen objekt gjykimi, nuk jemi në kushtet e një gabimi material të kryer nga pala e paditur, por në kushtet e pasaktësisë së evidentimit të të dhënave në aktin e lindjes së fëmijës së tij.

Lidhur me themelin e çështjes, në analizë të akteve e provave shkrësore të administruara në gjykim, Gjykata vlerëson të bazuara pretendimet e palës paditëse lidhur me korrigjimin e emrit të fëmijës së tij nga Sabian në Savvas.

Së pari, nga akti i lindjes nr. 1206, datë 29.12.2008 i lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Trikala, Greqi, rezulton se emri i fëmijës së paditësit A.Sh., nuk është Sabian, por Savvas. Nga përmbajtja e këtij akti rezulton se fëmija i paditësit është pagëzuar në datën 31.05.2011 dhe ka marrë emrin Savvas, pikërisht për shkak të aktit të pagëzimit.

Së dyti, edhe në certifikatën e lindjes së datës 22.07.2014, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Trikala, emri i djalit të paditësit, figuron të jetë Savvas dhe jo Sabian.

Së treti, fakti që djali i paditësit mban emrin Savvas rezulton edhe nga përmbajtja e vendimit nr. 11, datë 24.01.2014 i Gjykatës së Paqit Karditsa, Greqi, i cili është njohur me vendimin nr. 78, datë 03.07.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Konkretisht në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. 11, datë 24.01.2014 të Gjykatës së Paqes Karditsa konstatohet se: "...Në 27 korrik 2008 në Karditsa, kërkuesit celebruan martesë ligjore fetare sipas rregullave të kishës ortodokse, në kishën e Shën Georgios Karditsa, nga kjo martesë lindi një fëmijë, Savva Xoga, i Arturit dhe i Elisabetës, më 29.12.2008, sot 5 vjeç..."

Ky vendim ka fuqi juridike në Republikën e Shqipërisë dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, në kuptim të nenit 398 të këtij Kodi ku është parashikuar se: "Vendimi i gjykatës së shtetit të huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës të apelit që i jep fuqi këtij vendimi dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Kodi".

Në vijim të sa më sipër, si dhe në zbatim të vendimeve të mësipërme gjyqësore, pala e paditur, Zyra e Gjendjes Civile Vlorë, kishte detyrimin që, sikundër ka vepruar për ndryshimin e mbiemrit të fëmijes nga Xoga në Sharka, të merrte në konsideratë dhe të procedonte me regjistrimin e fëmijes në emrin Savvas dhe jo në emrin Sabian.

Bazuar në sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon të drejtë qëndrimin e mbajtur nga gjykata e shkallës së parë, lidhur me faktin që pala e paditur, Zyra e Gjendjes Civile Vlorë, ka detyrimin të ndryshojë emrin e fëmijës së paditësit A.Sh., nga Sabian në Savvas, bazuar në nenin 41, pika 3 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile" i ndryshuar, ku është përcaktuar se: "Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare, në vendin ku ka lindur. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi".

Për këtë arsye pretendimet e parashtruara në kërkesëpadi nga ana e palës paditëse përbëjnë pretendime të bazuara në ligj dhe në prova ndaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka disponuar me vendim për pranimin e tyre."

Nga përmbajtja e këtij vendimi, arrijmë në përfundimin se, ligji për gjendjen civile njeh vetëm rrugën gjyqësore (duke përjashtuar rrugën administrative të ankimit të refuzimit të organit publik për të kryer korrigjimin e aktit të lindjes) në rast të pretendimeve për pasaktësinë e përmbajtjes së aktit të lindjes, me qëllim rivendosjen e të drejtave të shkelura apo të cenuara për shkak të pasaktësisë së të dhënave të evidentuara në të.

Në këtë vendim, gjykata e apelit ka rrëzuar pretendimin e zyrës së gjendjes civile, se jemi përpara rastit të korrigjimit material të emrit, për sa kohë u provua në gjykim se, pasaktësia e aktit të lindjes, lidhur me emrin e djalit të paditësit, nga Sabian në Savvas.

6.3 Emrat e papërshtatshëm

Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, në përmbushje të detyrimit të tij ligjor, pasi ka marrë edhe mendimin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, ka përcaktuar në një listë joshteruese emrat e papërshtatshëm për shtetasit shqiptarë, të cilët kanë karakter fyës, imoral ose racist, me këtë përmbajtje: *Ankim, Arançata, Avash, Bretk, Berr, Burgim, Ballokume, Car, Cub, Currane, Currele, Careva, Carina, Cbane, Dert, Derman, Dogle, Durak, Ekran, Eros, Ferman, Federatë, Fodulle, Gazep, Gallata, Gabime, Groshë, Gjezap, Hyzmet, Hiçe, Hafije, Helme, Ironi, Jermsine, Keqan, Keqe, Krajlice, Levere, Meze, Mëshirë, Mjaftë, Mjaftime, Mjaftoni, Mbarime, Mbetë, Mbylle, Marrëzi, Ndalim, Pikëllime, Pafate, Pseerdhe, Rikë, Rakita, Spece, Sose, Stenate, Sherre, Shkurte, Shkurtime, Vajtime, Xhenaze, Zeherë.*

Edhe vendet e tjera, kanë përcaktuar emra të cilat janë të ndalur t'u vihen fëmijëve të sapolindur. Në vijim po listojmë një listë me emra, që sipas shteteve janë të ndaluar të vihen: Viking (Portugali), Jimmy (Portugali), Rihanna (Portugali), Sayonara (Portugali), Alice (Arabia Saudite), Maya (Arabia Saudite), Abdul Nasser (Arabia Saudite), Taylor (Gjermani/Danimarkë), Ashley (Gjermani/Danimarkë), Morgan (Gjermani/Danimarkë), Jordan (Gjermani/Danimarkë), Prince William (Francë), Osama bin Laden (Gjermani), Adolf Hitler (Gjermani), Anus (Danimarkë), Elvis (Suedi), Metallica (Suedi), Rambo (Meksikë), Batman (Meksikë), Sexual Intercourse (Malajzi), Smelly Head (Malajzi), Scrotum (Meksikë), Judas (Zvicër), Lucifer (Zvicër/Zelanda e Re), Malak/Angel (Arabia Saudite), Zoe (Islandë), Harriet (Islandë), Duncan (Islandë), Enrique (Islandë), Ludwig (Islandë), Hansen (Norvegji), Johansen (Norvegji), Olden (Norvegji), Facebook (Meksikë), Ikea (Suedi), Mercedes (Zvicër), Nutella (Francë), Mini Cooper (Francë), Chanel (Zvicër)¹⁸⁸.

7. Heqja e kombësisë si element i gjendjes civile

Ligji për gjendjen civile, nr. 10129, datë 11.05.2009, në variantin e tij original, e parashikonte kombësinë, si një ndër përbërësit e gjendjes civile. Më konkretisht:

në nenin 6/1 përcaktohej: *“Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri i identitetit, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, **kombësia**, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj”;*

në nenin 8, ku parashikohet: *“Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë, **kombësia** dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t'u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë”;*

në nenin 42/2, germa “e”, ku parashikohet: *“Akti i lindjes përmban (...) **kombësinë**, në përputhje me kombësinë e prindërve; dhe*

në nenin 58, ku parashikohen mënyrat e përcaktimit dhe ndryshimit të elementit “*kombësi*”, me përmbajtjen, si më poshtë:

¹⁸⁸ www.syri.net.

“1. Fëmija merr kombësinë e prindërve me kombësi të njëjtë, të dokumentuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Kjo kombësi nuk mund të ndryshohet, përveç rasteve, kur, sipas ligjit, vërtetohet pasaktësia e kombësisë së prindërve, ose kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndryshimin e atësisë apo të amësisë. Ndryshimi i kombësisë, në çdo rast, bëhet me vendim gjyqësor.

2. Kur prindërit kanë kombësi të ndryshme, fëmijës i shënohet kombësia e njërit prej prindërve, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre. Në rast mosmarrëveshjeje ose në rast vdekjeje të njërit prej tyre, shërbimi i gjendjes civile, përkohësisht, shënon si kombësi të fëmijës atë të të atit. Kombësia e fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile shënohet në bazë të vullnetit të të dy prindërve ose kombësia e njërit prej tyre, sipas vullnetit të fëmijës madhor.

3. Fëmija e lindur jashtë martese, kur nuk dihet atësia, merr kombësinë e nënës. Kjo kombësi mund të ndryshojë me vërtetimin e atësisë, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.

4. Fëmija me prindër të panjohur, i lindur në Shqipëri, prezumohet me kombësi shqiptare. Kur njëri ose të dy prindërit gjenden ose kur fëmija arrin moshën madhore, për kombësinë e tij zbatohen përcaktimet e pikës 2 të këtij neni.

5. I birësuari merr kombësinë e birësuesve, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni, por kur ai arrin në moshë madhore, ka të drejtë të rimarrë kombësinë që kishte para birësimit, ose ta ndryshojë atë, sipas kombësisë që kanë prindërit biologjikë.

6. I linduri me fekondim artificial nga një grua e martuar merr kombësinë e njërit prej bashkëshortëve, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

7. Ndryshimi i kombësisë bëhet në rastet e përcaktuara në këtë ligj vetëm me vendim gjyqësor, duke u thirrur, në çdo rast, si palë në proces shërbimi i gjendjes civile, edhe kur kombësia ka qenë caktuar përkohësisht ose kur është bërë një gabim material;

8. Ndryshimi i kombësisë shqiptare të shtetasve shqiptarë nga organe të huaja është absolutisht i pavlefshëm.”

Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, termi “komb” përkufizohet si “një bashkësi e qëndrueshme njerëzish e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës”.

Ndërsa termi “kombësi” përkufizohet si “bashkësi e qëndrueshme njerëzish që i paraprin kombit e që është formuar historikisht gjatë shthurjes së marrëdhënieve fisnore në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit e të kulturës, e cila ka ardhur duke u zhvilluar e duke u forcuar”.

“Përkatësia etnike” ose e thënë ndryshe “etnia”, sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe përkufizohet si “bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në një truall të caktuar e cila ka një gjuhë dhe kulturë materiale e shpirtërore të njëjtë”.

Kushtetuta shqiptare nuk ka një përkufizim të qartë për termin “kombësi” apo termin “pakicë kombëtare”, edhe pse këto terma janë të përfshirë në dispozita kushtetuese. Mungojnë, gjithashtu, edhe aktet e tjera ligjore apo nënligjore që përmbajnë rregullime në lidhje me termat “kombësi”, “pakicë etnike” apo “pakicë kombëtare”. Për herë të parë termi “kombësi” përmendet në ligjin nr. 8950, 10.10.2002 “Për gjendjen

civile”, i shfuqizuar, por pa u përkufizuar si term. Në këtë këndvështrim, vërehet se, edhe ligji për gjendjen civile nuk përcakton saktësisht dhe qartësisht se çfarë kuptohet me termin “kombësi”.

Gjykata Kushtetuese Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 52, datë 01.12.2011, ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën të termit “kombësi”, në nenet 6/1, 8, 42/2, germa “e” dhe të nenit 58, tërësisht, të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”.

Gjykata Kushtetuese, për arritjen në këtë përfundim, arsyetoi, si vijon:

A. Për konceptin “kombësi”

a) Gjykatat referuese pretendojnë se ligji për gjendjen civile, duke përcaktuar elementin “kombësi”, si element përbërës të gjendjes civile, dhe duke rregulluar mënyrën e regjistrimit të këtij elementi në regjistrat e gjendjes civile, detyron çdo shtetas shqiptar të deklarojë kombësinë e tij, në kundërshtim me parimin e mosdetyrimit të shprehjes së përkatësisë etnike, sipas nenit 20 të Kushtetutës.

b) Në funksion të ushtrimit të kontrollit kushtetues, Gjykata e sheh të nevojshme të vlerësojë fillimisht kuptimin e nocioneve “kombësi” dhe “pakicë kombëtare” dhe më pas të fokusohet tek çështja nëse ka apo jo cenim të nenit 20 të Kushtetutës.

c) Mosekzistenca e një përkufizimi të përbashkët për konceptin “komb” është tashmë një fakt i njohur dhe i pranuar në doktrinën e së drejtës¹⁸⁹. Pavarësisht se termi komb është i rrënjosur në kulturën dhe historinë e popujve dhe përfshin elementë themelorë të identitetit të tyre, modelet përkufizuese të këtij nocioni mbeten në një masë të madhe arbitrare. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (në vijim “Asambleja Parlamentare”) është shprehur në Rezolutën 1735 (2006) se “...ajo është e ndërjegjshme për nevojën e sqarimit të terminologjisë së përdorur, në kushtetuta dhe legjislacione në fuqi, mbi fenomenin e lidhjeve etnike, gjuhësore dhe kulturore ndërmjet grupeve të qytetarëve që jetojnë në shtete të ndryshme, e në veçanti të përdorimit të fjalës “komb” në një kontekst specifik historik ose politik”.

Asambleja Parlamentare pranon se, në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës, koncepti “kombësi” përdoret për të treguar shtetësinë, e cila përfaqëson një lidhje juridike ndërmjet shtetit dhe individit, pavarësisht nga origjina etno-kulturore e tij, ndërsa në disa shtete të tjerë, termi “kombësi” përdoret për të treguar një komunitet organik që flet një gjuhë të caktuar dhe karakterizohet nga një sërë traditash të ngjashme kulturore dhe historike, nga perceptime të ngjashme të së shkuarës, aspirata të ngjashme për të tashmen dhe të ardhmen. Në këndvështrimin e Asamblesë Parlamentare, aty ku koncepti “kombësi” do të thotë shtetësi, nënkuptohet një lloj marrëdhënieje kontraktuale ndërmjet një personi fizik dhe një shteti, ndërsa në vendet ku koncepti “kombësi” do të thotë komunitet etno-kulturor ai nënkupton një realitet kulturor (një fakt ose status kulturor) që

¹⁸⁹ Shih Rezolutën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës Nr. 1335 (2003).

bazohet në bashkimin e lirë dhe të njëanshëm të një personi fizik me atë komunitet dhe përfshin vetëm marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të komunitetit (*përkthim i Gjykatës*)¹⁹⁰.

ç) Duke pasur parasysh mënyrën se si u krijuan shtetet “komb” gjatë shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të, si edhe për shkak të ndryshimeve të kufijve të shteteve ‘komb’ në fund të Luftës së Dytë Botërore dhe në fund të Luftës së Ftohtë, në territoret e pothuaj gjithë shteteve anëtare të Këshillit të Evropës jetojnë grupe të ndryshme njerëzish, të cilët janë shtetas të të njëjtit shtet, por i përkasin pakicave të ndryshme kulturore. Në krahasim me grupin më të madh të qytetarëve me të njëjtën përkatësi etnike-kulturore, këto grupe, të cilat janë relativisht më të vogla, përbëjnë të ashtuquajturat pakica kombëtare.

Edhe për pakicat kombëtare nuk ka një përkufizim të pranuar universalisht. Formulimi që ka konsensusin më të gjerë në doktrinën juridike, e përcakton një pakicë kombëtare si një grup numerikisht më të ulët, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë së një shteti, në një pozitë jodominante, pjesëtarët e të cilit – duke qenë edhe shtetas të atij shteti - kanë karakteristika etnike, fetare ose gjuhësore të ndryshme nga ato të pjesës tjetër të popullsisë dhe tregojnë, qoftë dhe në mënyrë të nënkuptuar, një ndjenjë solidariteti të drejtuar drejt ruajtjes së kulturës, traditave, fesë apo gjuhës¹⁹¹(*përkthim i Gjykatës*).

Ky lloj përkufizimi përfshin si kritere objektivë ashtu dhe kritere subjektivë, të cilët janë të ndërvarur me njëri-tjetrin. Sipas studuesve të doktrinës juridike, grupi duhet të plotësojë karakteristikat objektive që e dallojnë atë nga pjesa tjetër e popullsisë, siç janë numri, historia, gjuha, feja, dhe jodominimi. Ndërsa komponenti subjektiv ka të bëjë me vetëperceptimin e grupit si të dallueshëm nga të tjerët, dhe dëshirën e anëtarëve individualë të grupit për të identifikuar veten e tyre së bashku si një grup. ...

B. Për pretendimin e papajtueshmërisë së termit “kombësia”, në nenin 6/1 dhe 8; termit “kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve” në nenin 42/2, germa “e” dhe nenit 58 të ligjit për gjendjen civile, me nenin 20 të Kushtetutës.

a) Një ndër parimet themelore të shtetit të së drejtës, në kuadrin kushtetues, është respekti ndaj të drejtave të pakicave, që jo vetëm nxit kohezionin social, por ndihmon dhe në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme, të integruar e multidimensionale, ku të drejtat e njeriut garantohen për të gjithë. Neni 20 i Kushtetutës, parashikon se “*personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre*”.

I marrë në tërësi, ky nen synon të garantojë të drejtat e pakicave kombëtare, në mënyrë që ato të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e shprehura në Kushtetutë, të zbatueshme për këdo dhe njëkohësisht, të ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre etnik,

¹⁹⁰ Shih Rekomandimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës Nr. 1735, 26 janar 2006.

¹⁹¹ Ky formulim është propozuar nga Francesco Capotorti, Raportuesi Special i Nën-Komisionit mbi Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave të OKB-së, në Studimin për të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Etnike, Fetare dhe Gjuhësore

kulturor, gjuhësor e fetar. Qëllimi i kushtetutëbërësit është që, në shoqërinë shqiptare, të gjithë të jetojnë së bashku në harmoni, duke njohur vlerat në ndryshimet e dallimet kulturore që karakterizojnë pakicat kombëtare. Në paragrafin e parë të tij, neni 20 i Kushtetutës parashikon të drejtën e ushtrimit nga pakicat kombëtare të të drejtave dhe lirive të tyre, në barazi të plotë para ligjit. Parimi i trajtimit të barabartë të personave që i përkasin një pakice me pjesën tjetër të popullsisë së një shteti, e cila përbën shumicën, përbën një garanci kushtetuese dhe një qasje me parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit, të parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës.

Paragrafi i dytë i nenit 20, shprehet për deklarinin lirisht, pa u ndaluar, as detyruar, nga personat që i përkasin pakicave kombëtare, të përkatësisë së tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Kushtetutëbërësi ka zgjedhur, siç duket qartë nga gjuha e këtij formulimi, që të sanksionojë në këtë paragraf, një parim mjaft të rëndësishëm, që është ai i mosdetyrimit të personave që iu përkasin pakicave kombëtare për të deklaruar përkatësinë e tyre etnike. Ky parim i mosdetyrimit është një garanci kushtetuese, për sa i përket të drejtës për të deklaruar ose jo disa përkatësi të veçanta që karakterizojnë pakicat kombëtare dhe lidhet ngushtësisht me mbrojtjen e autonomisë personale të individit. Në një shoqëri demokratike, mbrojtja e jetës private dhe respektimi i garancive në këtë drejtim janë thelbësore.

b) Ligji për gjendjen civile, objekt i këtij kontrolli kushtetues, është i aplikueshëm për të gjitha kategoritë e individëve që jetojnë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë edhe pakicat kombëtare (neni 1). Nisur nga ky fakt, Gjykata çmon se ligji për gjendjen civile bie në sferën e parashikimit të nenit 20 të Kushtetutës.

...

ç) Duke marrë në konsideratë tërësinë e këtyre dispozitave dhe lidhjen që ekziston midis tyre, Gjykata vëren se ky ligj, duke përfshirë elementin “kombësi” si përbërës të gjendjes civile, krahas përbërësve të tjerë, si dhe duke përcaktuar kriteret objektive që rregullojnë regjistrimin e kësaj të dhëne nga punonjësit e gjendjes civile, kërkon deklarinin e kombësisë në mënyrë të detyrueshme, ku nënkuptohet njëkohësisht dhe përkatësia etnike, si aspekt/element i kombësisë. Konkretisht, sipas ligjit për gjendjen civile, kombësia e një individit të sapolindur, në kushtet e pamundësisë objektive të zgjedhjes nga ana e tij për ta shprehur ose jo, është subjekt i deklarinimit të prindërve, bazuar në marrëveshjen mes tyre.

Neni 58 i ligjit për gjendjen civile rregullon rastet e mosmarrëveshjes si dhe rastet e tjera për përcaktimin e kombësisë së individit, në funksion të regjistrimit të këtij komponenti në regjistrat e gjendjes civile. Kështu, në kushtet kur vetëdeklarinimi i fëmijës është objektivisht i pamundur dhe mungon deklarinimi i prindit/prindërve, kategoria “kombësi” nuk mbetet e paplotësuar në regjistra, por nëpunësi i gjendjes civile e plotëson në përputhje me dispozitat ligjore për gjendjen civile. Sipas këtij arsyetimi, ligji për gjendjen civile e bën të detyrueshëm pasqyrimin e të dhënave për përkatësinë etnike të individit në aktet dhe regjistrat e gjendjes civile. Në vlerësimin e Gjykatës, parimi i mosdetyrimit për të bërë publike përkatësinë etnike, që përshkon nenin 20 të Kushtetutës, nënkupton shprehjen lirisht të vullnetit të një individit të caktuar për të deklaruar ose jo përkatësinë e tij etnike. Kjo do të thotë që në mungesë të deklarinimit, për çfarëdo lloj arsye, qoftë objektive apo subjektive, ligji për gjendjen

civile duhet të respektojë lirinë individuale të zgjedhjes për të mos bërë publike përkatësinë etnike.

Nëpërmjet dispozitave lejuese, ligji për gjendjen civile i ka dhënë kompetenca nëpunësit të gjendjes civile për të plotësuar përbërësin “kombësi” në kushtet e mungesës së deklaramit, duke krijuar kështu një konflikt me parimin e rëndësishëm të mosdetyrimit për të shprehur përkatësinë etnike, të përcaktuar në nenin 20 të Kushtetutës.

d) Parimi i zgjedhjes së lirë për të shprehur ose jo përkatësinë etnike dhe lidhjen me një identitet kombëtar, inkurajohet edhe në të Drejtën Ndërkombëtare. Në aspektin e përgjithshëm, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në nenin 14, ndalon, *inter alia*, diskriminimin bazë të “(...) origjinës kombëtare ose shoqërore, përkatësisë në një pakicë kombëtare(...)”. Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve (në vijim ‘Konventa Kuadër’), e ratifikuar nga Shqipëria, në nenin 3 të saj parashikon të drejtën e çdo personi që i përket një pakice kombëtare të zgjedhë ose të trajtohet ose të mos trajtohet si i tillë. Sipas Raportit Shpjegues të Konventës, ky nen, në paragrafin 1, i garanton, së pari, çdo personi që i përket një pakice kombëtare, lirinë për të zgjedhur për t'u trajtuar ose jo si i tillë.

Kjo dispozitë lë çdo person të tillë të vendosë nëse dëshiron të bëhet subjekt i mbrojtjes që ofron Konventa Kuadër. Ky paragraf nuk nënkupton një të drejtë të individit për të zgjedhur në mënyrë arbitrare përkatësinë në ndonjë pakicë kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është e lidhur pazgjidhshmërisht me kritere objektive të rëndësishme për identitetin e personit. Sipas këtij paragrafi, asnjë dëm nuk duhet të rezultojë nga garantimi i kësaj zgjedhjeje të lirë, apo nga ushtrimi i të drejtave të cilat janë të lidhura me këtë zgjedhje (*shih §33-36 të Raportit Shpjegues të Konventës Kuadër; përthimi i Gjykatës*). Në vlerësimin e Gjykatës, shprehja “që i përket një pakice kombëtare” do të thotë që Konventa e sheh anëtarësinë në një pakicë në një këndvështrim substancial dhe jo vetëm si markë apo si etiketë, ose zgjedhje të imponuar ndaj individit.

Nisur nga këndvështrimi i mësipërm, Gjykata vëren se neni 20 i Kushtetutës, në harmoni të plotë me standardet referuese ndërkombëtare, parashikon qartësisht se deklarimi i përkatësisë etnike mund të jetë vetëm i vullnetshëm dhe fryt i një zgjedhjeje të lirë të individit për ta shprehur atë ose jo.

e) Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, pretendon se përfshirja e elementit “kombësi” në regjistrat e gjendjes civile, i shërben identifikimit, mbrojtjes së të drejtave dhe zhvillimit të mëtejshëm të pakicave kombëtare, duke pasur parasysh se shteti, mbi bazën e këtyre të dhënave, përmbush detyrimin që të garantojë arsimimin e pakicave kombëtare në gjuhën e tyre amtare. Gjykata, në funksion të këtyre pretendimeve të Këshillit të Ministrave, e konsideron të rëndësishme të ndalet tek racionalja e përfshirjes së termit “kombësi” në ligjin për gjendjen civile.

Ligji për gjendjen civile rregullon funksionimin e një sistemi, nëpërmjet të cilit qeveria identifikon qytetarët/shtetasit e vet dhe personat e tjerë rezidentë në shtetin në fjalë, si dhe ngjarjet më të rëndësishme në jetën e tyre. Kombet e Bashkuara e përkufizojnë gjendjen civile si “regjistrim i vazhdueshëm, i qëndrueshëm, i detyrueshëm dhe universal i ndodhive dhe karakteristikave të ngjarjeve jetike të popullsisë, përmes një dekreti ose rregulloreje, në përputhje me kërkesat ligjore në një shtet. Regjistrat e

gjendjes civile janë edhe një burim kryesor për statistika jetësore dhe përfshijnë lindjet e gjalla, vdekjen, martesën, divorcin, anulimin e martesës, birësimin, vendbanimin”¹⁹² (përkthimi i Gjykatës).

...

Elementet e gjendjes civile kanë një rëndësi të veçantë për shtetin, jo vetëm sepse identifikojnë individin, si i tillë, por edhe sepse identifikojnë ngjarje thelbësore të jetës së tij, të cilat prodhojnë pasoja juridike në marrëdhëniet e individit me shtetin. Në momentin që këto ngjarje (siç janë martesa, divorci, vdekja) regjistrohen në regjistrat e gjendjes civile, ato prodhojnë efekte juridike, në formën e të drejtave dhe detyrimeve, në aspektin e raportit individ/shtet. Duke e përfshirë elementin “kombësi” në përbërësit e gjendjes civile, legjislatori automatikisht i ka dhënë atij një kuptim jetik, duke e klasifikuar si një komponent të domosdoshëm në aktet e gjendjes civile. Në vlerësimin e Gjykatës, “kombësia” si koncept i papërkufizuar, në ndryshim nga komponentët e tjerë të gjendjes civile, nuk krijon një lidhje juridike që përkthehet në të drejta dhe detyra të ndërsjellta të personit fizik dhe shtetit shqiptar.

Gjykata i konsideron të pabazuara pretendimet e Këshillit të Ministrave dhe çmon se ligji për gjendjen civile nuk mund të jetë i vetmi burim i identifikimit të pakicave kombëtare. Në këtë drejtim, nuk mund të mos merren parasysh parashikime të tjera, regjistrime të mëparshme, apo të dhëna historike, të cilat gjenerojnë informacion që i shërben identifikimit të pakicave kombëtare dhe politikave shtetërore për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtyre pakicave.

ë) Bazuar në vlerësimet e bëra më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se termi “kombësi”, i përcaktuar në nenin 6/1 dhe 8; termi “kombësinë në përputhje me kombësinë e prindërve”, i përcaktuar në nenin 42/2, germa “e”, dhe neni 58 i ligjit për gjendjen civile, bien në kundërshtim me nenin 20 të Kushtetutës dhe parimin e sigurisë juridike.

8. Veprimet për fitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare

Shtetësia është lidhja kryesore politike dhe juridike midis njeriut si person fizik dhe shtetit përkatës. Për hir të kësaj lidhje, një person i caktuar vihet nën pushtetin sovran të shtetit në gjirin e të cilit ai gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrohet të përmbushë të gjitha detyrimet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ligjet e shtetit, shtetas i të cilit është¹⁹³. Sipas nenit 19 të Kushtetutës, kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj. Shtetasi shqiptar nuk mund t’ a humbasë shtetësinë, përveçse kur ai heq dorë prej saj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile përcjell në zyrën e gjendjes civile, ku do të regjistrohet shtetasi, dekretin e Presidentit të Republikës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Në këtë rast, zyra e gjendjes civile, në momentin e paraqitjes së shtetasit,

¹⁹² ‘Handbooks on Civil Registration and Vital Statistics Systems, Policies and Protocols for the Release and Archiving of Individual Records’, Series F, No. 70, United Nations, New York, 1998

¹⁹³ Dobjani, Ermir. *E Drejta Administrative 1*, Shtypshkronja “Perlat Voshtina”, Tiranë 2007, f. 247.

cakton datën dhe orën e kryerjes së betimit¹⁹⁴. Në rastin e dekretit të Presidentit të Republikës për lënien e shtetësisë shqiptare, zyra e gjendjes civile, ku shtetasi rezulton i regjistruar, kryen veprimet për çregjistrimin e tij nga Regjistri Kombëtar brenda 30 ditëve, nga marrja e dekretit. Kopje e këtij dekreti i përcillet Ministrisë së Punëve të Jashtme nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Rregullat, procedurat për kryerjen e betimit dhe teksti i betimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

Shtetasi shqiptar ka të drejtë të heqë dorë nga shtetësia shqiptare vetëm nëse plotësohen njëri nga kushtet vijuese ¹⁹⁵:

- a) të ketë një shtetësi tjetër;
- b) të ketë fituar një shtetësi tjetër;
- c) t'i jetë garantuar dhënia e një shtetësie tjetër nga organet kompetente të shtetit të huaj. Të miturit fitojnë dhe humbasin shtetësinë me miratimin e prindërve. Për minorenët e moshës 14-18 vjeç merret edhe pëlqimi i tyre.

Ndërsa, shtetasit të huaj i lind e drejta për të kërkuar shtetësinë shqiptare me natyralizim kur plotësohen kushtet vijuese:

- Të ketë mbushur moshën 18 vjeç. Llogaritja bëhet në ditën e bërjes së kërkesës;
- Të ketë banuar ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se 5 vjet;
- Të ketë banesë dhe të disponojë të ardhura të mjaftueshme;
- Të mos ketë qenë ndonjëherë i dënuar (në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër) për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie. Përrjashtim nga ky rregull bëhen në rastet kur vlerësohet se dënimi është dhënë për motive politike;
- Të ketë njohuri, të paktën fillestare, të gjuhës shqipe;
- Dhënia e shtetësisë shqiptare të mos prekë sigurimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë.

Njëherësh, i huaji, që ka mbushur moshën 18 vjeç, mund të fitojë shtetësinë shqiptare edhe kur nuk i plotëson kushte e mësipërme, me kusht që dhënia e shtetësisë shqiptare të mos prekë sigurimin dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë. Personit, që është pa shtetësi, i kërkohen të ketë banuar ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se 5 vjet.

Por, nëse i huaji vërteton se është me origjinë shqiptare deri në dy shkallë, qoftë edhe nga njeri prind, koha e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë të paktën deri në 3 vjet. E njëjta periudhë i kërkohet të huajit edhe kur ai martohet me një shtetase shqiptare, nëse ai ka banuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të ligjshme në Republikën e Shqipërisë, të paktën një vit, si dhe të ketë mbushur moshën 18 vjeç, të ketë banesë dhe të disponojë të ardhura të mjaftueshme; të mos ketë qenë ndonjëherë i dënuar (në

¹⁹⁴Neni 23 i ligjit nr. 134/2016.

¹⁹⁵ Ligjin Nr. 8389, date 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, i ndryshuar.

Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë vend tjetër) për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3 vjet heqje lirie, përveç kur vlerësohet se dënimi është dhënë për motive politike;

Shtetasi i huaj për fitim të shtetësisë shqiptare me natyralizim duhet të depozitojë, këto dokumente:

- Kërkesa e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës. Kërkesa të përmbajë identitetin e plotë të kërkuarit (emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, shtetësinë), adresën e saktë të vendbanimit të tij të përhershëm dhe adresën ku pret informim për ecurinë e aplikimit të tij, arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër e firmë nga kërkuari;
- Mendimi me shkrim i nëpunësit që pranon dokumentet për nivelin e njohurive të gjuhës shqipe;
- Certifikata e lindjes;
- Lejeqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë, nëse banon në Shqipëri;
- Akti i pronësisë së banesës ose kontrata e qirasë së saj;
- Kontratë pune për të punësuarit ose vërtetim nga Zyra e tatimeve për të vetpunësuarit ose investitorët;
- Dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë si garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash;
- Dëshmi penaliteti e marrë në vendin e origjinës dhe në vendin ku kërkuari ka patur qëndrim legal për gjashtë muajt e fundit;
- Dokument që vërteton qenien azilant, nëse është i tillë;
- Fotografji e aplikantit, copë tre (Në rast se ka fëmijë nën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre).
- Certifikatë (kur është e nevojshme) për të vërtetuar origjinën shqiptare të kërkuarit, deri në dy shkallë, qoftë edhe nga njëri prind.

Ndërsa, qytetari i huaj për rifitim të shtetësisë shqiptare duhet të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm ¹⁹⁶:

- Kërkesë drejtuar Presidentit të Republikës.
- Certifikatë lindje dhe familjare;
- Relacion shpjegues dhe konfirmimi nga komisariati i policisë vendore dhe prefektura përkatëse lidhur me shtetësinë që kanë ose kanë patur prindërit e çdo aplikanti;
- Deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi 14 vjeç për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër;
- Vërtetimin e njësisë administrative përkatëse për çdo aplikant mbi 14 vjeç; Certifikatën e lindjes ose të vdekjes të prindërve të çdo aplikanti;

¹⁹⁶Udhëzimi i Ministrisë të Rendit Publik (Nr. 3583 datë 27.11.2001) dhe Ministrisë të Punëve të Jashtme (Nr. 6252 datë 10.12.2001) "Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare".

- Fotografi e aplikantit, copë tre (Në rast se ka fëmijë nën 14 vjeç, fotografi për secilin prej tyre).

Në rastin kur shtetasi shqiptar, kërkon të heqë dorë nga shtetësia shqiptare, duhet të paraqesë dokumentet që vijojnë:

- Kërkesë drejtuar Presidentit të Republikës;
- Premtimi nga autoriteti kompetent i shtetësisë tjetër ose dokument shtetësie origjinal, marrë në vendin përkatës;
- Certifikata e lindjes me fotografi e aplikuesit;
- Certifikata familjare e aplikuesit;
- Vërtetimi i gjendjes gjyqësore;
- Vërtetimi nga Gjykata e rrethit;
- Vërtetimi nga Prokuroria;
- Vërtetimi nga Zyra e Përmbarimit;
- Vërtetimi nga Kryetari i Njësies administrative që është banor i asaj njësie, në të cilin të konfirmohet adresa e saktë;
- Certifikata e martesës së aplikantit e marrë në vendin ku është lidhur martesa; Dokumenti që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin premtues të shtetësisë tjetër. Në çdo rast ky dokument duhet të jetë për të gjithë antarët e familjes;
- Deklarata noteriale e të dy prindërve, ku të shprehet pëlqimi i tyre për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare e fëmijëve të tyre të moshës deri 18 vjeç.

9. Funkzioni i akteve të gjendjes civile

Në mënyrë të përgjithshme, aktet e gjendjes civile shërbejnë për identifikimin e personave fizikë. Ata janë në fakt mjete të identifikimit civil. Në lidhje me këtë qëllim ato karakterizohen nga dy efekte specifike: Aktet e gjendjes civile janë (i) elemente të njohjes publike dhe (ii) mjete prove. Këto dy funksione publike vërehen me kalimin e kohës, sepse bëhet fjalë për secilin dhe në vijim të brezave, për njohjen publike dhe provën e ngjarjeve që përcaktojnë ekzistencën. Gjendja civile është në fragmentet e saj kujtesa zyrtare e individëve, e familjeve, e shoqërisë.

9.1 Njohja publike e akteve të gjendjes civile

Individët për t'u informuar mbi dikë tjetër (p.sh., para se ta kontraktojnë) nuk mundën ta konsultojnë drejtpërsëdrejti regjistrin e gjendjes civile. Por, depozituesit e këtyre regjistrave janë të detyruar (me disa kushte) të lëshojnë për ata që i kërkojnë ose kopje të plota, ose ekstrakte të akteve të gjendjes civile. Sistemi lejon kështu shpërndarjen e disa elementeve të gjendjes civile, pasi këto kopje ose ekstrakte duhet t'u lëshohen pas kërkesës së tyre, jo vetëm të interesuarve dhe të afërmve të tyre, por gjithashtu edhe të tretëve dhe administratës publike.

Megjithatë, për të shmangur shpërndarjen e informacionit, ligji përcakton në mënyrë të kufizuar personat që kanë të drejtë të kërkojnë kopje të plota (kryesisht paraardhës, pasardhës ose bashkëshort i personit që ka të bëjë me aktin dhe vetë personi

na fjalë) në dallim nga personat e tjerë që kërkojnë, por që mund të marrin vetëm disa ekstrakte.

9.2 Forca provuese e akteve të gjendjes civile

Duke marrë në konsideratë qëllimin e tyre kryesor, aktet e gjendjes civile hartohen me qëllim që të konstatohen disa elemente të gjendjes së personave. Megjithatë, vlera bindëse që u njihet të dhënave të akteve është e ndryshueshme¹⁹⁷. Këto të dhëna janë autentike pasi mendohet se janë të verifikuara nga nëpunësi i gjendjes civile (si nëpunës civil ai vërteton autenticitetin e një të dhëne për të cilën ai ka në ngarkim t'a verifikojë personalisht). Këto të dhëna konsiderohen të besueshme deri sa të tregohet pavërtetësia e tyre¹⁹⁸.

Përcaktimet e tjera janë të besueshme deri sa të provohet e kundërta, e cila është e lirë (një i tretë i interesuar mund të vërtetojë se në të vërtetë deklaratat e bëra nga një individ para nëpunësit civil janë të rreme). Ky dallim është i rëndësishëm në praktikë, pasi ajo që verifikon nëpunësi i gjendjes civile reduktohet në pak elemente (data dhe vendi i aktit, tregimi i autoritetit që e ka kryer aktin) me përjashtim të realitetit të fakteve të deklaruara nga të pranishmit (data dhe vendi i lindjes, gjendja e fëmijës).

Për arsye se është regjistrimi zyrtar i ngjarjes ku data, vendi, përmbajtja janë të saktësuara, si dhe personat që lidhen me to, gjendja civile është historike. E vërteta është arsyeja e ekzistencës së saj. Megjithatë, kjo e vërtetë ndërtohet për akte të ndryshme (lindje, vdekje) mbi deklaratat e të tretëve, të paverifikuara nga nëpunësi i gjendjes civile. Sistemi përshtatet me përafërsi (mosha e përafërt e një fëmije të gjetur, deklarimi gjyqësor i lindjes; vërtetimi i faktit juridik të vdekjes). Gjendja civile e një të panjohuri përpiket t'a plotësojë atë. Megjithatë, sistemi nuk e eliminon parimin e të vërtetës, pasi e lë gjithnjë të hapur rrugën për korrigjim.

10. Komisioni Ndërkombëtar i Gjendjes Civile

Komisioni Ndërkombëtar i Gjendjes Civile (KNGJC), është një organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare, e themeluar në 1948, ku janë bashkuar aktualisht 13 shtete anëtare¹⁹⁹. Ai harton, përditëson dhe shpërndan në lidhje me të drejtën, një dokumentacion ndërkombëtar drejtuar shteteve të ndryshme (dhe punon për përpunimin e rekomandimeve apo të projekteve të konventave për të harmonizuar legjislacionet e shteteve anëtare). Që prej krijimit të tij, 26 konventa (ndër të cilat 23 në fuqi) janë përpunuar si dhe 8 rekomandime.

Më poshtë po pasqyrojmë një pjesë të rekomandimeve të Komisionit Ndërkombëtar për Gjendjen Civile.

10.1 Rekomandimi (Nr. 2) për ligjin e martesës, i miratuar në Vjenë më 8 shtator 1976

¹⁹⁷ Ibid, f. 97.

¹⁹⁸ Ajo përcaktohet nga nenet 303 e në vijim të N.C.P.C. Shih në lidhje me këtë parim, dekretin e 3 gushtit 1962, neni 13.

¹⁹⁹ Shih, *Guide pratique internationale de l'état civil*, botimi Berger – Levraut, Paris.

Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, duke marrë parasysh se, në të gjitha shtetet anëtare, martesë nënkupton pëlqimin e dhënë lirisht të një burri dhe të një gruaje, të shprehura para një autoriteti kompetent dhe, duke vlerësuar se, përtej diversitetit të rregullave të caktuara, ekziston një konsensus i gjerë mbi elementët thelbësorë të ligjit të martesës, duke e konsideruar të dëshirueshme që, ndërmjet shteteve anëtare të Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, si dhe me rastin e reformave të reja, ligjet për këtë çështje duhet të sillen më ngushtë në linjë, duke vënë në dukje tendencën e përgjithshme, në të gjitha shtetet anëtare të Komisionit Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, për të lehtësuar lidhjen e martesës dhe për të ruajtur vlefshmërinë e lidhjes martesore, rekomandon që legjislativat e shteteve anëtare të Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, në mbledhjen e saj në Vjenë më 8 shtator 1976:

- Asnjë pengesë ligjore për martesë nuk mund të bazohet mbi racën, kombësinë ose fenë;

- Martesa nuk mund të kushtëzohet me autorizim administrativ ose dëshmi të një pale profesionale ose ushtarake;

-Martesa nuk mund të kushtëzohet nga rezultatet e një ekzaminimi mjekësor;

-Divorci, për çfarëdo arsye të theksuar, nuk mund të përbëjë pengesë, madje edhe të përkohshme, për të lidhur përsëri martesë;

-Vetëm personat e një moshe në të cilën duhet të supozohet se kanë arritur zhvillim fizik të mjaftueshëm dhe pjekuri intelektuale duhet të lejohen që të lidhin martesë; kjo moshë nuk mund të jetë më e ulët se 15 vjet;

-Përsa i përket një të mituri, i cili ka nevojë për pëlqimin e nevojshëm të personit ose personave që ushtrojnë autoritetin prindëror, ky pëlqim mund të zëvendësohet me një urdhër të gjykatës bazuar në interesat e të miturit;

-Celebrimi i martesës nuk mund të kushtëzohet me dhënien e njoftimit paraprak;

-Mundësia e celebrimit të martesës në një formë të pastër civile duhet të garantohet;

-Martesa me prokurë mund të lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe nëse njëri nga bashkëshortët është pranishëm;

-Martesa pas vdekjes nuk mund të lejohet;

-Martesa duhet të konsiderohet e vlefshme përsa kohë që nuk është shpallur i pavlefshëm me vendim të gjykatës;

-Arsyet për pavlefshmëri duhet të reduktohen në minimum;

-E drejta për të filluar procedurën për anulimin e martesës duhet të ushtrohet vetëm nga një numër shumë i kufizuar i personave;

-Përveç rastit të bigamisë ose inçestit, procedura për pavlefshmëri nuk mund të fillojë nëse martesë ka zgjatur më shumë se një vit. Në rast të bigamisë, procedura për pavlefshmëri nuk mund të fillojë nëse martesë e parë është zgjidhur;

-Një deklaratë e pavlefshmërisë duhet të prodhojë efekte në lidhje me bashkëshortët vetëm për të ardhmen dhe nuk duhet të ndikojë në ligjshmërinë e fëmijëve.

10.2 Rekomandimi (Nr. 4) në lidhje me bërjen publike të regjistrave të gjendjes civile dhe të dhënat, miratuar në Romë më 5 shtator 1984

Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, duke marrë parasysh shkallën në të cilën disponohen të dhënat e regjistrave të gjendjes civile, e cila ndryshon nga shteti në shtet dhe si rezultat këto të dhëna duhen të harmonizohen;

Duke marrë parasysh që neni 8, paragrafi 1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950, përcakton se çdokush ka të drejtën e respektit për jetën e tij private dhe familjare

Duke marrë parasysh se hapat e ndërmarrë nga shtetet për të bërë të dhënat e gjendjes civile të arritshme për publikun duhet të mos cenojë të drejtën e garantuar me këtë nen;

Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, rekomandon që në legjislacionin e tyre të gjitha shtetet anëtare të zbatojnë parimet e mëposhtme, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Komisionit Ndërkombëtar për Gjendjen Civile në mbledhjen e tij më 5 shtator 1984.

- Çdo ekstrakt nga regjistrat e gjendjes civile që mund të merret nga çdo person sipas kërkesës, nuk duhet të përmbajë tregues në lidhje me filiasionin, fenë, të dhëna për divorcin, ndarjen ose për shpalljen e pavlefshme të një martesë ose shkaqet e vdekjes, as ndonjë tregues tjetër që shkel të drejtën e jetës private.
- Riprodhimet dhe kopjet e plota të regjistrave të gjendjes civile si dhe ekstrakte që përmbajnë një nga artikujt e informacionit të listuar më sipër mund të lëshohen vetëm tek autoritetet publike, tek pasardhësit, parardhësit, trashëgimtarët, bashkëshortët dhe përfaqësuesve ligjorë, ose personave që vendosin një interes të ligjshëm dhe mbajnë një autorizim të veçantë të lëshuar nga autoriteti kompetent;
- Regjistrat e gjendjes civile mund të konsultohen drejtpërdrejt vetëm nga autoritetet publike të përshkruara me ligj ose, në raste të jashtëzakonshme, me autorizimin e shprehur të gjykatës ose të autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e gjendjes civile;
- Personave të cilëve u është refuzuar lëshimi i riprodhimit, kopjes ose ekstraktit, duhet të kenë të drejtën e ankimit në një gjykatë;
- Të dhënat, kur është e mundur, duhet të bëhen në format që mund të riprodhohen pjesërisht;

- Ky rekomandim nuk zbatohet për regjistrimet dhe regjistrat që janë më shumë se 100 vjet të vjetra.

10.3 Rekomandimi (Nr. 5) në lidhje me harmonizimin e shënimeve të gjendjes civile, miratuar në Lisbonë më 10 shtator 1987

Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, duke marrë parasysh harmonizimin midis shteteve anëtare të formatit dhe përmbajtjes së gjendjes civile, të dhëna, të cilat do të lehtësonin shumë përkthimin, mirëkuptimin dhe kompjuterizimin e mundshëm;

Duke pasur parasysh se ka një numër të dhënash, të cilat të gjitha shtetet e konsiderojnë të domosdoshme për t'u përfshirë në të dhënat e tyre për lindjen, martesën ose vdekjen, këto shtete gjithashtu e konsiderojnë të nevojshme që në këto regjistra të përfshihen tregues të caktuar që janë karakteristike për çdo shtet.

Në këtë mënyrë rekomandohet që shtetet anëtare të Komisionit Ndërkombëtar për Gjendjen Civile të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme gjatë hartimit të akteve të lindjes, martesës ose vdekjes:

Regjistrimet e lindjes, martesës ose vdekjes duhet të ndahen në katër pjesë:

Pjesa e parë e çdo regjistri duhet të përmbajë shënimet thelbësore që janë të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare dhe të aksesueshme për publikun;

Pjesa e dytë do të përmbajë të gjitha shënimet që janë të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare dhe të mbrojtura nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të nënshkruar në Romë më 4 Nëntor 1950, sikurse edhe Rekomandimi i Komisionit Ndërkombëtar për Gjendjen Civile në lidhje me aksesin e publikut në regjistrat e gjendjes civile, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në Romë më 5 shtator 1984;

Pjesa e tretë përfshin tregues të detyrueshëm ose opsional, të veçanta për disa shtete, ashtu siç janë të përcaktuara me ligjin e tyre të brendshëm; dhe

Në pjesën e katërt, do të regjistrohen shënimet e një natyre administrative në lidhje me vërtetimin e të dhënave dhe identitetin e regjistruarit civil kompetent. Hapësira bosh pas katër pjesëve të të dhënave është për të bërë, në rend kronologjik, pavarësisht nga pjesët e procesverbalit në të cilin ato lidhen dhe në mënyrën e përcaktuar me ligjin e secili shtet.

10.4 Rekomandimi (Nr. 8) për kompjuterizimin e regjistrimit civil miratuar në Strasburg më 21 mars 1991

Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, duke konstatuar se masat e marra në disa shtete anëtare për të kompjuterizuar regjistrimin e gjendjes civile dhe duke

pasur parasysh se është e dëshirueshme që këto masa të zbatohen në mënyrë të tillë që të garantojnë besueshmërinë e të dhënave të përpunuara, të sigurohet respektimi i privatësisë së personave të cilët kanë lidhje me këto të dhëna sikurse edhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit mbi gjendjen civile në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, rekomandon që shtetet anëtare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të siguruar që krijimi, përdorimi dhe çdo modifikim i sistemeve për përpunimin automatik të të dhënave të gjendjes civile të plotësojë kushtet e mëposhtme:

(a) Çdo sistem për përpunimin automatik të të dhënave të gjendjes civile duhet të përmbushë të gjitha kërkesat në lidhje me mbrojtjen materiale. Këto kërkesa kanë të bëjnë, ndër të tjera, me mbrojtjen e objekteve, sigurimin e një zone “të lartë të sigurisë”, të kenë masa të larta të mbrojtjes kundër dhe të kenë furnizim të rregullt me energji elektrike sikurse edhe të garantohet mbrojtja nga shkarkesat elektrike. Disa kopje rezervë të të dhënave në mënyrë elektronike duhet të mbahen në një vend të sigurt. Për më tepër, numri i ngjarjeve të regjistruara duhet të numërohen periodikisht dhe procedurat për kontrollimin e tyre duhet të ndiqen dhe të kryhet vazhdimësia e të dhënave sikurse edhe testet e konformitetit në programet në intervale të rregullta.

(b) Qasja, përdorimi dhe azhurnimi i të dhënave të gjendjes civile të regjistruar në formë elektronike duhet të jetë në varësi të kontrolleve specifike dhe të bëhet nën mbikëqyrjen e gjendjes civile.

(c) Gjithkush ka të drejtë të marrë dijeni dhe, nëse është e nevojshme, dhe të bëhen korrigjimet përkatëse në të dhënat e gjendjes civile.

(ç) Komunikimi me palët e treta në lidhje me të dhënat e gjendjes civile ose grupeve të të dhënave të gjendjes civile të regjistruara në kompjuter duhet t'i nënshtrohen rregullave të aplikueshme për qasjen në publik të të dhënave të gjendjes civile

Rekomandon që kopjet dhe ekstraktet e prodhuara me anë të një sistemi në përputhje me kushtet e përcaktuara më sipër do të pranohen në shtetet anëtare në të njëjtën mënyrë sikurse edhe të dokumentojë konformitetin me të cilin është verifikuar dokumentacioni origjinal në letër.

- Rekomandon që sistemet për përpunimin e të dhënave të gjendjes civile të programohen në mënyrë që të përkthehet informacioni i koduar sipas një kodifikimi të miratuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile.
- Rekomandon që me vendosjen e sistemeve për përpunimin automatik të të dhënave të gjendjes civile, shtetet anëtare sigurojnë që sistemet të jenë në përputhje me ato të përdorura në shtetet anëtare të tjera.
- Rekomandon që një shtet anëtar të komunikojë me një tjetër përsa i përket të dhënave të gjendjes civile të regjistruara në formë elektronike dhe duhet të kryhen në përputhje me rregullat për qasjen në publik të të dhënave që janë në fuqi në shtetin që regjistroi këto të dhëna.

10.5 Rekomandimi (Nr. 9) për luftën kundër mashtrimit me anën e dokumenteve të gjendjes civile, miratuar në Strasburg më 17 mars 2005

Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, duke marrë parasysh se autoritetet e shteteve anëtare po përballen me një numër në rritje të dokumenteve të huaja të gjendjes civile që vërtetojnë ngjarjet, që ndikojnë në gjendjen civile dhe që nuk korrespondojnë në realitet për shkak të defekteve në mbajtjen e regjistrave ose situatave mashtruese. Duke pasur parasysh se këto mënyra mashtruese shpesh kanë si qëllim si: marrjen ose njohjen e shtetësisë ose përfitime të drejtash sociale të ndryshme, Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, adreson rekomandimin në vijim për shtetet anëtare:

Shtetet Anëtare duhet të informojnë gjendjen e tyre civile, administratën dhe autoritetet e tjera kompetente se, kur kërkohet një ekstrakt nga një regjistër i gjendjes civile për të dëshmuar gjendjen civile, të vetmet ekstrakte të pranueshme janë ato që janë të nënshkruara dhe të datuara, dhe nëse është e përshtatshme mbajnë vulën e autoritetit kompetent dhe gjithashtu tregojnë regjistrin nga i cili rrjedhin ato.

Shtetet Anëtare duhet të tërheqin vëmendjen e autoriteteve të njëjta, sikurse dokumentet dhe adresuesit e gjendjes civile të huaja, madje edhe ato që janë legalizuar, duke shmangur në këtë mënyrë, dokumentat e prodhuara ose të dëmtuara, të rreme ose false:

(a) Kushtet në të cilat është përpiluar procesverbali ose dokumenti:

- një interval shumë i gjatë midis datës kur është përpiluar procesverbali dhe datës së regjistrimit të ngjarjes;

- procesverbali është hartuar me vonesë në datën e ngjarjes dhe shumë shpejt para se ky dokument është prodhuar;

- krahasimi i të dhënave të ndryshme në procesverbal ose në dokument zbulon kontradikta ose fakte të pamundura;

- procesverbali është hartuar vetëm në bazë të një deklaratë të bërë nga personi direkt;

- procesverbali është hartuar pa të dhëna objektive që garantonin realitetin e ngjarjes;

- dokumenti është hartuar nga një autoritet që nuk ka mbajtur asnjë dokument origjinal.

b) Zbulimi i të dhënave nga çështjet jashtë dokumentit:

- krahasimi i të dhënave në dokumentin e prodhuar me të dhënat që paraqiten në shënime të tjera ose dokumente të mbajtura nga autoriteti që merret me rastin, zbulon kontradikta ose mospërputhje;

- të dhënat në dokumentin e prodhuar nuk duket se korrespondojnë me personin në fjalë;

- ekzistenca e mashtrimeve të mëparshme ose parregullsive që i atribuohen personit janë sjellë zyrtarisht dhe kërkohet njohja e autoritetit lëshues;

- parregullsi të shumta në mbajtjen e regjistrave të gjendjes civile ose nxjerrjen e ekstrakteve prej tij në shtetin e origjinës së dokumentit të prodhuar, që janë sjellë zyrtarisht.

Kur treguesit ngrenë dyshime në lidhje me korrektësinë e të dhënave në dokumentin e prodhuar ose në lidhje me origjinalitetin e nënshkrimeve, vulën ose dokumentin, autoriteti që merret me rastin duhet të kryejë të gjitha kontrollet që mund të jenë të dobishme, veçanërisht me personin në fjalë. Nëse është e përshtatshme, ajo duhet, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe me pëlqimin e autoriteteve lokale, të ndërmerren hapa për të verifikuar atë regjistër që ekziston në regjistrat e Shtetit të origjinës dhe korrespondon me dokumentin e prodhuar në rastet kur:

(a) Nëse parregullsitë e gjetura vërtetojnë se dokumenti i prodhuar është fals, autoriteti që merret me këtë rasti duhet të refuzojë të përdorë këtë dokument; Nëse parregullsitë e gjetura vërtetojnë se dokumenti i prodhuar është i dëmtuar ose i gabuar, autoriteti që merret me rastin duhet të vlerësojë nëse mund të jepet ndonjë efekt, pavarësisht nga defekti ose gabimi që përmban.

(b) Nëse autoriteti që merret me çështjen refuzon të trajtojë në tërësi ose pjesërisht atë dokument, atëherë duhet të informojë personin në fjalë, për t'i dhënë të drejtën që të apelojë vendimin tek eprori i nëpunësit, në radhë të parë ose drejtpërdrejt në gjykatë, duke paraqitur atje edhe dëshminë përkatëse.

Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë së bashku për të bashkuar informacionin e tyre dhe mjetet e identifikimit, të dhënat dhe dokumentet e dëmtuara, të gabuara ose false. Në veçanti, ata duhet të marrin në konsideratë rezultatit e kontrolleve të kryera tashmë nga autoritetet e një shteti tjetër anëtar.

10.6 Rekomandimi (Nr. 10) për martesën, miratuar në Paris më 26 shtator 2014

Duke marrë parasysh rekomandimin për ligjin e martesës të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Komisionit Ndërkombëtar për Gjendjen Civile në Vjenë më 8 shtator 1976, Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, rekomandon që shtetet anëtare të marrin parasysh parimet e mëposhtme:

Parimi I – Pëlqimi

-Asnjë martesë nuk mund të lidhet pa pëlqimin e plotë dhe të lirë të bashkëshortëve të ardhshëm.

Parimi II – Pengesat

-Asnjë pengesë për martesë nuk mund të justifikohet duke u bazuar mbi racën, shtetësinë ose fenë;

-Divorci, për çfarëdo arsye, nuk mund të përbëjë një pengesë ligjore, madje edhe të përkohshme, për t'u martuar përsëri.

Parimi III - Kushtet e Ndaluar

-Martesa nuk mund të kushtëzohet me autorizim administrativ ose dëshmi të një pale profesionale ose ushtarake;

-Martesa nuk mund të kushtëzohet nga rezultatet e një ekzaminimi mjekësor.

Parimi IV - Moshë minimale e domosdoshme

-Vetëm personat që kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç duhet të lejohen të lidhin martesë;

-Sidoqoftë, duke u bazuar në interesat ekskluzive të të miturit dhe duke marrë parasysh pjekurinë e tij/saj, autoriteti kompetent, për arsye serioze, mund t'a përjashtojë të miturin nga kushti i moshës nëse ai ose ajo ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç;

-Përsa i përket një të mituri, i cili është përjashtuar nga kushti i moshës, pëlqimi i personit ose i personave që ushtrojnë autoritetin prindëror mbi të mundet, nëse kërkohet, të zëvendësohet me një vendim të gjykatës, duke u bazuar në interesat ekskluzive të të miturit;

-Në pajtim me Parimin I, pëlqimi personal i të miturit është i domosdoshëm në të gjitha rastet.

Parimi V - Celebrimi dhe regjistrimi i martesave

-Celebrimi i martesës nuk mund të kushtëzohet me dhënien e njoftimit paraprak, përveç rastit kur një njoftim i tillë është hartuar për të mbrojtur palët e treta;

-Duhet të garantohet mundësia e celebrimit të martesës në një formë të pastër civile;

-Një martesë duhet të regjistrohet nga autoriteti kompetent në një regjistër të gjendjes civile ose të regjistrohet nga një zyrtar tjetër i ligjshëm.

Parimi VI - Martesa me përfaqësim

-Martesa me përfaqësim mund të lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe nëse njëri nga bashkëshortët është i pranishëm;

-Akti i përfaqësimit duhet të tregojë shprehimisht martesën në fjalë dhe identitetin e bashkëshortëve të ardhshëm;

-Në përputhje me Parimin I, pëlqimi i plotë dhe i lirë i çdo bashkëshorti është i domosdoshëm.

Parimi VII - Martesa e pas vdekjes

-Martesa pas vdekjes është e ndaluar.

Parimi VIII - Martesa bigame

-Martesa bigame është e ndaluar.

Parimi IX - Martesa e detyruar

-Martesa e detyruar është e ndaluar;

-Nëse ekzistojnë prova që çojnë në supozimin se një martesë të planifikuar, atëherë kjo është një martesë e detyruar. Celebrimi i saj do të bëhet i kushtëzuar duke ju hapur rrugën verifikime të mëtejshme, në veçanti me anë të dëgjimit të bashkëshortëve të ardhshëm, për të cilët pëlqimi ishte dhënë lirisht;

-Nëse ka seancë dëgjimi, bashkëshortët e ardhshëm do të dëgohen ndaras dhe në kushte që inkurajojnë të flasin lirshëm;

-Autoritetet kompetente duhet të marrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e viktimës.

Parimi X - Martesa e rreme (e Bogusit)

-Autoritetet kompetente duhet të marrin masat e nevojshme për të penguar martesat e rreme.

Parimi XI - Procedura për pavlefshmërinë

-Martesa duhet të konsiderohet e vlefshme përsa kohë që nuk është shpallur e pavlefshme me vendim të gjykatës;

-Arsyet për pavlefshmëri duhet të parashikohen me ligj dhe të reduktohen në minimum.

E drejta për të filluar procedurën për shpalljen si të pavlefshme të martesës duhet të ushtrohet nga një numër i kufizuar i personave. Megjithatë, kjo e drejtë mund të ushtrohet nga autoriteti kompetent nëse martesë ishte lidhur në kundërshtim me rendin publik, veçanërisht në rastet e lidhje së martesës nën kanosje apo në rastin e bigamisë.

Parimi XII - Procedura e kundërshtimit

-Autoriteti kompetent mund të kundërshtojë celebrimin e martesës, kur është vërtetuar së paku se një nga dy bashkëshortët e ardhshëm nuk ka dhënë pëlqimin e tij lirisht dhe plotësisht;

-Vendimi duhet të merret sa më shpejt. Palëve u lind e drejta për t'u ankuar në gjykatë.

10.7 Rekomandimi (Nr. 11) në lidhje me njohjen e vendimeve të caktuara të birësimit të marra ose të njohur në një shtet anëtar të Komisionit Ndërkombëtar, miratuar në Strasburg më 17 shtator 2015

Komisioni Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, duke konstatuar vështirësitë që lidhen me njohjen nga një vend anëtar i Komisionit Ndërkombëtar i Gjendjes Civile të vendimeve të birësimit të marra ose të njohura në një shtet tjetër anëtar, kur ato vendime nuk janë të parashikuara nga Konventa e Hagës e datës 29 maj 1993 mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimit në respekt të adoptimit ndërshtetëror;

Duke pasur parasysh rekomandimin e Komisionit Ndërkombëtar për Gjendjen Civile (nr. 9) të datës 17 mars 2005 për luftimin e mashtrimit me anën e dokumenteve në lidhje me gjendjen civile, dhe sidomos pika 6 e saj që parashikon se: "Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë së bashku për të bashkuar informacionin e tyre dhe mjetet e identifikimit,

të dhënat dhe dokumentet e dëmtuara, të gabuara ose mashtruese. Në veçanti, ata duhet të marrin në konsideratë rezultatin e kontrolleve të kryera tashmë nga autoritetet e një shteti tjetër anëtar”,

Duke konsideruar se është e këshillueshme që të lehtësohet njohja e vendimeve të birësimit të marra ose të njohura në një tjetër shtet anëtar në mënyrë që të përmirësojë sigurinë ligjore për personin e adoptuar;

Duke konsideruar se njohja e atyre vendimeve të birësimit, të marra ose të njohura në një shtet anëtar të Komisionit Ndërkombëtar për Gjendjen Civile, do të lehtësohej nëse ai shtet, do të ishte i pari do të ndante të dhëna të tjera të dobishme nga Shtetet e tjera të interesuara që do t'u mundësonin atyre të përfitonin nga kontrollet kryer në Shtetin e parë;

Duke konsideruar që Rekomandimi i tanishëm nuk ka të bëjë me birësimet që parashikohen nga Konventa e lartpërmendur e Hagës e datës 29 maj 1993, të cilat janë apo duhet të jenë vërtetuar nga certifikata e konformitetit të referuar në nenin 23 të asaj Konvente;

Duke marrë parasysh që rekomandimi i tanishëm mbulon vetëm birësimet që krijojnë një marrëdhënie prind-fëmijë;

Rekomandon shtetet anëtare të saj që të miratojnë rregullat e mëposhtme:

- ° Një vërtetim që ka të bëjë me një vendim për miratimin e birësimit ose njohjen e një vendimi për miratimin e birësimit duhet të lëshohet për një palë të interesuar;
- ° Vërtetimi duhet të përpilohet në përputhje me modelet e bashkangjitura në përputhje me rregullat e zbatueshme, të përcaktuara në Shtojcën 3;
- ° Vërtetimi lëshohet kur vendimi i miratimit të birësimit merr formë të prerë;
- ° Shtetet anëtare do të përcaktojnë autoritetin ose autoritetet e autorizuar për të lëshuar vërtetimin dhe do t'i japë Sekretarit të Përgjithshëm informacionin e duhur;
- ° Pala e interesuar duhet të paraqesë vërtetimin tek autoriteti, i cili e ka thirrur për të përcaktuar nëse vendimi i adoptimit të huaj duhet të njihet.

KAPITULLI VI

MBROJTJA E PERSONIT FIZIK NË TË DREJTËN CIVILE

Në përgjithësi mund të themi se e drejta ka në qendrën e vëmendjes të saj mbrojtjen e njeriut dhe çdo degë e saj rregullon në mënyrë ligjore mbrojtjen e veçantë të saj. Tërësia e këtyre normave përbëjnë atë që quhet sistemi i mjeteve të mbrojtjes të njeriut, e cila përbëhet nga mjete juridike të degëve të së drejtës kushtetuese, administrative, civile, tregtare, të punës, penale, procedurës civile dhe penale, ndërkombëtare (private dhe publike), familjes etj. Në të drejtën civile mbrojtja specifike juridike nuk u dedikohet të gjithë personave, por ajo është e destinuar vetëm për një kategori të caktuar personash.

1. Mbrojtja e të miturit

Sipas legjislacionit shqiptar, fëmijë konsiderohet qenia njerëzore e lindur gjallë deri në moshën 18 vjeç, moment kur ai fiton zotësi të plotë juridike për të vepruar. Legjislacioni shqiptar është tepër i motivuar për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre, fakt që e dëshmon edhe ligjet e shumta të miratuara në interes të fëmijëve. Baza ligjore mjaft e pasur demonstroi edhe njëherë se ligji shqiptar mbron të gjitha të drejtat e fëmijëve dhe kontribuon në zhvillimin e tyre. Legjislacioni shqiptar, bazuar edhe në aktet e ndryshme ndërkombëtare, merr në mbrojtje dhe kujdes të veçantë të miturit. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si ligj themeltar, kodet e ndryshme dhe aktet e tjera ligjore, në përmbajtje të tyre pranojnë edhe parimet dhe normat e akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve.

Përsa i përket mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve para lindjes së tyre, në Kodin Civil, neni 2, parashikohet se zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Gjithashtu në Kodin Civil, neni 320, parashikohet mbrojtja e të drejtave pasurore të fëmijës, të fituara nëpërmjet trashëgimisë që në momentin e konceptimit të tij. Konkretisht, në këtë dispozitë thuhet se ka zotësi për të trashëguar personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë.

Në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, fëmija si të gjithë qytetarët gëzon të drejta të barabarta me ligj. Fëmijës i njihen të gjitha të drejtat e pranuar nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, miratuar nga Asambleja e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 20 nëntor 1989 (më poshtë referuar si “Konventa”).

Në përmbushje të detyrimeve të vendosura nga Konventa, vendi ynë ka miratuar ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” (më poshtë referuar si “ligji nr. 18/2017”).

Qëllimi i këtij ligji, i përcaktuar në nenin 2, është:

a) mbrojtja e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;

b) parashikimi i parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

c) garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik;

ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;

d) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;

dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;

e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 5 të ligjit nr. 18/2017, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive.

2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.

3. Barazia dhe mosdiskriminimi.

4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.

5. Ndarja e përgjegjësive ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.

6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.

7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj.

8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.

9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.

10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

I mituri që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, është i pazoti për të vepruar. Ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundërshtim. Veprimet e tjera i kryen në emër të tij, përfaqësuesi i tij ligjor.

Sipas Kodit të Punës, mosha minimale për punë e fëmijëve është 16 vjeç²⁰⁰. Fëmijët nga 14-18 vjeç mund të punojnë në punë të lehta gjatë pushimeve shkollore. Punët e lehta dhe oraret e tyre përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Sipas nenit 100 të Kodit të Punës parashikohet se vetëm personat madhorë mund të punësohen në punë të vështira, ose që paraqesin rrezik për shëndetin ose personalitetin e tyre. Këshilli i Ministrave përcakton punët e vështira, ose të rrezikshme.

Sipas Kodit Penal fëmija ka përgjegjësi penale me mbushjen e moshës 14 vjeç për veprat penale dhe 16 vjeç për kundërvajtjet penale. Të miturit nën 18 vjeç të dënuar me burgim, nuk mund të marrin më shumë se gjysma e dënimit të parashikuar për të rriturit. Në këtë mënyrë Kodi Penal ka mbrojtur të miturin.

Në Kushtetutën shqiptare thuhet se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kushtetuta dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi, në Republikën e Shqipërisë i garantojnë çdo fëmije, jo vetëm atyre rezidentë në juridiksionin e shtetit përkatës, me qëndrim të përhershëm në Shqipëri, por edhe fëmijëve me qëndrim të përkohshëm si dhe vizitorëve, ose për çdo arsye tjetër qoftë, të drejtat e mëposhtme:

- E drejta për të mos u diskriminuar;
- E drejta e jetës;
- Mbrojtja e veçantë nga shteti.

Në paragrafin 2 të nenit 54 të Kushtetutës parashikohet edhe një element tjetër i mosdiskriminimit të fëmijës dhe këtu bëhet fjalë për të drejta të barabarta që gëzojnë fëmijët e lindur jashtë martesë me ata të lindur nga martesë.

- Mbrojtja nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë (Paragrafi 3 i Nenit 54 të Kushtetutës);

- E drejta pasurore e fituar nëpërmjet trashëgimisë;
- E drejta e emrit (neni 5 i Kodit Civil);
- Të drejtën e vendbanimit (Kodi Civil, neni 13: “Fëmijët kanë për vendbanim atë të prindit”);
- Fitimi i shtetësisë (Ligji nr. 8442 datë 21.01.1999 “Për Shtetësinë”);

²⁰⁰ Nenet 98, 99

- E drejta për t'u pyetur para organeve administrative dhe gjyqësore (Kodi i Procedurës Civile);
- E drejta e mbrojtjes në punë (Kodi i Punës);
- Lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe besimit fetar (neni 24 i Kushtetutës);
- E drejta e informimit (neni 22 i Kushtetutës);
- E drejta e organizimit (neni 46) i Kushtetutës;
- E drejta për të patur kujdes shëndetësor (neni 55 i Kushtetutës);
- Të drejtat dhe lehtësitë në fushën penale të parashikuara me dispozitat e Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale etj.

Gjatë periudhës së regjimit komunist fëmijët diskriminoheshin për shkak të bindjeve ose opinioneve të shprehura nga prindërit e tyre ose të afërm të tjerë të familjes. Format e diskriminimit ishin nga më të ndryshmet duke filluar nga internimet deri tek mohimi i të drejtës për t'u arsimuar. Legjislacioni shqiptar nuk parashikon ndonjë dispozitë të veçantë lidhur me mosdiskriminimin e fëmijëve për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, etj.

Procesi i zhvillimeve demokratike në Shqipëri u shoqërua me kriza të mëdha politike, institucionale, ekonomike dhe psikologjike. Në këtë kuadër u shfaq një formë e re diskriminimi për shkak të pozitës së prindërve. U rishfaqën vrasjet në seri për shkak të gjakmarrjes dhe hakmarrjes dhe si pasojë, përveç të tjerash ngujimin e shumë fëmijëve në “burgun shtëpiak” dhe braktisjen e shkollës. Gjendja paraqitet veçanërisht e vështirë në rrethet e veriut të vendit.

1.1 Interesi më i lartë i fëmijës

Neni 54 i Kushtetutës garanton të drejtën e fëmijëve që të kenë një mbrojtje të veçantë nga shteti. Në këtë kuadër institucionet publike dhe private të mbrojtjes sociale, gjykatat dhe autoritetet administrative, në vendimet e tyre, kanë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës gjen pasqyrim të plotë në nenin 48 të Kodit të Familjes, ku thuhet se birësimi bëhet në interes të të birësuarit, dhe në ligjin nr. 7650, dt. 17.12.1992 “Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes” ku thuhet se birësimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore. Gjithashtu²⁰¹, në Kodin e Familjes ku bëhet fjalë për marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve thuhet se e drejta prindërore ushtrohet vetëm në interes të fëmijës së mitur dhe me marrëveshje ndërmjet dy prindërve.

Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës, sipas nenit 6 të ligjit nr. 18/2017, bëhet sipas parashikimeve të mëposhtme:

²⁰¹ Neni 64.

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirëritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Pas viteve 90-të vihet re një praktikë gjyqësore që deri diku nuk i përgjigjet maksimalisht interesit më të lartë të të miturit. Kjo sidomos në rastet e divorceve kur fëmija ose fëmijët i lihen për rritje dhe edukim një ose të dy prindërve, ku disa herë shihen më tepër interesat e prindërve sesa të fëmijëve, ose në rastet e detyrimit ushqimor, ku shpesh herë fëmijët nuk marrin shumën e nevojshme për edukimin, arsimimin, dhe mirëritjen e tyre. Me Kodin e Procedurës Civile (neni 354 pragrafi 2, dhe neni 357) parashikohet që gjykata e merr vendimin e saj për emërimin e kujdestarit të të miturit ose zëvendësimin e tij, duke patur parasysh interesin e të miturit. Gjithashtu në Kodin Civil, neni 320, parashikohet mbrojtja e të drejtave pasurore të fëmijës, të fituara nëpërmjet trashëgimisë që në momentin e konceptimit të tij.

1.2 E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 21 të saj shprehet se, jeta e personit (ku përfshihen edhe fëmijët), mbrohet me ligj. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Paktin Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike, ku respektivisht në nenin 2 dhe 6 është parashikuar e drejta për jetën.

Neni 7 i ligjit nr. 18/2017, e përcakton respektimin e të drejtës së jetës së fëmijës, me këtë përmbajtje:

1. Mbrojtja e jetës së fëmijës është e garantuar me ligj. Fëmija gëzon standardet më të larta të mundshme të shëndetit, trajtimit e rehabilitimit.

2. E drejta e aksesit të fëmijës tek institucionet e kujdesit shëndetësor garantohet pavarësisht gjinisë, orientimit seksual, racës, etnisë dhe aftësisë ose situatës ekonomike, sociale e ligjore të prindërve apo kujdestarit.

3. Çdo fëmijë që ka nevojë për shërbim shëndetësor ose trajtim mjekësor apo rehabilitues në situata emergjence, vetë ose nëpërmjet prindërve apo kujdestarit, ka të drejtë t'u drejtohet institucioneve të kujdesit shëndetësor ose social për këtë qëllim. Personi ose autoriteti përgjegjës, brenda fushës së kompetencave që ka, i ofron fëmijës ndihmën e menjëhershme dhe e referon atë në institucionin e kujdesit shëndetësor ose rehabilitues më të përshtatshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prindit ose kujdestarit.

4. Në raste përjashtimore, kur jeta e fëmijës rrezikohet ose ka një rrezik për pasoja serioze në jetën dhe shëndetin e fëmijës, mjeku ka të drejtë të kryejë ekzaminimin dhe të japë ndihmën mjekësore, si nevojë imediate për të shpëtuar jetën e fëmijës, edhe nëse prindërit ose kujdestari nuk japin pëlqimin.

Një e drejtë tjetër e lidhur me jetën është dhe ajo e zhvillimit të fëmijës. Për shembull në ligjin nr. 8528 të vitit 1999 "*Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gjë*", është përcaktuar se, prodhuesit detyrohen që etiketat e prodhimit të ushqimeve për fëmijë të përmbajnë formulimin "ushqimi i gjirit është ideal për ushqimin e fëmijës".

Një problem i diskutueshëm lidhur me të drejtën e pamohueshme për të jetuar të fëmijës është dhe aborti. Deri në vitin 1995 aborti vullnetar nuk ishte lejuar ligjërisht në Shqipëri. Më 7 dhjetor 1995, u miratua nga Kuvendi Popullor ligji nr. 8045 "*Për ndërprerjen e shtatzanisë*". Megjithëse në nenin 1 të tij parashikohet se ligji garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës, jepen përjashtimet se ky parim mund të shkelet kur është e domosdoshme dhe në kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

Ligji "*Për ndërprerjen e shtatzanisë*" garanton respektimin e çdo qenie njerëzore që në fillim të jetës së tyre, pra që në fazën e konceptimit të tyre. Ndërprerja e shtatzanisë lejohet vetëm për arsye shëndetësore (nëna dhe fëmija) dhe për arsye psikosociale. Në rastin e një shtatzanie jashtë martesore të të miturave deri në 16 vjeç, ndërprerja e shtatzanisë bëhet me miratimin e prindit ose kujdestarit ligjor. Përveç rasteve të ndërprerjeve të shtatzanisë për arsye shëndetësore, lejohet dhe ndërprerja vullnetare me kërkesën e nënës.

Seksioni V i Kodit Penal "*Vepra Penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës*" dhe "*Ndërprerja e shtatzanisë së gruas pa pëlqimin e gruas*", parashikon se duke përjashtuar këtu rastet e justifikuara të mbrojtjes së shëndetit të gruas, kjo vepër dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Kodi Penal parashikon dispozita të posaçme që synojnë të mbrojnë të drejtën e fëmijës për të jetuar. Neni 81 i Kodit Penal "*Vrasja e Foshnjës*" bën fjalë për vrasjen me dashje të foshnjës nga nëna, menjëherë pas lindjes. Në këtë rast kemi të bëjmë me kundravajtje penale dhe kundërvajtësja-nëna dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Kodi Penal në kreun II "*Vepra penale kundër personit*", "*Krime kundër jetës*", në nenin 79 "*Vrasja me dashje për shkak të cilësive të veçanta të viktimës*" germa a), parashikon një masë dënimi për vrasjen e të miturit nën 16 vjeç me burgim të përjetshëm.

1.3 Respektimi i mendimit të fëmijës

Legjislacioni shqiptar, institucionet e shtetit dhe komuniteti e konsiderojnë fëmijën si një qenie që merr pjesë aktive, progresivisht në përputhje me intelektin e tij, në

organizimin dhe rrjedhën e jetës së tij dhe të ambientit që e rrethon. Kështu, sipas Kodit të Procedurës Civile, fëmija mund të pyetet, ose të merret në konsideratë mendimi i tij, kur ka mbushur moshën 10 vjeç²⁰². Por, aftësia për të pasur mendimin e tij konsiderohet se ndryshon në funksion të zhvillimit të fëmijës, të aftësisë së tij për të kuptuar ngjarjet që e prekin atë, natyrën dhe shkallën e rëndësisë së çështjes konkrete.

Në Kodin e Familjes (nenet 66 dhe 70), në rastin kur prindërit për arsye të ndryshme nuk jetojnë bashkë, por nuk janë të divorcuar, vendos Këshilli i Kujdestarisë se me cilin prind do të jetojë fëmija, dhe në qoftë se fëmija ka mbushur moshën 10 vjeç, duhet të marrë dhe mendimin e tij. Në rastin e zgjidhjes së martesës, gjykata zgjidh edhe çështjen se cilit prind do t'i besohen fëmijët për rritje dhe edukim. Kur fëmija ka mbushur moshën 10 vjeç, Këshilli i Kujdestarisë merr në konsideratë edhe mendimin e tij (neni 97).

Në ligjin nr. 7650, datë 17.12.1992 “Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes” parashikohet e drejta e të miturit që të japë mendimin e tij për birësimin, në qoftë se ka mbushur moshën 10 vjeç. Pra, në rastin e birësimit merret mendimi i të miturit që në fazën e procedurës administrative (neni 7). Gjithashtu, edhe gjatë procedurës gjyqësore, nëse fëmija ka mbushur moshën 10 vjeç, merret edhe pëlqimi i tij (neni 54). Sipas Kodit të Familjes, në rastin kur Këshilli i Kujdestarisë emëron kujdestarin duhet të marrë edhe mendimin e të miturit që ka mbushur moshën 10 vjeç (neni 105).

Kodi i Procedurës Civile, konform nenit 12 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, parashikon të drejtën e të miturit që ka mbushur moshën 16 vjeç t'i drejtohet vetë gjykatës për vendosjen e kujdestarisë. Jo vetëm me çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet në familje të fëmijës, por edhe në rastin e fitimit ose heqjes dorë nga shtetësia, merret mendimi i tij. Në ligjin nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare” thuhet se çdo ndryshim në shtetësinë e të miturve të moshës 14-18 vjeç bëhet duke marrë edhe pëlqimin e fëmijës (neni 5). Gjithashtu, ligji parashikon rastin kur të dy prindërit fitojnë shtetësinë shqiptare me natyralizim, fëmija i tyre, nën moshën 18 vjeç, kur jeton me prindërit, bëhet shtetas shqiptar me kërkesën e prindërve dhe me pëlqimin e fëmijës, nëse ai është në moshën 14 -18 vjeç.

Kodi i Familjes, në këtë fushë ka bërë një hap të rëndësishëm në përcaktimin e të drejtës së fëmijës për t'u dëgjuar nga gjykata dhe për t'u përfaqësuar vetë, me avokat ose nga përfaqësuesi ligjor i tij. Kështu, në pjesën e parë mbi dispozitat e përgjithshme është paraqitur me dy variante e drejta e të miturit për t'iu drejtuar gjykatës dhe për t'u dëgjuar prej saj në rastet kur merren vendime që kanë të bëjnë me interesat e të miturit.

Në variantin e parë, nuk është përcaktuar mosha, por lidhet me aftësinë e të miturit për të kuptuar dhe me zhvillimin e tij intelektual, duke mos prekur dispozitat e Kodit, që parashikojnë të drejtën e fëmijës dhe detyrimin e gjykatës të dëgjojë dhe të marrë pëlqimin e fëmijës, sipas çështjes në gjykim.

Në variantin e dytë është përcaktuar mosha 12 vjeç si kufi për fëmijën që të dëgjohet, të marrë pjesë aktive në proces dhe të mbrohet sipas mjeteve ligjore të

²⁰²Neni 356 i Kodit të Procedurës Civile.

mbrojtjes të parashikuara në këtë Kod dhe në Kodin e Procedurës Civile. Ky përcaktim në Kodin e Familjes merr rëndësi, sidomos kur procedurat kryesore që i interesojnë fëmijës para gjykatës janë procedurat familjare, në veçanti, ato që lidhen me ushtrimin e të drejtës prindërore, si vendbanimi, marrëdhëniet me prindërit, e drejta e vizitës, vendosja e kujdestarisë, cenimi i jetës private dhe i korrespondencës, mbrojtja e të drejtave pasurore, etj.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe ka pranuar juridiksionin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila përgjithësisht ka arritur në konkluzionin se asnjë vendim nuk duhet të merret kundër vullnetit të një fëmije të moshës 12 vjeç në raste të vendosjes së tij në një familje ushqyese, të ndryshimit të emrit, të kërkesës për shtetësi, të besimit fetar, etj.

1.4 Mbrojtja e emrit dhe shtetësisë

Mbrojtja e të drejtës së emrit është parashikuar edhe në Kodin Civil, sipas të cilit çdo person fizik (ku përfshihen edhe fëmijët) ka të drejtën dhe detyrimin të ketë emrin dhe mbiemrin e tij që i vihet sipas ligjit. Personit, të cilit i mohohet e drejta e përdorimit të tyre ose cenohet nga përdorimi që të tjerët i bëjnë padrejhtësisht, mund të kërkojë në gjykatë përdorimin e emrit ose të mbiemrit të vet, pushimin e cenimit, si dhe shpërblimin e dëmit përkatës.

Kjo e drejtë i është njohur fëmijës edhe nga neni 8 i ligjit nr. 18/2017, ku sanksionohet, se në përputhje me legjislacionin në fuqi, ai ka të drejtë: a) të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi; b) të ketë një emër; c) të fitojë shtetësinë dhe ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë perkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur.

Deklarimi i lindjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e lindjes, dhe kur fëmija lind i vdekur brenda 3 ditëve. Kur kanë kaluar afatet përkatëse, regjistrimi bëhet me urdhër me shkrim të kryetarit të njësisë administrative të vendbanimit të prindërve ose të vendit ku ka ndodhur lindja pasi të ketë vërtetuar datën e lindjes.

Kur prindërit kanë mbiemra të ndryshëm, të gjithë fëmijët mbajnë një mbiemër, të atit apo të nënës, sipas marrëveshjes së arritur nga prindërit. Nëse marrëveshja nuk arrihet, fëmijët mbajnë mbiemrin e atit. Kur në kohën e regjistrimit fëmija nuk është i gjallë, me pëlqimin e prindërve, i caktohet emri, regjistrohet me emër lindja dhe bëhet shënimi se ka vdekur. Kur fëmija ka lindur i vdekur regjistrohet pa emër dhe bëhet shënimi përkatës në shtyllën e vërejtjeve të regjistrit.

Fëmija i lindur jashtë martese regjistrohet me emrin e tij, emrin e nënës dhe me emrin e paqenë të atit, kurse mbiemër merr kurdoherë atë të vajzërisë së nënës. Në rast se njihet ose vërtetohet atësia, fëmijës i regjistrohet emri dhe mbiemri i të atit. Fëmija i lindur jashtë martese në shtëpinë e lindjes regjistrohet në zyrat e gjendjes civile më të afërt, brenda tri ditëve, nga drejtuesi i këtij institucioni, pasi ka marrë pëlqimin e nënës për emrin e fëmijës.

Fëmija i gjetur regjistrohet brenda tre ditëve nga organi shtetëror, ose administrata e shtëpisë së fëmijës mbi bazën e një procesverballi të mbajtur në kohën e gjetjes. Në këtë rast nëpunësi i gjendjes civile i vë fëmijës emrin dhe e regjistron me emër ati, nënë dhe mbiemër të paqenë. Në këtë kuadër situata e krijuar në Shqipëri mbas viteve 90-të, kërkon një rregullim më të hollësishëm ligjor, pasi janë konstatuar mjaft raste ku shumë nëna mbasi lindin fëmijët e tyre, largohen pa u identifikuar ose japin emër të rremë, dhe kjo për shkak të parregullsive që ndodhin në maternitete.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 19) thuhet se, kushdo që lind, duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj. Shtetasi shqiptar nuk mund të humbasë shtetësinë, përveç se në rastin kur ai heq dorë prej saj.

Në ligjin nr. 8389, datë 05.08.1998 “*Për shtetësinë shqiptare*” parashikohen edhe rastet e fitimit dhe heqjes së shtetësisë së fëmijës. Sipas ligjit (neni 5), fitimi dhe rifitimi i shtetësisë shqiptare, si dhe heqja dore prej saj, nga të miturit, bëhet me miratimin e prindërve dhe se çdo ndryshim në shtetësinë e tyre, kur janë në moshën 14-18 vjeç bëhet duke marrë edhe pëlqimin e fëmijës.

Sipas ligjit të sipërpërmendur mbi shtetësinë, shtetësia shqiptare fitohet me lindje, natyralizim dhe birësim. Fitimi i shtetësisë shqiptare me lindje ndryshoi me ligjin nr. 8442, datë 21.01.1999, sipas të cilit kushdo që lind, duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Ligji për shtetësinë, në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, parashikon edhe rastet kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi.

Sipas tij, një fëmijë i lindur ose i gjetur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë merr shtetësinë shqiptare në rast se ai është lindur nga prindër të panjohur dhe si pasojë fëmija do të mbetet pa shtetësi (neni 8). Në rast se prindërit e fëmijës bëhen të njohur para se fëmija të ketë arritur moshën 14 vjeç (pasi në këtë moshë duhet të merret edhe pëlqimi i fëmijës), dhe ata janë me shtetësi të huaj, shtetësia shqiptare mund të hiqet me kërkesë të prindërve të njohur ligjërisht me kusht që fëmija të mos mbetet pa shtetësi më pas si pasojë e këtij veprimi.

Gjithashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur një fëmijë lind nga prindër të huaj (me shtetësi tjetër). Në këtë rast fëmija mund të marrë shtetësinë shqiptare me pëlqimin e të dy prindërve në qoftë se plotëson dy kushte:

Së pari, të ketë lindur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

Së dyti, prindërit të jenë rezidentë të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në Kushtetutë (neni 23) është parashikuar e drejta e informacionit në përgjithësi, ndërsa në nenin 35 i jepet e drejta kujtdo të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Në kuadër të dy dispozitave kushtetuese të përmendura më sipër përfshihet dhe e drejta e fëmijës të marrë informacion dhe të njihet me të dhënat që disponojnë organet përkatëse për prindërit e tij.

Çështja e informacionit në të drejtën shqiptare shfaqet në dy aspekte, në atë të birësimit të të miturit dhe në rastin kur fëmijët janë vendosur në shtëpitë e fëmijës. Pra, në rast se një fëmijë është birësuar, midis tij dhe birësuesve krijohen marrëdhënie të njëjta si ato ndërmjet prindit dhe fëmijës. Të drejtat dhe detyrat ndërmjet të birësuarit dhe të paslindurve të tij, nga njëra anë, dhe gjinisë së tij nga ana tjetër pushojnë.

Në regjistrat e gjendjes civile ruhet dhe regjistrimi i bërë para birësimit. Për të ruajtur prejardhjen e vërtetë të fëmijës së birësuar, nëpunësi i gjendjes civile nuk bën asnjë shuarje në gjeneralitetet e mëparshme, që ka fëmija i birësuar në aktin e lindjes. Ai, në bazë të vendimit të gjykatës për birësimin, bën shënimet përkatëse në shtyllën e veçantë të shënimeve të aktit të regjistruar të lindjes së të birësuarit. Nëpunësi i gjendjes civile, të dhënat lidhur me origjinën e fëmijës mund t'i japë vetëm kur këto kërkohen nga gjykata ose nga organi i prokurorisë sipas kërkesave të ligjit në këto raste.

Praktika ka treguar se është akoma më e vështirë për fëmijët e strehuar në shtëpitë e fëmijës dhe që nuk i njohin prindërit e tyre. Presupozohet që nëna dihet se kush është, me përjashtim të fëmijës së gjetur, megjithatë është tepër e vështirë të sigurohet ky informacion në shtëpitë e fëmijës. Pakujdesia që ndiqet në disa raste në maternitete, lidhur me regjistrimin e identitetit real të nënës, përbën shpesh herë cenim të të drejtës së fëmijës për të njohur njërin nga prindërit, sepse parregullsitë në regjistrim i mohojnë shpesh herë fëmijës mundësinë për të njohur të paktën nënën e tij.

Një tendencë tjetër, mjaft e diskutueshme në ditët e sotme, është dhe futja e metodave të riprodhimit artificial. Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 “Për shëndetin riprodhues” parashikon, ndërmjet të tjerash, dhe futjen, për herë të parë në Shqipëri, të teknikave të reja të riprodhimit artificial. Ligji parashikon inseminimin artificial dhe lindjen eksperimentale “*In vitro*”. Me këtë ligj merren në konsideratë dëshirat e prindërve për të zgjedhur metodat e riprodhimit.

Megjithatë problemet, në rastet e fekondimit artificial janë të shumta në raport me fekondimin natyral, duke krijuar situata të ndryshme në disfavor të interesave të fëmijëve, si p.sh lindja e fëmijës në mungesë të prindit ligjor, i cili ekziston fizikisht në momentin e lindjes së fëmijës, por që ligji nuk i njeh as titullin dhe as të drejtat dhe detyrimet e një babai, ekzistenca e dy nënave (njëra nga të cilat mban vezët e tjetrës dhe shërben si nënë surrogato), në rastin kur dy gra kanë kontribuar në lindjen e fëmijës. Njëra është nëna gjenetike, ndërsa tjetra nëna mbajtëse. Ligji, në këtë rast, parashikon hartimin e një kontrate noteriale midis çiftit dhe nënës mbajtëse, e cila me lindjen gjallë të fëmijës duhet t'ia dorëzojë çiftit.

1.5 Ruajtja e identitetit

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe në ligje të veçanta (neni 8 i ligjit nr. 18/2017) parashikohet e drejta e personit (ku bën pjesë edhe i mituri) për të ruajtur identitetin në elementë të veçantë të tij, siç janë shtetësia, lidhjet familjare, gjuha, kultura etj. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjisllacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.

Identitetin kombëtar, ka një kuptim më të gjerë se identiteti i personit. Gjithashtu, në Kushtetutë, kur bëhet fjalë për parimet e përgjithshme të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, parashikohet detyrimi i organeve të pushtetit publik të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Kufizime të këtyre të drejtave mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

Kushtetuta, gjithashtu respekton dhe ruajtjen e identitetit nga pakicat kombëtare, të cilët kanë të drejtë të shprehin dhe të ruajnë përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. E drejta për të ruajtur emrin dhe mbiemrin si dhe vendbanimin e tij (neni 5 dhe 12 i Kodit Civil). Në këtë Kod parashikohet gjithashtu e drejta e personit fizik për të gëzuar të drejtat civile, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj. Përsa i përket ruajtjes së shtetësisë, si në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” garantohet ruajtja e shtetësisë shqiptare e fituar sipas ligjit.

1.6 Mbrojtja e fëmijëve në transmetimet e mass-medias

Neni 22 i Kushtetutës garanton lirinë e informacionit, të shprehjes dhe lirinë e shtypit, gjithashtu garanton lirinë e radiotelevizionit. Nenet 56, 57, 58 të Kushtetutës, të cilat flasin për të drejtat social-kulturore, sanksionojnë të drejtën e kujtudo për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të drejtën e arsimit, lirinë e krijimit artistik dhe kërkimit shkencor. Ligji nr. 8410 datë 30.09.1998 “Për radio televizionin publik e privat”, shprehet në mënyrë të përgjithshme për respektimin e të drejtave të të miturve.

Edhe ligji nr. 8503 i vitit 1999 “Për të drejtat e informimit për dokumentat zyrtare” edhe pse nuk ka dispozitë të veçantë ku të flitet për fëmijët, në nenin 2 të tij, bën fjalë se të drejtën për këtë informim e kanë personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj. Duke qenë se fëmijët futen në kategorinë e personave fizikë rrjedh se ata kanë të drejtën e informimit. Sidoqoftë, ndihet një mungesë e akteve ligjore të cilat parashikojnë mënyrat dhe rrugët sesi mund të realizohet kjo e drejtë për fëmijët, që është shumë më tepër specifike sesa tek të rriturit.

Ligji nr. 8096 “Për kinematografinë” parashikon shfaqjen e filmave në mënyrë të diferencuar sipas moshave të fëmijëve, dhe ndalimin e shfaqjes së filmave për fëmijët nga 14-18 vjeç apo nën 14 vjeç në orë të caktuara. Ligji ndalon shfaqjen e reklamave, të cilat mund të ndikojnë në dëmtimin e shëndetit të fëmijëve, shfaqjen e reklameve me pije alkoolike në duart e fëmijëve apo që të përdoren nga fëmijët.

Ligji kryesisht ka parashikuar ndalimin e shfaqjes së programeve të caktuara për fëmijë, por jo llojin e programeve që duhet të transmetojë për t'i siguruar fëmijës informacionin dhe materialet e nevojshme që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor. Në vazhdim të kësaj ideje, ligji parashikon një dispozitë të veçantë për mbrojtjen e të miturve, sipas së cilës nuk lejohet të jepen në radio e televizion reklama që nxisin sjellje, të cilat rrezikojnë shëndetin dhe zhvillimin normal psikik të fëmijëve.

Programet e TV lidhur me fëmijët kanë si synim të transmetojnë emisione me karakter edukativ, arsimor, kulturor, argëtues, për forcimin e traditës kombëtare, mbrojtjes së gjuhës etnike që respekton edhe të drejtat e fëmijëve të minoriteteve. Me ligjin nr. 8525, datë 09.09.1999, Shqipëria ka ratifikuar Konventën Evropiane për Televizionin Ndërkufitar. Sipas Konventës, liria e shprehjes dhe e informimit, e parashikuar dhe në nenin 10 të KEDNJ-së, përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për zhvillimin e çdo qenieje njerëzore.

Konventa shprehet në mënyrë të veçantë për ta, për kufijtë e transmetimit të programeve dhe të reklamave duke parashikuar dispozita kufizuese në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Kështu, sipas Konventës²⁰³, të gjitha shërbimet programore, të cilat kanë gjasa të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve dhe adoleshentëve, nuk do të vihen në program kur për shkak të kohës së transmetimit dhe të marrjes, ka gjasa që ata t'i shohin ato.

Përsa i përket transmetimit të emisioneve ose programeve për fëmijët, që i përkasin një grupi etnik, ligji parashikon shfaqjen e programeve në gjuhën e pakicave kombëtare që ndodhen në Shqipëri, respektimin e gjuhës dhe kulturës së tyre dhe dhënien e informacioneve të veçanta për ta.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, krahas monitorimit të vazhdueshëm dhe të pandërprerë të të gjithë programeve si në radio dhe në televizion, ka vënë në dispozicion të publikut të gjerë një linjë telefoni, faksi dhe e-mail, ku personat fizikë mund të denoncojnë, shpërdorimin e dhunës, pornografinë, ose cenimin e dinjitetit në mediat e ndryshme elektronike.

1.7 Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

Në Kushtetutë parashikohet se shteti është asnjans në çështjet e besimit dhe të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike (neni 10). Gjithashtu, në Kushtetutë parashikohet se liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohe të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij²⁰⁴. Pra, Kushtetuta këtë të drejtë ia njeh gjithsecilit, duke mos përjashtuar dhe kategorinë e fëmijëve.

Kjo i drejtë i garantohet fëmijës edhe nga neni 15 i ligjit nr. 18/2017, sipas të cilit:

1. Fëmijës i garantohet liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.
2. Prindi ose kujdestari i fëmijës e drejton atë në ushtrimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, në zgjedhjen e një besimi fetar, pasi ka marrë në konsideratë mendimin e tij dhe pa ushtruar forcë në zgjedhjen e fëmijës, në përputhje me zhvillimin e aftësitë e tij.

²⁰³ Neni 7.

²⁰⁴ Neni 24 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

3. Nëse fëmija ndodhet në kushtet e mbrojtjes, personat që janë ligjërisht përgjegjës për të ndalohen të marrin masa të tilla, që ndikojnë në besimin fetar të fëmijës

Ligji nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar*”, meqenëse arsimi publik është laik, nuk lejon propagandën fetare të cilitdo besim qoftë. Në Shqipëri çështja e besimi fetar nuk ka paraqitur probleme edhe për faktin se për më shumë se 20 vjet me radhë besimi fetar ishte i ndaluar. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 28.05.1999, janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për funksionimin e institucioneve arsimore jopublike dhe të institucioneve arsimore plotësuese jopublike, në të cilat zhvillohen lëndë fetare.

Vendimi parashikon se subjekti privat, që do të funksionojë si institucion arsimor jopublik, ku do të zhvillohen lëndë fetare, midis të tjerave duhet të paraqesë edhe një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të respektojë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Vendimi nuk shprehet nëse duhet të merret pëlqimi i fëmijës që regjistrohet në këtë shkollë, ndërsa shprehet për pjesëmarrjen fakultative të fëmijëve në veprimtaritë jashtë procesit mësimor, ku miratimi i prindit, kujdestarit apo i vetë nxënësit është përcaktues. Vendimi nuk parashikon se për cilën moshë është përcaktues mendimi i prindit.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 459, datë 23.09.1999 është krijuar Komiteti Shtetëror për Kultet, i cili i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës mendimin e tij lidhur me planin mësimor, programet lëndore dhe tekstet e pjesës jolaikë për kërkesat e paraqitura për hapjen e institucioneve arsimore jopublike ku zhvillohen lëndë fetare.

Në Kodin e Familjes janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ose kujdestari i tij në drejtimin dhe edukimin e fëmijës. Në këtë Kod nuk parashikohet asgjë e veçantë për t’a drejtuar fëmijën në ushtrimin e të drejtës së besimit fetar, pra mund të konkludohet se fëmija është i lirë në zgjedhjen e besimit fetar, ndërgjegjës etj.

1.8 Liria e organizimit dhe mbledhjes paqësore

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë parashikohet e drejta e kujtudo të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.

Në Kodin Civil parashikohet e drejta e fëmijëve, që kanë mbushur moshën 14 vjeç, të bëjnë pjesë në organizata shoqërore²⁰⁵. Edhe ligji “Për organizatat jofitimprurëse” në nenin 3 kur flet për subjektet e ligjit shprehet se, çdokush ka të drejtën e organizimit kolektiv dhe në nenin 4 shprehet se çdo person fizik ose juridik vendas apo i huaj ka të drejtën e themelimit dhe të pjesëmarrjes në organizatat jofitimprurëse.

Gjithashtu, Kodi Civil trajton dhe procedurën e krijimit të shoqatave ku nuk përcaktohet moshë e themeluesve dhe anëtarëve, gjë që të lë të kuptosh që edhe fëmijët kanë të drejtën e tyre të organizohen në shoqata që i përshtaten interesave të tyre. Pra, nuk ka asnjë kufizim në këtë të drejtë.

²⁰⁵ Neni 7 i Kodit Civil.

Këtë të drejtë fëmijës ia njeh edhe neni 16 i ligjit nr. 18/2017, duke parashikuar se, mosrespektimi i saj përbën kundërvajtje administrative, e ndëshkueshme me gjobë, sipas përcaktimeve të vendosura në nenin 69 të të njëjtit ligj.

1.9. Mbrojtja e jetës private

Kushtetuta ka përcaktuar fshehtësinë e korrespondencës dhe paprekshmërinë e banesës për cilindo, pa përcaktuar në mënyrë të veçantë kategorinë e fëmijëve, por dhe pa e përfshirë atë. Pra, përcaktimet kushtetuese vlejnë edhe për të miturit. Sipas Kushtetutës, janë të garantuara liria dhe fshehtësia e korrespondencës (neni 36).

Edhe ligji nr. 18/2017 e ka parashikuar lirinë për jetë private të fëmijëve (neni 17), duke përcaktuar se, kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.

Ndërkohë, pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 14 vjeç në debate publike, si dhe në programe audiovizive bëhet vetëm me miratimin e prindit ose kujdestarit të fëmijës. Përfaqësuesve ligjorë të fëmijëve u ndalohet të përdorin apo të ekspozojnë fëmijët për qëllime të përfitimit personal apo për të ndikuar vendimet e autoriteteve publike.

Njëherësh, transmetuesit audiovizivë mbajnë përgjegjësi për rastet e mosrespektimit të lirive dhe të drejtave të fëmijës gjatë transmetimit të programeve të tyre, në përputhje me këtë ligj, si dhe me legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.

Gjithashtu, Kushtetuta garanton paprekshmërinë e banesës. Kontrollat e banesës mund të bëhen vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Dhunimi i banesës, ndërhyrja e padrejtë në jetën private, ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës përbëjnë vepër penale dhe dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

Konkretisht, sipas Kodit Penal dhunimi i banesës dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 muaj, ndërhyrja e padrejtë në jetën private përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet, pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

1.10 Administrimi i drejtësisë për fëmijët

Në Kushtetutën shqiptare parashikohet se çdo person, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij. Në bazë të legjislacionit shqiptar, të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon. Gjatë fazës së gjyqimit, sipas moshës të të miturit, gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Statusi i posaçëm i të miturve sipas Kodit Penal nuk përcaktohet thjesht nga kufizimi në moshën e përgjegjësisë penale, duke përcaktuar moshën 14 vjeç kur kemi të bëjmë me një vepër penale të rëndë (kryerje krimi) dhe moshën 16 vjeç për një

kundërvajtje. Kodi i Procedurës Penale, përcakton një sërë garancish për mbrojtjen e të miturve dhe personalitetit të tyre dhe konkretisht: Pyetja e të miturve në seancë me dyer të mbyllura; E drejta e përfaqësuesit ligjor të të miturit për të mbrojtur interesat e tij me cilësinë e të dëmtuarit akuzues; Mbrojtja e detyrueshme profesionale për të miturin nën 18 vjeç.

Ndalimi i publikimit të gjeneraliteteve dhe fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale. Mosarrestimi për një vepër penale e cila parashikohet si kundërvajtje penale. Këto garanci plotësojnë kuadrin ligjor procedural në procesin penal, dhe u japin të miturve mjete të nevojshme mbrojtëse që u takojnë për shkak të moshës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas të drejtës ndërkombëtare²⁰⁶.

Gjithashtu, në Kodin Penal parashikohet se askush nuk mund të dënohet për një vepër, që sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte vepër penale. Kushtetuta parashikon të drejtën e kujtdo që gjatë procesit penal t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, ekspertëve, dhe personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet. Kushtetuta shqiptare parashikon se cilido ka të drejtë të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij. Cilido ka të drejtë të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet.

Përsa i përket ndihmës juridike që duhet t'i sigurohet të miturit, në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar se të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon. Ndërsa, në Kodin e Procedurës Penale përcaktohet, se kur i pandehuri është nën moshën 18 vjeç, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme.

Kodi i Procedurës Penale parashikon një sërë rregullash që i referohen në radhë të parë aktorëve të procesit dhe rregullave që përcaktojnë marrëdhëniet midis tyre dhe në çdo rast, në dispozita të ndryshme, Kodi ndalet posaçërisht për të miturit. Kështu në nenin 35 të tij të miturit gëzojnë ndihmë të posaçme juridike dhe psikologjike në çdo shkallë të procedimit, në prani të prindit apo personave të kërkuar nga vetë i mituri.

Kodi parashikon dispozita përsa i përket kujdesit që duhet bërë nga organi procedues në lidhje me përcaktimin e saktë të moshës dhe personalitetit të të miturit. Këtë e parashikon neni 41 i Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu neni 42 i tij shpreh qartë se organi procedues duhet të marrë të dhëna për kushtet e jetës personale, familjare dhe shoqërore të të pandehurit të mitur me qëllim sqarimin e përgjegjshmërisë dhe shkallën e përgjegjësisë, vlerësimin e rëndësisë shoqërore të faktit për të caktuar masën e përshtatshme të dënimit penal.

²⁰⁶Neni 29 i Kushtetutës.

Vendimi nr. 30, datë 28.01.1999, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke i'u referuar nenit 40/b(iii) të Konventës, pranoi mbrojtjen e vendosur për të miturit në të gjitha fazat e gjyqimit pavarësisht nëse është në mungesë, ose jo. Po këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese. Referimi në Konventë u bë duke u mbështetur në nenin 122 të Kushtetutës shqiptare, sipas të cilës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

Kushtetuta shqiptare parashikon se askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së tij dhe as të pohojë fajësinë e tij (neni 32), kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë (neni 43). Edhe Kodi i Procedurës Penale parashikon ankimin dhe rekursin në instancat më të larta gjyqësore, sipas çështjes konkrete. Konform nenit 40/2(b) të Konventës, Kushtetuta e Shqipërisë parashikon ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur fëmija nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe²⁰⁷.

Kodi i Procedurës Penale e saktëson më tepër ndihmën që duhet të japë një përkthyes, duke ndihmuar të pandehurin e mitur të kuptojë akuzën dhe të ndjekë veprimet që kryhen gjatë procesit penal. Për të respektuar jetën private të fëmijës, në të gjitha fazat e procedurës, përveç sa parashikohet në Kushtetutë, Kodi i Procedurës Penale ndalon publikimin e gjeneraliteteve dhe fotografive të të pandehurit të mitur, të akuzuar për veprën penale për të cilën dyshohet. Gjithashtu, Kodi i Procedurës Penale përcakton dhe rregullat se në ç'raste mund të bëhet kontrolli i banesës dhe përgjimi i bisedimeve ose komunikimeve.

Kodi i Procedurës Civile i miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, ka parashikuar krijimin pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të seksioneve të veçanta për gjykimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me të miturit dhe familjen (nenet 320, 349, 368). Kjo ka bërë të mundur që problemet me të miturit të trajtohen në mënyrë më të specializuar. Kjo dispozitë parashikon se kur disa nga procedimet e lidhura ndërmjet tyre i përkasin kompetencës së gjykatës së zakonshme dhe të tjerat gjykatës që shqyrton çështjen me të mitur, kompetente për të gjitha procedimet është kjo e fundit.

Konform nenit 40/3(a) të Konventës, për përcaktimin e moshës minimale për përgjegjësi penale të fëmijës, Kodi Penal parashikon se përgjegjësi penale ka personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën 14 vjeç, ndërsa kur kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën 16 vjeç (neni 12). Përsa i përket paragrafit të tretë, germa "b" e nenit 40 të Konventës, në ligjin nr. 8465, datë 11.03.1999 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve" është parashikuar zgjidhja e kundërvajtjeve penale pa iu drejtuar procedurës gjyqësore. Ligji nuk shprehet në mënyrë të veçantë për të miturit, por i përfshin ata në kategorinë e personave që kanë kryer një kundërvajtje penale pavarësisht nga mosha. Një nga masat e parashikuara në këtë paragraf është edhe zgjidhja e konfliktit të krijuar për shkak të kundërvajtjes penale të kryer nga i mituri pa iu drejtuar procedurës gjyqësore.

²⁰⁷ Neni 31 i Kushtetutës.

Një rëndësi të madhe ka dhe njohja e të drejtave të parashikuara Konventë nga fëmijët dhe të rriturit, ku të parët duhet të njohin për t'i kërkuar ato dhe të dytët duhet t'i njohin për t'u krijuar kushte fëmijëve t'i bëjnë ato realitet. Edukimi i fëmijëve me të drejtat e tyre aktualisht ka hyrë në programet mësimore në shkollë, por një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe OJQ-të që merren me të drejtat e njeriut përfshi dhe të drejtat e fëmijëve.

E drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi administrativ ose gjyqësor, parashikohet edhe në nenin 29 të ligjit nr. 18/2017. Sipas kësaj dispozite, fëmijës, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij. Kjo ndihmë i ofrohet fëmijës drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës.

Ndihma juridike përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse, gjatë të gjithë procesit administrativ ose gjyqësor. Ndërsa, ndihma psikologjike përfshin të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike.

2. Përfaqësimi i të miturve

Në legjislacionin shqiptar në marrëdhëniet e fëmijës me prindërit dhe familjen ose që kanë të bëjnë me edukimin e fëmijës etj, prioritet i jepet të drejtave dhe detyrimeve që kanë prindërit, familja ose përfaqësuesit e tyre ligjor. E drejta e fëmijës për të pasur kujdesin e prindërve është përcaktuar në Kodin e Familjes. Prindërit e përfaqësojnë vetë fëmijën e tyre të mitur, që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, në të gjitha veprimet juridike, me përjashtim të atyre që sipas ligjit, i mituri mund t'i kryejë vetë. Gjithashtu, në Kodin e Familjes dhe në ligje të veçanta parashikohet detyrimi dhe e drejta e prindërve për t'u kujdesur për ushqimin e fëmijës, arsimimin e tij etj.

Në rastet e vendosjes së kujdestarisë, Kodi i Familjes parashikon detyrimin e gjykatës që të vendosë mbi bazën e cilësive të personit të zgjedhur për të edukuar dhe arsimuar të miturin sipas kërkesave të parashikuara në Kodin e Familjes. Po në kuadrin e përgjegjësive prindërore, një rol të madh luan shkolla, e cila ka një bashkëpunim të gjerë me komunitetin, veçanërisht me prindërit e fëmijëve. Kështu, prindërit marrin pjesë aktivisht në bordet e shkollës dhe aktivizohen për organizimin dhe mbarëvajtjen e saj si dhe informohen rregullisht nga mësuesit për ecurinë e fëmijëve në shkollë, për problemet që ata kanë dhe për mënyrat se si mund të rrisin kujdesin dhe kontrollin ndaj fëmijëve.

Braktisja e fëmijës parashikohet si vepër penale në Kodin Penal, Seksioni IX, Neni 124 "Braktisja e fëmijëve të mitur". Me anën e këtij neni parashikohet se braktisja e fëmijëve nën 14 vjeç nga prindi ose personi që e ka fëmijën nën kujdestari dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet. Kur braktisja ka rezultuar me dëmtim të rëndë të shëndetit, ose vdekje, sanksioni është dënim me burg nga tre deri në dhjetë vjet.

2.1. Përfaqësimi nga prindërit si pasojë e përgjegjësive prindërore

Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.

Ushtrimi i përgjegjësisë së prindërve ndaj fëmijëve shihet në tre këndvështrime:

- a) Kur përgjegjësia e prindërve ushtrohet gjatë martesës;
- b) Kur kjo përgjegjësi ushtrohet pas zgjidhjes së martesës;
- c) Kur prindërit biologjike nuk janë të martuar sipas kërkesave të ligjit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nga ana e saj nuk parashikon asnjë dispozitë të veçantë për përgjegjësinë e prindërve ndaj fëmijëve të tyre, por kjo fushë rregullohet me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, si Kodi i Familjes, Dekrete të ndryshme etj. Në Kodin e Familjes parashikohet se prindërit përgjigjen për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Përgjegjësia e përbashkët e prindërve për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës realizohet nëpërmjet ushtrimit të të drejtës prindërore. Kodi i Familjes, parashikon që prindërit kanë të njëjtat të drejta dhe detyra ndaj fëmijëve të tyre të mitur²⁰⁸. Gjithashtu, legjislacioni i familjes nuk i njeh asnjë përparësi ndonjërit prej prindërve në lidhje me të drejtën prindërore dhe ushtrimi i saj është në funksion të interesit të fëmijës. Ky kod parashikon se e drejta prindërore ushtrohet vetëm në interes të fëmijëve të mitur dhe me marrëveshje ndërmjet dy prindërve.

Në rastet kur prindërit, për arsye të ndryshme, nuk mund t'a mbajnë fëmijën e tyre, ata mund t'ia lënë për rritje dhe edukim vetëm një personi, i cili duhet të ketë cilësinë e kujdestarit, sipas kërkesave të ligjit. Prindërit i mbrojnë të gjitha të drejtat vetjake dhe pasurore të fëmijëve të tyre, pa qenë e nevojshme një emërim i posaçëm. Kjo bën pjesë në tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë prindërit për fëmijët e tyre. Prindërit, në mënyrë të përbashkët, përgjigjen për arsimimin, zhvillimin fizik e mendor, për shëndetin dhe detyrimin për ushqim të fëmijëve të tyre.

Në rastin kur prindërit zgjidhin martesën ose martesë është e pavlefshme, e drejta prindërore ushtrohet nga prindi që i është besuar fëmija për rritje dhe edukim. Megjithatë Prindi tjetër vazhdon t'a gëzojë të drejtën prindërore, por mënyra e ushtrimit të saj përcaktohet në vendimin e gjykatës për zgjidhjen e martesës.

Në rastin kur prindërit biologjikë nuk janë martuar, por e kanë njohur fëmijën si të tyre, kanë të njëjtat përgjegjësi si dhe prindërit që kanë lindur fëmijën e tyre nga një martesë e ligjshme. Shqipëria ka ratifikuar Konventën mbi Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave, ku parashikohet se prindërit kanë të drejta dhe detyra të barabarta ndaj fëmijëve të tyre. Interesi i fëmijës do të jetë konsiderata parësore në të gjitha rastet.

Përveç, përgjegjësisë që kanë prindërit për edukimin dhe zhvillimin, ata përgjigjen edhe për sjelljet anti-sociale të fëmijëve të tyre. Me Dekretin nr. 2450, datë 27.05.1957 "Për përgjegjësinë e prindërve për sjellje të këqija të fëmijëve dhe mbi masat

²⁰⁸ Neni 63 i Kodit të Familjes.

për edukimin e tyre”, ndryshuar me Dekretin nr. 7441, datë 1.12.1990, parashikohet dënimi i prindërve për sjellje të këqija dhe për rrugaçeri të fëmijëve të tyre të mitur, që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç. Dënimet në bazë të këtij Dekreti për kundërvajtje administrative përfshijnë gjoba deri në 500 lekë. Por, megjithëse ky Dekret është ende në fuqi, në praktikë ai nuk gjen më zbatim, kjo dhe për shkak të ndryshimit të kushteve që kërkojnë përdorimin e metodave të reja në edukimin e fëmijëve nën moshën 14 vjeç.

Sipas nenit 216 të Kodit të Familjes, “*Fëmija ndodhet nën përgjegjësinë prindërore deri në arritjen e moshës madhore*”. Megjithëse titulli i kësaj dispozite, kufijtë e përgjegjësisë prindërore evokon idenë e prerogativave të ushtrimit të përgjegjësisë apo tagrave të saj, nga përmbajtja e tij rezulton se bëhet fjalë vetëm për kufijtë kohorë gjatë së cilës mund dhe duhet të ushtrohet përgjegjësia prindërore²⁰⁹.

Duke qenë se çdo detyrimi prindëror i korrespondojnë të drejtat e fëmijëve, duhet të trajtojmë se cili është momenti kur i mituri konsiderohet se ka zotësi juridike, pra gëzon aftësinë për të pasur të drejta dhe detyrime civile. Sipas nenit 1 të Kodit Civil “*Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të patur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me lig*”. Zotësia juridike është një cilësi e pandarë e personit²¹⁰.

Në këtë mënyrë përgjegjësia prindërore fillon që në momentin kur *fëmija lind i gjallë*. Zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë sipas nenit 2 të Kodit Civil. Zotësinë juridike e fiton edhe fëmija që nga koha e zënies por kur lind gjallë. Si rezultat, data e lindjes është data e fillimit të zotësisë juridike të personit fizik ose “njeriu është subjekt i së drejtës që nga momenti kur lind”. Ky rregull është ndjekur në të gjitha kohërat (e drejta romake, e drejta e vjetër shqiptare dhe në Kodin Civil Shqiptar). Që të konsiderohet i gjallë duhet që fëmija të paktën të ketë marrë frymë një herë, fakt i cili mund të vërtetohet nëpërmjet prezencës të ajrit në mushkërinë e fëmijës.

Në lidhje më marrëdhënien prindërore që krijohet si rezultat i birësimit të një fëmije të mitur përgjegjësia prindërore fillon nga momenti që vendimi i gjykatës që vendos këtë lidhje merr formë të prerë, dhe jo nga momenti i lindjes së fëmijës. Sipas nenit 249 të Kodit të Familjes, rasti përjashtimor i fillimit të efekteve të marrëdhënies ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit është i kushtëzuar nga fakti i pranimit të këtij birësimi nga gjykata. Me fjalë të tjera, në rast se birësuesi vdes pasi ka dhënë pëlqimin për birësim procedurat e birësimit do të vazhdojnë, dhe në rast se ky proces finalizohet me pranimin e tij nga gjykata, pasojat e saj do të fillojnë në mënyrë prapavepruese që nga çasti i dhënies së pëlqimit nga birësuesi.

Është e kuptueshme që, megjithëse flasim teorikisht për fillim të përgjegjësisë prindërore që nga çasti i dhënies së pëlqimit për birësim nga de cuius, me një hipotezë të tillë, ligjvënësi ka synuar, mbi të gjitha mbrojtjen e interesave pasurore të fëmijës së birësuar, i cili, në këtë mënyrë mund të përfitojë të drejtën e trashëgimisë dhe cilësinë e trashëgimitarit të radhës së parë, të birësuesit, edhe pse trashëgimia do të çelet më parë se vendimi i gjykatës i cili pranon birësimin të marrë formën e prerë²¹¹.

²⁰⁹ Omari, Sonila, *E Drejta Familjare*, Tiranë, 2007, f. 461.

²¹⁰ Nuni, Ardian; op. cit., f. 114.

²¹¹ Omari, Sonila; op. cit. f. 463.

Sipas nenit 216 të Kodit të Familjes përcaktohet si moment përfundimtar i ushtrimit të përgjegjësisë prindërore arritja e moshës madhore të fëmijës. Nocioni i saktë juridik që i përgjigjet kuptimit të përfundimit të përgjegjësisë prindërore është fitimi i zotësisë së plotë për të vepruar nga subjekti në interes të të cilit ushtrohet kjo përgjegjësi.

Përgjegjësia prindërore përfundon në rastet e mëposhtme:

- a) Arritja e moshës tetëmbëdhjetë vjeç, pra në një farë mënyre me fitimin e zotësisë së plotë për të vepruar;
- b) Përgjegjësia prindërore përfundon përpara arritjes së moshës madhore, në rastet kur fëmija lidh martesë përpara se të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç;
- c) Përgjegjësia prindërore përfundon pas arritjes së moshës madhore, për fëmijët madhorë që ndjekin studimet deri në moshën 25 vjeç;
- d) Në rastin e birësimit të fëmijës së mitur përgjegjësia prindërore në ngarkim të prindërve biologjik përfundon më parë se fëmija të arrijë moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Sipas Kodit Penal një nga dënimet plotësuese është edhe humbja e përgjegjësisë prindërore. Sigurisht që ky lloj dënimi mund të konsiderohet si një dënim civil. Sipas Kodit të Familjes prindërit e fëmijës mund të humbasin përgjegjësinë prindërore nëpërmjet një vendimi penal që i ka dënuar ata si autorë ose si bashkëpunëtorë për një vepër penale ndaj fëmijës së tyre, si bashkëpunëtorë në një vepër penale të kryer nga fëmija i tyre ose nëse janë dënuar për ndonjë nga shkaqet e braktisjes së familjes, për sa kohë që ata nuk kanë marrë përsipër detyrimet që kanë ndaj saj²¹². Në çdo rast përgjegjësia prindërore mund të kthehet me vendim të gjykatës, kur pushon shkaku për të cilin është hequr kjo përgjegjësi. Në këtë mënyrë është vetë gjykata e cila u jep prindërve përsëri të drejtat për mirëritje, edukim dhe arsimimin e fëmijës.

Humbja e përgjegjësisë prindërore është një formë mikse dënimi i cili përmban të drejtën e familjes dhe të drejtën civile. Në këtë kontekst, për të drejtën civile ky lloj dënimi do të thotë që: a) prindërit nuk mund të përfaqësojnë fëmijën e tyre të mitur që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç në të gjitha veprimet juridike, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, i mituri mund t'i kryejë vetë; b) prindërit nuk kanë të drejtën që të asistojnë fëmijët e tyre nga mosha 14 deri 18 vjeç në kryerjen e veprimeve juridike.

Në qoftë se prindërit e fëmijës kanë vdekur, janë në pamundësi të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës ose për arsye veçanërisht të rënda, fëmija mund t'i besohet një anëtarit të familjes, një personi të caktuar si kujdestar, një familjeje kujdestare ose edhe një institucioni të përkujdesjes. Në këtë rast, merret mendimi i sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale, sipas dispozitave për kujdestarinë. Në qoftë se njëri nga prindërit është para pamundësisë së ushtrimit të

²¹²Neni 223 i Kodit të Familjes.

përgjegjësia prindërore ose kur njëri nga prindërit ka vdekur, përgjegjësia prindërore ushtrohet nga prindi tjetër.

2.2. Përfaqësimi i fëmijëve të privuar nga mjedisi familjar

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë garantohet përkujdesja dhe ndihma e shtetit për jetimët²¹³. Gjithashtu, Kushtetuta parashikon mbrojtjen e veçantë të fëmijëve nga shteti duke u shprehur në mënyrë të përgjithshme. Ndërsa, në Kodin e Familjes parashikohet detyrimi i shtetit për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të mbetur pa prindër dhe pa përkrahje.

Në Kodin e Familjes parashikohet e drejta e njësisë përkatëse të pushtetit vendor t'i drejtohet gjykatës dhe t'i kërkojë që të vendosë heqjen e fëmijës nga prindërit në rastet kur prindërit nuk kujdesen për rritjen dhe edukimin e fëmijëve ose kur këtë e kërkon interesi i fëmijës, dhe t'ia besojë për rritje dhe edukim një institucioni shtetëror ose një personi tjetër kur ky i fundit e pranon. Në këto raste nuk pushojnë të drejtat dhe detyrimet e tjera që u takojnë prindërve kundrejt fëmijës.

Në Kodin e Familjes parashikohen edhe rastet kur fëmijët nuk janë nën kujdesin e prindërve:

- a) kur të dy prindërit kanë vdekur;
- b) kur prindërit nuk njihen;
- c) kur prindërit janë shpallur si të pagjetur apo të vdekur;
- d) kur prindërve iu është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar.

Këta fëmijë vihen në kujdestari, e cila duhet t'u sigurojë atyre kushte të përshtatshme për rritjen, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e gjithanshëm të tyre, si dhe personi i caktuar si kujdestar i tyre, do t'i përfaqësojë ata në veprimet juridike që ata kryejnë, deri në mbushjen e moshës 14 vjeç, si dhe do të japë pëlqimin për të tilla veprime të kryera nga i mituri përgjatë periudhës kohore 14-18 vjeç.

Ligji nr. 7710, datë 18.05.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", me ndryshimet përkatëse, përcakton mënyrën e vendosjes në institucione të përkujdesit shoqëror të fëmijëve jetimë. Këto institucione, sipas ligjit mund të jenë në nivel lokal apo qendror.

Ligji nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", konsideron si jetimë personat nga 0-25 vjeç:

- të lindur jashtë martese;
- që nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit;
- që me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr e drejta prindërore të dy prindërve ose njërit prej tyre dhe tjetri nuk jeton;
- që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre.

²¹³ Neni 59/e.

Fëmijët jetimë mbahen në institucion deri në moshën 14 vjeç dhe në rast se nuk kanë mbaruar arsimin 8 vjeçar deri në moshën 17 vjeç. Për ata që mbarojnë shkollën e mesme ose të lartë dhe që jetojnë në konvikt, shpenzimet e ushqimit përballohen nga Seksionet e Ndihmës dhe të Përkujdesit Shoqëror pranë organeve të pushtetit vendor, deri në zënien e tyre me punë. Gjithashtu atyre u sigurohet shërbimi shëndetësor falas deri në fillimin e marrëdhënieve të punës.

Ligji parashikon një sërë lehtësirash në mundësitë për të gjetur punë, për strehim, në emigracionin e organizuar nga shteti, apo për argëtim. Në Shtëpitë e Fëmijës dhe të Foshnjës pranohen fëmijë nga mosha 0-6 vjeç dhe fëmijë të moshës 6-14vjeç. Lidhur me kriteret e vendosjes së fëmijëve në kujdestari nga ana e shtetit në institucione ndiqet një procedurë e caktuar ligjore e përcaktuar në VKM nr. 510 datë 24.11.1997, *“Për kriteret e vendosjes në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranim”* .

Sipas Kodit të Procedurës Civile kërkesa për vendosjen e kujdestarisë i paraqitet gjykatës nga të afërmit e fëmijës së mitur dhe nga cilido që merr njoftimin për mbetjen e fëmijës pa prindër, për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur dhe për çdo rrethanë tjetër që ligji kërkon vendosjen e kujdestarisë (neni 351).

3.1 Fëmijët e paaftë

Fëmijët me paaftësi mendore e fizike në Shqipëri deri në vitet 90-të trajtoheshin nga Ministria e Shëndetësisë dhe për pasojë kujdesin kryesor, institucionet përkatëse, e përqendronin në shëndetin e fëmijëve. Duke patur parasysh kushtet e reja në të cilat hyri Shqipëria mbas viteve 90-të, lindi domosdoshmëria e ndryshimit të trajtimit të kësaj kategorie fëmijësh dhe theksi u vu kryesisht në integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare.

E drejta shqiptare merr në konsideratë objektivat e Konventës për këtë kategori fëmijësh. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, kur trajton objektivat sociale, parashikon përgjegjësinë dhe synimin e shtetit që brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon të kujdeset për riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës.

Sipas Kushtetutës, përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohej drejtpërdrejtë në gjykatë. Kushtet dhe masa e realizimit të këtyre objektivave përcaktohen me ligje të veçanta. Ligji nr. 44/2012 *“Për shëndetin mendor”*, parashikon politikat parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor si dhe institucionet që i realizojnë ato. Këto institucione ndahen në institucione për personat me prapambetje mendore, të cilët merren me rehabilitimin, edukimin dhe kujdesin për këtë kategori personash ku hyjnë dhe fëmijët në institucionet psikiatrike dhe rehabilituese, si spitalet dhe shtëpitë e kurimit (neni 4).

Fëmijët me zhvillim mendor të vonuar dhe ata me çrregullime mendore trajtohen falas në institucionet publike të kurimit, rehabilitimit arsimimit dhe edukimit. Në dispozitat që parashikojnë lidhjet e personit me familjen, vendosjen e kujdestarit nga gjykata me kërkesë të komisionit psikiatriko - ligjor dhe mënyrën e trajtimit të tyre, nuk bëhet diferencim për fëmijën. Por, në një dispozitë përcaktohet se parashikimet e këtij

ligji për këtë pjesë janë të vlefshme edhe për kujdestarin ligjor të të miturit. Pra, ligji u jep fëmijëve një përkrahje të veçantë duke u siguruar atyre një pjesë të financimit për ta, në rastet e vendosjes së tyre në institucionet private të përkujdesit social.

Neni 9 i ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, parashikon heqjen apo kufizimin e zotësisë për të vepruar, me rekomandimin që komisioni psikiatriko-ligjor u bën subjekteve që kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, sipas Kodit të Procedurës Civile. Paragrafi i fundit i këtij neni, i njuh të drejtën titullari të shërbimit të shëndetit mendor, që nëse konstaton që kujdestari ligjor i personit me çrregullime të shëndetit mendor, që ndodhet nën kujdesin e shërbimit të shëndetit mendor, nuk i përmbush detyrimet e tij, t’i kërkojë gjykatës së rrethit zëvendësimin e kujdestarit.

Legjislacioni shqiptar për kategori të caktuar të fëmijëve me paaftësi ka parashikuar kritere të veçanta. Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërve”, përcakton përgjegjësitë e shtetit dhe të shoqërisë për këtë kategori personash. Këta persona edhe pse janë invalidë të grupit të parë dhe përfitojnë nga sigurimet shoqërore pension invaliditeti, si rregull nuk iu hiqet apo kufizohet zotësia për të vepruar, pasi në kryerjen e veprimeve të tyre juridike ndihmohen nga shoqëruesit e tyre, që gjithsesi nuk përmbush kërkesat ligjore të kujdestarit, si përfaqësues ligjor i tij.

Sipas ligjit, shteti dhe shoqëria marrin në mbrojtje personat e verbër dhe krijojnë të gjitha kushtet për integrimin në jetën normale nëpërmjet punësimit të tyre duke përcaktuar profesionet që i përshtaten gjendjes së tyre fizike, sigurimin e kushteve optimale të jetës, dhënien e fondeve për depistimin dhe ridiagnostikimin në klinikat brenda dhe jashtë vendit etj²¹⁴.

4. Vendoja e personit të pazot në kujdestari

4.1.1 Kujdestaria mbi fëmijën

Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata. Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit.

Të drejtën për paraqitjen e kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin e kanë²¹⁵:

- a) të afërmit e fëmijës së mitur;
- b) b) cilido që merr njoftim për mbetjen e fëmijës pa prindër ose për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur;

²¹⁴Neni 2.

²¹⁵Neni 264 i Kodit të Procedurës Civile.

- c) vetë i mituri që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç;
- d) prokurori i vendit ku i mituri ka vendbanimin;
- e) noteri, i cili në çeljen e një testamenti vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari.

4.1.2 Caktimi i kujdestarit me testament

Në rast të caktimit të kujdestarit nga prindi, që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore, me anë të testamentit ose deklaratës noteriale, ky vullnet duhet të përmbushet nga gjykata, por ajo më parë duhet të kërkojë, paraprakisht, mendimin e personit që është caktuar kujdestar, pasi çdo refuzim i këtij të fundit, passjell moscaktimin e tij si kujdestar. Në rastet kur kujdestari i caktuar me testament nuk plotëson kushtet e kërkuara nga Kodi i Procedurës Civile, ai nuk mund të caktohet si kujdestar, duke i kaluar pushteti gjykatës për zgjedhjen e një personi si kujdestar.

Gjykata, në çdo rast, merr mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale të vendit ku zhvillohet gjykimi, i cili përmban ekzaminimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës në kontekstin familjar, edukativ e social dhe ekzaminimin e kushteve dhe përshtatshmërisë së fëmijës me personin kujdestar të ardhshëm, të familjes kujdestare ose institucionit të përkujdesjes. Caktimi i kujdestarit nga gjykata bëhet duke parë cilësitë e personit kujdestar, të familjes kujdestare të zgjedhur ose të institucionit të përkujdesjes, si dhe pasi ka dëgjuar mendimin e një psikologu, që duhet të jetë i pranishëm gjatë gjykimit.

Në rast se nuk është caktuar kujdestar nga prindi që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore, gjykata i jep prioritet zgjedhjes së kujdestarit midis paraardhësve, personave të afërt të të miturit, një familjeje kujdestare dhe, si alternativë të fundit, institucionin publik ose privat²¹⁶. Para se gjyqtari të caktojë kujdestarin, duhet të dëgjojë personin e zgjedhur si të tillë dhe të marrë mendimin e të miturit nëse ai ka mbushur moshën dhjetë vjeç.

4.1.3 Familja kujdestare

Familja kujdestare është një familje alternative, e vendosur nga gjykata, për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirëritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale. Evidentimi i familjeve kujdestare është përgjegjësi e sektorit të ndihmës dhe shërbimit social pranë njësive administrative, ku banon i mituri, e cila realizohet me nënshkrimin e një deklaratë gatishmërie nga familja për të marrë fëmijë në kujdestari. Numri i fëmijëve që i jepen në kujdestari një familjeje kujdestare duhet të jetë i kufizuar, duke u dhënë prioritet në këtë vendosje fëmijëve që janë vëllezër dhe motra me njëri-tjetrin.

Kriteret për të qenë një familje kujdestare janë të përcaktuara në VKM Nr. 149, datë 13.03.2018 *“Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”*, të tilla si:

²¹⁶Neni 267 i Kodit të Procedurës Civile.

- a) Të ketë shfaqur interesin për të ofruar shërbimin e përkujdesjes alternative;
- b) Anëtarët e familjes të jenë të motivuar për të qenë familje kujdestare;
- c) Anëtarët e familjes të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- ç) Prindërit kujdestarë të kenë aftësi për të kryer detyrën e kujdestarit;
- d) Prindërit kujdestarë dhe të gjithë anëtarët e familjes të vërtetojnë me raport mjekësor nga komisioni mjekoligjor që janë të aftë për të ofruar këtë shërbim dhe se nuk mbartin sëmundje të transmetueshme;
- dh) Të strehojnë dhe të garantojnë mjedis familjar të sigurtë për fëmijën;
- e) Anëtarët e familjes të mos kenë qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve, fëmijëve me aftësi të kufizuara apo fëmijëve që i përkasin një minoriteti të caktuar;
- ë) Të respektojnë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës/fëmijëve apo të gjitha gjendjet e fëmijës sipas njërës apo disa prej shkaqeve të parashikuara në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi;
- f) Prindërit kujdestarë të kenë kuptim të qartë dhe të jenë të gatshëm të zbatojnë parimin e veprimt, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;
- g) Prindërit kujdestarë të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me familjen biologjike të fëmijës dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ;
- gj) Prindërit kujdestarë nuk kanë humbur, nuk u është hequr përgjegjësia prindërore ose nuk u është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;
- h) Prindërit kujdestarë të jenë nën moshën 65 vjeç;
- i) Prindërit kujdestarë të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në jo më shumë se tre fëmijë.

4.1.4 Njoftimi i rastit të fëmijës së mbetur pa prindër

Nëpunësi i gjendjes civile, që merr njoftimin për vdekjen e të dy prindërve ose prindit të vetëm, që ka lënë fëmijë në moshë të mitur, ose të lindjes së një fëmije nga prindër të panjohur, dhe noteri që çel një testament, ku parashikohet caktimi i një kujdestari, duhet të njoftojnë gjykatën për faktin brenda 10 ditëve. Njoftimi i gjykatës mund të bëhet edhe nga të afërmit e të miturit ose persona të tjerë të interesuar.

Gjykata, brenda 30 ditëve nga marrja njoftim ose nga paraqitja e kërkesës, vendos për caktimin e kujdestarit të të miturit. Për të miturit që janë vëllezër e motra caktohet një kujdestar i vetëm, përveç rastit kur rrethanat e veçanta kërkojnë domosdoshmërinë e caktimit të më shumë se një kujdestari.

4.1.5 Rastet e papajtueshmërisë për të qenë kujdestar

Nuk mund të caktohet kujdestar personi që:

- a) është vetë në kujdestari;

- b) ka konflikt interesash me të miturin;
- c) nuk ka administrimin e lirë të pasurisë së tij;
- ç) është përjashtuar nga kujdestaria për shkak të deklaramit me shkrim të prindit që ka ushtruar i fundit përgjegjësinë prindërore;
- d) ka humbur ose i është hequr përgjegjësia prindërore, ose i është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;
- dh) është i dënuar me burgim për një vepër penale dhe është gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe kur është dënuar për krime ndaj të miturve.
- e) ka mbushur moshën 65 vjeç;
- ë) për shkak të gjendjes së tij shëndetësore nuk mund ta ushtrojë me lehtësi kujdestarinë;
- f) ushtron përgjegjësinë prindërore në më shumë se tre fëmijë;
- g) është i ngarkuar me më shumë se dy kujdestari;
- gj) nuk jep pëlqimin për të qenë kujdestar.

4.1.6 Kujdestaria në institucionet e përkujdesjes

Kujdestaria mbi të miturin, i cili nuk ka të afërm të njohur ose të aftë për të ushtruar detyrën e kujdestarit, mund t'i jepet nga gjykata një institucioni publik ose privat të licencuar për përkujdesjen e fëmijëve. Drejtuesi i institucionit i delegon njërit nga punonjësit e tij të drejtën e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit. Drejtuesi i institucionit, brenda 10 ditëve nga caktimi i personit që merr funksionet e kujdestarit, i dërgon gjykatës aktin përkatës, i cili depozitohet në dosjen gjyqësore dhe pasqyrohet në regjistrin e kujdestarisë.

4.1.7 Kujdestaria e posaçme

Gjykata vendos caktimin e një kujdestari të posaçëm kur:

- a) ka konflikt interesash midis të miturit dhe prindërve ose midis të miturit dhe kujdestarit të tij, si dhe kur midis tyre duhet të kryhet një veprim juridik;
- b) ka konflikt interesash midis të miturve, vëllezër dhe motra, që kanë të njëjtin kujdestar ose kur duhet të kryhet një veprim juridik midis tyre. Për shkak sëmundjeje ose për shkaqe të tjera, kujdestari i caktuar pengohet të kryejë një veprim të caktuar ose të japë pëlqimin për kryerjen e një veprimi.

Kujdestari i posaçëm caktohet nga gjykata mbi bazën e kërkesës së prindit, të kujdestarit, së të afërmeve të të miturit, të miturit që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë

vjeç dhe personave të interesuar²¹⁷. Me caktimin e kujdestarit të posaçëm, gjykata cakton kufijtë e detyrave dhe të drejtave të kujdestarit, sipas rrethanave të çdo rasti të veçantë.

Gjykatë kompetente për caktimin e kujdestarit të posaçëm është ajo e vendbanimit ose e vendqëndrimit të të miturit, ose e vendit ku ndodhet pasuria e tij. Kujdestari i posaçëm përfaqëson të miturin në rastet kur interesi i tij është në konflikt me interesin e kujdestarit. Kur kujdestari i posaçëm ndodhet në konflikt interesash me të miturin, gjyqtari emëron një kujdestar tjetër.

Kujdestari i posaçëm duhet të kërkojë caktimin e një kujdestari të ri në rastin kur kujdestari nuk kryen ose braktis detyrën. Kujdestari i posaçëm kujdeset për të miturin, e përfaqëson atë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe administrimin e pasurisë në raste urgjente.

Kujdestaria e posaçme mbaron kur pushojnë shkaqet për të cilat është vendosur. Mbarimi i kujdestarisë së posaçme bëhet me kërkesën e personave, sipas Kodit të Procedurës Civile²¹⁸. Përpara se kujdestari të marrë përsipër funksionet e tij, i takon gjyqtarit që, qoftë kryesisht, qoftë me kërkesë të prokurorit, të një të afërmi ose të çdo personi të interesuar, të vendosë një kujdestar të përkohshëm ose të marrë masa të tjera urgjente që janë të nevojshme për mbrojtjen e të miturit ose për të ruajtur dhe administruar pasurinë e tij.

4.1.8 Detyrat e kujdestarit

Kujdestari, brenda 10 ditëve pasi ka marrë njoftimin ligjor për emërimin e tij, duhet të procedojë me inventarin e pasurisë së të miturit. Inventari duhet të bëhet brenda 30 ditëve. Me kërkesën e kujdestarit, gjyqtari mund të zgjasë afatin e mësipërm, nëse rrethanat e kërkojnë atë. Inventari bëhet në praninë e noterit, me pjesëmarrjen e kujdestarit dhe, nëse është e mundur, të të miturit që ka mbushur moshën dhjetë vjeç, si dhe në praninë e dy dëshmitarëve të zgjedhur nga gjykata, mundësisht midis të afërmeve ose miqve të familjes.

Gjyqtari mund të lejojë që inventari të bëhet pa praninë e noterit, nëse vlera e supozuar e pasurisë nuk e kalon shumën 50 mijë lekë. Inventari depozitohet pranë gjykatës. Në inventar përfshihen pasuritë e paluajtshme, të luajtshme, kreditë dhe debitë dhe përshkruhen dokumentet, shënimet dhe shkresat e lidhura me gjendjen e aktivitetit dhe pasivit të pasurisë, duke iu përmbajtur formaliteteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Kujdestari nuk është i detyruar të depozitojë shumat që nevojiten për shpenzimet urgjente lidhur me të miturin. Kapitallet e të miturit, me autorizim paraprak të gjykatës, mund të investohen nga kujdestari, në rastet që e shikon të përshtatshme dhe në interes të të miturit.

4.1.9 Kufizimet e detyrave të kujdestarit

Kujdestari, pa autorizim të gjykatës, nuk mund të kryejë veprime juridike që shkojnë përtej administrimit të zakonshëm të pasurisë së të miturit. Veprimet e

²¹⁷Neni 275 i Kodit të Procedurës Civile.

²¹⁸Neni 275 i Kodit të Procedurës Civile.

mëposhtme juridike, kujdestari mund t'i kryejë vetëm me autorizim të shprehur të gjykatës. Veprimet që i ndalohen shprehimisht kujdestarit janë:

a) të blejë pasuri, përveç sendeve të luajtshme të nevojshme për përdorim nga i mituri, për ekonominë shtëpiake dhe për administrimin e pasurisë;

b) të marrë kapitale, të lejojë heqjen e hipotekave ose zgjidhjen e pengut, të marrë përsipër detyrime, me përjashtim të rastit kur këto lidhen me shpenzimet e nevojshme për mbajtjen e të miturit dhe për administrimin e zakonshëm të pasurisë të tij;

c) të pranojë trashëgimi ose të heqë dorë prej saj, të pranojë dhurime ose leg, që janë me barrë ose me kusht;

ç) të lidhë kontrata qiraje të pasurive të paluajtshme për një afat mbi 9 vjet ose që në çdo rast zgjasin më shumë se 1 vit pasi i mituri ka mbushur moshën madhore;

d) të ngrejë padi, me përjashtim të rasteve kur bëhet fjalë për kallëzim të një punimi të ri ose të dëmit të mundshëm, të padive të posedimit, ose për nxjerrjen nga shtëpia të qiramarrësit, dhe të padive për kërkimin e fryteve ose për marrjen e masave konservative;

dh) të tjetërsojë pasurinë e të miturit, përveç fryteve dhe të mirave të luajtshme që dëmtohen lehtësisht;

e) të krijojë pengje ose hipoteka;

ë) të fillojë procedurën e pjesëtimit të pasurisë ose të ngrejë padinë përkatëse;

f) të bëjë premtime dhe transaksione ose të pranojë marrëveshje.

4.1.10 Zëvendësimi i kujdestarit

Gjykata e heq kujdestarin dhe e zëvendëson atë me një tjetër kur vëren se ai shpërdoron të drejtat e tij, tregohet i pakujdesshëm në kryerjen e detyrës ose, në mënyra të tjera, vë në rrezik interesat e të miturit, si dhe kur vetë kujdestari kërkon largimin e tij për shkaqe të arsyeshme.

Kërkesa për zëvendësimin e kujdestarit mund të bëhet nga personat e interesuar ose prokurori. Në këto raste gjykata dëgjon më parë pretendimet e kujdestarit. Me mbarimin e kujdestarisë ose zëvendësimin e saj, kujdestari duhet të bëjë menjëherë dorëzimin e pasurisë së të miturit, sipas rastit, të miturit që është bërë madhor, trashëgimtarëve të tij ose kujdestarit të ri²¹⁹.

Brenda 2 muajve nga çasti i mbarimit ose zëvendësimit, kujdestari i paraqet gjykatës llogarinë përfundimtare të administrimit të pasurisë. Gjykata, kur ka shkaqe të arsyeshme, vendos shtyrjen e dorëzimit të llogarisë tej këtij afati. Gjykata thërret kujdestarin e posaçëm, të miturin që ka mbushur moshën madhore, nëse është rasti kujdestarin e ri dhe, në rast të vdekjes së të miturit, trashëgimtarët e tij, për të shqyrtuar llogarinë dhe për të bërë vërejtjet përkatëse. Nëse nuk ka vërejtje dhe parregullsi ose mangësi në llogari, gjykata e miraton atë.

²¹⁹ Kodi i Procedurës Civile, neni 301.

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim nga kujdestari ose nga personat e tjerë të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni. Paditë e të miturit kundër kujdestarit dhe ato të kujdestarit kundër të miturit, për kujdestarinë, parashkruhen brenda 5 vjetëve, pasi i mituri ka mbushur moshën madhore ose ka vdekur. Nëse kujdestari ka paraqitur llogarinë përpara se i mituri të mbushë moshën madhore ose përpara vdekjes, afati fillon nga data kur gjyqtari ka marrë vendim mbi llogarinë. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për padinë e pagimit të diferencës që rezulton nga llogaria përfundimtare.

Midis kujdestarit dhe të miturit që ka arritur moshën madhore nuk mund të bëhet asnjë marrëveshje përpara miratimit të llogarisë së paraqitur nga kujdestari. I mituri që ka arritur moshën madhore, trashëgimtarët e tij ose ata që kanë një interes të ligjshëm mund t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar pavlefshmërinë e marrëveshjes së bërë, sipas paragrafit të parë të këtij neni.

Në regjistrin e kujdestarisë, që ndodhet pranë gjykatës, nën përkujdesjen e kancelarit të gjykatës, regjistrohen vendosja dhe mbarimi i kujdestarisë, përjashtimi ose shkarkimi nga detyra i kujdestarit ose kujdestarit të posaçëm, rezultatet e inventarëve dhe të llogarive, raportet vjetore të përcaktuara në nenin 302 të Kodit të Procedurës Civile dhe të gjitha masat që sjellin ndryshime në statusin vetjak ose pasuror të të miturit. Për vendosjen dhe mbarimin e kujdestarisë, kancelari i gjykatës njofton brenda 10 ditëve nëpunësin e gjendjes civile për të bërë shënimin në aktin e lindjes së të miturit.

Kujdestaria mbaron kur fëmija: a) bëhet madhor; b) vdes apo c) fiton zotësinë për të vepruar me martesë.

4.1.11. Procedura për vendosjen e kujdestarisë

Kompetent për vendosjen ose heqjen e kujdestarisë, si dhe për heqjen ose kthimin e pushtetit prindëror është seksioni përkatës i gjykatës së rrethit ku banon i mituri²²⁰. Kërkesa për vendosjen e kujdestarisë i paraqitet gjykatës nga të afërmit e fëmijës së mitur dhe nga cilido që merr njoftimin për mbetjen e fëmijës pa prindër, për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur dhe për çdo rrethanë tjetër që ligji kërkon vendosjen e kujdestarisë. Kur në çeljen e një testamenti, noteri, që bën publikimin e tij vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari, duhet të njoftojë gjykatën jo më vonë se 10 ditë nga marrja e dijenit, e cila procedon dhe vendos jo më vonë se 15 ditë. I mituri që ka mbushur moshën 16 vjeç mund të ushtrojë vetë të drejtën që t'i drejtohet gjykatës për vendosjen e kujdestarisë.

Gjykata emëron një kujdestar të vetëm edhe kur janë disa vëllezër e motra të mitur. Kur ka konflikt midis interesave të të miturve, ajo mund të caktojë edhe një kujdestar tjetër ose disa kujdestarë. Gjykata emëron si kujdestar personin e caktuar me testament dhe, në mungesë të tij, një nga të afërmit në linjë të drejtë dhe, pas kësaj, në linjë të tërthortë. Gjykata, nëse vlerëson se zgjidhja nuk është bërë në interes të fëmijës, vepron vetë për caktimin e kujdestarit. Gjykata emëron një kujdestar të posaçëm, kur këtë e kërkojnë interesat e të miturit. Kujdestaria e posaçme hiqet, kur pushojnë shkaqet për të cilat është vendosur.

²²⁰ Neni 350 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata, përpara se të procedojë për emërimin e kujdestarit, duhet të pyesë edhe të miturin, kur ai e ka mbushur moshën 10 vjeç. Kujdestaria merr fund kur i mituri mbush moshën 18 vjeç ose kur e mitura martohet para kësaj moshe. Me kërkesën e personave të përmendur në nenin 351 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e heq kujdestarin në çdo kohë dhe e zëvendëson me një tjetër, kur vëren se ai ka shpërdorur të drejtat që i takojnë si kujdestar, kur është treguar i pakujdesshëm në kryerjen e detyrës ose kur me mënyra të tjera ka vënë në rrezik interesat e të miturit, si dhe kur vetë kujdestari kërkon shkarkimin e tij për shkaqe të arsyeshme. Gjykata mund ta heqë kujdestarin vetëm pasi ta ketë dëgjuar ose njoftuar atë rregullisht.

4.1.12 Kujdestaria mbi personat që u është hequr zotësia për të vepruar

Gjykata, në vendimin për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, cakton dhe kujdestarin për personin që i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar. Kujdestari i personit, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, përfaqëson dhe administron pasurinë e tij, ashtu si prindi përfaqëson dhe administron pasurinë e të miturit që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç²²¹.

Kujdestari i personit, të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, detyrohet të kujdeset për personin dhe sidomos për mjekimin e tij. Të miturit që kanë mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe ndodhet nën përgjegjësinë prindërore, kur i hiqet zotësia për të vepruar, nuk i caktohet kujdestar, por vazhdon të jetë nën kujdesin e prindërve, si i mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç.

Kur i mituri bëhet madhor dhe nuk i është kthyer zotësia për të vepruar, gjykata i cakton një kujdestar, që mund të jetë një nga prindërit ose një person tjetër. Të miturit që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, kur ndodhet në kujdestari dhe gjatë kësaj kohe i hiqet zotësia për të vepruar, gjykata i cakton një kujdestar të ri ose vendos që kujdestari i tij të mbajë përsëri këtë detyrë. Kujdestaria mbi personin, të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, pushon kur kjo zotësi i është kthyer me vendim të gjykatës.

4.2. Mbrojtja e të sëmurit psikik me anë të vendimit gjyqësor

4.2.1 Procedura e heqjes të zotësisë për të vepruar

Personit që vuan nga një sëmundje psikike apo zhvillim i vonuar mendor, të tilla që nuk e lejojnë atë të kryejë me ndërgjegje të plotë veprime juridike, për shkak të perceptimit të gabuar për veprimet që kryen dhe pasojat juridike që rrjedhin prej tyre, mbi kërkesën e personave që tërheqin interesa pasurorë dhe jopasurorë, mund t'iu hiqet apo t'iu kufizohet zotësia për të vepruar.

Si persona të legjitimuar aktivisht për të paraqitur kërkesë në gjykatën kompetente për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar janë: bashkëshorti, gjinia e afërt, prokurori i vendit ku banon personi apo gjendet pjesa më e madhe e pasurisë, si dhe personat që kanë interes të ligjshëm për këtë fakt, si p.sh. kreditorët e personit që kërkohet t'iu hiqet apo kufizohet zotësia për të vepruar .

²²¹Neni 309 i Kodit të Procedurës Civile.

Kërkesa për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar i njoftohet prokurorit, kur ajo nuk është ngritur nga ky i fundit. Pjesëmarrja e prokurorit në këtë gjykim të posaçëm është gjykuar nga legjislatori si e nevojshme, pasi ai është garant i interesit publik, të mbrojtur me ligj, që kjo kategori personash të vihen në kujdestari, nëpërmjet heqjes apo kufizimit të zotësisë për të vepruar, në rast se provohen graviteti i sëmundjes psikike apo zhvillimi i vonuar mendor i tyre.

Me pjesëmarrjen e tij në këto gjykime, prokurori merr njohje për rastin, kërkon marrjen e provave të nevojshme për të vërtetuar rastin e sëmundjes mendore dhe jep mendim në përfundim të gjykimit për bazueshmërinë e kërkesës së bërë, pra nëse ajo duhet të pranohet tërësisht, pjesërisht apo duhet të rrëzohet. Një formë tjetër e kontrollit të vendimit të dhënë në këtë rast, është e drejta e prokurorit për të ankimuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë në Gjykatën e Apelit, si dhe vendimin e kësaj të fundit në Gjykatën e Lartë, kur mendon se vendimet gjyqësore nuk i përgjigjen realitetit të sëmundjes së personit që i hiqet a kufizohet zotësia për të vepruar.

Gjykata vendos lidhur me kërkesën, pasi të ketë pyetur personin për të cilin kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, persona nga gjinia e afërt e tij, mjekun që e ka kuruar ose pasi të ketë marrë mendimin e mjekëve të tjerë ekspertë, si dhe prova të tjera që do t'i çmojë të nevojshme. Pyetja e personit të cilit i kërkohet t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar, bëhet në institucionin që është shtruar për mjekim ose në banesën e tij nga një gjyqtar i deleguar, kur nuk është e mundur të paraqitet vetë në gjykatë.

Kundër vendimit për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, mund të bëjnë ankim vetë personi i mësipërm, kujdestari i përkohshëm i tij, personi që ka bërë kërkesën, si dhe të gjithë personat e tjerë që sipas nenit 382 të Kodit të Procedurës Civile kanë të drejtë të kërkojnë heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, pavarësisht nga pjesëmarrja ose jo e tyre në gjykimin e kësaj çështjeje.

Pasi vendimi me të cilin hiqet, kufizohet ose kthehet zotësia për të vepruar merr formë të prerë, një shkurtim i tij u dërgohet të gjithë gjykatave, për t'u regjistruar në një formë të veçantë, me të cilën mund të marrë dijeni cilido që ka interes. Gjykata i dërgon një shkurtim të këtij vendimi edhe Dhomës Kombëtare të Noterëve, e cila ua bën të njohur dhomave të noterëve nëpër rrethe.

Në rastin e heqjes të zotësisë për të vepruar me anën e vendimit të gjykatës duket qartë se kjo gjë ndodh për shkak të një sëmundje mendore e cila prek jetën psikike të njeriut. Në këtë mënyrë heqja e zotësisë për të vepruar ka si qëllim suprem, mbrojtjen e të sëmurit psikik.

Le t'a ilustrim me ndihmën e një vendimi gjyqësor të gjithë procedurën e heqjes dhe caktimit të kujdestarit të përkohshëm të sëmurit psikik. I kësaj natyre është **vendimi nr. 253, datë 18.12.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tropojë**, që ka marrë për shqyrtim kërkesën shtetases V.B.(D.), e cila kërkon heqjen e zotësisë për të vepruar dhe caktimin e kujdestarit të përkohshëm për shtetasen F.A.(D.), lindur në fshatin Shoshan-Tropojë dhe banuese në Bajram Curri, invalide me vendim nr. 618, datë 07.12.2016, të KMACP-it Tropojë.

Gjatë gjykimit, kërkuesja shpjegoi para gjykatës se motra e saj, F.A.(D.) nuk ka vetëdijen, është e papërgjegjshme në veprimet e saj, nuk komunikon me asnjë njeri, ajo të gjitha nevojat i kryen me ndihmën e anëtarëve të familjes. Sipas kërkueses, mjekët e kanë kuruar dhe vazhdojnë t'a kurojnë me ilaçe dhe kjo gjendje e saj mund të vazhdojë përjetësisht. Në këto kushte, kërkuesja kërkon që motrës së saj, F.A.(D.) t'i hiqet zotësia për të vepruar, dhe të caktohet ajo kujdestare për të kryer veprimet në emër dhe për llogari të saj.

Duke qenë se shtetasja ishte në pamundësi për të lëvizur dhe për t'u paraqitur në gjykatë, gjykata, me vendim të ndërmjetëm, delegoi kryesuesin e seancës z. E.Ç. për të parë gjendjen e të sëmurës nga afër. Gjyqtari, në prani të prokurorit, dhe të mjekëve A.B., M.H. dhe K.I., shkuan në banesën e shtetases V.B. Gjatë këqyrjes u mbajt procesverbali përkatës, ku gjykata konstatoi se, shtetasja F.A. gjendej e shtrirë në një krevat në banesën e saj, ajo nuk orientohej kur tentoje të komunikojë me të.

Gjykata pyeti mjekët për të përshkruar gjendjen e të sëmurës të cilët pohuan: Tek F.A.(D.), konstatohen çrregullime depresive mbipolare, humbet vetëdijen, dhe nga studimi i kartelës mjekësore përcaktohet se për të kjo gjendje është prej shumë kohësh dhe ka ardhur vetëm duke u përkeqësuar.

Gjithashtu nga gjykata gjatë këqyrjes u pyetën edhe familjarët e shtetases F.A.(D.). Ata pohuan se që nga koha që është sëmurë, e sëmura është fizikisht e pamundur për të kryer shërbime dhe vetëm me ndihmën e familjarëve të saj kryhen nevojat fiziologjike dhe nevojat e tjera, ndërsa vetëdijen e ka gati të humbur plotësisht.

Gjithashtu, gjykata iu caktoi si detyrë mjekëve që të paraqesin një raport me shkrim mbi gjendjen e të sëmurës, përsa ata konstatuan në vend pas njohjes edhe me provat (kartelat mjekësore), dhe rekomandim që ata të japin në lidhje me heqjen e zotësisë.

Në shkresën e titulluar në thonjëza “mendim i specializuar i mjekëve”, datë 15.12.2017, mjekët ndër të tjerat përcaktuan shprehimisht se:

“Nga këqyrja dhe nga studimi i kartelave mjekësore, në bazë të të cilave është caktuar një diagnozë, pacientja paraqitet në kushtet e një invaliditeti të plotë. Pacientja pothuajse në të shumtën e kohës paraqet humbje të koshiencës dhe disorientim në kohë dhe në hapësirë. Pacientja paraqitet e paaftë për të referuar dhimbje të çdo lloji simptome. Si rezultat i shenjave klinike të përcaktuara më sipër, pacientja është e pamundur të kryejë nevojat vetjake dhe personale, si ushqyerja dhe veshmbathja etj. Pacientja është e paaftë për t'u ushqyer, për t'u veshur dhe është i nevojshëm kujdesi intensiv ndaj saj.

Pacientja vuan nga diagnoza: çrregullime depresive bipolare. Kjo gjendje vazhdon prej shumë kohësh dhe kjo gjendje ka ardhur vetëm duke u përkeqësuar, gjendja e saj është e papërmisuar. Nga studimi i rastit të mësipërm arrijmë në përfundimin se, gjendja e shtetases F.A.(D.) është e papërmirësuar, si nga ana fiziologjike dhe nga ana psikomotore, që do të thotë që nuk mund të marrë përsipër të drejta dhe detyrime, nuk është e vetëdijshme për veprimet që kryen, nuk jep shenja përmirësimi të mëvonshme dhe ndodhur në këto kushte ne i rekomandojmë gjykatës që t'i heqë zotësinë për të vepruar dhe t'i caktojë një kujdestar që të kujdeset për plotësimin e nevojave të saj jetike.”

Në përfundim të gjykimit, gjykata, pasi u bind për gjendjen shëndetësore të saj, rrjedhojë e sëmundjes psikike çrregullimeve depressive bipolare, gjendje që vazhdonte prej shumë vitesh dhe vinte duke u rënduar, ka konkluduar se shtetasja F.A.(D.), nuk mund të marrë përsipër të drejta dhe detyrime, për shkak të mungesës së vetëdijes për veprimet që kryen, ndaj ka vendosur t'i heqë zotësinë për të vepruar dhe t'i caktojë një kujdestar, motrën e saj V.B. që të kujdeset për plotësimin e nevojave të saj jetike dhe kryerjen në emër e për llogari të saj të veprimeve juridike të nevojshme.

KONKLUZIONE

Për të drejtën civile njeriu është një person (fizik), ndërsa sipas doktrinës një subjekt i së drejtës. Në botën e së drejtës njeriut i është njohur atributi i qenies qendër e referimit të të drejtave dhe detyrimeve²²².

Personaliteti i personit fizik fillon në momentin e lindjes dhe mbaron në momentin e vdekjes së tij. Romakët përcaktuan një rregull sipas të cilit “fëmija i ngjizur konsiderohet si i lindur aq herë sa e kërkon interesi i tij” – *infans conceptus pro iam nato habetur, quotiens de eius commodis agitur*. Gjithsesi, u vendos kushti që i sapolinduri “të jetë i gjallë dhe të ketë një pamje humane”.

Në lidhje me faktin e lindjes së personit teoritë e së drejtës, që në periudhën romake janë ndarë, duke kërkuar që i sapolinduri të nxjerrë gjatë lindjes “një të qarë”, apo që i sapolinduri të manifestonte shenja jete. Këto diskutime duket se janë sheshuar së fundi, pasi legjislacionet e pjesës më të madhe të shteteve pranojnë si kusht të mjaftueshëm për të provuar lindjen e personit fizik, faktin që ai ka dhënë shenja jete, pra të ketë marrë frymë, rrethanë që vërtetohet lehtësisht nga shkenca mjekësore, nëpërmjet verifikimit të ekzistencës së gjurmëve të oksigjenit në mushkëritë e të sapolindurit.

Debate doktrinale ka patur në lidhje me regjistrimin e fetusit, të fëmijëve të lindur të vdekur dhe të atyre që vdesin ende pa u deklaruar lindja e tyre në gjendjen civile. Nga një studim që ka kryer Komisioni Ndërkombëtar i Gjendjes Civile²²³, rezulton se, vende të ndryshme kanë bërë zgjidhje të ndryshme për këto hipoteza.

(i) Në lidhje me regjistrimin e fetusit

Këtu duhet qartësuar se, asnjë prej shteteve të marra në studim²²⁴, nuk i regjistrojnë në gjendjen civile fetusin apo produktet e abortit nën një peshë të caktuar. Në Belgjikë (neni 326 i Kodit Civil), në Francë (Qarkorja e Ministrisë së Drejtësisë e 3 marsit 1993, I 3-7), në Greqi (ligji 344/1976, neni 37 § 3), në Luksemburg (sipas një praktike administrative konstante), nuk bëhet regjistrim në gjendjen civile nëse shtatzënia ka zgjatur më pak se 180 ditë.

Në Spanjë (neni 45 LRC; neni 171 deri 174 RRC) dhe në Zvicër (neni 66, paragrafi 1 OEC), nuk regjistrohen fëmijët e lindur të vdekur përpara përfundimit të muajit të gjashtë të shtatzanisë, në Portugali, përpara 22 javëve të shtatzanisë (neni 209 CRC). Në Holandë (neni 19 i, Librit 1 BW dhe ligji mbi varrimin i 12 prillit 1995) dhe në Britaninë e Madhe, kohëzgjatja e shtatzanisë duhet të jetë të paktën 24 javë, në mënyrë që të mos hartohet asnjë akt i gjendjes civile. Në Itali, ky afat është 28 javë. Në Gjermani (§

²²² Galgano, Francesco; op. cit., f. 86.

²²³ http://www.ciec1.org/SITECIEC/PAGE_Etudes/jAkAALINRRlreFlxS011b05TCAA

²²⁴ Gjermani, Austri, Belgjikë, Spanjë, Francë, Greqi, Itali, Luksemburg, Holandë, Portugali, Britani e Madhe, Zvicër dhe Turqi.

29, paragrafi 3 PStV – Dekret mbi zbatimin e ligjit për gjendjen civile) dhe në Austri (P 23.4 DA et § 8 Abs. 1 Z 2 e ligjit mbi gratë shtatzëna), shtatëzanitë jo të suksesshme nuk regjistrohen në gjendjen civile kur peshja e fëmijës është më e vogël se 500 gramë. Kjo zgjidhje i korrespondon rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (22 javë nga ikja e periodave ose 500 gram peshë) që, në fakt, është një prezumim i jetueshmërisë, gjendje fiziologjike minimale për të mbijetuar fëmija i konceptuar. Së fundi, në Turqi, nuk përpilohet asnjë akt i gjendjes civile për fëmijët që lindin të vdekur, cilado qoftë kohëzgjatja e shtazanisë (neni 16 i ligjit për popullsinë et 84 i Rregullores për gjendjen civile).

Gjithsesi, varrimi i fetusit lejohet në shumicën e shteteve: në Gjermani, nëse prindërit dëshirojnë; në Austri, sipas praktikave të autoriteteve vendore; në Belgjikë, mbi kërkesën e prindërve, por në një parcelë të varrezave të rezervuara posaçërisht, pa i vendosur emër (Qarkore e Ministrisë së Brendshme e 9 shtatorit 1991); në Spanjë, me paraqitjen e një certifikatë mjekësore që tregon origjinën e mbetjeve njerëzore nga aborti (neni 6 i Dekretit 2263/1974 i 20 korrikut); në Luksemburg, mbi kërkesën e familjes që e dëshiron një gjë të tillë; në Holandë (ligji mbi varrimin nuk gjen zbatim në këtë rast, por varrimi është i mundur në praktikë); në Mbretërinë e Bashkuar çështja rregullohet nga autoritetet lokale dhe rregulli i përgjithshëm është që varrimi është i mundur nëse prindërit e kërkojnë.

Në të kundërt, një varrim i tillë nuk është i mundur në Greqi, Itali, Portugali dhe në Greqi. Në Zvicër, zgjidhjet variojnë sipas kantoneve, pasi çështjet e shëndetit publik disiplinohen nga e drejta kantonale. Së fundi, në Francë, nuk ekziston ndonjë rregullim i veçantë.

Në rastin e Shqipërisë nuk është parashikuar në asnjë rrethanë, sado gjatë të ketë shkuar shtatzënia e një femre, pra edhe mbi 22 javë apo gjer në 28, apo me peshë fetusit mbi 500 gram, si regjistrimi i fetusit, ashtu edhe varrimi i tij. Pra, në rastin e vendit tonë, nuk bëhet asnjë shënim në regjistrat e gjendjes civile dhe as lejohet varrimi i fetusit, një situatë që ndodh vetëm në Turqi, sipas studimit të mësipërm.

(ii) Rasti i fëmijës të lindur i gjallë, por që ka vdekur përpara se deklarimi i tij të bëhet në gjendjen civile.

Shumica e sistemeve, në këtë rast, kanë bërë zgjidhje të ngjashme: - për pjesën më të madhe të shteteve, fakti që fëmija ka jetuar, edhe pse për një kohë të shkurtër, bën që të zbatohen të njëjtat rregulla, sipër për fëmijët që jetojnë. Fëmija, pra, regjistrohet në regjistrin e lindjeve, si çdo person i gjallë, dhe vdekja e tij regjistrohet në regjistrin e vdekjeve.

Këtë zgjidhje ka bërë edhe legjislatori ynë, edhe pse ligji për gjendjen civile nuk e rregullon në mënyrë specifike këtë situatë. Gjithsesi, për sa kohë fakti i lindjes së fëmijës provohet rregullisht me certifikatën e asistencës në lindje apo një procesverbal i mbajtur nga personeli mjekësor apo çdo autoritet tjetër dhe më pas, vdekja e tij nga skeda e vdekjes, e përpiluar nga mjeku, nuk ka asnjë pengesë për nëpunësin e gjendjes civile që së pari të hartojë aktin e lindjes së fëmijës, duke i vendosur emrin, mbiemrin, numrin personal, gjininë, datëlindjen, vendlindjes, marrëdhëniet e filiasionit etj., dhe regjistrimin e fëmijës në librin e lindjeve dhe në fletën e familjes së tij (prindërve; vetëm nënës, apo

me prindër të panjohur) dhe më pas të hartojë aktin e vdekjes, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për gjendjen civile, duke e regjistruar këtë fakt në librin e vdekjes dhe më pas në regjistrin kombëtar, në fletën e familjes së fëmijës.

(iii) *Rasti i fëmijës të lindur të vdekur:*

Duke përjashtuar Turqinë, që siç e thamë, nuk i regjistron fëmijët e lindur të vdekur, të gjithë shtetet e tjera të marra në analizë, parashikojnë detyrueshmërinë e deklarimit të këtij fakti në gjendjen civile, duke filluar nga kohëzgjatja minimale e shtatzanisë, ose e peshës së fetusit, mbi 500 gram. Duke qenë se fëmija ka vdekur gjatë lindjes, ai regjistrohet në librin e vdekjeve në Austri (§ 28 Abs. 2 PStG), në Belgjikë, në Francë, në Luksemburg (Dekreti i 4 korrikut 1806) dhe në Holandë (neni 19i Libri 1 BË). Në Gjermani, ndodhte e njëjta gjë (§ 24 PStG - Ligji mbi gjendjen civile) gjer në 1 korrik 1998, datë në të cilën hyri në fuqi ligji i 4 majit 1998, mbi reformën e martesës (*Eheschließungsgesetz*); tashmë, fëmijë që lind i vdekur regjistrohet në librin e lindjeve, me shënimin se bëhet fjalë për një fëmijë të tillë, dhe, mbi kërkesën e prindërve, shënohet emri dhe mbiemri i fëmijës. Po kështu, prindërit mund të kërkojnë regjistrimin e fëmijës në regjistrin e familjes (*Familienbuch*).

Duhet kujtuar se, në Francë dhe Luksemburg, fëmija i lindur i gjallë por pa mundësi mbijetese, regjistrohet, po ashtu, në regjistrin e vdekjeve, siç ndodh edhe në Belgjikë, për fëmijët e vdekur përpara konstatimit zyrtar të lindjes nga mjeku përkatës. Italia (R.D. n° 1238 i 9 korrikut 1939 et neni 74 OStC), Greqia (neni 37 i ligjit 344/1976) et Zvicra (neni 59 al. 1 et 74 OEC) bëjnë të zgjidhje: zyrtari i gjendjes civile harton një akt lindje me shënimin që fëmija ka vdekur. Në Britaninë e Madhe hartohet një akti i fëmijës të lindur të vdekur, që regjistrohet në një regjistër special (*Register of Stillbirths*).

Në Portugali, që prej reformës së realizuar me dekret-ligjin n° 36/97, të 31 janarit 1997, nuk hartohet më një akt i veçantë të fëmijës së lindur të vdekur, por arkivohet në shërbimin e gjendjes civile një deklaratë, të cilës i bashkëlidhet certifikata mjekësore (neni 209 CRC). Së fundi, në Spanjë, fëmija regjistrohet në një fletë speciale të aborteve (*legajo de abortos*: neni 29 et 30 i Kodit Civil; nenet 171 deri 174 RRC), të ruajtura në një dosje të aborteve së bashku me dokumentet mjekësore që shoqërohen. E njëjta procedurë zbatohet për fëmijët që vdesin brenda 24 orëve nga lindja.

Rasti i Shqipërisë është identik vetëm më atë të Turqisë, ku në çdo rrethanë fëmijët që lindur të vdekur gjatë procesit të lindjes, nuk regjistrohen në gjendjen civile, as në asnjë prej librave të saj, të lindjes dhe vdekjes. Kjo zgjidhje duket problematike, për sa kohë nuk merr parasysh vullnetin e prindërve, që për arsye afeksioni apo kujtimi, duan ta regjistrojnë fëmijën e lindur të vdekur në librat e gjendjes civile, por nuk i shërben as interesit shtetëror për të përcaktuar shkallën e mortalitetit në lindje.

Është shumë e qartë që në strukturën e zotësisë civile të personit fizik bëjnë pjesë dy elementë: *zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar*. Sipas nenit 1 të Kodit Civil, çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të patur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.

Personit fizik nuk mund t'i kufizohen të drejtat civile, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj. Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile²²⁵.

Dallimi midis këtyre dy llojeve të zotësive është bërë edhe në kohët e hershme. Në thelb, zotësia juridike mëshiron cilësinë e njeriut për të qenë subjekt i së drejtës civile, pra mbartës i të drejtave dhe detyrimeve. Nën këtë aspekt terminologjik në doktrinë dhe jurisprudencë gjen përdorim përkrah shprehjes “zotësi juridike” edhe shprehja “personalitet juridik”. Zotësia për të vepruar është zotësia për të pasur të drejta dhe të marrë përsipër detyrime duke nënshkruar akte juridike. Ashtu sikurse dihet akti juridik është burimi më i madh dhe më i rëndësishëm i të drejtave dhe detyrimeve në të drejtën civile. Akti juridik implikon vullnetin dhe ndërgjegjen e njeriut me qëllim që të prodhojë disa efekte juridike (*të drejta dhe detyrime*).

Përsa i përket zotësisë civile në doktrinë janë ngritur disa pyetje në lidhje me shtrirjen e kësaj zotësie.

Së pari, konsiderohet se nocioni i zotësisë civile ka prirje të përgjithshme, kurse zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar “ndërtojnë së bashku zotësinë civile” në kuptimin e zotësisë në shoqëri dhe jo të zotësisë të së drejtës civile, me kufizime që variojnë sa nga një degë e së drejtës tek tjetra²²⁶.

Së dyti, konsiderohet se zotësia civile është një zotësi e një degë dhe përkatësisht e së drejtës civile. Ekzistojnë disa argumente të cilat e përforcojnë më tej këtë ide. Një nga argumentet na paraqet një pasqyrë logjiko-juridike, sepse që nga momenti kur njihet autonomia e degëve të së drejtës, atëherë edhe pasojat që shfaqen do të kenë autonominë e tyre, duke ju referuar në këtë mënyrë zotësisë që është specifike për secilën degë. Nga ana tjetër, dallimi ndërmjet zotësisë civile dhe zotësisë në degë të tjera reflektohet në strukturë, përmbajtje dhe në mbarimin e zotësisë. Degë të ndryshme të së drejtës aplikojnë edhe zgjidhje të ndryshme.

Një interes të veçantë paraqet edhe lidhja reciproke ndërmjet zotësisë civile me nocionet ose konceptet e tjera, por gjithmonë duhet treguar kujdes që të mos krijojmë konfuzione. Ashtu sikurse kemi analizuar tashmë, ndërmjet zotësisë civile dhe zotësisë juridike ekziston një raport. E para përfaqëson një pjesë, kurse e dyta pjesën e plotë. Lidhja ndërmjet zotësisë civile, zotësisë juridike dhe zotësisë për të vepruar është më komplekse nga sa duket. Në qoftë se do të marrim në konsideratë zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar do të kuptojmë se një person nuk mund të fitojë zotësinë për të vepruar, para zotësisë juridike, por është e mundur që një person të ketë zotësi juridike pa pasur zotësi për të vepruar.

Nga ana tjetër zotësia civile nuk duhet ngatërruar me të drejtat subjektive dhe as me detyrimet civile. Zotësia është një aftësi e përgjithshme, kurse e drejta është një mundësi konkrete. Të drejtat dhe detyrimet nuk mund të ekzistojnë jashtë sferës të zotësisë civile dhe kjo e fundit mëshiron në vetvete, aftësinë për të pasur dhe ushtruar të drejtat subjektive dhe të marrë përsipër detyrimet civile nëpërmjet veprimeve juridike.

²²⁵Neni 6 i Kodit Civil 2017.

²²⁶Popa Nicolae, *Teoria generală a dreptului*, Editura Actami, Bukuresht, 1998, f. 88.

Praktikisht, të drejtat dhe detyrimet civile i japin kuptim nocionit të zotësisë, kurse zotësia është premisa e të drejtave dhe detyrimeve.

Së fundmi, zotësia civile nuk duhet të ngatërrohet me “përgjegjësinë civile”. Ashtu sikurse e dimë të gjithë, ne jemi të përgjegjshëm për veprimet tona, të cilat padyshim janë të lidhura me të drejtën e lirisë, e cila është një parim themelor i së drejtës që shpreh marrjen e përgjegjësisë në rastin e veprimeve tona sociale të cilat janë në kundërshtim me ligjin dhe sjellin një rrezik social.

Përgjegjësia juridike haset në më shumë degë të së drejtës sikurse janë: përgjegjësia kushtetuese, përgjegjësia penale, përgjegjësia administrative, përgjegjësia civile etj. Një nga kushtet esenciale të përgjegjësisë civile është konstatimi i fajit të personit, i cili ka shkaktuar dëmin. Në këtë kontekst zotësia civile përbën një premisë të përgjegjësisë civile, me supozimin se ndërmjet elementëve përbërës të zotësisë civile dhe kushteve të përgjegjësisë civile ekziston një lidhje komplekse.

Parimi kushtetues i cili frymëzon të drejtën civile është se të gjithë njerëzit janë të barabartë. Kjo barazi juridike është abstrakte dhe virtuale. Ajo nuk u siguron konkretisht të gjithëve të njëjtat përparësi ekonomike dhe të njëjtat pozicione shoqërore. Barazia civile ka për bazë personalitetin juridik: ajo gjendet njëherësh në njohjen e personalitetit juridik dhe në afirmimin e të drejtave të pandashme nga ky personalitet

Njohja e personalitetit juridik dhe atributet e personalitetit janë dy bazat themelore të së drejtës së personave të cilat përcaktojnë vlerën e rëndësishme të personit njerëzor në të drejtën civile. Personaliteti juridik i njihet nga ligji civil çdo qenieje njerëzore: ai i takon çdo individ. Një fakt i sigurtë është se personaliteti juridik i personave fizikë nuk varet nga vullneti i ligjvënësit. Gjithashtu ai nuk është një krijim arbitrar. Njohja ligjore e qenies njerëzore dhe respekti që i garanton e drejta që në fillim të jetës së tij, është nga një nga provat më të mëdha të veçantisë të personalitetit juridik.

Sinkronizimi i jetës nuk mund të jetë i përkryer, pasi jeta shfaqet në tre kohë - ngjizja, shtatzënia, lindja - dhe personaliteti juridik mund të përmbushet tërësisht vetëm në lindje. Duke u nisur nga ideja se kjo zotësi është një kusht *sine qua non* e cilësisë të subjektit të së drejtës, konsiderohet që shprehja më e duhur do të ishte “*zotësia subjektive*”, e cila do t’i jepte identitetin e vërtetë dhe specifikën e duhur përmbajtjes të konceptit që përfaqëson²²⁷. Megjithatë duhet të pranojmë se në legjislacione të ndryshme, doktrinë dhe jurisprudencë është imponuar shprehja “zotësia juridike” dhe përdorimi i një shprehje tjetër do të jetë një sfidë për të ardhmen, Zotësia juridike si pjesë e zotësisë civile disponon edhe disa karakteristika juridike të veçanta. Në doktrinën e sotme afirmohet se *zotësia juridike është e ligjshme, e përgjithshme, e pandashme, e pakufizuar, e barabartë dhe universale*.

Do të konstatojmë se, në konceptin aktual, zakonisht zotësia juridike konsiderohet si një zotësi e pakufizuar (e plotë dhe e pakufizuar nga normat juridike), por kufizimi i kësaj zotësie përbën në një farë mënyrë përjashtimin, i cili mund të ekzistojë vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Nga ana tjetër çdo ligj, i cili kufizon zotësinë juridike duhet që të përcaktojë edhe “kushtet” në të cilat ky kufizim mund të ketë juridiksion. Në

²²⁷Malaurie, Ph., Aynes, L., op. cit., f. 45.

doktrinë gjithashtu është theksuar fakti se ligji përmend në mënyrë afirmative dhe korrekte “kufizimin” e zotësisë juridike, por nuk i referohet “mungesës” të kësaj zotësie (*ashtu sikurse parashikon në rastin e zotësisë për të vepruar*), sepse është e pakonceptueshme që një qenie njerëzore të ketë mungesë të zotësisë juridike. Duke rregulluar në rrugë ligjore vetëm kufizimin e zotësisë juridike, vetë ligji përjashton në mënyrë kategorike, variantin e mungesës totale të zotësisë juridike.

Kufizimi i zotësisë juridike të personit fizik mund të bëhet duke respektuar një raport të arsyeshëm ndërmjet instrumentit të zgjedhur nga ligjvënësi dhe rëndesës të efekteve mbi situatën e personit fizik. Në këtë mënyrë kuptojmë se zotësia juridike është një zotësi e pakufizuar me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Të gjitha kufizimet e përcaktuara me ligj duhet të jenë të qarta dhe të argumentojnë arsyet se përse duhet të ekzistojnë këto kufizime.

Nga parimet e mësipërme do të konstatojmë se barazia është parë më shumë si një “mosdiskriminim”, duke konsideruar se parimi i mosdiskriminimit është një formë moderne dhe perfekte e parimit të barazisë dhe numërimi i kriterëve, të cilat nuk duhen të jenë objekti i i diskriminimit është sqarues, por jo kufizues. Praktikisht, “asnjë rrethanë” nuk mund të justifikojë idenë se personat të ndodhur nën të njëjtën situatë do të kenë zotësi juridike të ndryshme, por nuk përjashtohet fakti, kur personat të ndodhur në situata të ndryshme të kenë edhe zotësi juridike të ndryshme.

Universaliteti i zotësisë juridike shpreh idenë se të gjithë njerëzit kanë këtë zotësi, pavarësisht kohës dhe vendit, ku ata ndodhen. Edhe sipas Kushtetutës të gjithë shtetasit gëzojnë të drejtat dhe liritë të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet, sikurse marrin përsipër edhe detyrimet ligjore.

Në ditët e sotme është kontestuar ky fakt nga e drejta moderne dhe që fëmija të fitojë zotësinë juridike është e mjaftueshme që fëmija të lindë i gjallë. Ekziston një interes praktik për përcaktimin e zotësisë juridike duke u mjaftuar vetëm me faktin se fëmija ka lindur gjallë apo të ketë aftësi për të jetuar. Disa sisteme të së drejtës kanë eliminuar opinionet të shkencës të mjekësisë për aftësinë që duhet të ketë fëmija për të jetuar. Si konkluzion do të konsiderohet si “person” fëmija i lindur para kohe por edhe fëmija i cili paraqet deformime në lindje, në lidhje me të cilët shkenca mjekësore mbështet tezën se ky fëmijë nuk mund që të jetojë.

Në këtë situatë, kufiri “një frymëmarrje e vetme” bën diferencën ndërmjet fitimit ose jo të zotësisë juridike. Në Kodin Civil shqiptar nuk ekziston asnjë parashikim përpara i përket defekteve në lindje dhe as në ligjin për gjendjes civile. Nga ana tjetër rregullat e kishës katolike nuk lejonin pagëzimin e të sapolindurve të cilët kishin pamjen e një monstre. Për t’i akorduar personalitetin juridik kodi civil spanjoll përcakton dy kushte: së pari, fëmija nuk duhet të ketë kokë si monstër dhe së dyti të jetë i aftë që të jetojë i ndarë nga nëna për një kohë prej 24 orësh.

Në sistemin francez, fëmija duhet të lindë i gjallë dhe të ketë aftësi për të jetuar, aplikohet një prezumim i thjeshtë sipas të cilit “çdo fëmijë që lind i gjallë, është i aftë edhe për të jetuar”, edhe pse mund të vdes; në një kohë të shkurtër pas lindjes²²⁸. Nuk

²²⁸ Bihr, Ph., *op. cit.*, f. 34.

mjafton të jesh ngjizur dhe të jesh lindur për të qenë plotësisht një person: duhet të lindësh i gjallë dhe me aftësi për të jetuar. Fëmijët e lindur të vdekur nuk janë persona. Fëmijët e lindur të gjallë, por pa aftësi për të jetuar, konsiderohen se nuk kanë patur kurrë personalitet juridik.

Të lindurit gjallë dhe aftësia për të jetuar, nga plotësimi i këtyre dy kushteve së bashku varet konfirmimi (pohimi plotësisht) i personalitetit juridik. Një fëmijë lind i gjallë kur në lindje ai merr frymë plotësisht. Frymëmarrja pas çastit të lindjes është shenja e jetës pas lindjes. Ky është një fakt i cili provohet lirisht duke u mbështetur mbi dëshmitë dhe vëzhgimet e mjekësisë ligjore. Aftësia për të jetuar është e natyrshme. Çdo fëmijë që lind i gjallë prezumohet se ka aftësi të jetojë, edhe pse mund të vdesë shpejt më pas. Një prezumim i aftësisë për të jetuar lidhet me shenjën e parë të jetës. Frekuenca mjaft e ulët e vdekjeve perinatale (nga java 28 e shtatzënisë deri në ditën e shtatë pas lindjes) përforcon gjasat e prezumimit të aftësisë për të jetuar, dhe kjo vlen si një e dhënë fillestare.

Por, ky prezumim vuan nga prova e kundërt (që duhet paraqitur nga të gjithë ata që kanë interes të tregojnë se fëmija nuk kishte aftësi për të jetuar). Ky mund të jetë rasti i disa fëmijëve të lindur mjaft para kohe apo të keqformuar (ata që dikur quheshin përbindësia *monstra vel prodigia*). Më saktë, (dhe deri në një urdhër të ri) një fëmijë konsiderohet se nuk është i aftë të jetojë (edhe pse ka lindur i gjallë) kur në mungesë të një organi thelbësor për të jetuar, ai është domosdoshmërisht i paracaktuar të zhduket. Mungesa e aftësisë për të jetuar lidhet deri tani me keqformimet e lindura dhe çrregullime të mirëfillta që e bëjnë vdekjen të pashmangshme.

Ashtu sikurse dihet, lindja është momenti i fillimit të zotësisë juridike të personit fizik dhe për këtë arsye shfaqet një interes i madh regjistrimin e kësaj date. Në të drejtën moderne, vërtetimi i lindjes bëhet nëpërmjet aktit të lindjes në gjendjen civile ose ndryshe sikurse quhet certifikata e lindjes. Kjo certifikatë lëshohet në bazë të ligjit dhe ka një rubrikë e cila emërtohet “data e lindjes” duke treguar vitin, muajin dhe datën e lindjes të fëmijës. Ligji nr. 10 129, i datës 11.05.2009 “Për gjendjen Civile” rregullon deri në detaje hartimin e aktit të lindjes.

Infans conceptus pro nato habetur quoties de commodis ejus agitur. Ky rregull përjashtues për fitimin e zotësisë juridike në të drejtën romake, zbatohet gjithashtu edhe në të drejtën moderne, në shumë vende të botës. Për të aplikuar këtë parimin, duhet të plotësohen dy kushte të rëndësishme: fëmija i zënë duhet që të fitojë vetëm të drejta dhe jo detyrime dhe fëmija të lindë i gjallë (jo i aftë për të jetuar).

Sē pari, fëmija duke fituar këtë trashëgimi fiton edhe të drejta mbi këtë , por nga ana tjetër ka edhe detyrime. Gjithsesi doktrina ka konsideruar se ky rast nuk kundërshton rregullin e përjashtimit të fitimit të zotësisë juridike. Kushti i dytë, i cili parashikon që fëmija të lindë i gjallë është analizuar nga doktrina, sepse nga ky eveniment varet edhe fitimi i zotësisë juridike në përgjithësi dhe jo vetëm kaq, por, nga ky eveniment varet edhe fitimi i zotësisë juridike të parakohshme. Ashtu sikurse dihet, kjo kërkesë ligjore funksionon si një kusht i rëndësishëm, në kuptimin që, zotësia juridike njihet nga ligji por vetëm duke u plotësuar kushti që fëmija i zënë të lindë i gjallë, sepse në rast të kundërt

zotësia juridike humbet²²⁹. Për këtë motiv zotësia juridike e parakohshme kualifikohet si një zotësi “e kushtëzuar” ose si një zotësi e vendosur “nën kushte”.

Në doktrinë, është theksuar fakti se ekzistenca e kushtit që fëmija të lind; i gjallë, kusht, i cili nuk dihet nëse do të plotësohet në momentin e zënies, i jep një avantazh faktit që sipas rregullit *infans conceptus*, nuk i referohet akordimit të zotësisë juridike fëmijës të zënë ose të zotësisë të parakohshme, por njohjes prapavepruese të kësaj zotësie, duke filluar që nga momenti i zënies.

Problemi komplikohet në këtë pikë, për sa kohë gruas i është njohur e drejta të ndërpresë shtatzaninë në javët e para të zënies. Mund të ndodhë, që nëna e ardhshme, me qëllim përjashtimin nga trashëgimia të fëmijës së saj, të konceptuar tashmë, si rezultat i vdekjes së trashëgimlënësit të tyre të përbashkët, ushtron të drejtën për të abortuar fetusin. Kjo situatë zhduk të drejtën për të trashëguar të fëmijës së konceptuar për shkak të keqbesimit të nënës, me qëllim shtimin e pjesës takuese të saj në pasurinë trashëgimore. Një zgjidhje mund të ishte që gruaja të ndalohej të abortonte gjatë 300 ditëve nga vdekja e bashkëshortit, duke i kërkuar si pjesë të dokumentacionit edhe provimi i faktit të gjendjes së saj civile.

Vetëkuptohet që njëherësh me vdekjen, personi humbet cilësinë e të qenit subjekt i të drejtës civile. Në këtë kontekst, merr fund zotësia juridike e personit fizik. Vetëm një qenie humane ekzistente e lindur ose e zënë ka aftësinë për të qenë subjekt i së drejtës dhe të ketë zotësi juridike në të drejtën civile. Të gjithë këta elementë ndërtojnë të ashtuquajturin bosht human të zotësisë²³⁰. Si rezultat do të thotë që të konstatosh, datën e mbarimit të zotësisë juridike duhet të konstatosh më parë datën e vdekjes të personit. Vdekja është një proces biologjik, që nënkupton pushimin e funksioneve jetësore të organizmit pas të cilit, vjen menjëherë shuarja e veprimtarisë së indeve dhe qelizave të organizmit të njeriut²³¹.

Me ndarjen e një personi nga jeta ai ndahet edhe nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i ka pasur dhe i ka gëzuar në kohën që ka qenë gjallë. Kjo vlen për të gjitha të drejtat dhe detyrimet të natyrës pasurore dhe jopasurore. Me vdekjen natyrore ose fizike barazohet edhe vdekja civile. Tek vdekja civile personi në fjalë është i gjallë. Ai vetëm privohet nga të gjitha të drejtat civile²³². Vdekja mund të ndodhë në çdo moshë të jetës së njeriut. Dallohen dy lloje vdekjesh: vdekja e parakohshme dhe vdekja e natyrshme. Këto lloje vdekjesh mund të konstatohen fizikisht.

Në këtë mënyrë data e vdekjes është edhe data e mbarimit të zotësisë juridike. Legjislacioni i vendit tonë nuk e parashikon vdekjen civile. Sipas të drejtës franceze, fundi i personalitetit juridik përkon patjetër me atë të jetës njerëzore, me vdekjen natyrore. Parimi i së drejtës universale, marrë në zhvillimin e saj, çon në pohimin se: Çdo njeri e ruan personalitetin e tij deri në vdekje. Personaliteti zgjat po aq sa jeta. Ai shuhet vetëm në çastin e vdekjes. Ky rregull është absolut në kuptimin që asnjë ngjarje tjetër nuk shkakton humbjen e personalitetit. Nuk ka më të vdekur civilë dhe të paaftët janë dhe

²²⁹Birsan, C., op. cit., f. 32.

²³⁰Cantacuzino, M. B., op. cit., f. 26.

²³¹Meksi, Sokrat. Çipi Bardhyl, op. cit., f. 19.

²³²Kadriu, Osman., op. cit., f. 170.

mbeten persona. Me përjashtimin e vdekjes civile, paaftësitë civile sjellin kufizime (të cilat nuk janë të parëndësishme) për personalitetin, por që e pohojnë atë si parim.

Për të përcaktuar përmbajtjen e zotësisë juridike, duhet të kemi gjithmonë parasysh të gjitha aktet normative të cilat konsiderohen si burim i së drejtës civile. Shtrirja reale e përmbajtjes së zotësisë juridike të njeriut, sigurisht që përballet edhe me disa kufizime. Sipas nenit 1 të Kodit Civil, “Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të patur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.”

Personit fizik nuk mund t’i kufizohen të drejtat civile, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj. Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile. Edhe pse në konceptin aktual, zotësia juridike është një nocion i cili nuk njeh kufizime (*është një zotësi e plotë dhe jo e limituar nga norma juridike*), sistemi juridik me anën e disa përjashtimeve, ka pranuar kufizimin e kësaj zotësie.

Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Kushtetuta, mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast, ato nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut²³³. Pra, në këtë mënyrë Kushtetuta ka parashikuar të gjitha rastet, kur mund të kufizohen këto të drejta.

Sipas doktrinës, gjithmonë ligjvënësi duhet të ketë parasysh që të respektojë një raport të caktuar ndërmjet kufizimit të zotësisë juridike, me pasojat që mund të lindin mbi personin fizik. Si konkluzion, zotësia juridike e njeriut është në radhë të parë, vetë aftësia e tij për të pasur të drejta dhe detyrime civile. Në radhë të dytë, në këtë kontekst nuk bëjnë pjesë ato të drejta, të cilat janë kufizuar me anën e ligjit, sikurse të drejtat dhe ato detyrime civile, të cilat u përkasin degëve të tjera të së drejtës.

Nga ana tjetër, doktrina ka dhënë disa përkufizime të zotësisë për të vepruar të cilat ndryshojnë pjesërisht sa nga një autor tek tjetri. Autorët e së drejtës janë të opinionit që përkufizimi i zotësisë për të vepruar, duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementët e mëposhtëm: a) lidhja që duhet të ketë kjo lloj zotësie me zotësinë civile të vetë njeriut; b) zotësia për të vepruar presupozon kryerjen e veprimeve juridike civile dhe jo kryerjen e veprimeve juridike që u përkasin degëve të tjera të së drejtës; c) kryerja e veprimeve juridike nuk parashikon vetëm ushtrimin e të drejtave dhe marrjen përsipër të detyrimeve civile, por edhe fitimin e të drejtave subjektive civile sikurse edhe ekzekutimin e detyrimeve civile²³⁴.

Si konkluzion mund të themi se aftësia për të vepruar varet nga dy elementë bazë; a) nga mosha; b) shëndeti mendor. Ndërsa mosha është një kategori objektive dhe e matshme, pra është ngjarje e sigurt që do të ndodhë në të ardhmen, nuk mund të themi të njëjtën gjë për shëndetin mendor. E thënë me fjalë të tjera, ndërsa dihet me siguri momenti kohor që një person i caktuar fiton, fillimisht zotësi të kufizuar (14-18 vjeç) dhe

²³³Dispozitat e nenit 17 të Kushtetutës.

²³⁴ Urs I. , Angheni S. , *Drept civil. Partea generală. Persoanele*, vol. I, Ed. Oscar Print, Bukuresht 1999, f. 124.

më pas zotësi të plotë me mbushjen e 18 vjetëve, çka në mungesë të sëmundjeve psikike apo zhvillimi të metë mendor, passjell fitimin e plotë të aftësive për të kryer veprime juridike (pra marrë përsipër të drejta dhe detyrime), sëmundjet psikike, sidomos, janë fakte të paparashikuara që, së bashku me prapamendjen e thellë mendore, cenojnë aftësinë e një personi për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë e veprimeve që kryen dhe pasojat që vijnë nga këto veprime.

Ligjvënësi me qëllim mbrojtjen e kësaj kategoria shoqërore, ka parashikuar institutet e heqjes dhe kufizimit të zotësisë për të vepruar. Sa më e rëndë sëmundja psikike dhe më e thellë prapamendja mendore, aq më e ulët është shkalla e perceptimit të personit për veprimet që kryer dhe kuptimin e pasojave që i vijnë nga to. Sëmundjet psikike, për shkak të agresivitetit që paraqesin në shumë raste, kurohen në spitale psikiatrike, ndaj në zbatim të detyrimeve që parashikon ligji nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, komisionet psikiatriko-ligjore të tyre, e kanë për detyrë që t’i kërkojnë personave që legjitimohen për të paraqitur kërkesë për heqjen apo kufizimin e zotësisë për të vepruar të personit nën kujdesin shëndetësor, që t’i drejtohen gjykatës me kërkesë me objekt të tillë.

Ky parashikim ligjor, ka ndihmuar në evidentimin shkencor të rasteve të heqjes apo kufizimit të zotësisë për të vepruar të personave që vuajnë nga sëmundje psikike, për sa kohë opinion vjen nga specialistë të fushës mjekësore që e njohin në detaje si gjendjen e pacientit, ashtu edhe ecurinë e sëmundjeve të tilla, që në të shumtën e rasteve janë jo të shëruese, por vetëm të kurueshme, si llojet e ndryshme të skizofrenisë.

Një kompetencë mjaft të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të personit që i është hequr zotësi për të vepruar i ka njohur ligji për shëndetin mendor drejtuesit të institucionit mjekësor, ku është shtruar i sëmuri që tashmë është vendosur në kujdestari, që të kërkojë zëvendësimin e kujdestarit, kur drejtuesi i institucionit mjekësor konstaton se kujdestari nuk po i përmbush siç duhet detyrimet e tij karshi personit të pazot.

Në evidentimin e rasteve të tilla të sëmundjeve psikike dhe atyre me prapambetje mendore një rol më të madh duhet të luajë edhe organi i prokurorisë së shkallës së parë. I takon këtij organi që të kërkojë edhe kryesisht, informacione nga organet e pushtetit vendor, policisë, shërbimeve sociale etj., me qëllim grumbullimin e të dhënave për të sëmurë të tillë dhe kërkimin për to të shtrimit në spitale të specializuara, krahas paraqitjes së kërkesës për heqjen apo kufizimin e zotësisë për të vepruar.

Praktika e deritanishme ka treguar se organet e policisë, shërbimeve sociale në rang kombëtar e lokal, pak kujdes i kushtojnë evidentimit të personave të tillë. Kjo situatë vjen deri diku edhe nga tendenca e familjeve shqiptare për të mos kërkuar ndihmën e organeve të specializuara mjekësore për trajtimin e sëmundjeve të tilla, duke i quajtur si probleme të brendshme. Por pasojat nga mosmarrja në kohë dhe në mënyrën e duhur të trajtimit mjekësore ka rezultuar në jo pak raste fatale për jetët e të sëmurëve, por edhe të personave të tjerë, kryesisht të afërm, por edhe për pasuritë e tyre, që janë dëmtuar, shkatërruar, djegur etj. nga veprimet e pakontrolluara të të sëmurëve.

Mendojmë se, rastet e kufizimit të zotësisë për të vepruar nuk duhet të kufizohen vetëm tek sëmundjet psikike dhe zhvillimi i vonuar mendor i personit. Përvoja italiane na vjen në ndihmë në këtë pikë, teksa në nenin 415 të Kodit Civil, ka parashikuar si raste të

kufizimit të zotësisë për të vepruar edhe moshën e madhe të personit, rastet e personave që prishin shumë të holla, abuzojnë zakonisht me alkoolin apo lëndët narkotike, apo janë shurdhë dhe nuk shikojnë që nga lindja ose nga fëmijëria e hershme e tyre.

Shkenca mjekësore ka provuar se, njeriu në stad të avancuar të moshës, humbet shumë nga kthjellësia e mendjes, duke rënë jo rrallë pre e njerëzve që e rrethojnë, të cilët, duke përfituar nga gjendja e tij mendore e shpesh edhe shëndetësore, arrijnë t'iu zhvasin atyre përmes mashtrimeve shumë të mëdha parash që ata disponojnë apo të shpërdorojnë pasuritë e tjera të tyre.

Edhe rasti i alkoolistëve dhe personave të varur nga drogat, për shkak të shpeshësisë së pirjes së tyre, sasive të konsiderueshme të parave që kërkohen për blerjen e tyre, shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike për vetë personin dhe familjen e tij.

Edhe rasti i shurdhëve dhe personave që nuk shikojnë që nga lindja ose nga fëmijëria e hershme, mund të përbëjë rast të kufizimit të zotësisë së tyre për të vepruar, pasi një e metë e tillë ndikon, si rregull, në drejtim të përfytyrimit të realitetit objektiv, kuptimit të veprimeve që kryen dhe përcaktimin e pasojave që rrjedhin nga këto veprime.

Për sa u argumentua, do të ishte në interes të këtyre personave, por edhe të familjarëve të afërt të tyre, që atyre t'iu kufizohej zotësia për të vepruar, çka do të minimizonte mundësinë e kryerjes së veprimeve të rëndësishme juridike, për sa kohë do të duhej pëlqimi paraprak nga kujdestari i tyre, për vlefshmërinë e tyre.

Legjislacioni shqiptar, edhe pse ka parashikuar se vendimet gjyqësore që heqin apo kufizojnë zotësinë për të vepruar iu njoftohet gjykatave dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, me qëllim shënimin e këtij fakti në një regjistër të posaçëm që mbahet prej tyre, nuk parashikon ekzistencën e një regjistri elektronik në nivel kombëtar, i ngjashëm me atë të testamenteve, me qëllim evidentimin e fakteve të tilla, nga personat kompetente që do të kryejnë veprime juridike (noterët) apo procedurale me të (gjykatat, organet publike etj.).

Në mënyrë të përgjithshme, aktet e gjendjes civile shërbejnë për identifikimin e personave fizikë. Ata janë në fakt mjete të identifikimit civil. Në lidhje me këtë qëllim ata karakterizohen nga dy efekte specifike. Aktet e gjendjes civile janë elemente të njohjes publike dhe mjete prove. Këto dy funksione publike vërehen me kalimin e kohës, sepse bëhet fjalë për secilin dhe në vijim të brezave, për njohjen publike dhe provën e ngjarjeve që përcaktojnë ekzistencën. Gjendja civile është në fragmentet e saj kujtesa zyrtare e individëve, e familjeve, e shoqërisë.

Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes plotësohen e pasqyrohen në akte të veçanta, në formë elektronike dhe të printuara vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklaratimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto akte mbahen, për çdo rast, të renditura kronologjikisht.

Ligji për gjendjen civile nuk ka parashikuar situatën e mospranimit të personit që deklaron lindjen për t'i caktuar emrin fëmijës së sapolindur. Edhe pse kjo është një situatë hipotetike që mund të ndodhë shumë rrallë, besoj se ligji duhet t'i njohë të drejtën

nëpunësit të gjendjes civile t'i caktojë emrin fëmijës, në rast refuzimi të personit që deklaroi lindjen.

Ndërsa, në qoftë se, prindërit e fëmijës kanë mbiemra të ndryshëm, nëpunësi i gjendjes civile, duhet të kërkojë nga prindërit që në marrëveshje me shkrim ndërmjet tyre të zgjedhin mbiemrin. Nëse ata nuk e paraqesin në akord të tillë, brenda një afati të arsyeshëm të lënë nga nëpunësi i gjendjes civile, por gjithsesi jo më shumë se afati i përgjithshëm i deklarimit të lindjes, atëherë nëpunësi i gjendjes civile duhet të zbatojë rregullin e përcaktuar në normën lejuese, që fëmija merr mbiemrin e atit, kur prindërit në marrëveshje nuk caktojnë dot se cilin mbiemër të njëjtë do të mbajnë fëmijët e tyre.

Afati i deklarimit të lindjes prej 60 ditësh na duket shumë i gjatë dhe i paargumentuar. Përvoja e shteteve të tjera evropiane tregon se këto afate, me ndonjë përjashtim janë shumë të shkurtër, por që në asnjë rast nuk i tejkalojnë 6 javë (42 ditë). Kështu, ky afat është 3 ditë në Francë, Holandë et Zvicër; 5 ditë në Luksemburg; 1 javë në Gjermani e Austri; 8 ditë në Spanjë; 10 ditë në Greqi e Itali; 15 ditë në Belgjikë; 20 ditë në Portugali; 21 ditë në Skoci dhe 6 javë në Angli, Uells dhe Irlandën e Veriut dhe 30 ditë në Turqi. Lindja e një personi përbën një fakt të rëndësishëm juridik, ku subjektit i lindin të drejta e detyrime, ndaj një regjistrim në afate kohore më optimale, maksimumi 30 ditë, do të kontribuonte në dokumentimin në kohën e duhur të ekzistencës së personit dhe lindjen për të të drejtave subjektive, si p.sh. ajo trashëgimore nga paraardhësit e tij.

Ligji për gjendjen civile nuk ka parashikuar situatën e vendosjes së mbiemrit të fëmijës kur të dy prindërit mbajnë nga dy mbiemra. Ligji për gjendjen civile i vitit 2002, parashikonte se, fëmija mund të mbante dy mbiemra, kur prindërit mbanin mbiemra të ndryshëm, duke i shtuar mbiemri të babait, edhe atë të nënës. Edhe pse ky parashikim u përmbys shpejt nga Kodi i Familjes, që u miratuar një vit më vonë, nuk përjashtohet mundësia që persona që kanë lindur në këtë periudhë kohore të mbajnë dy mbiemra. Po kështu, një pjesë e shtetasve të huaj që marrin shtetasin shqiptarë kanë më shumë se një mbiemër, madje edhe tre. Në këtë rrethana, në rast të martesës së shtetasve me nga dy a më shumë mbiemra, sa mbiemra do të mbajë fëmija, mbiemrin e parë apo të gjithë mbiemrat e babait apo të nënës, sipas zgjedhjes së bërë nga prindërit?

Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes për shtetasit e huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përhershëm në Shqipëri, mbahen në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna ku ato janë të regjistruar ose ku ka ndodhur lindja apo vdekja. Këto akte mbahen nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.

Shqipëria nuk aderon në Komisionin Ndërkombëtar të Gjendjes Civile, që është një organizatë ndërkombëtare ndërshtetërore, me qendër në Strasburg, që ka për objekt të krijojë dhe të mbajë një dokumentacion legjislativ dhe gjyqësor, që pasqyron të drejtën e shteteve anëtare, në lidhje me kushtet e personave, familjes dhe shtetësisë; të mbledhë të dhëna dhe të ndërmarrë studime e punime, me qëllim hartimin rekomandimeve dhe projekt-konventave, me qëllim harmonizimin në këtë fushë të dispozitave në fuqi të shteteve anëtare; kërkimin e mjeteve juridike e teknike për të përmirësuar funksionimin e shërbimeve të gjendjes të shteteve anëtare dhe koordinimi i veprimeve të saj me organizma të tjerë ndërkombëtarë, që merren edhe ata me të drejtën e personave dhe familjes.

Gjykojmë që anëtarësimi në këtë organizëm do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e legjislacionit në fushën e gjendjes civile, përmirësimin e akteve që mbahen nga gjendja civile dhe përfitimi i përvojës nga shtet elitare të Evropës, si Gjermania e Franca.

Në të drejtën civile mbrojtja specifike juridike nuk u dedikohet të gjithë personave por ajo është e destinuar vetëm për një kategori të caktuar personash.

Sipas legjislacionit shqiptar fëmijë konsiderohet qenia njerëzore e lindur gjallë deri në moshën 18 vjeç, moment kur ai fiton zotësi të plotë juridike për të vepruar. Legjislacioni shqiptar është shumë i angazhuar për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre, fakt që e dëshmojnë edhe ligjet e shumta të miratuara në interes të fëmijëve. Baza ligjore mjaft e pasur demonstroi edhe njëherë se ligji shqiptar mbron të gjitha të drejtat e fëmijëve dhe kontribuon në zhvillimin e tyre. Legjislacioni shqiptar, bazuar edhe në aktet e ndryshme ndërkombëtare, merr në mbrojtje dhe kujdes të veçantë të miturit. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si ligj themeltar, kodet e ndryshme dhe aktet e tjera ligjore, në përmbajtje të tyre pranojnë edhe parimet dhe normat e akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve.

Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.

Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar gjykata.

REKOMANDIME:

Së pari, duke u nisur nga ideja se zotësia juridike, e cila është një kusht *sine qua non* e cilësisë të subjektit të së drejtës, rekomandoj që shprehja më e duhur do të ishte “zotësia subjektive”, e cila do t’i jepte identitetin e vërtetë dhe specifikën e duhur përmbajtjes të konceptit që përfaqëson. Megjithatë duhet të pranojmë se në legjislacione të ndryshme, doktrinë dhe jurisprudencë është imponuar shprehja “zotësia juridike” dhe përdorimi i një shprehje tjetër do të jetë një sfidë për të ardhmen, e cila tashmë duhet të mposhtë një “traditë”.

Së dyti, rekomandoj që të shtohet edhe “kufizimi i zotësisë juridike” në të drejtën civile shqiptare, sepse vihet re fakti se ligji nuk përmend në mënyrë afirmative dhe korrekte “kufizimin” e zotësisë juridike (*ashtu sikurse parashikon në rastin e zotësisë për të vepruar*). Është më se e natyrshme se duke rregulluar në rrugë ligjore kufizimin e zotësisë juridike, vetë ligji do të përjashtojë në mënyrë kategorike, variantin e mungesës totale të zotësisë juridike.

Së treti, të parashikohet në ligjin për gjendjen civile, se në rast të një shtatzënie që zgjat mbi 22 javë apo gjer në 28, apo me peshë fetusi mbi 500 gram, të bëhet regjistrimi i fetusit dhe varrimi i tij, nëse prindërit e kërkojnë.

Së katërti, të specifikohet shprehimisht në ligjin për gjendjen civile, rasti i vdekjes së fëmijës, ndërkohë që ende nuk është bërë deklarimi i tij në zyrën kompetente të gjendjes civile, duke përcaktuar se në këtë rast duhet të hartohet si akti i lindjes, ashtu edhe ai i vdekjes, me të gjitha të dhënat e nevojshme.

Së pesti, të parashikohet në ligjin për gjendjen civile regjistrimi i fëmijëve që lindin të vdekur, me kërkesë të prindërve. Një zgjidhje e tillë do të përmbushë ndjenjat afektive dhe kujtimin e prindërve për fëmijën e tyre, duke i shërbyer, njëkohësisht, edhe interesit shtetëror për të përcaktuar shkallën e mortalitetit në lindje.

Së gjashti, në Kodin Civil, të shtohen rastet kufizimit të zotësisë për të vepruar edhe për shkak të moshës së madhe të personit, personave që prishin shumë të holla, atyre që abuzojnë zakonisht me alkoolin apo lëndët narkotike, apo janë shurdhë ose nuk shikojnë që nga lindja ose nga fëmijëria e hershme e tyre.

Së shtati, Kodi Civil të parashikojë një regjistër të posaçëm që mbahet nga Ministria e Drejtësisë, në format elektronik, në nivel kombëtar, i ngjashëm me regjistrin e testamenteve, me qëllim evidentimin e personave që iu janë hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar.

Së teti, Ligji për gjendjen civile të parashikojë situatën e refuzimit të personit që deklaron lindjen për t'i caktuar emrin fëmijës së sapolindur. Në këtë rast ligji duhet t'i njohë të drejtën nëpunësit të gjendjes civile t'i caktojë emrin fëmijës, në rast refuzimi të personit që deklaron lindjen. Të njëjtën të drejtë t'i njohë ligji nëpunësit të gjendjes civile edhe në rast se prindërit kanë mbiemra të ndryshëm, dhe nuk paraqesin përpara tij marrëveshjen me shkrim për zgjedhjen e mbiemrit, duke zbatuar dispozitën ligjore, vendosjen e mbiemrit të të atit.

Së nënti, të reduktohet afati i deklarimit të lindjes nga 60 ditë, në 30 ditë, duke përqaftuar përvojën e shteteve të tjera evropiane, duke kontribuar në dokumentimin në kohën e duhur të ekzistencës së personit dhe lindjen për të, të të drejtave subjektive, si p.sh. ajo trashëgimore.

Së dhjeti, sugjeroj aderimin e Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar të Gjendjes Civile, organizatë ndërkombëtare ndërshtetërore, me qendër në Strasburg, pasi objekti që ka kjo organizatë: të krijojë dhe të mbajë një dokumentacion legjislativ dhe gjyqësor, që pasqyron të drejtën e shteteve anëtare, në lidhje me kushtet e personave, familjes dhe shtetësisë; të mbledhë të dhëna dhe të ndërmarrë studime e punime, me qëllim hartimin rekomandimeve dhe projekt-konventave, me qëllim harmonizimin në këtë fushë të dispozitave në fuqi të shteteve anëtare; kërkimin e mjeteve juridike e teknike për të përmirësuar funksionimin e shërbimeve të gjendjes të shteteve anëtare dhe koordinimi i veprimeve të saj me organizma të tjerë ndërkombëtarë, që merren edhe ata me të drejtën e personave dhe familjes, do t'i shërbejë krijimit të një legjislacioni bashkëkohor dhe përmirësimit të akteve që mbahen nga gjendja civile.

Së njëmbëdhjeti, rekomandoj që në një të ardhme të afërt të hartohet “*Guida e nëpunësit të gjendjes civile të Republikës së Shqipërisë*”. Rekomandoj që në përmbajtjen e kësaj guide të realizohet një trajtim teorik i subjekteve më të rëndësishme të së drejtës familjare dhe propozoj strukturën e mëposhtme:

- *Hyrje;*
- *Organizimi i aktivitetit të gjendjes civile (sistemi i organeve të gjendjes civile dhe atributet e nëpunësve të gjendjes civile);*
- *Hartimi i akteve të gjendjes civile dhe lëshimi i certifikatave të gjendjes civile;*
- *Modifikimi i akteve të gjendjes civile;*
- *Rishkrimi dhe regjistrimi i mëvonshëm i akteve të gjendjes civile;*
- *Anulimi i akteve të gjendjes civile dhe kazuse konkrete për zgjidhjen e të gjitha problemeve të identifikuar nga ana e personave fizikë në lidhje me gjendjen civile.*

Kjo guidë do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e cilësisë të shërbimit të gjendjes civile dhe do të jetë gjithashtu një dokument informues dhe orientues për të gjithë shtetasit të cilët dëshirojnë të zgjidhin problemet e konstatuara.

Së dymbëdhjeti, rekomandoj rregullimin më të detajuar ligjor të bashkëjetesës, ku partnerët të kenë të njëjtat të drejta sikurse edhe bashkëshortët. Bashkëjetesa dallon edhe nga fejesa, e cila është “një premtim për martesë”. Bashkëjetesa nuk është rregulluar

plotësisht ligjërish në Shqipëri. Sipas nenit 163, të Kodit të Familjes: *“Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”* dhe sipas nenit 164 *“Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës”*.

Këto konsiderata nuk paraqesin një bazë ligjore të qartë për bashkëjetuesit në krahasim me legjislacionet e huaja të cilat trajtojnë gjerësisht këtë bashkim civil. Nga ana tjetër, Shqipëria gjithashtu nuk njeh bashkimet civile të cilat janë kryer nëpërmjet kontratave nga shtetas shqiptarë ose shtetas të huaj. Ekzistojnë vende të Bashkimit Evropian të cilat i njohin efektet juridike të bashkimeve ose partneriteteve civile. Në këtë këndvështrim, vendi ynë nuk ka ndërmarrë asnjë nismë legjislative dhe kjo ndoshta edhe për vetë arsye se Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk imponon adoptimin e këtij kuadri legjislativ.

Në rastin e lidhjes së martesës ekzistojnë më shumë avantazhe juridike për bashkëshortët, avantazhe të cilat nuk i kanë personat që bashkëjetojnë. Por të mos harrojmë se martesë vjen së bashku me një paketë detyrimesh duke mënjanuar bashkimin të bazuar mbi dashuri ose afekcion dhe duke i dhënë prioritet një bashkimi të interesave të bashkëshortëve, pra më konkretisht duke e transformuar martesën në një biznes.

Në rastin e bashkëjetesës, praktikisht, bashkimi i interesave nuk qëndron. Me fjalë të tjera bashkëjetuesit nuk kanë të drejta dhe detyrime reciproke. Ata nuk janë të detyruar që të deklarojnë vlerën reale të pagave të tyre dhe të gjitha sendet e blera i përkasin personit, i cili i ka blerë ato. Në qoftë se një nga bashkëjetuesit është pronari i apartamenti, atëherë ai mund të hipotekojë këtë apartament pa pëlqimin e partnerit tjetër.

Argumentet e paraqitura krijojnë një ide që rregullimi ligjor i bashkëjetesës duhet të ketë të vetmin qëllim atë, të mbrojtjes të personave të cilët bashkëjetojnë dhe të interesave të tyre.

BIBLIOGRAFIA: (LITERATURA)

1. Sambrian, Teodor., *Iustiniani Digesta, Liber Primus*, Editura Universitaria, Krajovë, 2002.
2. Hanga, Vladimir., *Drept privat roman*, E.D.P., Bukuresht, 1978.
3. Dogaru Ion. Cercel, Sevastian, *Drept civil, Persoanele*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2007.
4. Tsitso, Niko. “*Elementa të së drejtës të personave dhe të familjes*”, Shtypëshkronja “Dhori Koti”, Korçë, 1933.
5. Dogaru Ion, Draghici Pompil, *Bazele dreptului civil, Volumul III, Teoria generala a obligatorit*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2009.
6. Beleiu Gheorghe, *Drept civil, Persoanele*, Bukuresht, 1982.
7. Dogaru, Ion. *Teoria generalë a dreptului*, Editura Sitech, Krajovë, 1998.
8. Popa, Nicolae. *Teoria generalë a dreptului*, Editura Actami, Bukuresht, 1998.
9. Dogaru, Ion. Dănișor D.C. Dănișor Gh., *Teoria generalë a dreptului*, Editura Științifică, Bukuresht 1999.
10. Nuni, Ardian. *Hyrje në të drejtën civile*, Botimet Morava, Tiranë 2006.
11. Malaurie, Ph. Aynes, L. *Droit civil. Les Personnes*. Defrenois, Paris, 2003.
12. Pop, Teofil. *Drept civil român. Persoanele fizice și Persoanele juridice.*, Editura Lumina Lex, Bukuresht, 1994.
13. Negrea, C. *Dreptul civil, vol I, fasc.I*, Tipografia Bernat, Cluj, 1920.
14. Castaing, Zenati, A-F., *Manuel de droit des personnes*, PUF, Paris, 2006.
15. Stătescu, C. *Drept civil. Contractul de transport. Dreptul de creație intelektualë*, E. D. P., Bukuresht, 1967.
16. Dogaru, Ion. *Valențele juridice ale voinței*, Editura Științifică și Enciclopedică, Bukuresht, 1996.
17. Filipescu P., Ion. *Drept civil. Dreptul de proprietate și alte drepturi reale*. Editura Actami, Bukuresht, 1998.
18. Laurent, François. “*Principes de droit civil français*”, vol I, Paris, ed. a III-a, 1878.
19. Cornu, Gerard. *Droit civil, Les personnes*, 13 edition, Montchrestien, 2007.
20. Chelaru, Eugen, *Curs de drept civil. Drepturile reale principale*, Editura All Beck, Bukuresht, 2000.
21. Hanga, Vladimir. *Principiile dreptului privat român*, Editura Dacia, Cluj-Napoca, 1989.
22. Kondili, Valentina. *E Drejta Civile I*, Geer, Tiranë, 2008.
23. Boroi, G. *Drept civil. Partea generalë. Persoanele*, Editura All Beck, Bukuresht, 2001.
24. Beleiu Gh. *Drept civil român. Introducere în dreptul civil. Subiectele dreptului civil, ediția a VII-a revizuită și adăugită de Marian Nicolae, P. Trușcă*, Ed. Universul Juridic, Bukuresht, 2001.
25. Bihr, Ph. *Droit civil general*, 13 edition, Dalloz, Paris, 2000.
26. Latifi, Juliana. *E Drejta Civile*, Shtëpia Botuese ILAR, Tiranë 2001.

27. Terre, F. Fenouillet, D. *Droit civil, Les personnes. La famille. Les incapacités*, Dalloz, 1996.
28. Kadriu, Osman. *Hyrje në të drejtën civile*, Tringa Disign, Tetovë, 2008.
29. Meksi, Sokrat. Çipi, Bardhyl. *Mjekësia Ligjore*, Shtëpia Botuese “Arbëria”, Tiranë.
30. Galgano, Francesco., *E drejta private.*; Shtëpia Botuese “Luarasi”, Tiranë, 1999.
31. Costin M.N., *Marile Instituții ale dreptului civil român, vol I-III, Persoana fizică și persoana juridică*, Ed. Dacia, Cluj Napoca, 1983-1984.
32. Kalia, Ardian. *E Drejta Ndërkombëtare Private*, Shtëpia Botuese, Flesh, Tiranë, 2010.
33. Dimitrescu, Gr., *Drept roman. Obligațiuni, succesiuni*, Bukuresht, 1936.
34. Cercel, S. *Drept civil. Patrimoniul. Poesia. Proprietatea*, Editura Universitaria, Krajovë, 2002.
35. Petit, B. *Introduction general au droit, sixième édition*, Presses universitaires de Grenoble, 2006, f. 112.
36. Nedelcu, Iulian. *Drept Administrativ si elemente de stiinta administratiei*, Universul Juridic, Bukuresht, 2009, f. 243.
37. Ikonomi, Luljeta, *Filozofia e së Drejtës*, Shtëpia Botuese Onufri, Tiranë, 2010.
38. Elezi, Ismet. Kaçupi, Skënder. Haxhia, Maksim, *Komentari i Kodit Penal së Republikës së Shqipërisë*, Shtëpia Botuese West Print, Tiranë 2009.
39. Urs I. , Angheni S. *Drept civil. Partea generală. Persoanele*, vol. I, Ed. Oscar Print, Bukuresht 1999.
40. Deak, Fr. *Drept civil. Contracte speciale*, Editura Actami, Bukuresht, 1996, f. 23-25.
41. Dogaru, Ion. Draghici, Pompil. *Bazele dreptului civil, Volumul III, Teoria generala a obligatilor*, Editura C.H. Beck, Bukuresht, 2009.
42. Gutmann, Daniel;. *E Drejta Ndërkombëtare Private*, Botimet Papyrus, Tiranë, 2015.
43. Filipescu, I. P., *Drept civil. Dreptul de proprietate și alte drepturi reale*, Editura Actami, Bukuresht, 1998.
44. Cârperaru, St., *Drept civil. Contractul de transport. Drepturile de creație intelectuală. Succesiunile*. Editura Didactică și Pedagogică, Bukuresht, 1971.
45. Buse, Ionel. *Filosofie*, Editura Universitaria, Krajovë 2012.
46. Malaurie, Ph., Aynes, L., *Droit civil. Les Personnes. Les incapacites*, ed.a 5-a, Ed. Cujas, Paris, 1999.
47. Ilia, Bledar, *Statul ca Subiect al Dreptului de Proprietate Publica*, Editura Privirea, Bukuresht, 2010.
48. Çipi, Bardhyl. *Identifikimi i Personit*, ShBLU, Tiranë, 2011.
49. Dumitrescu, M. A., *Manual de drept roman*, Bukuresht, 1920.
50. Alexandresco, D., *Explicațiunea teoretică și practică a dreptului civil român. Partea I. Donațiunile între vii*, tomul IV, Bukuresht, 1913.
51. F. Polluauud – Dulian, “*L’utilisation du nom patronimique comme nom commercial*”, J.C.P 1992. I. 3618.
52. Cayser, P. “*La défense du nom d’après la jurisprudence civile et d’après la jurisprudence administrative*”, RTD civ., 1959.10.

53. Handbooks on Civil Registration and Vital Statistics Systems, Policies and Protocols for the Release and Archiving of Individual Records', Series F, No. 70, United Nations, New York, 1998.
54. Dobjani, Ermir. *E Drejta Administrative I*, Shtypshkronja "Perlat Voshtina", Tiranë 2007, f. 247.
55. *Guide pratique internationale de l'état civil*, botimi Berger – Levrault, Paris.
56. Omari, Sonila, *E Drejta Familjare*, Tiranë, 2007.
57. Popa Nicolae, *Teoria generală a dreptului*, Editura Actami, Bukuresht, 1998.
58. Urs I. , Angheni S. , *Drept civil. Partea generală. Persoanele*, vol. I, Ed. Oscar Print, Bukuresht 1999.

LEGJISLACION:

1. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
2. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë;
3. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë;
4. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë;
5. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;
6. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
7. Kodi i Mbretërisë Shqiptare, i vitit 1928;
8. Ligji mbi aplikimin e Kodit Civil të vitit 1928;
9. Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqipëtare;
10. Shtojca e Dytë e Procedurës Civile;
11. Ligji për aktet e gjendjes civile i datës 24 Maj 1929;
12. Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë;
13. Ligji nr. 6340, datë 26.6.1981 "Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
14. Ligji nr. 2022, datë 2.4.1955 "Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil";
15. Ligji nr. 2023, date 2.4.1955 "Mbi dispozitat zbatuese të pjesës së përgjithshme të Kodit Civil";
16. Ligji Nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për Gjendjen Civile", së bashku me ndryshimet e pësuara;
17. Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 5591, datë 15.06.1977 dhe ndryshuar me ligjin 6300, datë 27.03.1981;
18. Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.06.1981;
19. Kodi i Punës të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 6200, datë 28.06.1980, ndryshuar me ligjin nr. 6342 datë 27.06.1981;
20. Kodi i Procedurës Civile i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 6341, datë 27.06.1981;
21. Kodi i Familjes i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 6599, datë 29.06.1982;
22. Ligji nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor";
23. Ligji rumun i akteve të gjendjes civile i datës 11 korrik 1913;
24. Kodi Civil i Mbretërisë së Spanjës;
25. Ligji Nr. 7650, date 17.12.1992 "Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj

- dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”;
26. Ligji 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;
 27. Ligji Nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”;
 28. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
 29. Ligji nr. 8417, datë 22.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”
 30. Kodit Civil i Serbisë i vitit 1844;
 31. Kodi Civil i Etiopisë;
 32. Kodi i vjetër civil rumun Calimach;
 33. Kodi Civil i Gjermanisë;
 34. Kodi Civil i Greqisë;
 35. Ligj nr. 9109, datë 17.7.2003, “Për profesionin e avokatisë në Republikën e Shqipërisë”;
 36. Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
 37. Ligji nr. 8389, datë 05.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”;
 38. Ligji nr. 7650, datë 17.12.1992 “Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”;
 39. Ligji Nr. 8528, 23.09.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”;
 40. Ligji Nr. 8045, datë 07.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzanisë”;
 41. Ligji Nr. 7650, datë 17.12.1992 “ Për birësimin e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e Familjes”;
 42. Ligji 8410 datë 30,09.1998 “Për radio televizionin publik e privat”;
 43. Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtat e informimit për dokumentat zyrtare”;
 44. Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”;
 45. Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”;
 46. Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar”;
 47. Ligji nr. 8465, datë 11.03.1999 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve”;
 48. Ligji nr. 8496, datë 03.06.1999, për ratifikimin e “Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve”;
 49. Ligji nr. 8092, datë 21.03.1996 “Për shëndetin mendor”;
 50. Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërve”;
 51. Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”;
 52. Ligji nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”;
 53. Ligji nr. 17/2018 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”ë
 54. Udhëzim Nr. 91, datë 2.4.2014 “Për rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave të konsideruar të papërshtatshëm dhe të atyre me rëndësi historike, të familjeve të shquara në shkallë kombëtare, apo të mirënjohura në bashkinë/komunën, ku ka vendbanimin personi i interesuar”;
 55. Dekreti nr. 2450, datë 27.05.1957 “Për përgjegjësinë e prindërve për sjellje të këqija të fëmijëve dhe mbi masat për edukimin e tyre”, ndryshuar me Dekretin Nr. 7441, datë 1.12.1990;
 56. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 28.05.1999;
 57. Dekreti nr. 2450, datë 27.05.1957 “Për përgjegjësinë e prindërve për sjellje të

- këqija të fëmijëve dhe mbi masat për edukimin e tyre”;Udhëzimi nr. 13, datë 19.12.2002 për “Procedurën për ndryshimit e emrit dhe të mbiemrit”;
58. Udhëzimi nr. 481, datë 05.09.2013 “Për procedurat e korigjimit të emrit/mbiemrit si korigjim material”;
 59. Udhëzimi i Ministrit të Rendit Publik (Nr. 3583 date 27.11.2001) dhe Ministrit të Punëve të Jashtme (nr. 6252 date 10.12.2001) “Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare”;
 60. Udhëzimi nr. 90, datë 2.4.2014 “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së shpalljes, për kërkesën e ndryshimit të emrit/mbiemrit”;
 61. Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Rendit Publik (nr. 925 date 03.03.1999), Ministrit të Punëve të Jashtme (nr. 337/1 date 08.03.1999) , Ministrit të Drejtësisë (nr. 782/1 datë 25.03.1999) dhe Ministrit të Financave (nr. 583/3 datë 05.03.1999) “Për procedurat që ndiqen për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim”.

MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
3. Pakti Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut;
4. Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike të Njeriut;
5. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989
6. Konventa e Hagës e datës 29 maj 1993 mbi Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimit në respekt të adoptimit ndërshtetëror;
7. Konventa Evropiane për Televizionin Ndërkufitar;
8. Konventa mbi Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave;

JURISPRUDENCË SHQIPTARE

1. Vendimi nr. 52, datë 01.12.2011 i Gjykatës Kushtetuese.
2. Vendimi nr. 30, datë 28.01.1999, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë
3. Vendimi nr. 350, datë 25.02.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit
4. Vendimi nr. 1997 (1924), datë 04.05.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit
5. Vendimi nr. 739, datë 20.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Lezhë.
6. Vendimi nr. 253, datë 18.12.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tropojë.
7. Vendimi nr. 1504, datë 30.11.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër.
8. Vendimi nr. 992, datë 19.07.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

FAQE INTERNETI

1. http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf
2. www.ciecl.org
3. <http://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/sq/al/al068sq>
4. www.syri.net
5. www.femijet.gov.al
6. <http://www.gjykataelarte.gov.al/>

7. <http://www.gjk.gov.al/>
8. <http://www.shqiperia.com/kategori/kat/knr/998/Gjendja-Civile>
9. <http://www.president.al/>
10. http://www.mb.gov.al/files/programs_files/14-09-10-10-12-20shtetesia_shqiptare.pdf
11. <https://www.universuljuridic.ro/>
12. www.beck.ro
13. <http://drept.ucv.ro>
14. <http://www.starecivila1.ro/transcriere-acte/>
15. <https://www.linguee.com/english-greek/translation/civil+status.html>
16. <http://www.wordreference.com/engr/marital%20status>
17. https://fr.wikipedia.org/wiki/Droit_civil_en_France
18. <https://www.service-public.fr/particuliers/vosdroits/N359>
19. <https://www.jura.ch/DIN/SPOP/Etat-civil/Mariage/Procedure/Procedure-du-mariage.html>
20. http://ec.Evropa.eu/eurostat/statisticsexplained/index.php/Marriages_and_births_in_Spain
21. <http://www.konitsa.gr/documents/lexiarceio-2/3-lexiarceike-praxe-gennese>
22. <https://www.parajurist.md/rom/cum-se-stabileste-numele-de-familie-la-incheierea-casatoriei/>